



ISBN 978-9928-210-05-0

ISSN 2413-1334

Konferenca e II-të Shkencore Ndërkombëtare

VËLLIMI I PARË



# Policimi dhe **SIGURIA**

Shkencat ligjore dhe sfidat  
bashkëkohore të sigurisë

NËNTOR  
2017

PROCEEDINGS  
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2017



**POLICIMI DHE SIGURIA**  
**AKADEMIA E SIGURISË**

POLICIMI DHE SIGURIA

Shkencat ligjore dhe sfidat  
bashkëkohore të sigurisë

---

PROCEEDINGS

---

*Vëllimi I*

© - **Akademia e Sigurisë, Tiranë.**

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të këtij botimi, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

**Akademia e Sigurisë**

Shkencaat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë :  
konferenca 2-të ndërkombëtare : Tiranë, nëntor 2017 :  
proceedings / Akademia e Sigurisë. - Tiranë : Akademia  
e Sigurisë, 2017

Vol. 1 ; 203 f. ; 16.5 X 24cm.

ISBN 978-9928-210-05-0

1.Policia 2.Siguria kombëtare 3.Kriminologjia  
4.Bashkimi ndërkombëtar 5.Konferenca

351.74 (062)

343.9 (062)

NR **8**  
NËNTOR  
**2017**

## **BORDI EDITORIAL**

### **Kryetari i Bordit**

Dr. Xhavit SHALA

### **Anëtarët e Bordit**

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Sebastiano TAFARO

Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Fatmir TARTALE

Dr. Frank HARRIS

### **Redaktor shkencor**

Albert HITOALIAJ

### **Përkthyes**

Vangjel LILI  
Lavdim KAZAZI

### **Punimet grafike**

Andi OSMANI

### **Realizimi teknik**

Qendra Kërkimore Shkencore,  
Akademia e Sigurisë

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë"

## Bordi Shkencor/ Scientific Committee

### Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Giovanni **ARCUDI**, Universiteti i Romës "Tor Vergata"

### Anëtarët/Members

Prof. Dr. Ismet **ELEZI**, Kriminolog  
Prof. Ali **CHADLY**, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë në Monastir (Tunizi)  
Prof. Dr. Irakli **KOCOLLARI**, Rektor i Universitetit "Akademia Profesionale e Biznesit"  
Prof. Dr. Sebastiano **TAFARO**, Universiteti i Barit  
Prof. Dr. Ilirjan **MANDRO**, Akademia e Sigurisë, Tiranë  
Prof. Asc. Rauf **DIMNAJ**, Zv. Minister i Arsimit dhe Sporteve  
Prof. Asc. Ferdinand **ELEZI**, Prokuroria e Apelit Durrës  
Prof. Asc. Nikola **DUJOVSKI**, Fakulteti i Sigurisë, Shkup  
Prof. Asc. Luan **VELICOTI**, Kolegji Universitar "Luarasi" Tiranë  
Dr. Blerim **OLLURI**, Kryeshef Ekzektiv i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë  
Dr. Frenk **HARIS**, MSc, D.Crim.J., University of Portsmouth  
Dr. Sandër **LLESHI**, Këshilltar për Sigurinë, Këshilli i Ministrave  
Dr. Bilbil **MEMAJ**, Rektor/Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Tiranë  
Dr. Xhavit **SHALA**, Akademia e Sigurisë, Tiranë  
Dr. Artur **BEU**, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit  
Dr. Admir **SINAMATI**, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Tiranë  
z. Ismail **SMAKIQI**, Drejtor i Akademisë së Sigurisë, Kosovë

## Komiteti organizator/Organizational committee

Drejtuues i Lartë Dr. Bilbil **MEMAJ**, Drejtori i Akademisë së Sigurisë, Tiranë  
Drejtuues Dr. Xhavit **SHALA**, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë, Tiranë  
Drejtuues Msc. Xhevahir **ÇELOALIAJ**, Drejtor i Institutit të Policisë Shkencore  
Kryekomisar Msc. Bilbil **DERVISHI**, QKSH, Akademia e Sigurisë  
Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Redaktor shkencor, Akademia e Sigurisë Tiranë.

## Sekretariati dhe koordinimi/secretariat and coordination

Dr. Irvin FANIKO, Shef i Sektorit të Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë Tiranë, (përgjegjës)  
Msc. Anisa AGASTRA, Sektori i Kërkimeve Shkencore, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (koordinatore e konferencës)  
Andi OSMANI, Sektori i Botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë (anëtar)

## Redaktor Shkencor

Dr. (proc.) Albert **HITOALIAJ**, Akademia e Sigurisë, Tiranë

### Punimet grafike

Andi Osmani

### Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2017

# Përmbajtja

## Sesioni I/First Section

### Aspektet gjithëpërfshirëse të disiplinave forenzike: impakti në sigurinë publike

#### Fjalët përshëndetëse

##### **Kryeministri Edi RAMA**

Akademia e Sigurisë, aktor i rëndësishëm në sfidat bashkëkohore të sigurisë ..... i

##### **Ministri i Brendshëm Fatmir XHAFAJ**

Reformimi i Akademisë së Sigurisë, rritja e cilësisë së programeve dhe e nivelit profesional, - prioritet i veçantë, i Ministrisë së Brendshme ..... v

##### **Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë, Dr. Bilbil Memaj**

Vetëm duke zhvilluar shkencën dhe dijen, zhvillojmë një forcë policore, që mund të shndërrojë sistemin..... ix

#### Punimet e konferencës

##### **Dr. Sc. Blerim OLLURI**

Shkenca e forenzikës në shtetin e ri të Kosovës.....14

##### **Prof. Asc. Dr. Snezana MOJOSKA dhe Prof. Asc. Dr. Nikola DUJOVSKI**

Financial forensic (audit and accounting) .....30

##### **Dr. Xhavit SHALA**

Shkencat ligjore shqiptare, mes veprimtarisë tradicionale dhe konceptit të ri të inteligjencës forenzike.....42

##### **Dr. Bajram IBRAJ**

Sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri.....56

##### **Dr. Admir SINAMATI, Prof. Dr. Bardhyl ÇIPI**

Ekspertimi mjekoligjor dhe sfidat aktuale ndaj terrorizmit.....68

##### **MSc. Nikoll RICA, MSc. Erand RICA**

Të drejtat dhe garancitë procedurale së të miturit në konflikt me ligjin.....80

<b>Dr. Elmas SHAQIRI</b> Procedura në praktikën juridike në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me praktikën për trajtimin e rasteve të shkeljeve mjekësore. ....	96
<b>Dr. Artur BEU, Doc. Dr. Arjana NEPRAVISHTA</b> Teknologjia në mbështetje të dokumentimit ligjor të luftës kundër kultivimit të kanabisit. Rasti studimor i Shqipërisë. ....	106
<b>MSc. Ajdin MBORJA</b> Roli i inteligjencës kriminalistike. ....	118
<b>Dr. Xhevdet KOPANI</b> Auditimi i jakave të bardha, një mundësi më shumë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. ....	128
<b>Dr. Sc. Xhemaj ADEMAJ, Dr. Sc. Blerim OLLURI, MSc. Sokol DEDAJ</b> Ekspertiza e ADN-së, roli i saj në procedurën penale. ....	140
<b>MSc. Ilia NASI, MSc. Skender KALEMI</b> Hartimi e zbatimi i programeve bashkëkohore, në luftën kundër kriminalitetit. ....	152
<b>MSc. Anisa AGASTRA, Dr. Silvana IBRAHIMI, Cav. Dr. Ervin IBRAHIMI</b> Profilet psikologjike: domosdoshmëri për hetimin. ....	160
<b>Dr. (proc.) Adriana ZOTAJ, Dr. (proc.) Aulona ZOTAJ</b> Sistemi i drejtësisë, reformimi dhe lufta ndaj korrupsionit, garanci e funksionimit të shtetit të së drejtës. ....	174
<b>MSc. Valeria BARDHAJ</b> Sfidat dhe mundësitë, në epokën e re të optimizimit të reformave kërkimore, dhe në shkencat ligjore. ....	182
<b>Abstraktet në anglisht / Abstracts. ....</b>	192





## **AKADEMIA E SIGURISË**

KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, nëntor 2017, Tiranë

Në bashkëpunim me Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore Tiranë, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Fakultetin e Sigurisë në Shkup, Universitetin e Barit dhe Fakultetin e Mjekësisë në Monastir (Tunizi), Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia e Forenzikës së Kosovës

SHKENCAT LIGJORE DHE SFIDAT BASHKËKOHORE TË SIGURISË  
FORENSIC SCIENCES AND CONTEMPORARY SECURITY CHALLENGE

## KONFERENCA E II-të SHKENCORE NDËRKOMBËTARE Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë Nëntor 2017, Tiranë

### Fokusi i konferencës

Në format e tij bashkëkohore, kriminaliteti përbën sot një faktor me ndikim në rritje në mjedisin e sotëm strategjik e të sigurisë, i cili karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga të panjohura dhe nga mundësitë e zhvillimeve krejtësisht të paparashikueshme. Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit adekuat të rreziqeve të ardhshme, i detyron strukturat e sigurisë që të orientohen drejt krijimit të kapaciteteve polivalente, të cilat duhet të jenë të afta që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura.

Përmirësimi i sundimit të ligjit, përbën për ne një domosdoshmëri strategjike dhe kjo, ndërmjet të tjerave, kërkon fuqizimin dhe modernizimin e Policisë së Shtetit, përmes përmirësimit të kapaciteteve të hetimit dhe informacionit, me qëllim rritjen e kontrollit mbi territorin dhe përmirësimin e aftësive parandaluese dhe goditëse ndaj krimit. Gjithashtu, ngritja e kapaciteteve të agjencive të zbatimit të ligjit, për të siguruar zbatimin e rreptë të ligjit, është prioritet i adresuar në “Planin kombëtar për integrimin evropian 2016-2020” dhe planin e veprimit në zbatim të tij. Problematika e kriminalitetit dhe procesi i hetimit rreth zbulimit, analizimit, masave dhe mënyrave të parandalimit, kërkon sofistikim të fushave specifike të shkencave ligjore, që përfshin aplikimin e metodave shkencore për të zgjidhur problemet që lidhen me ligjin, hetimin, mënyrat apo mjetet e përdorura. Ndërmarrja e projekteve, studimeve e kërkimeve në fushën e shkencave ligjore, përfshin aplikimet shkencore, punimet, trajnimet, studimet dhe analizat e thelluara, lidhur me fusha të ndryshme të shkencave ligjore, në kuadër të zhvillimit

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

dhe përmirësimit të këtyre shkencave, përmirësimit të punës së punonjësve e profesionistëve, të gjetjes së formave të reja, të metodave shkencore e teknologjike të zbulimit e hetimit të krimit, të rishikimit e ndikimit të tyre në aspektin ligjor e më gjerë, rritjen e efikasitetit dhe besueshmërisë së testeve dhe intervistimeve profesionale, etj., në kuadër të ndërtimit të strategjive të nevojshme të identifikimit, trajtimit dhe parandalimit të krimit. Kjo konferencë, shërben në kuadrin shkencor, për të ndihmuar institucionet, programet, agjencitë, individët, ekspertët, për të bashkëpunuar dhe për të ndarë burimet, informacionet dhe ekspertizën në lidhje me shkencat ligjore, aplikimin dhe rëndësinë e tyre, me në fokus krijimin e mundësive për rrjetëzim, bashkëpunim dhe këmbim të ideve me udhëheqës, profesionistë, ekspertë e studiues në nivel kombëtar e ndërkombëtar për përmirësimin, sofistikimin e zbulimin e metodave e mënyrave për hetimin e krimit dhe impaktin në sigurinë publike.

### **Objekti i konferencës**

Objekti i konferencës është trajtimi në mënyrë gjithëpërfshirëse nga disiplina të ndryshme të shkencave ligjore, nëpërmjet punimeve të mirëfillta shkencore në nivel të gjerë kombëtar e ndërkombëtar, i rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga kriminaliteti bashkëkohor, përgjithësimi i përvojës më të mirë, zgjerimi i dijeve aplikative, dhënia e rekomandimeve për hartimin e politikave për përmirësimin e punës në shërbim të një policimi më efektiv.

### **Qëllimi i konferencës**

Qëllimi i konferencës është mbledhja, përpunimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar shkencor të fushës së shkencave ligjore, për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor; trajtimi në këndvështrim analitik e në mënyrë shkencore të aplikimit të disiplinave të ndryshme të shkencave ligjore në hetimin e krimeve në Shqipëri, në aspektin ligjor e më gjerë, në varësi të fushave specifike e profesionale, kontributit dhe rëndësisë së tyre në punën e punonjësve të policisë e më gjerë; evidentimi i problematikave dhe nevojave për përmirësimin e punës nëpërmjet zhvillimit të dijeve, teknikave të reja e modeleve të përparuar të këtyre disiplinave, përballë sfidave të kriminalitetit bashkëkohor.

### **Synimi i konferencës**

Kjo konferencë synoi të bashkojë njëzëri akademikë, shkencëtarë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të shkencave ligjore, për të ndarë eksperiencat, praktikat, punimet shkencore dhe gjetjet, për të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të forensikës në raport me sfidat bashkëkohore të sigurisë.

### **Tipi i konferencës**

Konferenca është shkencore ndërkombëtare, në një auditor me staf akademik të Akademisë së Sigurisë, studiues dhe ekspertë vendas dhe të huaj të çështjeve të sigurisë, drejtues dhe specialistë të strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive të tjera ligjzbatuese, përfaqësues të misionëve policore që asistojnë Policinë e Shtetit, përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve e universiteteve policore partnere të huaja.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

## Struktura e konferencës

### Sesioni I

Aspektet gjithëpërfshirëse të disiplinave forensike; impakti në sigurinë publike dhe në arsim, me nënçështje si:

- Praktikimi i shkencave ligjore në mjediset sfiduese: perspektivat ndërkombëtare.
- Sfidat dhe mundësitë në epokën e re të optimizimit të reformave kërkimore në shkencat ligjore.
- Shkencat ligjore në Shqipëri – perspektiva e zhvillimit të tyre.
- Hulumtime mbi kuptimin, saktësinë, besueshmërinë dhe matjen e vlefshmërisë të disiplinave të shkencave ligjore.
- Trajtim në aspektin ekonomik dhe të fondeve mbi kërkimin, zhvillimin dhe vlerësimin e shkencave ligjore.
- Këndvështrim mjekoligjor i zhvillimit të hetimit në skenën e krimit: metodat, identifikimi, zbulimi, interpretimi dhe evidentimi i problematikave.
- Aplikimi i disiplinave të shkencave ligjore për qëllimet e drejtësisë penale: ligjet civile dhe penale.
- Hulumtime dhe zhvillime për laboratorët e financuar nga burimet e shkencës ligjore për të vlerësuar testimin dhe përpunimin e dëshmimeve fizike.
- Studime rasti: menaxhimi dhe qasjet e suksesshme bashkëpunuese dhe multidisiplinare, për hetimin e vrasjeve të profilit të lartë dhe komplekse.
- Gabimet e sistemit të drejtësisë dhe bindjet e gabuara.
- Sfida e policisë: identifikimi i substancave që mund të jenë lloje të ndryshme drogash të palejueshme nën metodologjinë që ofron forensika.
- Efikasiteti i testeve dhe intervistave më profesionale në fushën e forensikës, përballë vështirësisë dhe nevojës për identifikim.
- Analizë e thelluar mbi programin arsimor e trajnues në lidhje me ekspertizën e disiplinave të ndryshme të forensikës.
- Diapazoni i shkencave ligjore dhe kërkimet kriminale në policinë shqiptare dhe në policitë e vendeve fqinje.
- Aspekte ligjore në lidhje me forensikën në Shqipëri: modele praktikash.

### Sesioni II

Këndvështrime profesionale të shkencave forensike në hetimin e skenës së krimit, në aspektin ligjor e më gjerë, me nënçështje si:

- Evidencat forensike për marrjen e gjurmëve të gishtave: hulumtime dhe propozime.
- Analiza dhe interpretime për mënyrën e mbledhjes së provave dhe të dhënave në procesin e hetimit: metoda dhe mënyra të reja për përmirësimin e procesit.
- Analizë Instrumentale për aplikime të shkencave ligjore: niveli i efektivitetit në procesin e hetimit dhe në punën e punonjësit të policisë.
- Kriminialistika dhe kontributi i saj në këqyrjen e vendit të ngjarjes.
- Aspektet mjekoligjore të dëmtimeve: diagnoza specifike dhe studime rasti.
- Niveli i zhvillimit të entomologjisë ligjore në Shqipëri dhe matja e kohës që ka kaluar nga vdekja e trupit të viktimës.
- Këndvështrim analitik e krahasues i procedimit me dokumentacionin: organizimi, mbledhja, interpretimi i të dhënave dhe sfidat.

- Prezantimi i modeleve të dëshmimeve në sistemin gjyqësor: roli i ekspertizës forensike në organizimin dhe interpretimin e të dhënave.
- Hulumtime biometrike dhe analizë e ADN-së për identifikimin e burimeve të kampionit: rastet e pazgjidhura dhe ato të pasdënimit.
- Rëndësia e ndërtimit të profilit fizik e psikologjik të autorit e viktimës: këndvështrim nga psikologjia forensike.
- Perspektiva e balistikës kriminalistike në nivel kombëtar e ndërkombëtar.
- Aspektet forensike të çështjeve të migrimin.
- Teknologjitë e reja në fushën e forensikës, provat digjitale dhe krimet kibernetike.
- Droga të reja, çështje të reja, metoda të reja doping.
- Dhuna ndaj grave dhe personat vulnerabël.
- Terrorizmi dhe konfliktet e armatosura.
- Integrimi i provave forensike në hetimet nga oficerët e policisë: kujdesi në paraburgim.
- Zbatimi i metodave dhe teknikave të reja bashkëkohore në ekspertim në prova shkencore, procesin penal dhe civil.

### **Pjesëmarrja në konferencë**


Pjesëmarrja ishte ftesë e hapur, për stafin akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe nga vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare, partnere të Policisë së Shtetit etj.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# Akademia e Sigurisë, aktor i rëndësishëm në sfidat bashkëkohore të sigurisë



**Edi RAMA**

KRYEMINISTËR\*



Roli që po merr përditë e më tepër Akademia e Sigurisë në funksion të rritjes së kapaciteteve në këtë fushë është vërtetë kyç dhe rëndësia e vendimit për t'i kthyer Policisë së Shtetit, Akademinë e saj, në vitin 2015, pas 7 vitesh mungese të pashpjegueshme, provohet përditë e më tepër në cilësinë e re dhe efektivitetin në rritje të policimit në çdo skaj të vendit. Unë jam shumë mirënjohës, shumë sinqerisht, të gjithë pedagogëve dhe pedagogeve të kësaj Akademie për rilindjen e një vatre kaq të rëndësishme, saç është kjo Akademi, në funksion të rritjes të një gjenerate tjetër kuadros të Policisë së Shtetit, korrektesa e sjelljes dhe profesionalizimi i të cilëve janë një domosdoshmëri e vazhdueshme për Policinë e Shtetit. E pa asnjë diskutim, ne të gjithë shohim me kënaqësi përparimet në këtë aspekt dhe presim me padurim brezat e rinj të Akademisë të Sigurisë, që t'i bashkëngjiten përpjekjes në terren të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit.

## AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

\*Fjala e Kryeministrit Edi Rama, në konferencën e dytë shkencore ndërkombëtare, "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë", organizuar nga Akademia e Sigurisë.

*Shumë të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë të dytë ndërkombëtare të organizuar nga Akademia e Sigurisë!  
Ju falënderoj për ftesën!*

**D**ua ta nis me premisën e qartë se lufta kundër krimit është një luftë që në radhë të parë zhvillohet në fushën e inteligjencës së mirëfilltë, në kuptimin e mendjes. Roli që po merr përditë e më tepër Akademia e Sigurisë në funksion të rritjes së kapaciteteve në këtë fushë është vërtetë kyç dhe rëndësia e vendimit për t'i kthyer Policisë së Shtetit, Akademinë e saj, në vitin 2015, pas 7 vitesh mungese të pashpjegueshme, provohet përditë e më tepër në cilësinë e re dhe efektivitetin në rritje të policimit në çdo skaj të vendit. Unë jam shumë mirënjohës, shumë sinqerisht, të gjithë pedagogëve dhe pedagoqeve të kësaj Akademie për rilindjen e një vatre kaq të rëndësishme, saç është kjo Akademi, në funksion të rritjes të një gjenerate tjetër kuadrosh të Policisë së Shtetit, korrektesa e sjelljes dhe profesionalizimi i të cilëve janë një domosdoshmëri e vazhdueshme për Policinë e Shtetit. E pa asnjë diskutim, ne të gjithë shohim me kënaqësi përparimet në këtë aspekt dhe presim me padurim brezat e rinj të Akademisë të Sigurisë, që t'i bashkëngjiten përpjekjes në terren të Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit.

Jetojmë në një kohë, kur zhvillimet revolucionare në fushën e teknologjive krahas shumë mundësive të mëdha përbëjnë edhe sfida më vete për institucionet ligjzbazuese. Jemi të gjithë të vetëdijshëm se falë këtyre zhvillimeve nuk është vetëm shteti, nuk janë vetëm institucionet, nuk është vetëm trupa e angazhuar në luftën kundër krimit që mund të përfitojë, por edhe vetë krimi, nga ana tjetër.

Sot është e bërë e mundur që kushdo të ketë mundësi aksesit në teknologji shumë të avancuar, që tradicionalisht kanë qenë gjithnjë monopol i shteteve. Për këtë arsye,

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

elementët apo grupet kriminale, sot kanë një kapacitet të lartë keqpërdorues të teknologjive në funksion të qëllimeve të tyre të mbrapshta, që e bëjnë punën e institucioneve ligjzbatuese shumë më të ndërlikuar dhe shumë më komplekse dhe pa diskutim e bëjnë rolin e kësaj Akademie shumë më kyç për të ardhmen e përpjekjes së Policisë së Shtetit dhe të institucioneve ligjzbatuese, në tërësi, në fushën e betejës me krimin. Në kuadrin e një sërë reformash rrënjësore që qeveria ka ndërmarrë pas pothuajse tre dekadash stanjacioni dhe letargjie, në raport me mekanizmat dhe funksionet e shtetit, reforma në fushë e sigurisë është padyshim një nga më të rëndësishmet. Shteti modern ka një katalog të madh përgjegjësish dhe detyrash për të plotësuar përballë qytetarëve të tij. Pikërisht në funksion të sigurisë dhe në varësi të qasjeve dhe shkollave politike, spektri i përgjegjësive që shteti tenton të plotësojë, ndryshon. Në disa qasje, shteti mban pak dhe në disa të tjerë shumë më tepër rol dhe përgjegjësi. Megjithatë ka një konstante që i bashkon si karakteristikë të gjitha shkollat politike, përgjegjësia e pandashme e shtetit për sigurinë publike mbetet një kontribut i dorës së parë në çdo shtet.

Siguria është një e mirë publike, e cila nuk mund të krijohet nga aktorët privatë, sepse siguria nuk shitet dhe nuk blihet. Nga ana tjetër, kur ajo ekziston, askush nuk mund të privohet nga përfitimet e saj. E kjo natyrë e posaçme e bën sigurinë publike, produktin më të veçantë, mbase, që mund të ofrojë dhe e ka për detyrë të ofrojë shteti. E mira publike e parë dhe më e rëndësishme është siguria publike. Sipas Hobsit, vetë shteti sovran u krijua për të ofruar pikërisht sigurinë publike. Reformat tona në siguri synojnë një strategji të re dhe të pandarë të shtetit në këtë fushë. Natyrisht që koha ime, sado unë të abuzoj me të, duke abuzuar me mikpritjen tuaj, është e kufizuar, ndërkohë që ju takon juve të organizoni gjatë debateve tuaja, temën e kësaj përgjegjësie, por në pamundësi për t'u thelluar sa duhet, unë dua të prek vetëm disa aspekte.

*Së pari;* si një produkt i ndërlikuar shtetëror, siguria publike nuk mund të krijohet nga qasja apo nga procese të izoluar. Për këtë qëllim, ne do ta fillojmë procesin e krijimit të kapaciteteve dhe do të nxisim procese që mundësojnë një përpjekje të përbashkët të institucioneve ligjzbatuese, në funksion të sigurisë dhe patjetër në përballjen me krimin si një prioritet i pandryshueshëm.

Përvoja e shkëlqyer në funksionimin e disa task-forcave, si ato kundër kanabisit, për mbrojtjen e pyjeve, për energjinë, për territorin, janë një provë e pakundërshtueshme e nevojës për sinergji ndërmjet aktorëve të ndryshëm që kanë për detyrë, - apo të cilët i lidhin funksionet e tyre, - krijimin e mjedisit të sigurt për qytetarët.

Fillimi i Operacionit “Forca e Ligjit”, i cili mbështetet po në të njëjtën qasje, do të shërbejë për konsolidimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional, por edhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë. Në një të ardhme të afërt, ne do të përpiqemi të kalojmë në një nivel të ri koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve, që do të synojë krijimin e mekanizmave të përhershëm për këtë qëllim, të cilët mbase mund ta plotësojnë në kohë dhe me qëndrueshmëri nevojën e shpeshtë për task-forca të bazuara në objektiva shumë të veçanta.

*Së dyti;* Modernizimi i vazhdueshëm i strukturave ligjzbatuese është prioritet. Organizimi dhe sofistikimi i krimit, mpleksja e tij jo vetëm në rrafshin kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar dhe burimet financiare e kapacitetet teknologjike të tij mund të përballen vetëm nëpërmjet një modernizimi të shpejtë dhe sa më të thellë së të gjithë sistemit të sigurisë kombëtare, ku modernizimi i Policisë së Shtetit është nevoja dhe prioriteti parësor. Në këtë kuadër, Akademia e Sigurisë ka një rol prijës dhe ne do të vijojmë ta mbështesim dhe do të bëjmë çmos që në një kohë relativisht të shpejtë ta



ngremë në një nivel të ri, duke mundësuar një revolucion të vërtetë në kurrikula dhe në teknologji, i cili duhet të udhëhiqet prej jush, prej drejtuesve dhe pedagogëve të kësaj Akademie, që janë njerëz të lidhur me shkollën, nga njëra anë, por dhe me shkollën e eksperiencës, nga ana tjetër. Duhet të sigurojmë që punonjësit e rinj të Policisë dhe ata më të vjetër, po ashtu, të zotërojnë mjeshtrinë e vërtetë të përdorimit të shkencës dhe të teknikës në funksion të luftës kundër krimit. Kjo konkurrencë vjen në kohën e duhur si një nxitje në këtë aspekt.

*Së treti*; pastërtia e radhëve të Policisë dhe të strukturave të tjera ligjzbatuese, integriteti i lartë i punonjësve të këtyre institucioneve është parakusht i domosdoshëm dhe i padiskutueshëm. Ne kemi bërë sa kemi mundur, jo sa kemi dashur, në funksion të rritjes së shpërblimit moral dhe financiar për punonjësit e Policisë së Shtetit, do vazhdojmë të bëjmë edhe më shumë, por procesi historik i pastrimit të Policisë së Shtetit. Ashtu sikundër dhe pastrimi i sistemit gjyqësor nga elementë të kriminalizuar, të korruptuar, apo thjesht të paaftë për plotësimin e detyrës do të vijojë me vendosmëri dhe ekzigjencë të shtuar së pari në radhët e Policisë së Shtetit e pastaj së të gjitha strukturave të tjera ligjzbatuese. Jam i bindur që procesi i *Vetting*-ut që është organizuar dhe që do të fillojë të zbatohet në Policinë e Shtetit, duke filluar nga muaji janar, do të japë rezultate të qenësishme, ashtu sikundër kam shumë besim se brezat që do të dalin prej Akademisë, duke filluar nga së shpejti dhe në vijim vit pas viti, do të jenë një burim i jashtëzakonshëm transformimi dhe transfuzioni të gjakut të Policisë së Shtetit.

*Së katërti*; vijimi i goditjeve për të shkatërruar grupet e rrjetet kriminale mbetet një prioritet kryesor operacional për Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese.

I kthehem edhe njëherë operacionit “Forca e Ligjit”, si një ndërmarrje shumë e rëndësishme, e cila do të synojë katet më të larta dhe nyjet më të thella të krimit të organizuar që, për hir të së vërtetës, për shumë vite kanë qenë larg fokusit të goditjeve të mirëfillta. Por çka është më e rëndësishme, besoj unë, në këtë operacion është shenjestrimi i asetëve dhe i financave me origjinë kriminale, duke i zhveshur këto rrjete dhe këta elementë nga mundësia e rikthimit dhe duke bërë të mundur një mesazh shumë të qartë, që kush përfiton nga krimi nuk i gëzon dot ato që përfiton.

Shumë të dashur miq dhe të nderuar pjesëmarrës, ndërmarrja e reformave të thella në një vend ku rënia e komunizmit u shoqërua me një boshllëk të madh në rrugën e ndërtimit të një shteti demokratik, me institucione të reja demokratike, ishte një proces jashtëzakonisht i vështirë, që u vështirësua edhe për shkak të mungesës së vizionit dhe të aftësive tona për të bërë më të mirën në një kohë të arsyeshme. Por sot jemi, besoj, në një moment kur mund të themi me plot gojën se kemi shumë arsye për të besuar në suksesin e objektivave të mëtejshme. Mjafton t’ju jap një shifër, 4 vrasje për 100 mijë banorë kishte Shqipëria në vitin 2013, ndërsa sot, kjo shifër është 1.5. Më lejoni t’ju kujtoj se mesatarja e këtij treguesi, sipas EUROSTAT-it, në Bashkimin Europian është 1.7. Pra, jemi nën mesataren e Bashkimit Europian, për sa i përket vrasjeve.

Nga ana tjetër nuk diskutohet se aty ku jemi larg mesatares së Bashkimit Europian, është cilësia dhe qëndrueshmëria në cilësi e trupave të Policisë së Shtetit dhe së të gjithë mekanizmave, përfshirë edhe mekanizmin bazë që ka të bëjë me inteligjencën e Policisë së Shtetit. Këtu mbetet një sfidë e hapur për të gjithë ne sëbashku, duke shprehur bindjen se kjo është një sfidë ku fjala “sëbashku” ka një kuptim vërtetë të plotë, pasi pa Akademinë e Sigurisë, pa rritjen e kapaciteteve falë kësaj Akademie, pa fuqizimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të kësaj Akademie, përmirësimin e mëtejshëm të kushteve në këtë Akademi, ne do ta kemi të pamundur aspektin tjetër.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# Reformimi i Akademisë së Sigurisë, rritja e cilësisë së programeve dhe e nivelit profesional, - prioritet i veçantë, i Ministrisë së Brendshme



**Fatmir XHAFAJ**

MINISTËR I BRENDSHËM\*



Në dëshirojmë dhe do të punojmë fort në muajt në vijim të shohim më shumë profesionistë të zotë dhe të përkushtuar në trupën pedagogjike të Akademisë së Sigurisë, mësimdhënës me integritet dhe me pasion shkencor, si garanci për të përgatitur studentë dhe punonjës policie shumë më të aftë, të motivuar e të ndërgjegjshëm për misionin e tyre fisnik në mbrojtje të jetës, lirisë, pronës dhe sigurisë së qytetarëve tanë. Uroj që kjo konferencë të zhvillojë një debat të hapur, profesional dhe shkencor rreth sfidave bashkëkohore që përfshijnë fushën e shkencave ligjore dhe atë të sigurisë, por edhe mundësive që ofrohen në vende me përvoja të suksesshme në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti.

## AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Fjala e ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, në konferencën e dytë shkencore ndërkombëtare, "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë", organizuar nga Akademia e Sigurisë.

*I nderuar z. Kryeministër!*

*I nderuar z. Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit!*

*I nderuar z. Drejtor i Akademisë së Sigurisë!*

*Të nderuar akademikë, profesorë, studiues dhe pedagogë!*

Kurdoherë një event shkencor është i mirëpritur, por e fokusuar kjo te shkencat ligjore dhe ato të sigurisë përbën një ngjarje me rëndësi. Kjo për shkak të sfidave të rëndësishme që përballemi në këto fusha, por edhe për shkak të mungesës së ndjeshme dhe etjes që kemi për trajtimin e temave të tilla me pritshmëri të lartë.

Dëshiroj t'ju jap vlerësimet më të mira organizatorëve të kësaj konference, Akademisë së Sigurisë, Qendrës Kërkimore Shkencore dhe bashkëpunëtorëve të tyre, që kanë mundësuar të jenë këtu së bashku, me këtë pjesëmarrje ndërkombëtare, akademikë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të shkencave ligjore.

Si Ministër, por edhe si jurist në profesion, e shoh me interes të veçantë këtë konferencë, që synon në një dimension gjithëpërfshirës të nxisë shkëmbimin e përvojave kërkimore për sa i përket aplikimit të shkencave ligjore në hetimin e krimit në Shqipëri. Unë besoj se kjo konferencë do të ndihmojë për të përmbushur më mirë misionin e Policisë së Shtetit në këto kohë kur krimi dhe format e organizuara të tij janë më të sofistikuar dhe kanë nevojë jo vetëm për forcim të bashkëpunimit ndërkombëtar, por edhe për përdorim më të mirë dhe të gjerë të metodave bashkëkohore dhe mundësive që ofron zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë në ditët tona.

Është me rëndësi që punimet e kësaj konference të reflektojnë eksperiencat që kemi, problematikat, vështirësitë dhe sfidat që duhet të kapërcehen dhe të mund të ofrojnë rekomandime për zgjidhje të mundshme në drejtim të zhvillimit dhe të zbatimit të mundësive që ofrojnë sot shkencat ligjore.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Plani i Veprimit – Operacioni ‘Forca e Ligjit’ i miratuar së fundmi nga qeveria shqiptare, dëshmon vullnetin politik dhe institucional të qeverisë dhe agjencive të tjera ligjzbatuese në vend në luftën pa kompromis dhe ndëshkimin e ashpër ligjor të kriminalitetit në vend dhe veçanërisht ndaj krimit të organizuar.

Buxheti i alokuar nga qeveria për Ministrinë e Brendshme për vitin 2018 është gjithashtu një tjetër tregues i qartë i vullnetit të qeverisë dhe kujdesit personal të Kryeministrit të vendit për jetësimin e këtyre prioritetëve madhore të bëra publike tashmë. Ky është buxheti më i lartë i investimeve në fushën e rendit dhe sigurisë për të paktën 10 vitet e fundit, me një rritje prej rreth 70 % krahasuar me vitin që po mbyllim. Mbi 80 % e kësaj rritjeje fokusohet te Policia e Shtetit dhe kryesisht do të përdoret për investime të teknologjia në fushën e hetimit dhe pajisjet shkencore, një mungesë e ndjeshme që për vite të tëra ka ndikuar ndjeshëm në zbulueshmërinë e krimit dhe efektivitetin e procedimit penal të tyre.

Përbën një domosdoshmëri me rëndësi të theksuar shoqërore kryerja e studimeve shkencore rreth formave të shfaqjes së kriminalitetit, të faktorëve kriminogjenë, metodave të kryerjes së hetimeve, rrethanave lehtësuese dhe favorizuese për kryerjen e një krimi, duke mos nënvleftësuar as format e krimit urban dhe duke studiuar në mënyrë të veçantë format e krimit të organizuar dhe krimet e reja që cenojnë rendin dhe sigurinë publike dhe përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare dhe më gjerë.

Në kohën e sotme, hetimi për veprat penale kërkon një sintezë të mirëbalancuar mes njohurive të përgjithshme dhe padyshim analizë shkencore të provave të gjithanshme. Procedurat përfshijnë një ndërthurje analitike të një spektri të gjerë të shkencave ligjore, biologjike-mjekësore, sociale-psikologjike, ekonomike, historike dhe kjo kryhet vetëm nga një bashkëpunim mes profesionistësh të fushave të ndryshme.

Punonjësit e ardhshëm të Policisë duhet ta mësojnë këtu, në Akademinë e Sigurisë, abc-në e punës për zbulimin dhe ruajtjen e gjurmëve në çdo vendngjarje dhe për çdo çështje me interes hetimor. Mbeten kritike për cilësinë e punës hetimore procedurat e kërkimit, marrjes dhe dokumentimit të provave, mënyra e përdorimit dhe rregullat e ruajtjes dhe asgjësimit të tyre sipas procedurave të përcaktuara në ligj, si kusht që ato të përmbushin kërkesat shkencore dhe juridike për të qenë të pranueshme në gjykatë, por dhe si garanci për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve. Organet e hetimit dhe të gjykimit duhen mbështetur me të dhëna shkencore, të siguruar në rrugë ligjore nga strukturat përgjegjëse hetimore.

Uroj që kjo Konferencë, përvoja e ekspertëve të nderuar nga vende të tjera gjithashtu, t’i shërbejë zhvillimit të diskutimeve konstruktive dhe gjetjes së alternativave të mundshme për adresimin e këtyre problematikave.

Në mbyllje të fjalës time, dëshiroj të theksoj se reformimi i Akademisë së Sigurisë, përcaktimi i kriterëve më të larta të pranimit, konsolidimi i aplikimit të një modeli transparent konkurrimi që u zbatua këtë vit, rritja e cilësisë së programeve dhe kurrikulave mësimore, e nivelit profesional të mësimdhënies, modernizimi i infrastrukturës përbëjnë një prioritet të veçantë të Ministrisë së Brendshme dhe Qeverisë.

Miratimi i zhvillimit të programit *Master Profesional* është një tregues pozitiv i transformimit të Akademisë së Sigurisë në qendrën e vetme të formimit, trajnimit dhe kualifikimit të të gjithë punonjësve të policisë dhe jo vetëm. Ju inkurajoj që në zhvillimin e programeve *Master*, Ju, të angazhoni jo vetëm profesorët dhe ekspertët më të mirë vendas, por edhe të rrisni bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojës me profesorë dhe profesionistë të praktikës së shërbimeve shkencore homologe dhe të akademive të

sigurisë në vendet e tjera.

Në dëshirojmë dhe do të punojmë fort në muajt në vijim të shohim më shumë profesionistë të zotë dhe të përkushtuar në trupën pedagogjike të Akademisë së Sigurisë, mësimdhënës me integritet dhe me pasion shkencor, si garanci për të përgatitur studentë dhe punonjës policie shumë më të aftë, të motivuar e të ndërgjegjshëm për misionin e tyre fisnik në mbrojtje të jetës, lirisë, pronës dhe sigurisë së qytetarëve tanë.

Uroj që kjo konferencë të zhvillojë një debat të hapur, profesional dhe shkencor rreth sfidave bashkëkohore që përfshijnë fushën e shkencave ligjore dhe atë të sigurisë, por edhe mundësive që ofrohen në vende me përvoja të suksesshme në parandalimin dhe ndëshkimin e krimit në përgjithësi dhe atij të organizuar në veçanti.

Faleminderit dhe ju uroj edhe një herë suksese.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

**viii**

# Vetëm duke zhvilluar shkencën dhe dijen, zhvillojmë një forcë policore, që mund të shndërrojë sistemin



**Dr. Bilbil Memaj**

DREJTOR/REKTOR I AKADEMISË SË SIGURISË\*



Në këtë akademi, i kemi vënë vetes si synim që të rrisim kapacitetet, duke përmirësuar formimin e oficerëve të policisë me dije dhe duke i hapur një udhë më të gjerë shkollimit dhe kërkimit shkencor. Jemi të vetëdijshëm se mangësitë ekzistojnë; vështirësitë po ashtu. Por, ne nuk do të tërhiqemi, do të përmirësohemi në vijim. Shembull i kësaj rruge që vazhdon në ngjitje, është edhe hapja së fundmi, e programeve “Master profesional” në fushën e sigurisë dhe hetimit. Duke uruar punimet e kësaj konference, më lejoni që të theksoj se, kontributi ynë do të jetë i heshtur e i vazhdueshëm, në të mirë të sigurisë e të zhvillimit të vendit. Vetëm duke zhvilluar shkencën dhe dijen, zhvillojmë një forcë policore, e cila do të mund të shndërrojë e të përmirësojë sistemin: të mundësojë drejtësinë!

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Fjala e Drejtorit/Rektorit të Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, në konferencën e dytë shkencore ndërkombëtare, “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë”, organizuar nga Akademia e Sigurisë.

*I nderuar zoti Kryeministër!  
I nderuar zoti Ministër!  
I nderuar Drejtori i Përgjithshëm!  
Të nderuar drejtues dhe profesorë të akademive të sigurisë nga Maqedonia,  
Mali i Zi, Kosova, Italia dhe nga universitete të Shqipërisë!  
Të nderuar, përfaqësues të ambasadave të akredituara në Shqipëri!  
Të nderuar kolegë, nga PAMECA, ICITAP, OSCE dhe INTERFORC!  
Të nderuar referues dhe pjesëmarrës!  
Zonja dhe zotërinj!*

Ju uroj mirë se ardhjen në konferencën II-të shkencore ndërkombëtare të Akademisë së Sigurisë! Është nder për mua, që të çel punimet e konferencës shkencore ndërkombëtare, me temë: “Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë”. Konferencën e konsideroj mjaft të rëndësishme, për sa i përket tematikës së trajtuar dhe kontributit që do të japë. Sot, diskutohet gjerësisht, për problematikën e sistemit të sigurisë publike dhe mangësitë e sistemit të drejtësisë, si dhe për shkallën e për nivelin e tyre. Ne jemi të ndërgjegjshëm që qytetarët presim më shumë nga ne, nga institucionet e zbatimit të ligjit.

Në vendet e zhvilluara, shkencat ligjore janë bërë një partner i fuqishëm në përmirësimin e punës parandaluese e zbuluese të kriminalitetit. Ato janë një faktor ndihmës në dhënien e vendimeve të drejta. Për këtë arsye, shkencat ligjore, ndihmojnë në vendosjen e sigurisë publike, në hetimin e krimit dhe në vendosjen e drejtësisë, madje korrigjojnë edhe vetë sistemin, kur ky i fundit gabon. Punimet që do kemi mundësinë të ndjekim, nxjerrin në pah këtë rëndësi dhe vijnë me një qasje konstruktive e me rekomandime konkrete. Ofrohen pikëshikime të reja për gjetjen e zgjidhjeve,

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

nëpërmjet përmirësimit të shkencave ligjore në veprimtarinë e policisë. Në këtë akademi, i kemi vënë vetes si synim që të rrisim kapacitetet, duke përmirësuar formimin e oficerëve të policisë me dije dhe duke i hapur një udhë më të gjerë shkollimit dhe kërkimit shkencor. Jemi të vetëdijshëm se mangësitë ekzistojnë; vështirësitë po ashtu. Por, ne nuk do të tërhiqemi, do të përmirësohemi në vijim. Shembull i kësaj rruge që vazhdon në ngjitje, është edhe hapja së fundmi, e programeve “*Master profesional*” në fushën e sigurisë dhe hetimit.

Duke uruar punimet e kësaj konference, më lejoni që të theksoj se, kontributi ynë do të jetë i heshtur e i vazhdueshëm, në të mirë të sigurisë e të zhvillimit të vendit. Vetëm duke zhvilluar shkencën dhe dijen, zhvillojmë një forcë policore, e cila do të mund të shndërrojë e të përmirësojë sistemin: të mundësojë drejtësinë!

Ju faleminderit!





---

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**



*Sesioni I / First Section*

Aspektet gjithëpërfshirëse të disiplinave forenzike:  
impakti në sigurinë publike

# Shkenca e forenzikës në shtetin e ri të Kosovës

Dr. Sc. Blerim OLLURI

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
blerim.olluri@rks-gov.net

## Abstrakt

*Ky hulumtim shkencor i titulluar "Shkenca e Forenzikës në Kosovë" ka për qëllim të studiojë zhvillimin e shkencës së forenzikës në Kosovën e pasluftës. Thëks i veçantë, do t'i kushtohet veprimtarisë, organizmit dhe funksionimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, duke elaboruar kështu edhe rregullativën ligjore dhe standardet ndërkombëtare që ndërlidhen me këtë disiplinë shkencore. Në të kaluarën, shkenca e forenzikës në Kosovë, nuk kishte shënuar ndonjë zhvillim të theksuar. Pas luftime forenzika e Kosovës, ishte konsoliduar në kuadër të administratës së UNMIK-ut, në nivel qendror dhe lokal, kryesisht e udhëhequr nga policia e UNMIK-ut. Qeveria amerikane, duke parë të rëndësishme përkrahjen e Kosovës, për ngritjen e kapaciteteve forenzike në luftimin dhe parandalimin e krimit, vendosi që përmes ICITAP-it në Kosovë, të investojë një shumë të konsiderueshme mjetesh për ndërtimin e një laborator modern të forenzikës. Ligji për AKF, konsiderohet një ndër zhvillimet më të rëndësishme për forenzikën e Kosovës. Ky ligj organik rregullon përkufizimet shkencore, administrative dhe procedurale, themelimin e agjencisë së Kosovës për forenzikë, organizimin dhe funksionet, kompetencat, përgjegjësitë, të drejtat e personelit dhe kodin e etikës. Sot Agjencia e Kosovës, si agjenci e pavarur ekzekutive ka rol kyç në sigurinë e përgjithshme në kuptimin e zbulimit dhe parandalimit të veprave penale në Kosovë dhe më gjerë. Metodat që do të aplikohen në kuadër të këtij punimi shkencorë, kryesisht do të jenë metodat krahasuese dhe përshkruese, mbështetur dhe ilustruar nga disa statistika të rasteve të kryera nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në periudhën kohore gjatë viteve 2012-2016.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**forenzikë, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, akreditim, standarde shkencore, laborator, procedurë penale.**

## 1. Hyrje

Në një shoqëri që beson në parimet e demokracisë dhe në sundimin e ligjit, parim themelor është që çdo person i dyshuar dhe që akuzohet për një vepër penale, të konsiderohet i pafajshëm përderisa të vërtetohet fajësia e tij, bazuar në prova materiale apo shkencore. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe i shkencës ka bërë të mundur integrimin e metodave shkencore në hetimin, në zbulimin dhe në parandalimin e veprave penale, si mbështetje me rëndësi vendimtare, duke i ofruar gjyqësorit konkluzione të bazuara në të dhëna shkencore. Provat e mbledhura, ekspertizat dhe konkluzionet e nxjerra shkencore nga ekspertët e forenzikës dhe interpretimi i tyre objektiv, ka përparësinë e të qenit më të pranueshme për gjykatat në procedurë penale. Teknikat e shkencës së forenzikës, janë përgjithësisht të pranueshme edhe nga perspektiva e të drejtave të njeriut, duke qenë relativisht joinvazive në krahasim me metodat e mëparshme. Sigurisht, është e rëndësishme që ekspertizat forenzike të kenë kredibilitetin e duhur, dhe kjo, është e mundur vetëm me një standardizim, me një sistem cilësor, me një personel profesional të kualifikuar, objektiv, të paanshëm dhe me qasje në metoda e pajisje moderne laboratorike.<sup>1</sup>

Mendimi shkencorë ndihmon që gjendja faktike të vërtetohet përmes proceseve të ndryshme njohëse. Njohja e mirë e rregullave të ekspertizës forenzike është më se e nevojshme, sepse bëhet fjalë për vërtetimin e fakteve, të cilat janë me rëndësi të veçantë për të vërtetën para drejtësisë. Duke ditur rëndësinë dhe kontributin e çmuar të shkencës së forenzikës në procedurë penale, e sidomos në ofrimin e provave shkencore për hetime kriminale, pas luftës, në Kosovë, u bënë shumë investime për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve forenzike. Sot shërbimet forenzike që ofron nga laboratorët

<sup>1</sup> Blerim Olluri, *Shkenca e forenzikës dhe roli i saj në procedurë penale (Një vështrim i posaçëm mbi praktikat dhe veçantitë e saj në Kosovë)*, Punim Doktorature, Tiranë: UET, 2016, f. 6.

modern të forenzikës, këtu edhe laboratorët e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, janë të një rëndësie të veçantë dhe shumë të kërkuara nga organet proceduese.

## 2. Historik i shkurtër mbi zhvillimin e shkencës së forenzikës në Kosovë

Në Kosovën e pasluftës, gjatë viteve 2000-2005, forenzika ishte konsoliduar në kuadër të administratës së UNMIK-ut, e organizuar në nivel qendror dhe lokal, kryesisht e udhëhequr nga policia e UNMIK-ut. Njësia e forenzikës e policisë së UNMIK-ut, përbëhej nga njësia për këqyrjen e vendit të ngjarjes, njësia e daktiloskopisë, njësia e balistikës, njësia e dokumenteve kontestuese dhe njësia kimiko-biologjike. Të gjitha këto njësi, përbëheshin nga personeli i ndryshëm ndërkombëtar, kryesisht nga SHBA-ja, Rusia, Turqia, Bullgaria etj. Njësia e forenzikës kishte edhe njësitë rajonale në kuadër të komandave rajonale policore, të cilët kryenin këqyrjen e vendit të ngjarjes, ndërsa provat fizike për ekspertizë dërgoheshin në njësinë e forenzikës së shtabit qendror të policisë së UNMIK-ut. Llojet e ekspertizave që kryheshin në atë kohë, ishin ekspertiza e dokumenteve, ekspertiza e gjurmëve të gishtërinjve dhe ekspertiza balistike. Provat fizike për analizë kimiko-biologjike të ADN-së dhe drogave, dërgoheshin në Institutin e Forenzikës të Bullgarisë, në Sofje.

Në tetor, 2003 qeveria amerikane, ICITAP-i, vendosi gurthemelin e objektit të Laboratorit të Forenzikës. Ky vit, padyshim, konsiderohet viti i themelimit të forenzikës në Kosovë. "Viti 2003, është simbolizuar edhe në emblemën e AKF-së, gjë që nënkupton vitin e themelimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë" (udhëzim administrativ nr. 40/2012-MPB, për stemën identifikuese të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë: 2012: 3). Ndërsa gjatë viteve 2005-2007, laboratorit i forenzikës nën udhëheqjen e përbashkët të ICITAP dhe të policisë së Kosovës, kalon një etapë të rëndësishme të zhvillimit. Gjatë kësaj kohe, ndër zhvillimet më të rëndësishme, konsiderohet zhvillimi i metodave shkencore forenzike për ekspertizë të drogave, analizë të ADN-së, ekzaminim të dokumenteve, ekzaminim balistik, ekzaminim të gjurmëve të gishtërinjve, krijimi i sistemit për sigurim të cilësisë dhe trajnimi i personelit brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2005, fillon të funksionojë laboratorit i forenzikës në kuadër të policisë së Kosovës. Disiplina e parë që filloi me ekspertizë, ishte ekspertiza e drogave.

Ky vit, konsiderohet jo vetëm viti i fillimit të ekspertizave forenzike bashkëkohore, por njëherazi edhe viti i fillimit të zhvillimit të shkencës moderne të forenzikës në Kosovë. Pranim-dorëzimi zyrtar i laboratorit të forenzikës nga Ambasada Amerikane, ICITAP-i, u bë më datë 5. 7. 2008.<sup>2</sup> Ambasadorja e SHBA-së në Kosovë, Tina Kajdanova, në mënyrë solemne ia dorëzoi çelësat ish-ministrit të Punëve të Brendshme z. Zenun Pajaziti, përkatësisht ish-drejtorit të Laboratorit të Forenzikës, nënkolonel policor, z. Blerim Olluri.

Nga kjo datë Laboratorit i Forenzikës pavarësohet dhe udhëhiqet nga ekspertë vendorë. Ndërsa në vitin 2010, forenzika e Kosovës përjeton një ndryshim thelbësor: laboratorit i forenzikës i Policisë së Kosovës, shndërrohet në agjenci të pavarur ekzekutive, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, përcjellë me hartimin e infrastrukturës ligjore për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë (në tekstin e mëtejme AKF). Këtë legjislaturë, përkatësisht ligji për AKF-në, miratohet nga parlamenti i Kosovës dhe hyn

<sup>2</sup> Blerim Olluri, op. cit., f. 109-110.

në fuqi më datë 28. 11. 2011. Ndërsa ky vit, padyshim, në aspektin juridik, konsiderohet viti i zhvillimit dhe i konsolidimit ligjor të forenzikës së Kosovës.

### **3. Organizimi dhe funksioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë**

Ashtu siç theksuam më lartë, ligjërisht përgjegjës për kryerjen e ekspertizave forenzike në Kosovë është Agjencia e Kosovë për Forenzikë (tani e tutje AKF). Kjo agjenci ka infrastrukture ligjore, metoda shkencore bashkëkohore, personel të kualifikuar dhe të specializuar në nivel ndërkombëtar, me teknologji bashkëkohore. AKF kryen ekspertizat forenzike si në vijim:

1. ekspertiza balistike (armët e zjarrit),
2. ekspertiza të numrave identifikues të automjeteve,
3. ekspertiza daktiloskopike, ekspertiza të dokumenteve,
4. ekspertiza grafologjike të nënshkrimeve dhe të dorëshkrimeve,
5. ekspertiza të substancave narkotike,
6. ekzaminim të kompjuterëve dhe të telefonave celularë,
Regarding that Macedonia is also a part of the overall globalisation of the world, in our country frauds will also appear as well as in all the other countries. Some types of frauds which we could not even imagine taking place in our country, have already been detected or are to be detected. Also, whereas in our country, in the previous periods the enterprises mainly had the tendency of underestimation of the financial results, mostly because of the undefined ownership and the high taxes, in the recent times the estimation of the working results is more and more present because of the financial pressure coming from the loan institutions, the will of increasing the bonuses of the managers or the dividend of the investors.

All this emphasizes the need of generation of staff in the area of forensic audit and their continuous education. Of course, at the beginning, because of the small market and with it the small space for conduction of frauds in quantity and in value, we consider that there will not be a proper environment for independent functioning of this type of audit. But, forensic audit can be performed through the existing auditing companies as special departments. Further, when the enterprises perceive the benefits of forensic audit, special companies for forensic audit can also be formed.<sup>29</sup>

<sup>28</sup> <http://www.romanian-accountants.com/forensic-accounting-in-romania> (accessed on 25.08.2015)

<sup>29</sup> <http://www.revizija.com.mk/new-page.aspx>

## 4. Macedonian Financial Forensic

In Macedonia there is no professional financial forensic. In order to observe the situation in the Republic of Macedonia related to the perception about the knowledge of the forensic accountant and the forensic auditor, a survey research was conducted on 25 accountants and 37 auditors on the territory of the Republic of Macedonia in 2015. The recognizing of the two concepts according to the research carried out in the Republic of Macedonia, has the following result: 93% of the accountants are familiar with the term of forensic accounting, while 7% are not. 97% know about trainings or bodies which conduct trainings of forensic accountants, 3% do not know. To the question of whether they see the difference between forensic accountants and forensic auditors, 74% see, and 5% do not, while 11% do not know. All 100% of the accountants consider that there should be a special training for forensic accountants.

As to the profession of forensic auditor, 99% of the auditors in the Republic of Macedonia had heard about the existence of this profession and they know their work tasks, while 1% had never heard of it. All 100% have never heard about special trainings or a body which conducts trainings on the territory of the Republic of Macedonia. To the question of whether they see the difference between forensic accountants and forensic auditors 91% see the difference, 5% do not see the difference, while 3% do not know.

Public prosecutor office use a form of economics expertise. Economics expertise is the preparation of expert findings and opinions based on scientific and expert methods, technical achievements, professional knowledge and experiences in the areas defined in all cases determined by law or at the request of an interested person - a contracting authority. "Expert" means a person who has a license for expertise from the relevant area and is registered in the Register of Experts.

The expert is independent and independent in the performance of the expertise within the framework of the powers determined by law. It is obliged to perform the expertise professionally and conscientiously in accordance with the rules of science and profession, ethical norms and professional standards and submit it to the commissioning authority in a timely manner in accordance with the deadlines prescribed by the law or the deadlines specified by the contracting authority.

In order to obtain an expertise license, it is necessary to pass a professional examination. The professional exam is taken for the purpose of checking the necessary expert knowledge from the respective field. A professional examination may be taken by a person who meets the following conditions:

- to be a citizen of the Republic of Macedonia,
- to have a place of residence in the Republic of Macedonia,
- have a university degree in the relevant field (a completed four-year university degree or a 300-credit diploma under the European Credit Transfer System (ECTS)),
- by an effective decision not to propose a ban on performing a profession, activity or duty until the consequences of the prohibition and
- have at least five years of working experience after graduation in the relevant field for which the application for passing the professional examination has been submitted.

The person who passed the professional exam, can apply for the issuance of an expertise license to the Ministry of Justice. The application of this Article shall be ac-

accompanied by:

- proof of passed professional exam and
- evidence that a legally valid decision does not impose a ban on performing a profession, activity or duty, while the prohibition continues.

The Ministry of Justice grants to the person who meets the requirements an expert license. The expert's license is valid for a period of five years. The expert's license is extended on the basis of a request submitted to the Ministry of Justice for renewal of the license for expertise no later than two months before the expiration of the validity, if in a procedure before the competent authority in which the expert's report is carried out it is not fined three times one calendar year and if every year he fulfills the obligation to attend the training for continuous improvement conducted by the Chamber of Experts.

With a license for an expert examination without taking the professional exam can be obtained:

1) doctor of science from a relevant scientific field or third cycle of university studies - doctoral studies in the relevant field of science, after applying for a license for expertise and submitting the necessary documentation, after which a license for expertise is issued and registered in the Register;

2) Master of Science from the relevant scientific field with five years of work experience after the masters degree, that is, the passed specialist exam and a person with a passed specialist examination in medicine or a second cycle of university studies - master's degrees from the respective scientific field, upon application for license and delivery the required documentation, after which he is issued a license for expertise and is registered in the Register and

The issued, seized and extended licenses of the experts, as well as the licenses of the experts who have ceased to be valid, are recorded in the Register kept by the Ministry of Justice.<sup>30</sup>

Economic expert is quite different from financial forensic scientist. But curricula for both positions is not a subject of observation in this paper. Macedonia has need of profession financial forensic and its time to think introducing it in the Law enforcement agencies.

## 5. Conclusion

The theoretical determination of the profession of forensic accountant and forensic auditor is identified by its definition. According to the reviewed literature, we can deduce the definition on forensic accountant and forensic auditor.

Many authors do not see the difference between the two concepts, i.e. they equalize them. If we compare the definitions of the two concepts, we will notice that there are many similarities.

Forensic accounting is an advanced accounting conducted by a competently trained person by knowledge of finances and economy, discovering a fraud or a crime through investigation of the accounting paperwork, and in service of a legal support in criminal charges or a judicial trial.

Forensic audit is an audit above audits carried out by a forensic auditor trained for

<sup>30</sup> Ministry of justice of Republic of Macedonia

conduction of investigation for the sake of prevention and discovery of frauds especially in the financial reports, as well as estimation of the risk of financial frauds, and it should provide the evidence for the court procedure.

From the investigation conducted in the Republic of Macedonia we can conclude that these two disciplines are new in the modern world, full of frauds and crime. There is economic expert what is different from financial forensic. The auditors possess more knowledge in forensic audit than the accountants do in the accounting audit. There is a need of training for promotion of profession financial forensic as well as forming of a special body which will be part of the international association of investigators of financial crime or certified investigators of frauds.

## Literature

1. Belak, V., (2011) *Business forensics and forensic accounting – fight against fraud*, Belak Excellens d.o.o., Zagreb.
2. Budimir N., (2013) *Forensic Accounting*, A Yearbook of Business Economy, year V, book 1, No. 8, UDK: 657.632:343.983, DOI: 10.7251/APE0813001B pp. 1–16.
3. Kranacher, *Core foundation related to fraud examination and Financial Forensics*, c01.tex V1 - February 10, 2010 3:19 P.M.
4. Zitzewitz E., (2011) *Forensic Economics*, Forthcoming, Journal of Economic Literature, February.
5. Ramaswamy, V., (2007) *New Frontiers: Training Forensic Accountants within the Accounting Program*, Journal of College Teaching & Learning, v. 4, n. 9.
6. Nigerian Academic Forum (2009), Multidisciplinary Journal, National Association of the Academics.
7. Dreyer K. A., *History of Forensic Accounting*, Grand Valley State University ScholarWorks, GVSU Honors Projects Undergraduate Research and Creative Practice 2014 Grand Valley State University.
8. Hanson R., (2007) *Encyclopedia of Business and Finance*, 2nd edition.
9. B. K B Kwok (2008) *Forensic Accountancy*, 2nd edition, LexisNexis .
10. M. Nigrini (2011) *Forensic Analytics: Methods and Techniques for Forensic Accounting Investigations*, Wiley and Sons.
11. Singleton T. W., Singleton A. J. (2006) *Fraud Auditing and Forensic Accounting*.
12. Zabihollah R., (2007) *Financial Statement Fraud: Prevention and Detection*. New York: Wiley.
13. Buckhoff, Thomas., (2008) "Forensic Audit vs. Financial Statement Audits". *Current Accounts*, September/October.
14. Petkoviæ A., (2010) *Forensic Audit – Criminal Actions in the Financial Reports*, Beëej: Proleter, 2010.
15. Mojsoska, S. and Dujovski, N., "Theoretical Defining of Forensic Accounting and Forensic Audit as New Disciplines in the Modern World". *Forezicka revizija Zbornikradova Beograd*, 2016.
16. Mojsoska, S. and Dujovski, N. (2015) "Recognizing of forensic accounting and forensic audit in the SouthEastern European countries", *Journal of Eastern-European Criminal Law*, No. 2.

# Shkencat ligjore shqiptare, mes veprimtarisë tradicionale dhe konceptit të ri, të inteligjencës forenzike

— Dr. Xhavit SHALA

Akademia e Sigurisë

xhavit.shala@asp.gov.al

## Abstrakt

*Objekti i studimit dhe i hulumtimit në këtë punim është trajtimi i konceptit të ri të inteligjencës forenzike (të shkencave ligjore), të rolit të saj në kuadër të policimit dhe të zbatimit të ligjit si dhe të raporteve të saj me veprimtarinë tradicionale të shkencave ligjore. Mjedisi i sigurisë sot, karakterizohet nga rreziqe e kërcënime më të ndërlikuara dhe më të ndërvarura se në të kaluarën, nga një kompleksitet i tyre në rritje dhe një nivel parashikimi në ulje. Ato ndërthurin kërcënimet të shkaktuara nga krimi i organizuar, individë të korruptuar, terrorizmi, etj. Në kushtet e një mjedisi të tillë, gjithnjë e më të pasigurt, merr një rëndësi të madhe inteligjenca dhe në këtë kuadër, edhe ajo e shkencave ligjore.*

*Modeli i ciklit të inteligjencës kriminale, mund të zbatohet edhe në kontekstin e shkencave ligjore, kur vetë këto janë ofruese të informacionit të ciklit të inteligjencës. Kjo lloj inteligjence, njihet si inteligjenca forenzike dhe është një lloj tjetër i inteligjencës kriminale. Produkti i inteligjencës së shkencave ligjore, siguron njohuri mbi aktivitetin kriminal dhe mbështet qasjet proaktive dhe parandaluese ndaj krimit. Thelbi i kësaj inteligjence është se, krahas trajtimit të çdo rasti individualisht me synimin e dërgimit të një çështje në gjykatë, të shohë ngjashmëritë në më shumë çështje duke u bazuar në studimin e fenomeneve të krimit. Në thelbin e saj, inteligjenca e shkencave ligjore është rezultat i një procesi analize, që synon transformimin e të dhënave të grumbulluara dhe të përpunuara, nga vendi i ngjarjes, i ekzaminimeve të tyre në databazat e ndryshme të administrimit së të dhënave biometrike, traseologjike, balistike, etj., në një formë më të përshtatshme për marrjen e vendimeve. Qëllimi është të shtojë vlerën e informacionit të mbledhur, duke e analizuar atë në mënyrën e duhur.*

*Gjatë këtij punimi, janë aplikuar metoda dhe instrumente bazë kërkimore shkencore, sasiore dhe cilësore si, metoda e analizës dhe sintezës, analizës krahasuese, ajo historike, juridike, e krahasimit dhe konfrontimit si dhe e studimit të rastit. Në përfundim të punimit nxirren konkluzione, ndërmjet të tjerave, se, pavarësisht rolit në rritje, inteligjenca e shkenca ligjore nuk duhet të jetë qëllim me vete, por pjesë e inteligjencës më të gjerë kriminale. Inteligjenca e shkencave ligjore nuk është provë për në gjykatë. Ajo është një produkt i një procesi që më vete apo e kombinuar me forma të tjera të inteligjencës na çon tek autori dhe tek provat.*

## Fjalëkyçe:

**analizë, inteligjencë, shkenca ligjore, forenzika, pollicimi, krimi, kërcënim.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »



## 1. Kuptimi mbi inteligjencën dhe rolin e inteligjencës kriminale në procesin e policimit dhe të zbatimit të ligjit

Në kohën që po jetojmë, në kushtet e një mjedisi sigurie me një shkallë rreziku në rritje e nivel parashikimi në ulje, ku ndërthuren rreziqe e kërcënime tradicionale konvencionale dhe ato jokonvencionale, të shkaktuara nga krimi i organizuar, individë të korruptuar e terrorizmi, roli i inteligjencës në përgjithësi dhe në këtë kontekst edhe si i inteligjencës kriminale e asaj të shkencave ligjore, nuk ka qenë kurrë më i rëndësishëm. Por, përkufizimi i inteligjencës është i vështirë, pasi në shumë shtete të ndryshme, ka tradita të ndryshme dhe përdorime të ndryshme. Megjithatë të gjithë bien dakord se intelijenca është një ndërthurje e informacioneve të besueshme, me informacione të analizuara e të vlerësuara më parë, nga të cilat kanë dalë përfundime. Ajo është procesi i “nxjerrjes” së kuptimit nga faktet dhe produkt i shtimit të vlerës së informacioneve dhe së dhënave, përmes analizës. Termi inteligjencë, i referohet procesit të përcaktimit të nevojave të grumbullimit, analizimit, prodhimit dhe përdorimit të informacionit, rreth shteteve, grupeve, individëve ose aktiviteteve potencialisht të rrezikshme.<sup>1</sup> Intelijenca i referohet gjithashtu proceseve me anë të së cilave kjo zhvillohet, si dhe individëve e institucioneve që e realizojnë atë.

Kinezët e lashtë e kanë përdorur inteligjencën në ushtri, më herët se në kohët biblike. Mësimet e gjeneralit dhe filozofit kinez Sun Tzu, në këtë fushë, janë e kanë mbetur aktuale në çdo kohë. Për Sun Tzu-në informacioni përfaqëson çelësin e fitores në luftë: “Njihe armikun njihe dhe veten; në njëqind beteja nuk do të jesh kurrë në rrezik”<sup>2</sup>. Për Sun Tzu-në përfundimi i luftës mund të dihet përpara kohe, nëse lideri bën

<sup>1</sup> Stan A. Taylor: “Roli i shërbimeve të inteligjencës në sigurinë kombëtare” në *Strategy in the contemporary world*. Oxford University Press, 2007; Uet Press, Tiranë 2012, f. 316.

<sup>2</sup> Thomas G. Mahnken: “Teoria e strategjisë” në *Strategy in the contemporary world*. Oxford University Press, 2007; UET press, Tiranë 2012, f. 94.

një vlerësim të plotë të situatës<sup>3</sup>, dukë nënkuptuar këto rolin e inteligjencës. Doktrina e Sun Tzu-së për rolin e inteligjencës në luftë<sup>4</sup>, ndonëse është konceptuar rreth 2520 vite me parë, ka rivalizuar më sukses doktrinën e gjeneralit Klauzeviç<sup>5</sup> i cili ishte skeptik ndaj inteligjencës dhe mbivlerësonte fuqinë ushtarake në fushën e betejës. Sipas tij, “Shumë raporte të shërbimeve të fshehta në luftë janë kontradiktore, shumë janë false dhe shumica janë të pasigurta. . . Shkurt, shumica e materialeve të inteligjencës është e pasaktë dhe efekti i frikës shumëfishon gënjeshttrat dhe pasaktësitë”.

Agjencitë e zbatimit të ligjit kanë qenë relativisht të vonuara për të aplikuar inteligjencën. Roli i inteligjencës në agjencitë e zbatimit të ligjit, ka ndryshuar sidomos pas 11 shtatorit 2001 ku dhe janë aplikuar modele e koncepte të reja të policimit si “policimi i udhëhequr nga inteligjenca”, “problemi udhëheq policimin”, “policimi në komunitet”, etj. Përdorimi i efektshëm i procesit të inteligjencës, nënkupton diferencën ndërmjet suksesit dhe dështimit për një agjenci të zbatimit të ligjit. Inteligjenca mund të mbështesë një gamë të gjerë të luftës kundër kriminalitetit në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar. Në mënyrë të veçantë, kur informacioni është i shumtë dhe shpesh, konfuz e kontradiktor, inteligjenca mund të shënojë rrugën drejt politikave efektive. Përdorimi efikas i inteligjencës në agjencitë e zbatimit të ligjit është jetësor. Një përdorim i plotë dhe i saktë i inteligjencës, krijon premisa për përballimin me efikasitet të problemeve që do të lindin në të ardhmen dhe, do të lejojë autoritetet e zbatimit të ligjit, të kenë një përgjigje paraprake për veprimtarinë e grupeve kriminale në zonë. Nëse grupet kriminale identifikohen në mënyrat e veprimit të tyre, atëherë autoritetet e zbatimit të ligjit mund ta kenë më të lehtë që të parandalojnë aktivitetin e mundshëm në të ardhmen.

Përkufizimi i inteligjencës, siç e thamë edhe më lart, është i vështirë, pasi varet nga tradita e shteteve të ndryshme. Gjithsesi, inteligjenca përfshin mbledhjen, vlerësimin, sistemimin, analizimin, shpërndarjen dhe rivlerësimin e informacionit. Analiza është pjesa më e rëndësishme e procesit të inteligjencës e në një farë mënyre, është edhe truri i këtij procesi<sup>6</sup>. Pa analizë, funksioni i inteligjencës është thjesht grumbull të dhënash dhe informacionesh pa asnjë vlerë, ose me shumë më pak kuptim dhe vlerë. Informacioni dhe të dhënat në vetvete, janë thjesht diçka me pak ose pa vlerë, por kur analizohen

<sup>3</sup> Sipas SunTzu-së “Për matjen e rezultatit të luftës duhet të krahasojmë të dyja palët, duke vlerësuar fuqitë e tyre relative. Kjo do të thotë të bëjmë pyetjet që vijojnë: Cili sundimtar e ka drejtimin? Cili komandant ka më shumë aftësi? Cili krah ka avantazhin e klimës dhe të terrenit? Cila ushtri u bindet rregullave dhe urdhrave në mënyrë më strikte? Cila ushtri ka fuqi më të madhe? Cilët oficerë dhe trupa janë të stërvitur më mirë? Cili krah është më strikt dhe i paanshëm në zbatimin e ndëshkimeve dhe të shpërblimeve? Mbi bazën e këtyre krahasimeve unë e di cili do të fitojë dhe cili do të humbasë”. Përgjigje këtyre pyetjeve i jep vetëm informacioni dhe inteligjenca.

<sup>4</sup> Për shembull Sun Tzu mbështet mendimin për goditjen e pjesëve të caktuara të diapozitivit të armikut me gjithë forcat e veta: “Në qoftë se unë jam në gjendje që të përcaktoj vendosjen e armikut ndërsa në të njëjtën kohë të fsheh (maskoj) forcat e veta, atëherë unë mund të përqendrohem (grupohem) dhe ai duhet të shpërndahet (copëtohet). Dhe në qoftë se unë përqendrohem gjatë kohës që ai shpërndahet, unë mund të përdor gjithë fuqinë (forcat ushtarake) për të goditur një pjesë të tij”. Është diçka e njohur të pohosh që Sun Xu mbështet idenë e mashtrimit të armikut dhe të arritjes së fitores pa zhvilluar luftim. Për shembull, ai shkruante “Të arrish njëqind fitore në njëqind beteja nuk është kulmi i zotësisë. Të mposhtësh armikun pa zhvilluar luftime është kulmi i aftësisë”.


<sup>5</sup> J. Boone Bartholomees, “Një vështrim mbi teorinë e strategjisë”. *Guidë mbi politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare, Vëllimi I*, Tiranë: Akademia Ushtarake, 2009, f. 42.

<sup>6</sup> Sipas Clauswitz-it “Shumë raporte të shërbimeve të fshehta në luftë janë kontradiktore, shumë janë false dhe shumica janë të pasigurta... Një raport kundërshton tjetrin, ose e konfirmon, e zmadhon, i jep ngjyrë, ndërsa drejtuesit i duhet të marrë një vendim të shpejtë, i cili shumë shpejt kuptohet se është i gabuar, ashtu siç ndodh që raportet dalin se janë mashtrime, ekzagjerime e kështu me radhë. Shkurt, shumica e materialeve të inteligjencës është e pasaktë dhe efekti i frikës shumëfishon gënjeshttrat dhe pasaktësitë”.

Thomas G. Mahnken: po aty. Burim i cituar.

marrin vlerë. Termi “analizë” dhe “inteligjencë”, shpesh, keqkuptohet nga punonjës të agjencive të zbatimit të ligjit. Duhet kuptuar qartë se analiza është një pjesë e një procesi, ndërsa inteligjenca është një produkt përfundimtar i analizës.

Një variant i procesit të inteligjencës i shprehur në mënyrë skematike do të ishte si më poshtë:



Ndërsa inteligjenca kriminale, është informacioni i hartuar, i analizuar dhe i shpërndarë në një përpjekje për të parashikuar, parandaluar ose monitoruar aktivitetin kriminal<sup>7</sup>. Inteligjenca kriminale mund të përfshijë një produkt të përgjithshëm që për shkallën e rrezikut dhe të kërcënimit, jo domosdoshmërisht në një arrestim ose ndjekje specifike. Ajo mund të përkufizohet si një produkt i një procesi analitik, i cili trajton një të ardhme të integruar të informacioneve të ndryshme rreth krimit, tendencave të tij, krimit dhe kërcënimit të sigurisë e kushteve që lidhen me kriminalitetin. Pjesë të informacionit, të mbledhura nga burime të ndryshme (nga përgjimet, informatorët, vëzhgimi, etj.) janë vetëm disa të dhëna të thjeshta, të cilat të veçuara kanë një vlerë të kufizuar. Ajo përfshin mbledhjen, vlerësimin, sistemimin, analizimin, shpërndarjen dhe rivlerësimin e informacionit mbi kriminelë të veçuar apo organizata kriminale<sup>8</sup>.

Ajo na ndihmon në marrjen e vendimeve dhe përzgjedhjen e objektivave për hetime të mëtejshme, planifikimin e operacioneve të vëzhgimit, burimet dhe menaxhimin e buxhetit si dhe lejon marrjen e përgjegjësi për të parandaluar krimin. Policimi proaktiv (parandalues) kërkon një përdorim masiv të inteligjencës nga agjencitë e zbatimit të ligjit, si mjetin kryesor dhe më efikas të luftës kundër krimit. Aq i rëndësishëm është përdorimi i efektshëm i procesit të inteligjencës, sa që nënkupton diferencën ndërmjet suksesit dhe dështimit, për një agjenci të zbatimit të ligjit. Inteligjenca sot mbështet një gamë të gjerë të luftës kundër kriminalitetit, në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar, sidomos të terrorizmit e të krimit të organizuar. Në mënyrë të veçantë, kur informacioni është i shumtë dhe shpesh konfuz e kontradiktor, inteligjenca mund të shënojë rrugën drejt politikave më efektive.

<sup>6</sup> Në përgjithësi pranohet se pjesa e “analizës” së procesit të inteligjencës përbëhet nga pesë nën pjesë: krahasimi, analiza, sinteza, abstragimi, përgjithësimi.

<sup>7</sup> *Criminal Intelligence and Intelligence Gathering*: University of Colorado Denver Police Department Standard Operating Procedure Nr. 309. 1. 2. 2012, f.1.

<sup>8</sup> Harris, *The Basic Elements of Intelligence*, 1976, f, 1-8.

Gjithashtu, inteligjenca kriminale mund të përdoret për të asistuar hetuesit, vëzhguesit, njësitë operacionale, procedimin penal, agjencitë e zbatimit të ligjit për të menaxhuar burimet, financat e të parandalojë krimet. Inteligjenca kriminale, promovon gjithashtu njohuri mbi bazën e të cilave vendoset dhe zgjidhet shënjestra (subjekti, grupi kriminal) për hetim. Përfshirja në këtë proces, edhe e teknikave të tjera analitike, nxjerr një produkt që do t'i shërbejë nivelit strategjik, operacional dhe teknik, në luftën kundër krimin të organizuar.

Le të marrim si shembull procesin e inteligjencës dhe teknikat analitike që përdor sot policia shqiptare, për matjen dhe standardizimin e vlerësimit të rrezikshmërisë dhe të kërcënimit nga grupet kriminale. Një ndër modelet e njohura, për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale, është modeli "Sleipnir"<sup>9</sup>. Ky model zbatohet nga agjencitë ligjzbatuese në Kanada<sup>10</sup>, por edhe në disa vende të Evropës. Modeli "Sleipnir" mundëson teknikën e një sistemi matjesh për të vlerësuar se sa i organizuar është krimi, se sa serioze është situata dhe se cilat janë grupet më të rrezikshme. Kjo teknikë analitike i lejon specialistët, të rendisin sipas rangut, në mënyrë të hollësishme dhe të saktë, grupet e krimin të organizuar. Ky model analizon krimin e organizuar nëpërmjet përcaktimit, përkufizimit dhe vlerësimit të aftësive dhe të cilësive të tij. Përgjithësisht janë 19 aftësi dhe cilësi të përcaktuara për t'u vlerësuar në një organizatë kriminale<sup>11</sup>. Secila nga 19 aftësitë dhe cilësitë, ka pesë nivele vlerësimi. Pasi bëhet vlerësimi i tipareve në vlerë numerike, plotësohet ajo që quhet matrica e rrezikut.<sup>12</sup> Kjo, në vetvete, është një teknikë analitike matjesh dhe rezultati i vlerësimit shprehet me vlera numerike.

Vlerësimi i rrezikut<sup>13</sup> synon që të analizojë karakterin, shtrirjen dhe pasojat e kriminalitetit. Ai bëhet për një grup apo për shumë grupe. Mund të jetë specifik, i lidhur

<sup>9</sup> Christopher Black, Tom Vander Beken, B. Frans: *Reporting on Organised Crime: A Shift from Description to Explanation in the Belgian Annual Report on Organised Crime*. Ghent University 2001, f.7-8.

<sup>10</sup> *Integrated Threat Assessment Methodology, Version 1.0*, Criminal Intelligence Service Canada.

<sup>11</sup> 19 aftësitë dhe cilësitë e përcaktuara për t'u vlerësuar në një organizatë kriminale janë konkretisht:

1. Korrupsioni, ndikim mbi procesin gjyqësor dhe në persona të rëndësishëm në jetën publike; 2. Dijet e ekspertëve. Për kryerjen me sukses të veprave penale duhen njohuri të veçanta. Për këtë arsye grupi shfrytëzon specialistë-ekspert me njohuri specifike të cilët mund të jenë anëtarë të grupit. Organizata sipas rastit përdor dhe shfrytëzon njohuritë edhe për ata që nuk janë anëtarë të grupit; 3. Disiplina, varësi të detyruara, mbështetjet në përdorimin e dhunës ose kërcënimit që mbajnë lidhur një grup; 4. Shkalla e informimit, mundësitë dhe aftësitë e një grupi për t'u informuar rreth aktiviteteve të agjencive ligjzbatuese dhe grupeve rivale; 5. Gatishmëria për dhunë, dëshirë e qartë për përdorim dhune e kërcënim; 6. Monopoli në drejtime të caktuara kriminale, kontrolli i një apo më shumë sektorëve kriminalë, brenda një hapësire gjeografike, pa tolerancë kundrejt konkurrencës. Dhuna dhe kërcënim janë metodat normale që mbajnë monopolin; 7. Strategjia, qëllimi i grupeve të krimin të organizuar, është të ruajnë ose rrisin madhësinë e sferës së tyre të influencës dhe ndikimit; 8. Izolimi-fshehja-maskimi, aftësia e grupit për të përdorur teknika vetjake komunikimi të cilat e mbrojnë nga ndërhyrjet e forcave policore; 9. Gatishmëria për të rrezikuar, gatishmëria e grupeve për të kryer vepra penale në kushte jo të favorshme (kamera vëzhgimi, shërbime sigurie në objekte, etj.); 10. Suksesi, veprat penale të kryera me sukses në një periudhë të caktuar; 11. Struktura, mënyra se si është ndërtuar dhe strukturuar grupi; 12. Madhësia, numri i anëtarëve aktivë apo pasivë të grupi; 13. Bashkëpunimi, shkalla e bashkëpunimit me grupet e tjera të krimin të organizuar; 14. Bashkëpunimi me grupet-organizatat e tjera ekstremiste terroriste dhe niveli i këtij bashkëpunimi; 15. Mobiliteti, shkalla dhe përhapja gjeografike e veprimtarisë së grupit; 16. Homogjeniteti-heterogjeniteti. Grupet homogjene, duke pasur prejardhje, tradita, zakone e gjuhë të përbashkët vlerësohen më lart se të tjerët; 17. Mesatarja e grupit, është mesatarja e veprimtarisë së grupit dhe mesatarja e parave që shpenzon për kryerjen e një vepre penale, apo shpenzime të tjera të grupit për t'u shmangur ndjekjes së agjencive ligjzbatuese; 18. Përvoja, operacionet kërkojnë zhvillimin e vënien në përdorim të metodave dhe proceseve komplekse të punës gjatë planifikimit, zbatimit dhe komunikimit; 19. Kohëzgjatja/vazhdimësia e grupit. Nëpërmjet kryerjes së shumë veprave penale, ose nëpërmjet kryerjes së veprave penale në një periudhë të gjatë kohore.

<sup>12</sup> Royal Canadian Mounted Police. "Sleipnir" *The Long Matrix for Organized Crime an Analytical Technique For determining relative levels of theat posed by organized crime groups*. Criminal Analysis Branch, Criminal Intelligence Directorate, 2000, f. l.

<sup>13</sup> Europol, *Strategic Intelligence Analysis Cours*, f. 49.


me një ose disa lloj krimesh, ose mund të jetë i përgjithshëm për të gjitha llojet e krimeve. Kur bëhet një vlerësim rreziku, shqyrtohen jo vetëm shkaqet, por edhe format se si mund të shfaqet ky rrezik dhe gjithashtu shqyrtohen pasojat e mundshme në shoqëri, sektorët që mund të jenë më të prekur dhe mundësitë që ekzistojnë për materializimin e tij. Vlerësimet e rrezikut shpesh kanë të bëjnë me perspektivat afatgjata dhe janë orientime strategjike për të ardhmen.

Ndërsa vlerësimi i kërcënimit, ka si qëllim që të identifikojë dhe të ekzaminojë pikat e dobëta të sektorëve, sistemeve (sektorë të ekspozuar, që preken lehtë nga veprimtaria kriminale) të cilët shfrytëzohen ose mund të shfrytëzohen për të shkaktuar dëmtime), karakterin e potencialeve kriminale dhe mënyrat e veprimit të përdorura prej tyre.

Model i matricës së rrezikut<sup>14</sup>

Dëshira	Disiplina			
	Shkalla informimit			
	Dhuna			
	Sigurimi sferës influencës			
	<b>Shuma e vlerave "dëshira"</b>	0	0	0
Çfare pritët	Strategjia			
	Fshelja, maskimi			
	Gatishmëria për të rrezikuar			
	<b>Suksesi</b>			
	<b>Shuma e vlerave "Çfare pritët"</b>	0	0	0
<b>Qëllimi =</b>	<b>Shumën e vlerave "Dëshira + Çfare pritët"</b>	0	0	0
Burimet	Struktura			
	Numri antarëve			
	Bashkëp grupet e krimit të organizuar			
	Bashkëp.Org.terroriste			
	Sfera gjeografike e aktivitetit			
	Homogjeniteti/heterogjeniteti			
	Mesatarja shpenzimeve për veprat penale			
	Korrupsioni			
	<b>Shuma e vlerave "Burimet"</b>	0	0	0
Njohuritë	Njohuritë e Eksperteve			
	Përvoja-eksperiencia			
	Kohëzgjatja/Vijueshmëria			
	<b>Shuma e vlerave "Njohuritë"</b>	0	0	0
<b>Aftësitë =</b>	<b>Shumën e vlerave "Burimet + Njohuritë"</b>	0	0	0
<b>Rreziku =</b>	<b>Shumën e vlerave të "Qëllim +Aftësitë"</b>	0	0	0
Demi				
Fitimi				
<b>Kërcënimi=</b>	<b>Shumën e vlerave "Rreziku + Demi + Fitimi"</b>	0	0	0

Paraqitje tabelore e elementeve të rrezikut dhe kërcënimit



Duke përdorur metodat e kësaj matrice dhe mbi bazën e vlerave numerike që i janë dhënë çdo tipari, grupet kriminale radhiten sipas rrezikshmërisë. Produkti i inteligjencës, i dalë nga ky proces, mundëson evidentimin e grupeve që përbëjnë “rrezik” apo “kërcënim” për sigurinë e vendit, duke u përcaktuar kështu edhe “radhën e punës” së agjencive ligjzbatuese ndaj tyre.

Plotësimi i matricës kërkon informacione të grumbulluara, vlerësuara, analizuara nga të gjitha burimet e disponueshme të policisë, pra, një inteligjencë të mirëfilltë kriminale. Por, a janë përfshirë në këtë proces vlerësimi, të dhëna nga shkencat ligjore?

## 2. Inteligenca e shkencave ligjore (forenze), kuptimi dhe roli i saj në procesin e policimit dhe të zbatimit të ligjit

Shkencat ligjore (forenze), sipas definicionit të tyre, luajnë një rol ndërmjetës midis fushave të specializuara të shkencës dhe zbatimit të ligjit. Më sipër ne trajtuam kuptimin e përgjithshëm të inteligjencës si dhe ciklin e inteligjencës. Ky model mund të zbatohet në kontekstin e shkencave ligjore, kur vetë këto janë ofruese të informacionit të ciklit të inteligjencës. Kjo lloj inteligjence njihet si inteligenca forenzike dhe është një lloj tjetër i inteligjencës kriminale. Nëse do të këmbëngulnim që ta shqipëronim, mund të quanin inteligenca e shkencave ligjore. Kolegët tanë në Kosovë e kanë futur në zhargonin profesional, por edhe zyrtar termin ndërkombëtar “forenzikë”. Gjithsesi, me kalimin e kohës do të shihet, nëse ky termin do të fillojë të përdoret gjerësisht në terminologjinë profesionale edhe në Shqipëri.


Inteligenca e shkencave ligjore (forenze), është një proces që fillon nga mbledhja e të dhënave, kryesisht në vendngjarje. Shfrytëzimi i tyre mbështetet plotësisht në cilësinë dhe sasinë e të dhënave të grumbulluara në vendin e ngjarjes. Prandaj, mund të thuhet se përfundimet e nxjerra dhe veprimet e kryera në vendngjarje, janë thelbësore për inteligjencën forenzike, pasi ato do të jenë tërësisht të përcaktuara nga të dhënat që do të mblidhen e që më pas do të shfrytëzohen. Një variant i procesit të inteligjencës forenze, e shprehur në mënyrë skematike do të ishte si në skemën e faqes përballë.

Pra, mund të themi se inteligenca e shkencave ligjore, është produkti i saktë, në kohë dhe, i dobishëm, i përpunimit të së dhënave logjike të shkencave ligjore<sup>15</sup>. Në njëfarë mënyre burim i kësaj inteligjence, janë të dhënat e grumbulluara, të përpunuara e të analizuara të rasteve të ndryshme të shkencave ligjore. Produkti i inteligjencës së shkencave ligjore, siguron njohuri mbi aktivitetin kriminal dhe mund të mbështesë qasjet proaktive dhe parandaluese ndaj krimit<sup>16</sup>. Thelbi i kësaj inteligjence është se, në vend që të trajtojmë çdo rast individualisht, me synimin e dërgimit të një çështjeje në gjykatë, të shohim ngjashmëritë në më shumë çështje, duke u bazuar në studimin e fenomeneve të krimit, si dhe në njohuritë e fituara pas arrestimit të një të dyshuari, mund t’i ripërdorim dhe përpunojmë ato, për raste të tjera. Studimi i konkluzioneve të nxjerra gjatë zgjidhjes së çështjeve të veçanta, është një qasje e dobishme, për të analizuar

<sup>14</sup> Variant i ripunuar i matricës publikuar në “Udhëzues për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale” Pika 4. Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 996, datë 1. 9. 2009.

<sup>15</sup> O. Ribaux, A. Girod, S. J. Walsh, P. Margot, S. Mizrahi, V. Clivaz: “Forensic intelligence and crime analysis”. *Law, Probability and Risk*, Volume 2, Issue 1, 1 March 2003. Oxford University Press, 2003, f. 50.

<sup>16</sup> Eva Bruenisholz, Sameer Prakash and Alastair Ross: *The intelligent use of forensic data*. Sydney: ANZPAA National Institute of Forensic Science (ANZPAA NIFS), 2015, f.3.



se si duhet të integrohen të dhënat shkencore të shkencave ligjore, në inteligjencën kriminale. Kështu, ajo erdhi duke u profilizuar si një inteligjencë më vete. Në thelbin e saj inteligjenca e shkencave ligjore është rezultat i një procesi që synon transformimin e të dhënave të grumbulluara dhe përpunuara nga vendi i ngjarjes, i ekzaminimeve të tyre në bazat e të dhënave të ndryshme, të administrimit të së dhënave biometrike,

## AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë shkencore ndërkombëtare:*

« Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë »

traseologjike, balistike etj., në një formë më të përshtatshme për marrjen e vendimeve. Qëllimi është shtimi i vlerës së informacionit të mbledhur, duke e analizuar këtë të fundit në mënyrën e duhur.

Pra, intelijenca e shkencave ligjore i referohet përpunimit dhe asimilimit të strukturuar të së dhënave të rasteve të shkencave ligjore (të tilla si ADN-ja, gjurmët e gishtave, etj.), brenda një grupi të së dhënave të referuara dhe të indeksuara. Ky grup i të dhënave mund t'i nënshtrohet analizës rigoroze cilësore dhe sasiore, për të identifikuar modelet kuptimplota të veprimtarisë kriminale. Nga kjo pamje, mund të ndërmerren një gamë e gjerë veprimesh operacionale për të parandaluar rastet e mëvonshme, madje edhe identifikimin dhe arrestimin e të dyshuarve, ose, për të përshkruar profilin e autorit të veprës (gjeografik, kohën, *modus operandi*, veçori të tjera, etj.). Një analizë e tillë e të dhënave, konsiderohet strategjike, përdërisa mundëson përdorimin nga vendimmarrësit të informacionit të analizuar, për të informuar strukturat e policisë si dhe për hartimin e politikave, për të luftuar kundër krimit. Pra, përfitimet e përgjithshme të zbatimit të një modeli të inteligjencës ligjore në kuadër të zbatimit të ligjit do të përfshijnë përfitime konkrete dhe një kuptim më të mirë të tërësisë së aktivitetit kriminal, etj.<sup>17</sup>

Megjithatë, duhet pranuar se, intelijenca ligjore nuk është provë, siç mund të keqkuptohet ndonjëherë. Ajo është vetëm një produkt i një procesi, që më vete apo i kombinuar me forma të tjera të inteligjencës, na çon tek autori dhe tek provat. Kur jepet një informacion me shkrim, në këtë rast, thjesht duhet të theksohet se nuk është akt përfundimtar ekspertimi, ose është raport paraprak dhe jo për qëllime gjyqësore. Përdorimi i të dhënave të hershme ose paraprake të inteligjencës ligjore nuk cenon integritetin, standardet etike të punonjësve të shkencave ligjore, por as dhe standardet e akreditimit.

Trajtimi i inteligjencës së shkencave ligjore edhe në botë është në fillimet e veta, pasi fokusi i shkencave ligjore ka qenë tradicionalisht zgjidhje e rasteve konkrete të krimit dhe paraqitja e çështjeve në gjykatë. Intelijenca e shkencave ligjore është diçka e re si koncept edhe për vetë shkencat ligjore dhe shërbimet policore, ndonëse oficerët e policisë janë më të familjarizuar me konceptin e inteligjencës nëpërmjet njohurive dhe aftësive që ata zotërojnë për inteligjencën kriminale. Për një qasje pozitive, gjithëpërfshirëse dhe mbështetëse ndaj inteligjencës ligjore, nevojitet një ndryshim në mendësi. Përhapja e këtij koncepti do të ndeshë disa sfida pasi shkencat ligjore, si fillim, kanë vështirësi në ofrimin e inteligjencës, pasi intelijenca është një koncept i ri dhe të dhënat e shkencave ligjore janë të vështira për t'u standardizuar, kombinuar dhe analizuar.

Në të vërtetë, sot në botë, një numër në rritje i profesionistëve të forenzikës, besojnë se shkencat ligjore kanë nënvlerësuar kontributin e tyre të mundshëm në reduktimin e krimit dhe, kanë një rol më të rëndësishëm për të luajtur, në policim<sup>18</sup>. Gjithashtu, edhe politika në nivel evropian, po nxit agjencitë e brendshme të zbatimit të ligjit, si prodhuesit, konsumatorët dhe furnizuesit e informacionit dhe inteligjencës së shkencave ligjore, për të zgjeruar dhe për të përshpejtuar aftësitë e tyre teknologjike për të mbledhur dhe përhapur informacionin dhe inteligjencën forenzike në kuadër të zgjerimit të kufijve operacionale. Për shembull, ekzistojnë një numër marrëveshjesh që premtojnë

<sup>17</sup> Eva Bruenisholz, et al., burim i cituar, f. 4.

<sup>18</sup> Carole McCartney: "Forensic data exchange: ensuring integrity". *Australian Journal of Forensic Sciences*. Volume 47, 2015 - Issue 1, f.36.



shkëmbimin automatik së të dhënave ligjore, në nivel ndërkombëtar, në veçanti shenjat e gishtërinjve, profilet e ADN-së dhe së të dhënave të automjeteve si dhe ndarjen e informacione të tjera të zbatimit të ligjit nëpërmjet një sërë kanalesh.<sup>19</sup>

Për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm të inteligjencës ligjore duhet të investohet kohë dhe përpjekja në tri nivele të procesit të policimit, në atë strategjik, operacional, por dhe atë individual. Angazhimi i plotë në inteligjencë do të kërkojë ndryshime organizative dhe kulturore, por dhe në sistemet e teknologjisë së informacionit dhe bazave së të dhënave. Duhet të synohet implementimi i programeve, të cilat “krijojnë mundësinë që të dhënat e vendit të ngjarjes dhe rezultatet e testeve laboratorike, duhet të integrohen në një sistem të vetëm për të lejuar analizë dhe vlerësim të shpejtë”<sup>20</sup>.

Gjithashtu, duhet rritur shkalla e besimit të ndërsjellë mes specialistëve të shkencave ligjore me ata të hetimit të krimit, në mënyrë që specialistët e forenzikës, të mos kufizojnë dhënien në kohë, ndaj specialistëve të hetimit, së të dhënave potencialisht të dobishme për qëllime të inteligjencës, për shkak të barrierave të panevojshme. Për të pasur sukses modeli i inteligjencës forenzike, është e domosdoshme nxitja e një bashkëpunimi midis specialistëve të shkencave ligjore, specialistëve të hetimit të krimit si dhe të atyre të njësive të inteligjencës.

Duke u nisur nga parimi i mësipërm, që shkëmbimi i shpejtë i informacionit është thelbësor për suksesin e inteligjencës ligjore, është e dobishme që të dy, hetuesit dhe ekspertët ligjorë të kuptojnë se zbulimi i ekspertëve ligjorë në kuadrin e inteligjencës, zhvillohet dhe përdoret në një kontekst tjetër nga ato për provat e përgatitura për gjykatat (objektivi tradicional i shkencave ligjore). Ky kuptim duhet të mbështetet nga procedurat standarde, ndërorganizative dhe nga një nivel besimi që inteligjenca do të përdoret për qëllimet për të cilat është prodhuar<sup>21</sup>.

Gjithashtu, çdo nismë për krijimin e kapaciteteve dhe aftësive të inteligjencës së shkencave ligjore, duhet të përfshijë një grup të veçantë, me përgjegjësi për menaxhimin dhe shpërndarjen e produktit të inteligjencës, deri tek përdoruesit përfundimtarë. Kjo është e rëndësishme. pasi inteligjenca e shkencave ligjore nuk duhet të jetë qëllim me vete, por duhet të jetë pjesë e inteligjencës më të gjerë kriminale.

Produkti i inteligjencës forenzike, duhet të përdoret me integritet. Integriteti është thelbësor për një besim të ndërsjellë mes aktorëve dhe konsumatorëve direkt të inteligjencës së shkencave ligjore. Për të ruajtur integritetin e kësaj inteligjence, vëmendja duhet t’i kushtohet jo vetëm qëndrueshmërisë së prodhimit dhe shkëmbimit të produktit të inteligjencës së shkencave ligjore, por edhe legjitimitetit dhe pranueshmërisë<sup>22</sup>. Gjithashtu, duhet të sigurohen mundësi të mjaftueshme për stafet e shkencave ligjore dhe të hetimit të krimit, për të shkëmbyer informacion mbi proceset, kërkesat dhe vëzhgimet në një mjedis të hapur për zgjidhjen e problemeve, afërsisht se ç’diskutojnë mes vetes ekspertët e shkencave ligjore, për një rast të tyrin kompleks shkencor. Për të inkurajuar bashkëpunimin në vazhdim, duhet të praktikohet dhe *feedback*-u për të siguruar që stafi i shkencave ligjore të jetë i informuar për sukseset e arritura përmes

<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> O’Malley, Troy. “Forensic informatics enabling forensic intelligence”. *Australian Journal of Forensic Sciences* 47, no. 1 (2015): 36-48.

<sup>21</sup> Eva Bruenisholz, Sameer Prakash and Alastair Ross: *The intelligent use of forensic data*. Sydney: ANZPAA National Institute of Forensic Science (ANZPAA NIFS), 2015, f. 7.

<sup>22</sup> Carole McCartney, po aty.

produktit të inteligjencës së tyre.

### 3. Shkencat ligjore shqiptare mes tradicionales dhe konceptit të ri të inteligjencës ligjore

Në praktikën shqiptare, me investimet që ka kryer shteti shqiptar në vite, në institucionet që mbulojnë shërbimet e shkencave ligjore si dhe me projektet që janë mbështetur nga partnerët tanë, ka filluar në praktikë zbatimi i inteligjencës ligjore. Tek ne, përdorimi i bazave së të dhënave të sistemit AFIS, sistemit CODIS (ADN) dhe ARSENAL etj., dëshmojnë një nga format më të zakonshme të inteligjencës së shkencave ligjore që bazohet në të dhënat e rasteve të kriminalistikës ligjore e që ndihmon në përcaktimin e burimit të një gjurme. Implementimi i projektit të financuar nga Bashkimi Evropian, për vendosjen e *Live* të skanerëve në pikat e kalimit kufitar dhe drejtoritë e policive të qarqeve, e ka shtrirë këtë proces edhe në strukturat vendore të policisë.

Përparimet shkencore të kohëve të fundit dhe ekspertët tanë të mirëtrajnuar, kanë mundësuar nxjerrjen nga bazat e të dhënave të kornizave, që përcaktojnë alelet (karakteristikë e veçantë e profilit), për më shumë se një individ (sipas zonave gjeografike). Për shembull, krahasimi i një profili të ADN-së, veçoritë e zgjedhura nga një profil i ADN-së mikser, ose një profil ADN-je me përputhje të pjesshme (i cili është ndërtuar nga profili i anëtarëve të familjes) mund të përputhet me më shumë se një nga mostrat (në rastet e lidhjeve gjinore), që gjenden në bazën e të dhënave. Dhe kështu, përdorimi i bazave së të dhënave të ADN-së, për të identifikuar të dyshuarit e mundshëm përmes krahasimit të profileve të ADN-së, me përputhje të pjesshme, i kombinuar me forma të tjera të inteligjencës, ka ndihmuar më pas me identifikimin e autorit, dokumentimin e aktivitetit të tij kriminal dhe dërgimit e çështjes në gjykatë me prova “të kopsitura” mirë. Kjo ka dhënë rezultate pozitive në zbulimin e disa veprave të rënda penale kohët e fundit, në Qarkun e Tiranës.

Por, pavarësisht investimeve të kryera, mungojnë programet të cilat krijojnë mundësinë që të dhënat e vendit të ngjarjes, të jenë *online*, në laboratorët e strukturave të shkencave ligjore dhe që rezultatet e testeve laboratorike, të integrohen në një sistem të vetëm, për të mundësuar një analizë dhe një vlerësim të shpejtë. Gjithashtu, ka një shkëputje mes bazës së të dhënave të laboratorëve të strukturave të shkencave ligjore, me bazën e të dhënave strukturave të hetimit të krimit. Kjo, në njëfarë mënyre, kufizon specialistët e hetimit të krimit në monitorimin e statusit të analizës së rasteve që ata kanë në hetim, duke krijuar kështu vonesa dhe pengesa, jo vetëm në çështjen në ndjekje, por edhe në inteligjencën kriminale. Një qasje më e plotë e specialistëve të hetimit të krimeve, në sistemin e menaxhimit të informacionit të institucioneve që grupojnë veprimtaritë e shkencave ligjore, jo vetëm që do të shtonte efikasitetin e veprimtarisë së tyre investigative, por do të rriste edhe rolin dhe “peshën specifike” të këtyre institucioneve, në inteligjencën kriminale.

Implementimi i inteligjencës së shkencave ligjore duhet të kthehet në një prioritet për institucionet e këtyre strukturave, sepse përfitimet e përgjithshme të zbatimit të një modeli të inteligjencës ligjore, në kuadër të zbatimit të ligjit, do të përfshijnë dhe jo vetëm:

- identifikimin e hershëm së të dyshuarve, mbështetje për një qasje proaktive dhe parandaluese ndaj krimit;
- përfitime në kohë dhe kosto;

- përdorimi më efektiv i gjurmëve të forenzikës për të informuar policinë dhe strukturat e sigurisë;
- përfitimet të përgjithshme e të prekshme të lidhura vlerësimin e rrezikut dhe të kërcënimit si dhe një kuptim më të mirë të situatës së kriminalitetit;
- bashkimi i dy apo më shumë i ngjarjeve kriminale me prova shkencore që i ka lënë i njëjti person, por që për momentin nuk disponohen të dhënat e tij në databazat e policisë.

Ne jemi në fillimet e implementimit të inteligjencës ligjore dhe kemi për të kapërcyer disa pengesa, të cilat konsistojnë në drejtim të nevojës së:

- Edukimit dhe trajnimit të aktorëve pjesëmarrës si prodhues dhe konsumatorë të produktit të inteligjencës së shkencave ligjore. Meqenëse në vendin tonë, trajtimi i inteligjencës së shkencave ligjore është akoma në fillimet e veta, është e nevojshme përfshirja e tij në procesin e arsimit dhe të trajnimit të së gjithë aktorëve që kanë lidhje me këtë proces. Një trajnim i tillë, është i domosdoshëm për maksimalizimin e dobisë nga intelijenca e shkencave ligjore. Kurrikulat e tanishme të arsimit dhe të trajnimeve në këtë fushë, janë të paplotësuara me njohuritë e nevojshme për rolin e inteligjencës ligjore në kontekstin e inteligjencës kriminale. Fillimisht, trajnimi duhet të marrë një qasje të ndërgjegjësimit, në mënyrë që praktikuesit dhe përdoruesit fundorë, të kenë njohuri dhe kuptim të koncepteve. Në të njëjtën kohë, është e nevojshme që edhe menaxhuesit e lartë, të kuptojnë inteligjencën ligjore, të njohin rreziqet dhe përfitimet dhe të angazhohen në mbështetje të procesit të ndryshimit<sup>23</sup>. Trajnimi, edhe në nivel strategjik, është i domosdoshëm.

- Ndryshimit të mendësive të vetë punonjësve të strukturave të shkencave ligjore. Intelijenca e shkencave ligjore është një koncept i ri, që kërkon ndryshim në mendësinë edhe të vetë specialistëve të agjencive të shkencave ligjore, të cilët, duke mos u larguar nga fokusi tradicional i zgjidhjes së rasteve konkrete të krimit dhe paraqitja e çështjeve në gjykatë, kanë nënvlerësuar mundësinë dhe kontributin e tyre të mundshëm në reduktimin e krimit.

- Ndryshimeve strukturore e organizative. Implementimi i inteligjencës së shkencave ligjore po tregon gjithnjë e më tepër se institucionet që mbulojnë shërbimet e shkencave ligjore kanë një rol në rritje në procesin e policimit dhe të parandalimit të krimit, në këto kushte ka vend për të rishikuar organizimin dhe varësinë e tyre strukturore.

- Ndërhyrjes dhe përshtatjes, në funksion dhe të procesit të inteligjencës së shkencave ligjore, të sistemit të tanishëm të teknologjisë së informacionit dhe bazave së të dhënave të institucioneve të shkencave ligjore dhe të strukturave të hetimit të krimit.

Mjedisi i sigurisë, sot karakterizohet nga një kompleksitet në rritje dhe një nivel parashikimi në ulje, me rreziqe e kërcënime më të ndërlikuara dhe më të ndërvarura se në të kaluarën. Ato ndërthurin kërcënimet tradicionale konvencionale dhe ato jokonvencionale, të shkaktuara nga krimi i organizuar, individë të korruptuar, terrorizmi, etj. Në kushtet e një mjedisi të tillë, gjithnjë e më të pasigurt, merr një rëndësi të madhe intelijenca dhe, në këtë kuadër, edhe ajo e shkencave ligjore. Ne duhet kërkojmë politikëbërësve, mbështetje për të bërë ndryshimet e duhura, me qëllim që të arrihet në maksimumin e dobisë nga intelijenca e shkencave ligjore në një periudhë afatmesme. Kjo, është përgjegjësia jonë. Përndryshe, nuk duhet të mërzitemi kur të dëgjojmë shpesh fjalën “dështim i inteligjencës” dhe gishti të drejtohet drejt nesh, pasi siç

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>23</sup> Eva Bruenisholz, Sameer Prakash dhe Alastair Ross, burim i cituar, f.8.

thotë Stan A. Taylor, një ekspert i sigurisë kombëtare me përmasa ndërkombëtare: “Fraza “dështim politik” dëgjohej rrallëherë, ndërsa fraza “dështim i inteligjencës” dëgjohej përherë e më shpesh”. Nëse funksionon një iniciativë qeveritare, ajo pasqyrohet gjithnjë si një “sukses politik”, por rrallëherë si “sukses i inteligjencës”. Nëse një politikë qeveritare nuk është e suksesshme, mediet mbushen plotë me akuza për “dështim inteligjence”, por rrallëherë shihet ose dëgjohej shprehja “dështim politik”<sup>24</sup>.

## 4. Përfundime

Pas studimit dhe hulumtimit në këtë punim, të inteligjencës së shkencave ligjore, të rolit të saj në kuadër të policimit dhe të zbatimit të ligjit, arrijmë në përfundimin se:

Inteligjenca e shkencave ligjore është produkti i saktë, në kohë dhe i dobishëm i përpunimit të dhënave logjike të shkencave ligjore. Në thelbin e saj është rezultat i një procesi që synon transformimin e të dhënave të papërpunuara, në një formë më të përshtatshme, për marrjen e vendimeve. Qëllimi, është që të shtojë vlerën e informacionit të mbledhur, duke e analizuar atë në mënyrën e duhur, në funksion të zbatimit të ligjit dhe të një policimi më efektiv. Pavarësisht rolit në rritje, inteligjenca e shkencave ligjore nuk duhet të jetë qëllim më vete, por pjesë e inteligjencës më të gjerë kriminale. Inteligjenca ligjore nuk është provë për në gjykatë. Ajo është një produkt i një procesi, që më vete, apo e kombinuar me forma të tjera të inteligjencës, na çon tek autori dhe tek provat.

## 5. Rekomandime

Sa më sipër, për zhvillimin dhe zbatimin e suksesshëm të inteligjencës ligjore do të ishte e rekomandueshme:

- mbështetja e një studimi të thelluar, në rang të organizatës policore dhe më gjerë, me synim analizimin e gjendjes, identifikimin e problemeve dhe rekomandimin e politikave për mbështetjen dhe implementimin e suksesshëm të zbatimit të inteligjencës së shkencave ligjore në procesin e policimit dhe të zbatimit të ligjit në vend.

- organizimi i punës për edukimin, trajnimin dhe ndryshimin e mendësive të aktorëve pjesëmarrës, si prodhues dhe konsumatorë të produktit të inteligjencës së shkencave ligjore, me qëllim maksimalizimin e dobisë nga inteligjenca e shkencave ligjore në procesin e policimit dhe të zbatimit të ligjit;

- për këtë, të investohet kohë dhe përpjekje në tri nivele të procesit të policimit: në atë strategjik, operacional, por dhe në atë individual;

- mbështetja e ndryshimeve strukturore, në institucionet që mbulojnë shërbimet e shkencave ligjore në funksion të konsolidimit të procesit të filluar, të implementimit të inteligjencës së shkencave ligjore;

- përshtatja e sistemit të tanishëm të teknologjisë së informacionit dhe bazave së të dhënave të institucioneve të shkencave ligjore dhe, të strukturave të hetimit të krimit, në funksion të arritjes së sinergjisë së dëshirueshme, në procesin e inteligjencës së shkencave ligjore dhe të inteligjencës kriminale.

<sup>24</sup> Stan A. Taylor: “Roli i shërbimeve të inteligjencës në sigurinë kombëtare” në *Strategy in the contemporary world*. Oxford University Press, 2007; Tiranë: UET press, 2012, f. 323.

## Referenca

1. Michael I. Handel : *Sun Tzu and Clausewitz: The art of war and on war compared*. Strategic Studies Institute. U.S. Army War College. Carlisle Barracks, Pennsylvania. 1991.
2. O. Ribaux, A. Girod, S. J. Walsh, P. Margot, S. Mizrahi, V. Clivaz: "Forensic intelligence and crime analysis". *Law, Probability and Risk, Volume 2, Issue 1, 1*, March 2003. Oxford University Press 2003.
3. Stan A. Taylor: "Roli i shërbimeve të inteligjencës në sigurinë kombëtare" në *Strategy in the contemporary World*. Oxford University Press, 2007. UET Press, Tiranë 2012.
4. Thomas G. Mahneken: "Teoria e strategjisë" në *Strategy in the contemporary world*. Oxford University Press, 2007. Uet Press, Tiranë 2012.
5. *Criminal Intelligence and Intelligence Gathering*: University of Colorado Denver Police Department Standard Operating Procedure Nr.309.1.2.2012.P.1.
6. Harris ,*The Basic Elements of Intelligence* , 1976.
7. Christopher Black, Tom Vander Beken, B. Frans: *Reporting on Organised Crime: A Shift from Description to Explanation in the Belgian Annual Report on Organised Crime*.Ghent University 2001.
8. Integrated Threat Assessment Methodology/Version 1.0/ *Criminal Intelligence Service Canada*.
9. Royal Canadian Mounted Police. "Sleipnir" *The Long Matrix for Organized Crime an Analytical Technique For determining relative levels of theat posed by organized crime groups*" Criminal Analysis Branch, Criminal Intelligenc Directorate, 2000.
10. O'Malley, Troy. "Forensic informatics enabling forensic intelligence". *Australian Journal of Forensic Sciences* 47, no. 1 (2015): 36-48.
11. Carole McCartney: "Forensic data exchange: ensuring integrity". *Australian Journal of Forensic Sciences, Volume 47, - Issue 1*, 2015.
12. Europol, *Strategic Intelligence Analysis Course*.
13. Eva Bruenisholz, Sameer Prakash and Alastair Ross: *The intelligent use of forensic data*. Sydney: ANZPAA National Institute of Forensic Science (ANZPAA NIFS), 2015
14. Policia e Shtetit. "Udhëzues për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale" miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 996, datë 01.09.2009.

# Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri

Dr. Bajram IBRAJ<sup>1</sup>

Kolegji ISPE, Kosovë

bajramibraj@yahoo.com

## Abstrakt

*Në kuadrin e objektit, qëllimit dhe synimit të kësaj konference, kam përgatitur punimin për identifikimin e përcaktimin e sfidave kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Ky punim trajton problemet më serioze dhe sfidat kryesore të sigurisë kombëtare, në raport me aspektet gjithëpërfshirëse të institucioneve demokratike dhe kriminalitetit të organizuar bashkëkohor, të cilat përbëjnë dhe konsiderohen nga të intervistuarit dhe të anketuarit, reziqe e kërcënime kryesore për sigurinë kombëtare në Shqipëri.*

*Punimi ka si synim, provimin e lidhjes dhe ndikimin që mbartin në vetvete, siguria kombëtare dhe sfidat e saj në raport me krimin e organizuar transnacional në Shqipëri. Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve demokratike të Shqipërisë mbetet e kushtëzuar nga parandalimi, goditja dhe lufta e krimin të organizuar transnacional. Prandaj, ky punim synon të trajtojë aspekte si, sfidat dhe specifikat e sigurisë kombëtare në Shqipëri. Kjo gjë do të zhvillohet me analizë krahasuese, mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervista të thelluara me personalitetet e larta shtetërore, publike, shoqërore, politikanë, ministra, deputetë, zyrtarë të lartë të zbatimit të ligjit, juristë, studiues, pedagog e profesorë, ekspertë të sigurisë e Policisë së Shtetit, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të njohur në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë; analizë krahasuese mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorëve me studentë të anketuar të studimeve bachelor e master për drejtësi dhe studime të sigurisë në universitetet publike dhe private në Tiranë dhe Prishtinë; dhe, me dokumentin e “Strategjisë së sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë, 2014”.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

## Fjalëkyçe:

**siguria kombëtare, krim i organizuar, korrupsion, sundimi i ligjit.**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>1</sup> Drejtues-ekuivalent, “gjeneralmajor”, në pension; gradë shkencore “Doktor” në shkencën sociale, me profil shkencë politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare; Drejtor i Sigurisë Fizike dhe Kryetar i Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Intesa Sanpaolo Bank Albania. Kryetar i Komitetit të Sigurisë Bankare, Shoqata Shqiptare e Bankave të Nivelit të Dytë. Pedagog i lëndëve Krimi i organizuar, Bazat e veprimtarisë policore, Politika kriminale dhe Menaxhimi strategjik në Kolegjin ISPE - Studime Evropiane për të Ardhme Evropiane, Prishtinë, Kosovë.

## 1. Hyrje

### 1.1 Qëllimi dhe objektivat e punimit

Punimi është i fokusuar në gjendjen dhe situatën e sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë. Objektivat kryesore të punimit janë fokusuar në identifikimin dhe analizën e këtyre aspekteve: *së pari*, në vështrimin e sfidave të sigurisë kombëtare; *së dyti*, në hulumtimin në nivelin lokal, Shqipëri; *së treti*, gjykimi i ekspertëve në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertëve ndërkombëtarë mbi sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri - analizë krahasuese; *së katërti*, analizë-krahasuese e sfidave të sigurisë kombëtare mbi bazën e përgjigjeve të pyetësorëve dhe intervistave të thelluara me personalitetet shtetërore, publike e ekspertët dhe dokumentit “Strategjia e sigurisë kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2014”.

### 1.2 Pyetja kërkimore

Pyetja kërkimore bazë që ngre punimi është. Cilat janë sfidat kryesore të sigurisë kombëtare të Shqipërisë?

### 1.3 Hipoteza e punimit

Punimi synon t’i japë përgjigje kësaj hipoteze: “Siguria kombëtare dhe funksionaliteti i institucioneve të sigurisë s, Shqipërisë mbeten të kushtëzuara nga parandalimi, goditja dhe lufta kundër krimit të organizuar transnacional”.

### 1.4 Modeli analitik dhe metodologjia

Realizimi i punimit ka ndjekur një metodologji që diktohet nga vetë lënda e punimit.

Metodologjia e përzgjedhur është metodologjia analitike e kombinuar me qasjen cilësore, përshtatet me qëllimin dhe objektivat e punimit, pyetjen kërkimore dhe hipotezën fillestare. Për përgatitjen e këtij punimi, u përdoren dy burime parësore: Burimi i parë parësor pyetësorët dhe burimi i dytë intervistat e thelluara. Gjithashtu, u përzgjedhën dy kampione. Kampioni i parë u zgjodh me kujdes duke përzgjedhur 120 persona sipas katër target-grupeve: 1. personalitete e zyrtarë të lartë shtetërorë e publikë; 2. studiues, pedagogë, profesorë; 3. oficerë e drejtues policie, prokurorë, gjyqtarë, avokat, ekspertë të sigurisë; 4. gazetarë, opinionistë, përfaqësues të shoqërisë civile. Kampioni u zgjodh me persona nga Shqipëria, Kosova dhe ekspertë të huaj.

Ndërsa, në kampionin e dytë u zgjodhën 702 studentë të anketuar të fakulteteve të Drejtësisë dhe Studimeve të Sigurisë në *bachelor* e master në katër universitete, nga të cilat dy universitete në Shqipëri, dhe dy universitete në Kosovë: Universiteti i Tiranës dhe ai i Prishtinës, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Kolegji Studime Evropiane, për të Ardhmen Evropiane (ISPE), Fakulteti Studime të Sigurisë, në Prishtinë, si dhe Akademia e Sigurisë, Tiranë. Të dy kampionet dhe target-grupet u zgjodhën me qëllimin për të përfituar një panoramë sa më të gjerë, të problematikave që lidhen me sfidat themelore të sigurisë kombëtare dhe krimin e organizuar transnacional, të cilat janë objekt i punimit.

Metodologjia e kërkimit shkencor është bazuar në instrumente kualitative si dokumente, konventa, ligje, 40 intervista të thelluara, si burime cilësore për provimin e hipotezës. Të dhënat e plotësuara nga të intervistuarit dhe të anketuarit janë përfshirë në një program të veçantë, janë përpunuar rezultatet e tyre dhe mbi bazën e tyre janë prodhuar tabela, grafike dhe figura. Mbledhja e të dhënave ka vazhduar gjatë viteve 2015-2016. Të dhënat demografike bazë, të institucioneve arsimore të së anketuarve, paraqiten në tabelën 1.

**Tabela 1. Të dhëna demografike bazë të institucioneve arsimore të së anketuarve.**

Vendi	Institucioni Arsimor i të anketuarve	Nr. i të përgjigjurve
Shqipëri	Akademia e Sigurisë, Tiranë	200
	Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë	200
Kosovë	Kolegji Universitar ISPE, Fakulteti i Studimeve të Sigurisë, Prishtinë	150
	Universiteti "Hasan Prishtina", Fakulteti Drejtësisë, Prishtinë	152
Total		702

Anketimi në dy universitete, në Shqipëri, përfshiu 400 studentë ose 56.98%, nga të cilët: 200 studentë ose 28.50%, në Akademinë e Sigurisë, Tiranë dhe, 200 studentë ose 28.50%, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë; si dhe, dy universitete në Kosovë, me 302 studentë ose 43.02%, nga të cilët: 150 studentë ose 21.36 %, në Kolegjin Universitar ISPE Prishtinë, dhe 152 studentë ose 21.64%, në universitetin “Hasan Prishtina”, Prishtinë.

Shtetësia e të anketuarve, rezulton si më poshtë: në Shqipëri 400 studentë ose 56.98%, në Kosovë 302 studentë ose 43.02%. Ndërsa, gjininë e të anketuarve është 376 femra ose 53.56%, dhe 326 meshkuj ose 46.44% e të anketuarve. Fusha e studimit dhe numri i të anketuarve paraqiten në tabelën 2, ndërsa, dega dhe viti i studimit së të anketuarve paraqiten në tabelën 3.



**Tabela 2. Fushat e studimit të anketuarve.**

Nr.	Fusha e studimit	Nr. i të anketuarve
1	Drejtësi	352
2	Studime të Sigurisë	150
3	Siguri dhe Hetime Kriminale	170
4	Rend dhe Siguri Publike	30
	Total	702

**Tabela 3. Dega dhe viti i studimit së të anketuarve.**

Dega e Studimit	Viti i Parë		Viti i Dytë		Viti i Tretë		Viti i Katërt
	Studime të Sigurisë	Drejtësi	Rend dhe Siguria publike	Siguria dhe Hetimi Kriminal	Studime të Sigurisë	Studime të Sigurisë	Drejtësi
Nr i të Anketuarve	166	217	30	47	38	50	152
% e të Anketuarve	24%	31%	4%	7%	5%	7%	22%

Nga analiza e të dhënave të tabelës 3 rezultojnë se: nga 702 të anketuar, në vitin e parë janë anketuar 166 studentë ose 24%, në vitin e dytë 352 studentë ose 47%, në vitin e tretë 50 studentë ose 7% dhe në vitin e katërt 152 studentë ose 22% e të anketuarve.

#### 1.4.1. Modeli i hulumtimit

Modeli i hulumtimit mbi të cilin mbështetet punimi është analiza krahasimore duke u fokusuar në kontekstin lokal, Shqipëria.

#### 1.4.2 Mbledhja dhe analizimi i të dhënave

Për vetë natyrën e punimit, skema për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave ka kaluar nëpërmjet disa fazave si: përcaktimi apo zgjedhja e modelit; vlerësimi i modelit; vlefshmëria e modelit në mbledhjen e të dhënave; menaxhimi i të dhënave; përshkrimi statistikor; analiza strukturore është mbështetur në, - analizën “e drejtuar nga modelet e zgjedhura”, dhe në analizën “e drejtuar nga të dhënat e grumbulluara”; përmes një “laboratori analitik”, tabelimi, grafikimi; përfundime dhe rekomandime të rezultateve.

## 2. Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri

Çështjet e sigurisë kombëtare kanë rëndësi themelore, të rëndësishme dhe vendimtare për çdo shtet, vend dhe shoqëri, në aspektin e brendshëm dhe në aspektin e jashtëm, si dhe për bashkëpunimin rajonal e ndërkombëtar me shtete e organizata ndërkombëtare. Sfidat, rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë së pari, duhen njohur e vlerësuar ato dhe strategjitë, dokumentet e planet e miratuara, dhe së dyti, duhen marrë masa për zbatimin rigoroz të tyre me qëllim krijimin e sigurisë së duhur, zhvillimit ekonomik e shoqëror, stabilitetit të vendeve dhe sigurimit të jetës, mirëqenies dhe lirive e të drejtave të njeriut. Sipas Alan Collins në librin “Studime bashkëkohore të sigurisë”: “*Si kërcënim ndaj sigurisë*”

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

kombëtare konsiderohet një veprim ose një sërë veprimesh që (1) kërcënojnë, në mënyrë drastike dhe brenda një intervali të shkurtër kohor cilësinë e jetës së banorëve të një shteti, ose (2) kërcënon të ngushtojë në mënyrë thelbësore gamën e zgjedhjeve politike në dispozicion të qeverisë së një shteti ose të entiteteve private, joqeveritare (të tilla si individë, grupe apo korporata) brenda shtetit.” Richard H. Ullman, “Ripërkufizimi i Sigurisë”, International Security, 8/1(1983).<sup>2</sup> Ndërsa, sipas Barry Busan, Ole Waever dhe Jaap de Wilde në librin e tyre me titull: “Siguria: Një kuadër i ri analize”, qasje kjo e cila u bë e njohur si Shkolla e Kopenhagës, nocioni i analizës sektoriale të sigurisë të quajtur “sigurizim”, (sigurizimi si qasje ndaj sigurisë), sigurinë duhet ta trajtojmë si një akt ligjërimi, pra si një veprim konkret i kryer.<sup>3</sup> “Siguria” është një praktikë vetë-referuese, ku përmes kësaj praktike çështja shndërrohet në çështje sigurie.<sup>4</sup>

Siguria është çështje e të gjithë qytetarëve, shteteve dhe institucioneve ndërkombëtare, dhe ajo merr një rëndësi të veçantë për Shqipërinë aktualisht edhe si vend anëtar i NATO-s.

Lind pyetja: “Shteti dhe institucionet në Shqipëri, a janë në gjendje të sigurojnë me sukses çështjet e sigurisë kombëtare?” Për shembull, çështjet e luftës kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit, çështjen e parandalimit të mbjelljes e kultivimit të kanabisit dhe luftës së drogës të së gjitha llojeve. Me qëllim njohjen dhe përcaktimin e sfidave kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë, pasi studiuam bazën teorike legjislatonin, dokumentet e sigurisë kombëtare, zgjodhëm me kujdes kampionin me 120 persona dhe përpilua dhe shpërndamë pyetësorin 1: “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015”. Në këtë kampion u përgjigjen 65 persona duke ju përgjigjur pyetjes “2” : “Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë?” Sfidat kryesore të Sigurisë Kombëtare në Shqipëri paraqiten në tabelën 4 dhe figurën 1.

**Tabela 4. Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri.**

Faktore	Ekspertet ne Shqiperi %	Ekspertet ne Kosove %	Ekspertet Nderkombetare %	Total %
Sfida te Krimit te Organizuar dhe Veprimtarive Kriminale	18.30%	21.20%	23.10%	19.50%
Korrupsioni	12.80%	5.80%	23.10%	11.50%
Terrorizmi Nderkombetar, Eksternizimi Politik dhe Fetar	18.30%	13.50%	15.40%	16.70%
Situara Gjeopolitike ne Ballkanin Jug Perendimor	7.30%	7.70%	0.00%	6.90%
Sfida te Zhvillimit te Shtetit Ligjor	2.80%	5.80%	15.40%	4.60%
Sfida te Zhvillimit Ekonomik	10.10%	17.30%	0.00%	11.50%
Destabiliteti dhe Konfliktualiteti Politik ne Vend	4.60%	5.80%	0.00%	4.60%
Kapje e pushtetit	2.80%	5.80%	0.00%	3.40%
Permesimi i Strukturave, Politikave dhe Edukimit Policor dhe Ushtarak	4.60%	1.90%	0.00%	3.40%
Migrimi	0.00%	5.80%	7.70%	2.30%
Sfida te Integrimit	2.80%	0.00%	0.00%	1.70%
Sfida Sociale	4.60%	5.80%	0.00%	4.60%
Mosfunksionimi i institucioneve te ekonomise ne vend/ Nivel profesional dhe moral I ulet ne Administrate	2.80%	0.00%	0.00%	1.70%
Informaliteti	1.80%	0.00%	0.00%	1.10%
Te Tjera	6.40%	3.80%	15.40%	6.30%
Total	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%

<sup>2</sup> Collins, A., *Studime bashkëkohore të sigurisë*, UET Press, Tiranë, 2010, f. 133.


<sup>3</sup> Po aty, f. 89.

<sup>4</sup> Po aty, f. 90.

*Burimi: Pyetja 2 - Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë? Pyetësi 1, "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015" (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë); Përpunim i autorit.*

*Burimi: Pyetja 2 - Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë? Pyetësi 1, "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015" (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). Përpunim i autorit.*

**Figura 1. Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri.**



Nga analiza e të dhënave tabelore dhe grafike të paraqitura në mbi bazën e përgjigjeve të pyetjes 2, të pyetësit për sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri, rezulton se, në total, të pyeturit janë përgjigjur për 15 sfida kryesore të sigurisë në Shqipëri. Nga 15 sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri, shtatë sfidat më kryesore janë:

1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale 19.5%; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar 16.7%; 3. korrupsioni 11.5%; 4. sfida të zhvillimit ekonomik 11.5%; 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor 6.9%; 6. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor 4.6%; 7. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend 4.6%. Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë nga anketimi i studentëve, paraqiten në tabelën 5 dhe figurën 2.

**Tabela 5. Sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë (anketimi i studentëve).<sup>5</sup>**


Alternativa	Sfida e krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale	Terrorizmi nderkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar	Sfida e integritetit	Situata gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor	Sfida të zhvillimit të shtetit ligjor	Destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend	Sfida të zhvillimit ekonomik	Përmirësimi i strukturave, politikave dhe edukimit policor	Kapja e shtetit	Korrupsioni	Sfida sociale	Keqfunksionimi i administratës	Tjetër	Nuk e di/Pa përgjigje
Nr i përgjigjeve	535	146	83	59	151	189	206	44	69	455	46	88	1	3
%	76%	21%	12%	8%	22%	27%	29%	6%	10%	65%	7%	13%	0%	0%

*Burimi: Përgjigjet e pyetjes B5- Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë? - pyetësi 2 “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë, në Prishtinë dhe Tiranë); përpunim i autorit.*

*Burimi: Përgjigjet e pyetjes B5 - Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë?. Pyetësi 2, “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri, Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga studentët e fakulteteve të Drejtësisë dhe të Sigurisë, në Prishtinë dhe Tiranë); përpunim i autorit.*

**Figura 2. Sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë (anketimi i studentëve).**

Nga analiza e të dhënave tabelore dhe grafike të paraqitura në tabelën 5 dhe figurën



<sup>5</sup> Të anketuarit kanë pasur të drejtën e më shumë se një përgjigje (deri në tri mundësi përzgjedhje për secilën pyetje).

2, rezulton se për periudhën 2008-2015, janë evidentuar sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri, ai më poshtë: 1. Sfidat të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, me 535 përgjigje ose 76%; 2. Korrupsioni, me 455 përgjigje ose 65%; 3. sfida të zhvillimit ekonomik, me 206 përgjigje ose 29%; 4. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend, me 189 përgjigje ose 27%; 5. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor, me 151 përgjigje ose 22%; 6. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar me 146 përgjigje ose 21%; 7. sfidat e integritetit me 83 përgjigje ose 12%.

Nga analiza e të dhënave tabelore dhe grafike, të paraqitura dhe nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga politikanët dhe ekspertët e sigurisë, si dhe nga analiza e të dhënave të përgjigjeve të anketimit të studentëve, për sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri, rezulton se, në rastin e parë janë evidentuar shtatë sfida: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. korrupsioni; 4. sfida të zhvillimit ekonomik; 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor; 6. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor; 7. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend. Ndërsa, anketimi i studentëve ka evidentuar këto shtatë sfida:


1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. korrupsioni; 3. sfida të zhvillimit ekonomik; 4. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend; 5. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor; 6. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 7. sfidat e integritetit. Pra, sfidat e sigurisë në Shqipëri, që janë evidentuar nga 767 të anketuarit, rezulton se janë: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. korrupsioni; 4. sfida të zhvillimit ekonomik, etj.

### **3. Gjykimi i ekspertëve në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertëve ndërkombëtarë mbi sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri - analizë krahasuese.**

Nga analiza e të dhënave tabelore dhe grafike të paraqitura dhe nga krahasimi i përgjigjeve së të pyeturve sipas pyetjes 2, sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri, nga gjykimet e ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe ekspertët ndërkombëtarë, nga 15 sfida apo faktorë kryesorë të sigurisë në Shqipëri, rezultojnë se pesë janë sfidat apo faktorët kryesorë të sigurisë në Shqipëri: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, sipas ekspertëve në Shqipëri me 18.3% dhe sipas ekspertëve në Kosovë me 21.2%; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar, me 18.3% dhe 13.5%; 3. Korrupsioni, me 12.8% dhe 5.8%; 4. sfida të zhvillimit ekonomik 10.1% dhe 17.3%, dhe, 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor, 7.3%, dhe 7.7%. Në mënyrë grafike, në grafikun 1 paraqiten sfidat kryesore të sigurisë në Shqipëri dhe krahasimi i gjyqimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë.

*Burimi: Pyetja 2- Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë?. Pyetësi 1 "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015" (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë). - përpunim i autorit.*


**Grafiku 1. Sfidat kryesore të Sigurisë në Shqipëri dhe krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë.**



Gjykimet e ekspertëve, të paraqitura në mënyrë grafike, pasqyrojnë të dhënat e pasqyruara në nga ekspertët në Kosovë dhe në Shqipëri. Ndërsa, në figurën 3, paraqitet krahasimi i qëndrimeve të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.

*Burimi: Pyetja 2- Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë? Pyetësi 1, “Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015” (plotësuar nga personalitete publike dhe ekspertë të sigurisë e drejtësisë në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë); përpunim i autorit.*

**Figura 3. Krahasimi i qëndrimeve të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.**



Nga analiza e të dhënave tabelore dhe grafike të paraqitura dhe, nga krahasimi i përgjigjeve të pyetësorëve të plotësuar nga ekspertët ndërkombëtarë, renditen gjashtë problematika kryesore: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale, me 23.1%; 2. korrupsioni, me 23.1%; 3. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar, me 15.4%; 4. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor 15.4%; 5. migrimi 7.7%; dhe, 6. të tjera, 15.4%. Ndërsa, nga analiza krahasuese e të dhënave të përgjigjeve të ekspertëve ndërkombëtarë, ekspertëve në Shqipëri dhe në Kosovë rezultojnë se, nga përgjigjet e dhëna nga ndërkombëtarët, ka peshë më të madhe në përgjigjet e tyre për sfidat zhvillimit të shtetit ligjor dhe migrimin, ku përgjigjet e ekspertëve në Shqipëri kanë një peshë të ulët, respektivisht 2.8% dhe 0% dhe nga ekspertët në Kosovë nga 5.8%.

Në funksion të këtij studimi janë marrë 40 intervista të thelluara<sup>6</sup> nga personalitete të larta shtetërore, publike, shoqërore, politikanët, zyrtarët e zbatimit të ligjit, ministra, deputetë, ekspertë të sigurisë, juristë, pedagogë, profesorë, përfaqësues të shoqërisë civile, në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertë ndërkombëtarë, ku të dhënat e nxjerra janë përpunuar, analizuar dhe pasqyruar në këtë punim. Në mënyrë të përmbledhur, ato trajtojnë këto sfida kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë: sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; korrupsionin e zyrtarëve të lartë dhe sistemit të drejtësisë; sfida të zhvillimit ekonomik; ekstremizmin politik dhe fetar; situatën gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor; terrorizmin ndërkombëtar; sfida të zhvillimit të shtetit ligjor; destabilitetin dhe konfliktualitetin politik në vend;

Sipas dokumentit “Strategjia e sigurisë kombëtare e Republikës së Shqipërisë të vitit 2014”,<sup>7</sup> klasifikimi i rreziqeve është bërë duke shqyrtuar dy parametra kryesorë: gjasat e shfaqjes së rrezikut dhe pasojat që mund të shkaktojnë për sigurinë kombëtare. Në bazë të kombinimit të këtyre dy parametrave, rreziqet janë klasifikuar në tre nivele. Në nivelin e parë janë grupuar rreziqet që kanë gjasa të larta shfaqjeje dhe pasoja të larta në rast se materializohen. Në nivelin e dytë janë grupuar rreziqet të cilat ndërthurin gjasa të ulëta dhe pasoja të larta. Në nivelin e tretë janë grupuar rreziqet që kanë gjasa të ulëta shfaqjeje dhe pasoja më të kufizuara. Këto përfundime janë arritur duke analizuar edhe dobësitë strukturore dhe institucionale që ndikojnë më së shumti në aftësinë tonë për tu përballur me këto rreziqe.

Rreziqet e nivelit të parë kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së

<sup>6</sup> Dr. Alfred Moisiu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë (2002-2007); Prof. Dr. Fatmir Sejdiu, Presidenti i Republikës së Kosovës (2006-2010); PhD Walter Schwimmer, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës (1999-2004); Dr. Bajram Rexhepi, Kryeministri i Republikës së Kosovës (2002-2004) dhe Ministër i Brendshëm (2009-2014); Dr. Bashkim Kopliku Zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe Ministër i Rendit Publik (1992-1993); Prof. Dr. Neritan Ceka, Ministër i Brendshëm (1997-1998), Kryetar i Komisionit Parlamentar të Sigurisë (1998-2005), Nënkrjetar i Kuvendit të Shqipërisë (2008-2009); Prof. Asc. Dr. Bajram Zejraj, Ministër i Rendit Publik (1991); Dr. Ilir Panda, Ministri i Drejtësisë (1999-2000) dhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (2003-2007); Dr. Aldo Bumçi Ministri i Drejtësisë (2005-2007); Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (2011-2013), Ministër i Punëve të Jashtme (2013-2014); Avokat Ylli Manjani, Ministër i Drejtësisë (2015-2017); Dr. Zef Preçi, Ministër i Ekonomisë (2002) Drejtor i Përgjithshëm ACER; Prof. dr. Ermir Dobjani, Avokat i Popullit (2000-2010); Dr. Marko Bello, Ministër i Mbrojtës (2003-2005); Prof. Asc. Dr. Iva Zajmi Zëvendësmministre e Punëve të Brendshme (2005-2013); Gjergj Lezhja, Zëvendësmministër i Punëve të Brendshme (2005-2008), Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave (2008-2012) dhe Këshilltar i Presidentit të Republikës për Sigurinë Kombëtare (2012-2017); Avokat Dilaver Bengasi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (1987-1990); Avokat Sokol Bare, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (1997-1998); Ahmet Prençi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (2007-2009); PhD Kandidat Reshat Maliqi, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Kosovë (2010-2011) dhe Drejtor i Analizës së Planifikimit Strategjik e Juridik, Drejtorja e Përgjithshme e Policisë Kosovë; Arben Doçi Zv/Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit (2005-2007), Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit të Parave (2007-2013); PhD Florian Qehaja, Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës për Studime të Sigurisë Kosovë; Dr. Xhavit Shala, Drejtor i Qendrës Kërkimeve Shkencore, Akademisë e Sigurisë Tiranë; Prof. Assoc. Dr. Enver Bytyçi, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Evropës Juglindore; Prof. Asc. Saemira Pino, Dekane e Fakultetit të Shkencave Sociale në Universitetin “Marin Barleti”; Hydajet Hyseni Deputet, Kryetar i Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Kosovës; Ismail Kurteshi, deputet në Kuvendin e Kosovës; Dr. Ruzhdi Jashari, Drejtor i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Kosovë; Kujtim Bytyçi, Analist i lartë për Politikën e Sigurisë Kosovë; Shyqyri Dekavelli, Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (2002-2014); MA Erion Kristo, gazetar dhe drejtues i emisionit “Bardh e Zi” ne Scan TV; Drejtues Besnik Shehu, Drejtor i Policisë Kriminale (1992-1993), Drejtor i Drejtorisë së Studimeve Strategjike në Akademinë e Policisë; Drejtues Fredi Agastra, ekspert i Sigurisë, Drejtues në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; PhD Bekim Podrimcaku, Drejtor i Departamentit për Analizë dhe Politikë të Sigurisë në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë në Qeverinë e Kosovës; Dr. Mentor Nazarko, analist, opinionalist, studiuues; Dr. Petrit Bushi, Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale Kolegji AAB Prishtinë; Dr. Ilir Kulla, gazetar, ekspert i çështjeve të sigurisë në rajon; Asllan Dogjani deputet, avokat; Peter Linden Jones, ekspert i Sigurisë në Mbretërinë e Bashkuar, Ekspert i Misionit PAMECA, Tiranë; Arne Stivs, ekspert i sigurisë ndërkombëtare, përgjegjës i këshillimit në Misionin Policor të Bashkimit Evropian, MAPE, në Shqipëri, (1997-2001); Andreas Berg Këshillues Suedez, Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.; Ferdinand Dervishi, gazetar, analist, kryeredaktor TV ABC NEWS, etj.

<sup>7</sup> Ligj nr. 103/2014, datë 31.7.2014 “Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë”.

Shqipërisë.<sup>8</sup> Gjasat e shfaqjes dhe pasojat e tyre, për sigurinë kombëtare, vlerësohen të larta. Rreziqet e nivelit të parë janë: korrupsioni dhe krimi i organizuar; kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike; mangësitë në kontrollin dhe administrimin e territorit, që kërcënojnë sigurinë individuale dhe favorizojnë trafiqet e ndryshme; sulmet kibernetike nga aktorë shtetërorë ose jo shtetërorë; degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut. Pra, korrupsioni dhe krimi i organizuar janë klasifikuar rreziku i parë në rreziqet e nivelit të parë, dhe rreziqet e nivelit të parë sipas këtij dokumenti kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë.

Reagimi ndaj sfidave kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri, ka të bëjë me impaktin që ka krijuar dhe që krijon shteti, institucionet e sigurisë kombëtare, institucionet ligjzbatuese, në raport me përgjegjësinë për të mbrojtur, përgjegjësinë për të parandaluar, përgjegjësinë për të reaguar dhe me përgjegjësinë për të rindërtuar në aspektin e uljen e frikës së qytetarëve ndaj jetesës së tyre më të mirë, në aspektet e sigurisë së jetës, shëndetit, pasurisë, sigurimit të së ardhmes së tyre më të sigurt.

#### 4. Përfundime dhe rekomandime

- Nga shqyrtimi analitik dhe me analizë krahasimore i përgjigjeve, nga 767 të anketuarit dhe intervistat e tyre për sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë rezulton se: janë evidentuar 15 sfida kryesore për *sigurinë kombëtare* në Shqipëri. Sfidat me kryesore për sigurinë në Shqipëri janë evidentuar si: 1. sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; 2. terrorizmi ndërkombëtar, ekstremizmi politik dhe fetar; 3. korrupsioni; 4. sfida të zhvillimit ekonomik. 5. situata gjeopolitike në Ballkanin Jugperëndimor. 6. sfida të zhvillimit të shtetit ligjor ; 7. destabiliteti dhe konfliktualiteti politik në vend.

- Gjithashtu, konkludohet se sfidat kryesore të sigurisë kombëtare janë të lidhura ngushtësisht me demokracinë, institucionet demokratike dhe të sigurisë, si dhe me krimin e organizuar transnacional. Kjo përputhshmëri arrihet edhe me dokumentin “Strategjia e sigurisë kombëtare së Republikës së Shqipërisë, 2014”, i cili përcakton se: korrupsioni dhe krimi i organizuar janë klasifikuar rreziku i parë, në rreziqet e nivelit të parë, dhe për rrjedhojë rreziqet e nivelit të parë sipas këtij dokumenti kanë prioritetin më të lartë për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Ndërkohë që nga analiza analitike dhe krahasimore e përgjigjeve nga të intervistuarit dhe të anketuarit, u arrit në përfundimin se në sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë, *sfida e parë*, është sfida të krimit të organizuar dhe veprimtarive kriminale; dhe, *sfida e dytë*, korrupsioni i zyrtarëve të lartë dhe i sistemit të drejtësisë.

- Rekomandohet të bëhet një raport dhe analizë e zbatimit të detyrave të përcaktuara në dokumentin “Strategjia e sigurisë kombëtare së Republikës së Shqipërisë të vitit 2014”, për periudhën 2014-2017 nga qeveria shqiptare nën drejtimin e Kryeministrit të Shqipërisë dhe, Këshilli i Sigurisë Kombëtare, nën drejtimin e Presidentit të Republikës. Sugjerojmë marrjen parasysh të këtij studimi për “Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe rekomandojmë që sugjerimet e të intervistuarve dhe të anketuarve, të përpunuara, analizuar dhe të pasqyruara në këtë punim, të merren

<sup>8</sup> Po aty, shtojca C- klasifikimi i rreziqeve, f. 25.



në konsideratë.

- Sfidë për të ardhmen, mbetet njohja e gjendjes reale dhe lufta e veprimtarive kriminale të organizuara e korrupsionit të nivelit të lartë, kryerja e vërtetë e procesit të vetingut në drejtësi, politikë, administratën publike, media, si dhe reforma e vërtetë zgjedhore e politike, administratës publike dhe ndërtimi i demokracisë dhe shtetit ligjor, me qëllim sigurimin e jetës, shëndetit e të respektimit të lirive e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

## Bibliografia

1. Collins, A., *Studime bashkëkohore të sigurisë*, botuar nga UET Press, Tiranë, 2010.
2. Ligj nr. 103/2014, datë 31.7.2014 "Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë".
3. Pyetësi 1 "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015". Pyetja 2- *Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë?*.
4. Pyetësi 2 "Institucionet demokratike dhe krimi i organizuar transnacional, Shqipëri-Kosovë, 2008-2015". Pyetja B5- *Cilat janë sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë?*.
5. Intervista të thelluara me personalitetet e larta shtetërore, publike, shoqërore, politikanë, ministra, deputetë, zyrtarë të lartë të zbatimit të ligjit, juristë, studiues, pedagogë, profesorë, prokurorë, gjyqtarë, avokatë, ekspertë të sigurisë e të Policisë së Shtetit, gazetarë, opinialistë, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe ekspertë të njohur në Shqipëri, Kosovë dhe ekspertët ndërkombëtarë. Intervistat janë marrë nga autori, gjatë viteve 2015-2016.

## Lista e tabelave ose diagrameve

### Tabelat

- Tabela 1 Të dhëna demografike bazë të institucioneve arsimore të të anketuarve.  
Tabela 2 Fushat e studimit të anketuarve.  
Tabela 3 Dega dhe viti i studimit të të anketuarve.  
Tabela 4 Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri.  
Tabela 5 Sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë (anketimi i studentëve)

### Grafikët

- Grafiku 1 Sfidat kryesore të Sigurisë në Shqipëri dhe krahasimi i gjykimeve të ekspertëve në Shqipëri dhe Kosovë.

### Figurat

- Figura 1 Sfidat kryesore të sigurisë kombëtare në Shqipëri.  
Figura 2 Sfidat kryesore që cenojnë sigurinë kombëtare në Republikën e Shqipërisë (Anketimi i studentëve).  
Figura 3 Krahasimi i qëndrimeve të të intervistuarve mbi problematikat kryesore të ngritura nga ndërkombëtarët.

# Ekspertimi mjekoligjor dhe sfidat aktuale ndaj terrorizmit

Disa koncepte teorike mbi terrorizmin - roli i ekspertimit mjekoligjor në përcaktimin e kësaj figure penale

Dr. Admir SINAMATI  
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë  
asinamati@yahoo.com

Prof. Dr. Bardhyl ÇIPI  
Instituti Mjekësisë Ligjore, Shqipëri

## Abstrakt

Termi “terrorizëm”, që po përdoret në kohën e sotme gjithnjë e më shumë, ka mbi 100 përkufizime. Ai përdoret sot, për cilësimin e ngjarjeve të tilla si, shpërthimi i një bombe në një avion apo rrëmbimi i një avioni dhe përplasja e tij me një godinë shumëkatëshe, djegiet, rrëmbimet, sulmet vetëvrasëse më armë dhe lëndë plasëse, të shoqëruara me viktima të shumta të pafajshme, etj., - të gjitha këto, veprime në emër të një arsyeje politike apo ideologjike. Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 1980, aktet e terrorizmit kanë qenë të pakta. Nga viti 1981 deri në vitin 2015, ka pasur 4814 akte të tilla në mbi 40 vende të botës, duke u vrarë 45 mijë njerëz<sup>1</sup>, ku 90% e tyre, kanë ndodhur në Afganistan, Irak, Izrael, territoret palestineze, Pakistan dhe Sri Lanka. Që nga viti 2015, 3/4 e tyre ndodhin në tre vende: Afganistan, Pakistan, Irak. Zakonisht, në SHBA, terrorizmi nënkupton një dhunë të kryer në bashkëpunim me një grup terrorist ndërkombëtar, si Al Qaeda, Hezbollah, Hamas etj. Përpjekjet e shumta, që janë kryer për një përcaktim sa më real të terrorizmit, mund të përmbledhen në pohimin e filozofit Jacques Derrida: “Terrorizmi konsiderohet si një krim kundër jetës humane nga shkelja e ligjeve kombëtare ose ndërkombëtare, ku viktima të tij janë zakonisht personat civilë, krim ky, i kryer për një qëllim politik, për të ndikuar ose ndryshuar politikën e një vendi, duke terrorizuar popullsinë e tij”<sup>2</sup>. Në këtë punim do të trajtojmë nga ana teorike përcaktime juridike, filozofike, historike, gjuhësore dhe kontekstin ekspertues mbi termin “terrorizëm”.

AKADEMIA  
E SIGURISË

## Fjalëkyçe:

terrorizëm, ekspertim mjekoligjor, krim terrorist.

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Koncepte teorike mbi terrorizmin

Termi “terrorizëm” përdoret sot për cilësimin e ngjarjeve të tilla si shpërthimi i një bombe në një avion, apo rrëmbimi i një avioni dhe përplasja e tij me një godinë shumëkatëshe, djegiet, rrëmbimet, sulmet vetëvrasëse me armë dhe lëndë plasëse të shoqëruara me viktima të shumta të pafajshme, - të gjitha këto veprime, në emër të një arsyeje politike apo ideologjike. Në SHBA, terrorizmi nënkupton një dhunë të kryer në bashkëpunim me një grup terrorist ndërkombëtar, si Al Qaeda, Hezbollah, Hamas etj. Në SHBA, personat e dyshuar për veprime terroriste mund të mbahen në gjendje arresti, pa ju ngritur padi penale, më gjatë se të dyshuarit e tjerë për akte kriminale; ata mund të merren në pyetje pa praninë e një avokati dhe dënohen më rëndë<sup>3</sup>.

“Të burgosurit terroristë” u nënshtrohen një numri më të madh masash kufizuese, shtesë, të njohura me emrin, “masa të veçanta administrative” (Special Administrative Measures – 2002), në bazë të “Aktit të sigurimit nga rreziku i terrorizmit” të vitit 2002 (Terrorism Risk Insurance Act – 2002).

Nga ana tjetër, viktimat e terrorizmit kanë disa përfitime shtesë, në formë të lehtësirave fiskale. Në rast se dhuna nuk vërtetohet që të jetë kryer nga bashkëpunimi me një grup terrorist të sanksionuar ndërkombëtar, atëherë ajo duhet të shpjegohet nga sëmundja mendore, tensioni në familje, gjendja e ankthit e një adoleshenti, emigranti etj.

Në këtë kuptim, koncepti i terrorizmit i afrohet pak a shumë atij të luftës, apo më

<sup>1</sup> List of terrorist incidents, Wikipedia, the free encyclopedia.

<sup>2</sup> Jacques Derrida, *Philosophy in a Time of Terror*, University of Chicago Press, 2003, f. 85–89.

<sup>3</sup> 18 U. S. Code Chapter 113B – Terrorism.

saktë të krimeve të luftës, ku janë shkelur ligjet e luftës. Ngjashmëria më e madhe e tij, do të jetë me luftën civile, kur ajo karakterizohet nga veprime të një dhune ekstreme, e motivuar për qëllime politike, ideologjike, ku viktimë e tyre është popullsia civile, e dëmtuar qëllimisht apo aksidentalisht. Por në dallim nga këto luftëra, grupet terroriste janë përgjithësisht më pak të organizuar dhe të pajisura me mjete financiare më të kufizuara.

Përkufizimi i terrorizmit i bërë nga OKB-ja në vitin 2004 paraqitet si vijon: “...çdo veprim që ka për qëllim shkaktimin e vdekjes apo të dëmtimeve të rënda trupore, të personave civilë, jo luftëtarë, ku qëllimi i këtij veprimi, në lidhje me natyrën dhe përmbajtjen e tij, është që të kërcënojë një popullatë, ose t’i ushtrojë presion një qeverie apo një organizate ndërkombëtare për të marrë disa masa ose të heqë dorë prej tyre”.<sup>4</sup>

Një përcaktim të ngjashëm ka dhënë edhe Asambleja e Përgjithshme e OKB-së që e ka përcaktuar terrorizmin si “veprim kriminal me qëllim politik, për të provokuar terror në publik...”

Nga pikëpamja historike, për herë të parë termi “terrorizëm” është përdorur në Francë, ku u praktikua nga qeveria franceze në vitet 1793-1794 nga ana e partizanëve të terrorit (terreur), që zhvilluan një luftë shumë të dhunshme ndaj kundërshtarëve të tyre kundër-revolucionarë. Më pas, fjala “terror” nënkuptonte abuzimin, vrasjen e njerëzve të pafajshëm për qëllime politike. Fjala “terreur” në gjuhën frënge, e ka origjinën nga folja në gjuhën latine “terreo” që përkthehet në shqip “frikësoj”. Në Romën e Vjetër, përdorej cilësimi “terror cimbricus”, që konsiderohej një panik dhe gjendje e jashtëzakonshme nga afirmimi i luftëtarëve të fisit Cimbri, në vitin 105 p.e.s.

Si veprime terroriste, do të konsiderohen ato të pilotëve kamikazë japonezë gjatë luftës së dytë botërore, që vetëvriteshin nga përplasje që i bënin avionit të tyre me një objekt luftarak të kundërshtarit të tyre, apo sulmet e 11 shtatorit 2001, të kullave binjake të Neë Yorkut. Nga fundi i Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 1980, aktet e terrorizmit kanë qenë të pakta. Nga viti 1981 deri në vitin 2015, ka pasur 4814 akte të tilla në mbi 40 vende të botës, duke u vrarë 45 mijë njerëz. 90% e tyre kanë ndodhur në Afganistan, Irak, Izrael, territoret palestineze, Pakistan dhe Sri Lanka. Që nga viti 2015, 3/4 e tyre ndodhin në tre vende: Afganistan, Pakistan, Irak.<sup>5</sup>

Së fundi si raste të tilla kanë qenë: sulmi në Paris ndaj gazetës satirike Charlie Hebdo më 2015, ku u vranë 13 njerëz; sulmi në Bruksel, më 22 mars 2016, ku u vranë 32 persona civilë; sulmi në Nicë të Francës, në 14 korrik 2016, ku u vranë 86 civilë dhe u plagosën 434 të tjerë; sulmet terroriste në Turqi në Stamboll dhe Ankara në vitin 2016; sulmi terrorist në Londër, pranë parlamentit në 22 mars 2017.

## 2. Llojet, metodat dhe motivet e terrorizmit

*Llojet e terrorizmit janë të shumta, ku më kryesoret paraqiten si vijon:*

*Terrorizmi individual*, i shfaqur në fund të shekullit 19 dhe fillimin e shekullit 20, i përdorur nga disa anarkistë, si p.sh. rastet e Ravachol dhe vrasja e presidentit Sadi Carno, në Lion të Francës<sup>6</sup>, disa atentate me inspirim anarkik të kryera në Rusi, Spanjë,

<sup>4</sup> Definition of “Terrorism” in the UN Security Council: 1985-2004.

<sup>5</sup> List of terrorist incidents Wikipedia, the free encyclopedia.

<sup>6</sup> Presidenti i Francës, zgjedhur më 1887, (1837 - 1894). Carnot është vrarë nga një akt terrorist më 24 qershor 1894, në Lyon (Biography.com)

Itali. Këto atentate janë kryer ndaj personaliteteve të sferës politike, ushtarake, etj., që kishin ushtruar një shtypje ndaj popullatës.

*Terrorizmi i organizuar*, praktikohet nga një grup personash që nuk përfaqësojnë një qeveri. Ky terrorizëm në format e ekstremit të djathtë dhe të majtë, u ndesh në vitet 1960-1970. Ai kishte qëllime politike dhe zhvillonte një luftë direkte ose indirekte me shtetin. Kështu, grupe terroriste të majta, kanë qenë ato të rezistencës, luftëtarëve, apo partizanëve, të cilat kanë kundërshtuar shtypjen e pushtetit politik, apo terroristët islamikë, duke e konsideruar veten e tyre si luftëtarë të Zotit, zhvillojnë luftën e shenjtë, të quajtur “Xhihad”. Që nga vitet 1990, i ashtuquajturi terrorizmi islamik mori një zhvillim të madh. Veprimet e tij terroriste “justifikoheshin” si një përgjigje ndaj situatës politike në Izrael-Palestinë, dhe në Irak, nga ndërhyrja amerikane. Ndërsa në vende të tjera si në Algjeri, Egjipt, Indonezi, ka pasur si qëllim përmbysjen e qeverive, duke demonstruar forcën e besimeve fetare ekstremiste kundër shtetit. Në vitet 1954-1962 në Algjeri, FLN<sup>7</sup> zhvillonte një strategji terrori ndaj popullatës myslimane dhe jomyslimane. Organizata OAS-së, e përbërë nga shtetasit francezë që jetonin në Algjeri, në fillim të viteve 1960, ushtronte terror ndaj popullatës myslimane që favorizonte FLN. Në SHBA, organizata Ku Kluku Klan terrorizonte në mënyrë të vazhdueshme popullatën afroamerikane, deri në vitet 1960.

*Terrorizmi shtetëror*, nënkupton kryerjen e akteve terroriste nga shteti. Metodatat e përdorura: rrëmbimi, sekuestrimi, vrasja etj., justifikohen se janë kryer për arsye shtetërore, p.sh., terrorizmi i shtetit spanjoll kundër grupit të armatosur nacional bask, ETA.<sup>8</sup> Në vitet 1930, shërbimet sekret sovjetike dhe italiane, kanë eliminuar shumë kundërshtarë të regjimeve të tyre të emigruar në vende të tjera, si p.sh., ekzekutimi i Trockit (kundërshtar i Stalinit). Nga ana e tyre, Sadam Husein në Irak, Mouamar Kadafi në Libi, regjimi i Koresë së Veriut kanë kryer likuidimin e kundërshtarëve jashtë vendeve të tyre.

*Terrorizmi ekonomik*, nënkupton kryerjen e akteve terroriste, nga njësi transnacionale ose qeveritare të veprimeve të ndryshme të koordinuara dhe të sofistikuara, për të destabilizuar dhe dezorganizuar stabilitetin ekonomik dhe financiar të një vendi, ose një grup vendesh, për motive ideologjike, fetare etj.

*Terrorizmi kibernetik (cyberterrorism)*, është përdorimi i internetit, duke sulmuar informacionet, sistemet, programet, të dhënat kompjuterike, për të kryer veprime të dhunshme, apo për të bërë kërcënime me humbje të jetës, të dëmtimeve të rënda trupore etj., për të arritur qëllime të caktuara politike.

*Terrorizmi bërthamor* është përdorimi i paligjshëm lëndëve radioaktive në një nga format e tyre, për të krijuar dëmtime, panik dhe frikë të pamasë në popullatën e përgjithshme. Për këtë, terroristët, përveç bombave bërthamore, mund të përdorin, metoda të ndryshme për të shkaktuar panik në popullatë, si p.sh., shkelja e qëllimshme e operacioneve të sigurimit në vendet e instalimeve të armatimeve bërthamore, apo në përdorimet e energjisë bërthamore, në degë të ndryshme të ekonomisë si në metalurgji, gjeologji-miniera, meteorologji, industrinë kimike dhe të naftës, mjekësi, bujqësi etj. Rrezatimet që dëmtojnë organizmin e njeriut mund të jenë të jashtme ose, të brendshme, kur lënda radioaktive është futur në organizëm nëpërmjet ushqimeve, ose të jashtme dhe të brendshme njëkohësisht. Dëmtimet nga rrezatimet janë lokale dhe të përgjithshme.

<sup>7</sup> National Liberation Front (Algeria)-Fronti për Çlirimin Kombëtar (Algjeri).

<sup>8</sup> Teresa Whitfield, *The Basque Conflict and ETA: The Difficulties of an Ending*, United States Institute of Peace (USIP) 2015.

Dëmtimet lokale që ndodhin kryesisht gjatë aplikimit mjekësor të rrezeve të ndryshme jonizuese, prekin kryesisht lëkurën duke shkaktuar dermatite të ndryshme. Dëmtimet e përgjithshme shkaktojnë të ashtuquajturën “sëmundje të rrezes”, në formë akute ose kronike, gjatë së cilës shfaqen hemorragji të ndryshme, dëmtime të organeve të prodhimit të gjakut, rënie e flokëve, katarakte të syrit, anemi, dëmtime të organeve gjenitale, infeksione të ndryshme, dëmtime të gjeneve që shfaqen në sëmundje të pasardhësve etj. Të gjitha këto dëmtime mund të shihen në këqyrjen e kufomës në rastet vdekjeprurëse të një krimi terrorist, me anë të përdorimit të energjisë bërthamore.

*Bioterrorizmi (terrorizmi biologjik)*, është përdorimi i paligjshëm i organizmave biologjike (kafshë, bimë dhe mikroorganizma: baktere, viruse), të ngordhura apo të gjalla, në gjendjen e tyre natyrale ose pas modifikimeve gjenetike, apo produktet e tyre si gjaku, toksinat, të shoqëruar ose jo me sëmundje dhe vdekje njerëzore; të gjitha këto, për të shkaktuar frikë, alarm, tmerr në popullatë. Bioterrorizmi ka avantazhe ndaj metodave të tjera, për arsye se ai, nuk është i shtrenjtë: zhdukja e gjysmës së popullsisë për çdo km<sup>2</sup> kërkon si shpenzim, 1 USD, ndërsa nga përdorimi i armëve të zjarrit të zakonshme dhe atyre bërthamore, shpenzimi do të ishte respektivisht 2000 USD dhe 800 USD.<sup>9</sup> Nga ana tjetër, një përparësi tjetër e bioterrorizmit ka të bëjë me faktin se zbulimi i përdorimit të tij është shumë i vështirë, sepse mund të ngatërrohet me një ngjarje natyrale; ndërkohë që nga një sulm bërthamor ose me armë zjarri të zakonshme, menjëherë do të ngrihet dyshimi për një sulm terrorist.

Në metodat e terrorizmit, më të shpeshta janë sulmet vetëvrasëse (sulme të dhunshme, në të cilat sulmuesit presin që të vdesin gjatë kryerjes së tyre), rrëmbimet e avionëve, prerja e kokës, vrasjet, përdorimi i autobombave, nganjëherë edhe përdhunimet etj.

*Motivet e terrorizmit janë të shumta. Disa prej tyre, që janë më aktuale, paraqiten si vijon:*

*Etnonacionalizmi.* Dëshira e një popullate për t’u shkëputur nga një qeverisje apo pushtet, për të krijuar një shtet më vete, mund të shkaktojë formimin e grupeve terroriste, si p.sh. Hamasi – një nga grupet më aktive etnonacionaliste, që kryejnë sulme vetëvrasëse kundër shtetit të Izraelit. Organizatat terroriste çëqene kundër qeverisë dhe popullit rus, grupet e pakicave në shumë vende që dëshirojnë të krijojnë shtete të pavarura, përbëjnë një burim etnonacionalist të rëndësishëm të terrorizmit. Prandaj, duhet njohur kjo gjë, me qëllim për ta kundërshtuar, duke ndjekur politikën e proceseve gjithëpërfshirëse, që mund të zbusin ankesat e grupeve minoritare, për të pakësuar kështu këtë shkak të terrorizmit.

*Tjetërsimi ose diskriminimi.* Grupet e popullatave të vendeve të varfra të lindjes, që kanë emigruar në vendet e përparuara të Evropës dhe Amerikës (me nivele kulturore të ndryshme nga ato të vendeve mikpritëse), përballen me diskriminimin në vendet ku banojnë, gjë që i çon në rritjen e ndjenjës së izolimit. Për këtë arsye, te këto grupe mund të zënë vend ideologjitë ekstremiste, të prira drejt terrorizmit.

*Besimi fetar.* Ka pikëpamje që e përcaktojnë atë si shkak të terrorizmit. Këtu, në radhë të parë është fundamentalizmi islamik. Aktet terroriste të kryera prej tij, janë akte vetëvrasëse me taktika të sofistikuara dhe të vështira për t’u mbrojtur prej tyre, sepse ata që i kryejnë besojnë se do të marrin shpërblimet e premtuara në jetën e përtejme.

<sup>10</sup> Dishovsky, C., Pivovarov, A., *Counteraction to Chemical and Biological Terrorism in East European Countries NATO Science for Peace and Security Series A: Chemistry and Biology*, Springer Science & Business Media, 2009, f. 122.

*Statusi socioekonomik.* Ky ka të bëjë me dallimet e mëdha ekonomike të vendeve të zhvilluara perëndimore, ndaj atyre të pazhvilluara myslimane. Kjo ka nxitur terrorizmin në popullatën myslimane, për shkak të kësaj pabarazie shoqërore, që ata e konsiderojnë të padrejtë. Përveç kësaj, kjo popullatë që jeton në një varfëri të madhe, korruptohet me lehtësi për të pranuar kryerjen e veprimeve terroriste.

### **3. Veçoritë mjekoligjore dhe rastet e terrorizmit në Shqipëri**

Në shqyrtimin e rasteve të terrorizmit, një vend me rëndësi zënë ekzaminimet mjekoligjore e kriminalistike, të cilat duhet të kryhen sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të hollësishe, sidomos në rastet e dëmtimeve me armë zjarri, shpërthimeve vetëvrasëse, ekzaminimeve toksikologjike etj.; të gjitha këto, me qëllim që organet përkatëse të drejtësisë (prokuroria, gjykatat etj.) të marrin maksimumin e informacionit të nevojshëm për ndjekjen me sukses të krimeve të terrorizmit.

Nga ana tjetër, duhet pasur parasysh që rreziku i terrorizmit është i madh edhe për Shqipërinë, ku ai, është ndeshur në raste dhe situata të ndryshme, si në periudhën e mëparshme të regjimit komunist (terrorizmi shtetëror), ashtu dhe në periudhën e sotme. Vendin e parë në aktet terroriste e zë padyshim përdorimi i lëndëve eksplozive. Këto raste kërkojnë një investigim kompleks, në mënyrë që të arrihet në zbulimin e autorëve e vënien e tyre para drejtësisë, mekanizmin e ngjarjes etj. Në rast se më përpara, metodat e përdorura në kryerjen e krimeve me lëndë eksplozive, ishin klasike, pra një sasi lënde, një fitil, apo më tej një mekanizëm komandimi i thjeshtë, sot përdoren metoda që me arritje të shkencës dhe teknikës, sidomos në drejtim të elektronikës dhe telekomunikacionit, që përdoren edhe në krimet me origjinë terroriste.

Po kështu, ndërsa më parë përdoreshin lëndë eksplozive të përgatitura në mënyrë artizane dhe, ishin destinuar për përdorim kryesisht civil, si dinamiti, apo amonitet, sot përdoren lëndë të fuqisë së mesme dhe të lartë, ku përveç lëndës eksplozive të llojit TNT (tritol), kanë gjetur një përdorim të madh lëndë të tilla si C4, hegzogjen etj., të cilat kanë për destinacion kryesor, përdorimin në fushën ushtarake dhe si të tilla janë mjaft të fuqishme, të përdorshme në kushte ambientale nga më të vështirat, të transportueshme në mënyrë të sigurt etj.

Në vendin tonë ky përdorim i tyre, ku përfshihen edhe aktet terroriste, është favorizuar nga hapja e depove ushtarake në vitin 1997, shpërbërja e ushtrisë ish-jugosllave, kalimi i rrugëve të trafikut të lëndëve apo pajisjeve eksplozive nëpër Ballkan. Kështu, në Shqipëri në kohën e sotme janë zbuluar dhe dënuar disa grupe kriminale, të cilat merreshin me prodhimin apo trafikimin e pajisjeve eksplozive, si ngarkesa eksplozive të komanduara me anë të telefonave celularë, përdorimi i predhave reaktive (raketa) etj. Për të krijuar një ide më të plotë mbi aktet terroriste nga shpërthimet e lëndëve të ndryshme plasëse, po japim disa të dhëna të përgjithshme mjekoligjore dhe kriminalistike të tyre:

-Shpërthim quhet një çlirim shumë i shpejtë i energjisë si rezultat i ndryshimeve fizike, kimike e bërthamore të lëndëve, të shoqëruara me kthimin e tyre nga gjendja e ngurtë dhe e lëngët në atë të gaztë, të cilat mund të shkaktojnë dëmtime shumë të rënda ose vdekjeprurëse në trupin e njeriut. Veprimet dëmtuese të bombave, granatave dhe lëndëve të ndryshme plasëse shfaqen në këto drejtime kryesore:

-Dëmtimet nga shpërthimi (eksplozioni). Këto dëmtime kur viktima gjendet në

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

qendër të shpërthimit, p. sh. kur ajo e mban në duar ose në xhepa bombën ose lëndën plasëse, shprehen me ndarjen e plotë të trupit në copa që shpërndahen në një sipërfaqe të madhe me rreze rreth 200 m, të përbëra kryesisht nga pjesë lëkure të kokës (skalp), pjesë të shpinës, copa muskujsh etj. Në rastet e viktimave që gjenden në afërsi të shpërthimit, trupi zakonisht nuk ndahet në copa, por mund të ketë shkëputje të gjymtyrëve etj. me dëmtime karakteristike në trajtën e ekimozave, plagëve të vogla shpuese, të shoqëruara me nxirrje të lëkurës për rreth. Si rezultat i veprimit të faktorëve plotësues, bloza e grumbulluar në lëkurë mund të gjendet edhe në rastet kur viktimia ka qenë 1-2 m larg vendit të shpërthimit. Kur shpërthimi ndodh në një largësi më të madhe, forca e tij mund ta përplasë viktimën në objekte të ndryshme ose në tokë duke shkaktuar dëmtime karakteristike të përplasjes.

- Dëmtimet nga predhat fluturuese (Flying missiles), shkaktohen nga copëzat e mëdha të bombave, granatave ose objekteve të ndryshme, të cilat shkëputen me forcë në kohën e shpërthimit dhe depërtojnë në trupin e njeriut, duke shkaktuar dëmtime vdekjeprurëse.

- Dëmtimet nga vala goditëse, ndodhin nga vala e presionit që krijohet kur ndodh shpërthimi, e cila duke u teçuar nëpër muret e trupit, dëmton kryesisht organet me ajër, si çarja e zorrëve dhe organeve të tjera të barkut, hemorragji të mushkërive me edemë pulmonare, çarja e alveolave, dëmtime të trurit, të syve, daullës së veshit etj. Në mjaft raste, nga shpërthimet e fuqishme janë vënë re vetëm dëmtimet e valës goditëse, pa asnjë lloj dëmtimi tjetër, ndërsa në bombat e zakonshme dëmtimet e saj janë të parëndësishme. Vala goditëse është e përbërë nga një valë presioni pozitiv, që është më e rrezikshme, e pasuar nga një valë presioni negativ. Vala e presionit pozitiv ose vala e shokut, lëviz me shpejtësi shumë të madhe që e kalon atë të zërit, vepron për një kohë shumë të shkurtër, më të vogël se 0,01 sekonda, dhe ndjehet si një goditje e fortë, që në shpërthimet e zakonshme ka një presion prej 300 kg. Ndërsa vala e presionit negativ (thithjes) që e pason atë, është e dobët, me një presion rreth 6 kg dhe vepron për një kohë shumë më të gjatë, duke shkaktuar shpeshherë të ashtuquajturat “zhveshje” të viktimave dhe zhvendosjet e tyre paradoksale drejt qendrës së shpërthimit.

- Dëmtimet nga djegiet ndodhin si rezultat i çlirimit të nxehtësisë gjatë shpërthimit dhe mund të jenë të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta. Djegiet e drejtpërdrejta janë të lokalizuara kryesisht në fytyrë e në duar, me përzhitje të flokëve, vetullave, me djegie sipërfaqësore, me djegie të rrugëve të frymëmarrjes, në të cilat mund të gjenden të grumbulluara gazet dhe pluhurat e çliruara gjatë shpërthimit, etj. Djegiet jo të drejtpërdrejta shkaktohen nga djegia e viktimës prej objekteve që ndodhen pranë saj dhe që kanë marrë zjarr si pasojë e shpërthimit.

- Dëmtimet nga shembjet e ndërtesave ndodhin në rastet e shpërthimeve të fuqishme brenda ndërtesave, apo tuneleve apo shkëmbinje. Viktimat pësojnë dëmtime të rënda nga pjesët e shembura. Kufomat e tyre mund të jenë të mbuluara, p.sh. nga rëra, zhavorri dhe pjesët e tjera të ndërtesës së shembur. Në shpërthimet e shoqëruara me vdekjen e shumë viktimave, që mund të jenë të copëtuara dhe të djegura (karbonizuara), në ekzaminimin e kufomave të tyre, mund të dalin probleme për zbulimin e shenjave identifikuese dhe dëmtimeve me mekanizmat e ndryshme etj., për të cilat mund të jenë të nevojshme ekzaminimet plotësuese histopatologjike, ekzaminimet radiologjike për të parë mundësinë e gjetjes së copave metalike të armës shpërthyes brenda trupit, ekzaminimet identifikuese antropologjike, odontologjike, të ADN-së etj. Në ngjarjet me shpërthime të karakterit terrorist me shumë viktimë, ka rëndësi në fillim këqyrja e



vendit të ngjarjes, nga e cila mund të përcaktohet nëse viktimi ka qenë ose jo autori i krimit.

Në literaturën mjekoligjore përshkruhet rasti i një shpërthimi të ndodhur në një automjet, ku shoferi e kishte pjesën e djathtë të trupit të shkatërruar plotësisht, ndërsa pasagjeri në ndenjësën e parë – kishte të destruktuar anën e majtë të trupit. Nga ky konstatim u mendua se bomba ishte vendosur midis tyre në ndenjësën e parë dhe se ata ishin duke e çuar atë në destinacionin e caktuar. Pra kjo e dhënë, përforcoi dyshimin se të dy ata ishin terroristë dhe jo viktimi të pafajshme, në automjetin e të cilëve ishte fshehur një bombë.

Përveç kësaj, në këqyrjen e vendit të ngjarjes së këtyre rasteve ka rëndësi të përcaktohet lloji i lëndës eksplozive të përdorur, ka qenë shpërthim kriminal apo aksidental, kush janë të dyshuarit për përgatitjen e kësaj lënde etj.

Në vendin tonë, ka pasur edhe mjaft raste të terrorizmit individual, ose të organizuar, me vendosje bombash në shtyllat e tensionit të lartë, në rrethe të ndryshme të vendit, apo vrasje me anën e shpërthimeve të armëve plasëse në banesa, automjete etj.

Një rast tipik i shpërthimeve, ka qenë ai i bombës në supermarketin VEFA, në qendër të Tiranës, më 26 shkurt 1996. Nga ky shpërthim u vranë katër persona dhe u plagosën 26 të tjerë. Shpërthimi ndodhi në orën 9:15, disa metra larg hyrjes në supermarket, disa minuta pas hapjes së tij. Në këtë rast u përdor një automjet, - brenda të cilit ishte vendosur lënda shpërthyesë, - i cili u parkua nga autorët e këtij akti terrorist ngjitur me murin e supermarketit. Lënda eksplozive e vendosur në automjet ishte në sasi të madhe, pasi kishte si synim të dëmtonte objektin që ndodhej në një farë distance nga automjeti, siç ishte edhe supermarketi. Momenti i shpërthimit mund të ketë qenë i komanduar saktësisht, p.sh. me telefon celular, biper etj.), por mund të ketë qenë dhe i paracaktuar (koha e djegies së fitilit sipas gjatësisë, mekanizëm i djegies me orë).

Njëra prej viktimave, e seksit femër, me moshë 38 vjeçe, e punësuar si shitëse në supermarket, paraqitej në një gjendje krejtësisht të karbonizuar. Në vendin e ngjarjes, trupi i saj u gjet në një largësi rreth 15 metra nga muri që i korrespondonte vatrës së shpërthimit ku ishte mbështetur automjeti bombë, e mbuluar nga pjesët e rrëzuara të rafteve ku ishin ekspozuar mallrat, midis të cilave produkte kozmetike me lëndë detergjente. Pra, në këtë rast djegia deri në një karbonizim të thellë të trupit të saj, që përbën një prej dëmtimeve nga shpërthimet, ka qenë më shumë një djegie indirekte. Kjo, jo aq nga energjia termike që ka shoqëruar shpërthimin, sepse vatra e tij gjendej mjaft larg prej viktimës, sesa nga djegia e lëndëve detergjente të produkteve kozmetike prej shpërthimit, që ndodheshin në raftet që ishin rrëzuar dhe kishin qëndruar një farë kohe sipër viktimës.

Një rast tjetër i një krimi terrorist, ka qenë ai i vrasjes të gjyqtarit Skerdilajd Konomi, me anën e lëndës eksplozive të vendosur brenda automjetit, më datë 9. 9. 2011, rreth orës 9:30, në kohën që po udhëtonte në bulevardin e qytetit të Vlorës, për të vajtur në zyrën e tij në gjykatë. Lënda plasëse ishte vendosur brenda në makinë dhe momenti i shpërthimit duhet të ketë qenë i komanduar me telekomandë. Pas shpërthimit automjeti mori zjarr dhe viktimi që u nxor prej tij ende i gjallë, me dëmtime të rënda nga shpërthimi dhe djegia e automjetit ku kishte qëndruar një farë kohe pas shpërthimit, ndërroi jetë në spital. Autorët e këtij krimi të rëndë terrorist nuk janë zbuluar ende. Ky krim i rëndë terrorist kundër këtij gjyqtari është konsideruar si një atentat ndaj sistemit të drejtësisë, shtetit ligjor dhe demokracisë në vendin tonë.

Por, rasti më i rëndë, me dyshime të mëdha për një akt terrorist, për të dëmtuar

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

imazhin dhe besueshmërinë e vendit tonë për t'u anëtarësuar në NATO, ngjarje kjo që është shoqëruar me një debat të fuqishëm politik dhe mediatik, që prej shumë vitesh, padyshim është shpërthimi më datën 15. 3. 2008, rreth orës 12:05, në fshatin Gërdec (bashkia Vorë), në një fabrikë që shërbente për çmontimin e municioneve luftarake. Nga ky shpërthim i fuqishëm, që krijoi një krater gjigant, shumë të thellë, të ngjashëm me atë të një bombe atomike në miniaturë, humbën jetën 26 persona, u plagosën rëndë 11 të tjerë, 31 të tjerë me plagosje të lehta dhe 260 të tjerë – dëmtime më të lehta, si dhe lëndime të shëndetit mendor dhe emocional, të një numri të konsiderueshëm personash të tjerë; u dëmtuan 5413 banesa dhe objekte private dhe 32 biznese private.

Trupat e 19 viktimave të para (ndërsa 7 viktima të tjera vdiqën më vonë në spitale) u ekzaminuan menjëherë në morgun e IML Tiranë, ku u konstatua se dëmtimet e tyre ishin shkaktuar kryesisht me mekanizmin e shpërthimit dhe djegies së drejtpërdrejtë nga ky shpërthim, të shoqëruara këto me copëtim dhe karbonizim të disa prej viktimave të kësaj ngjarjeje. Nga këto viktima, 12 rezultuan të seksit mashkull dhe 7 të seksit femër. Për 10 kufoma, me dëmtime më të pakta, identifikimi u krye me lehtësi, kryesisht nëpërmjet njohjes nga të afërmit e tyre. Ndërsa për 4 viktima, identifikimi i tyre u arrit duke përdorur metodat e antropologjisë dhe odontologjisë mjekoligjore. Për 5 viktimat e fundit, të vdekura menjëherë pas kësaj ngjarjeje, të karbonizuara plotësisht dhe të ndara secila në disa pjesë, u përdor me sukses metoda gjenetike krahasuese e ADN-së.

Si mjete të tjera për kryerjen e krimeve terroriste janë vrasjet me armë zjarri, me mjete brejtëse dhe të mprehta, traumat automobilistike (akti terrorist në Nicë, në vitin 2016) etj. Në vendin tonë, vrasjet për motive politike të kundërshtarëve të regjimit komunist, mund të cilësohen si forma të terrorizmit shtetëror. Një rast i tillë mund të konsiderohet pushkatimi pa gjyq i 22 viktimave të pafajshme, intelektualë të Tiranës, në vitin 1952, nën akuzën false se ata kishin vendosur një bombë në ambasadën e Bashkimi Sovjetik në Tiranë.<sup>10</sup> Ky rast është sqaruar plotësisht nga pikëpamja mjekoligjore, sepse janë zbuluar plotësisht mbetjet skeletike të viktimave të tij dhe, shenjat e vrasjes me armë zjarri dhe të keqtrajtimit (gjetja e vrimave të plumbave në kocka, të mbetjeve të predhave në vendin e ngjarjes, kocka të parakrahëve të lidhura midis tyre etj.).

Njëkohësisht, ai përbën një rast tipik të terrorizmit shtetëror, ku shteti komunist i ka vrarë pa asnjë arsye këta intelektualë, të konsideruar si kundërshtarë potencialë të regjimit, me qëllim që të forcojë pushtetin komunist nëpërmjet vrasjes së tyre, e cila do ta trembte dhe terrorizonte popullsinë e vendit tonë.

Një rast tjetër që ka ndodhur në vitet 1970, ka qenë edhe ai i pushkatimit të tre udhëheqësve të Ushtrisë (B. B., P. D., H. Ç.) nën akuza të pavërteta, veprim që do të konsiderohet si terrorizëm shtetëror, që kishte qëllimin që me anën e frikës që do krijonte në popullsi dhe instancat drejtuese të vendit tonë, të forconte pozitën e diktatorit komunist. Edhe ky rast është sqaruar plotësisht nga pikëpamja mjekoligjore.

#### 4. Përfundime

Sot, në vendin tonë, rreziku i terrorizmit pasqyrohet në forcimin e të ashtuquajturit terrorizmit islamik, i influencuar nga motive fetare të devijuara. Ky fenomen është

<sup>10</sup> Gazeta "Koha Jonë", *Bomba në Ambasadën Sovjetike, si u ekzekutuan pa gjyq 22 intelektualë*, Tiranë: 26. 2. 2016.

shoqëruar me vajtjen e shtetasve Shqiptarë në Siri dhe rekrutimi i tyre nga ushtria e ISIS (Islamic State of Iraq and Syria), një shtet terrorist, ku mjaft prej tyre janë vrarë atje. Një aspekt tjetër i terrorizmit në vendin tonë ka të bëjë me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, gjë që për të cilën, janë marrë masa të ndryshme, si p.sh ato ligjore: ligji nr. 157/ 2013 që ka si qëllim parandalimin dhe goditjen e veprimtarive terroriste dhe të atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin etj.

Pra, vendi ynë sot është plotësisht i ekspozuar ndaj rrezikut të terrorizmit ndërkombëtar, të së gjitha llojeve të tij. Për këtë arsye, te ne janë marrë masa të shumta për ta luftuar dhe parandaluar terrorizmin, siç janë: masat ligjore në lidhje me disa ndryshime në Kodin Penal mbi financimin e terrorizmit; krijimi i njësisë antiterror, për bashkëveprimin e aksioneve në luftën kundër terrorizmit; nënshkrimi i protokolleve të bashkëpunimit policor për shkëmbimin e menjëhershëm të informacionve që kanë të bëjnë me krimin dhe, në këtë kuadër dhe me terrorizmin, të cilat kanë dhënë rezultate konkrete në shumë raste.

Si përfundim duhet theksuar se, sot, terrorizmi ndërkombëtar dhe sidomos i ashtuquajturit islamik, përbëjnë një rrezik të madh për jetën e qytetarëve dhe sigurinë e zhvillimit normal të vendeve të ndryshme. Për këtë, në vendin tonë janë marrë masa të ndryshme në drejtim të hartimit të një strategjie të sigurisë kombëtare, miratimit të disa ndryshimeve në Kodin Penal, krijimit të komitetit ndërinstucional (krijimi i njësisë antiterror) etj., për bashkëveprimin e aksioneve në luftën kundër terrorizmit.

Përveç tyre, në luftën kundër terrorizmit ka rëndësi të studiohen dhe të analizohen në fillim, shkaqet dhe motivet që i shtyjnë njerëzit në veprime terroriste; kjo, me qëllim për të lehtësuar marrjen e masave për parandalimin dhe luftimin e tij.

Gjithashtu, për të shmangur të ashtuquajturin terrorizëm islamik ka rëndësi që edukata fetare islame të zhvillohet në shkolla dhe të jepet nga persona të përgatitur dhe programe të aprovuara dhe të kontrolluara nga shteti, e kësaj t'i mbyllet rruga edukimeve të mbrapshta, mashtrimeve dhe manipulimeve.

Nga ana tjetër, mediet, gjatë publikimit të lajmeve që kanë të bëjnë me akte terroriste, duhet të tregohen të kujdesshme, sepse qëllimi kryesor i organizatave terroriste është që nëpërmjet medieve të përçojnë mesazhin e frikës te shoqëria dhe shteti dhe, t'i bëjnë ato që të nënshtrohen e dorëzohen ndaj kërkesave të tyre. Gjithashtu, mediet duhet të kenë parasysh që organizatat terroriste nuk e konsiderojnë të përfunduar aktin terrorist, nëse ai nuk është publikuar në media.

Më në fund, është e rëndësishme që në këto masa të përfshihen edhe ato të përdorimit sa më të plotë dhe sa më efektiv të ekzaminimeve mjekoligjore përkatëse.

## Bibliografi

1. Aggrawal A., "Terrorism; medico-legal aspects". *Encyclopedia of Forensic and legal medicine*, Vol. 4, London, 2005, 269-296.
2. Ceko E., Ferra M., Xhexhi A., "Terrorizmi, faktorët ndihmues të tij dhe kundërveprimi". *Proceedings of 4 International Conference, Akademia Profesionale e Bisnesit Tiranë 2016*, 384-391.
3. Çipi B., *Identifikimi i personit*, Tiranë 2011.
4. Çipi B., "Identifikimi i viktimave të katastrofave". *Revista e Mjekësisë Ligjore Shqiptare*, Nr. 2, 2005, 63-71.
5. Çipi B., *Manual i Mjekësisë Ligjore*, Tiranë 2015.
6. Çipi B., Haliti. N, Sinamati. A., *Mjekësia Ligjore*, Prishtinë 2017.
7. Çuberi B., *Dëmtimet nga armët e zjarrit*, Tiranë, 1990.
8. Dix J., *Atlas of Forensic Pathology*, New York, 2000.
9. Dix J., *Time of Death, Decomposition and Identification*, Florida, 2000.
10. Dolinak D., et al., *Forensic Pathology, Principles and Practice*, Oxford, 2005.
11. Halili R., *Kriminologjia*, Prishtinë, 2005.
12. Harito F., et al., "Aspekte mjekoligjore të dëmtimeve me armë zjarri", *Konferenca e IV e shkencave ligjore*, Tiranë, 1999, 61-64.
13. Latifi V., *Kriminalistika*, Prishtinë, 1999.
14. Latifi V., *Taktika kriminalistike*, Prishtinë, 2001.
15. Lawson G., *Armët dhe çunat*, Tiranë, 2015.
16. *Ligji nr. 157 datë 10. 10. 2013*, "Për masat kundër financimit të terrorizmit".
17. Mborja A., *Këqyrja e vendit të ngjarjes në raste të vendosjes së lëndës eksplozive në automjet*, Tiranë, 2006.
18. Myslimaj F., *Aspekte psikiatriko-ligjore të tentativave vetëdëmtuese dhe vetëvrasëse në Shqipëri*, Temë doktrature, Tiranë, 2016.
19. Sinamati A., "Rrezatimet jonizuese në këndvështrimin mjekoligjor". *Revista e Mjekësisë Ligjore nr. 7*, Tiranë 2008, 25-40.
20. Zeneli Xh., *Tanatologjia Ligjore*, Tiranë, 2006.
21. Wagner S., *Death Scene Investigation*, New York, 2009.
22. *Catholic Encyclopedia*, Oxford, 2011.
23. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2002.
24. *Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, 2002.
25. IDM, *Tendencat e krimit në Shqipëri*, 2008-2012, Tiranë, 2012.
26. Dishovsky, C., Pivovarov, A., *Counteraction to Chemical and Biological Terrorism in East European Countries*. *NATO Science for Peace and Security Series A: Chemistry and Biology*. Springer Science & Business Media, 2009.



---

## **AKADEMIA E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Të drejtat dhe garancitë procedurale, së të miturit në konflikt me ligjin

**MSc. Nikoll RICA**  
Drejtorja e Policisë së Shtetit  
nikoll.rica@asp.gov.al

**MSc. Erand RICA**  
BOKU-Universität für Bodenkultur,  
Vjenë, Austri

## Abstrakt

*Fëmijët janë krijesa më e çmuar e jetës në tokë. Pa ekzistencën dhe zhvillimin e fëmijëve, jeta nuk do të kishte asnjë kuptim, bota njerëzore do të asimilohej dhe zhdukej përfundimisht. Veçanërisht për prindin, fëmija është gjithçka, është drita e syve, gjaku, dashuria dhe lumturia që i lidh brezat njeri pas tjetrit, si hallkat e një zinxhiri të pashkëputur. Por, mund të ndodhë, që fëmija të kthehet edhe në shqetësim të madh për prindin e shoqërinë, kur ai nuk i nënshtrohet procesit edukativ, ose, më keq akoma, kur futet në rrugën e së keqes, duke u bërë subjekt i veprimtarisë kriminale. Për këtë arsye, veprimtaria e shoqërisë për mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin, ka funksionuar që në kohët më të hershme, duke reaguar ashpër ndaj veprimeve apo sjelljeve që cenonin interesat, vlerat dhe normat vitale të fëmijëve. Nevoja për të siguruar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe për të parandaluar pasojat e veprimtarisë kriminale ndaj tyre, i ka diktuar shtetet të miratojnë marrëveshje, konventa apo statute me efekte juridike në planin rajonal e ndërkombëtar, si dhe të ngrënë struktura të posaçme investigimi (organe të zbatimit të ligjit) në planin kombëtar, në funksion të realizimit sa më eficient të drejtësisë penale ndaj të miturve.*

*Nisur nga rëndësia që ka vendosja e drejtësisë penale për të mitur, kjo temë nëpërmjet një studimi të thelluar ka për qëllim të trajtojë situatën aktuale së të miturve në konflikt me ligjin, kornizën e re ligjore që i merr ata në mbrojtje, si dhe gjetjen e formave e metodave të reja shkencore në punën investiguese që kryen policia gjyqësore në funksion të parandalimit të veprimtarisë kriminale ndaj të miturve. Përmirësimi i kapaciteteve të marrjes së informacionit dhe hetimit të krimit do të fokusohen në sigurimin e zbatimit të reptë të ligjit material e atij procedural penal, të lidhura këto ngushtë me parimet dhe rregullat e përgjithshme që respektohen gjatë procedimit penal së të miturve, pozicionin e tyre si viktimë dhe dëshmitar i veprës penale, shmangien nga ndjekja penale apo dënimi i të miturve përmes masave alternative etj. Për grumbullimin dhe paraqitjen e këtyre të dhënave, janë shfrytëzuar burimet statistikore të organeve të procedimit penal: policisë gjyqësore, prokurorisë dhe gjykatës.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**I mitur, drejtësi penale, kërkim shkencor, prezumim i pafajësisë, alternativë e dënimit me burgim, riviktimizim, proporcionalitet, ndërmjetësim.**

## 1. Hyrje

Funksionimi dhe administrimi i drejtësisë penale për të mitur, përbën pjesën me delikate të sistemit të drejtësisë penale në tërësi. Kjo gjë, ka funksionuar që në kohët më të hershme, si reagim i ashpër i shoqërisë ndaj veprimeve që cenojnë interesat e fëmijëve. Për shkak të veçorive specifike që mbart moshën e fëmijërisë, si, mungesa e pjekurisë fizike dhe intelektuale, apo trajtimi i pakujdesshëm që u bëhet atyre nga të rriturit, fëmijët, janë ajo pjesë e shoqërisë që kanë më shumë nevojë për mbrojtje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Çdo fëmijë, duhet të gëzojë të drejtat e tij themelore të përkujdesjes për rritje, arsimim, edukim, mbrojtje sociale, argëtim, garanci procedurale në drejtësi etj. Këto të drejta janë të përcaktuara në ligje të veçanta të çdo shteti, si dhe në mënyrë të posaçme, në Konventën e OKB-së, “Mbi të Drejtat e Fëmijës”<sup>1</sup>.

Angazhimi i shoqërisë në tërësi dhe institucioneve arsimore e ligjzbatuese në veçanti, duhet të jetë detyrë prioritare, për të krijuar një botë të denjë për fëmijët, ku ata ta nisin jetën e tyre në mënyrën më të mirë dhe të kenë mundësi të shumta, për zhvillimin e aftësive individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues. Pikërisht ky mjedis, duhet të shërbejë si nxitje për zhvillimin fizik, psikologjik, shpirtëror, shoqëror, emocional dhe kulturor të fëmijëve.

Duke e vlerësuar periudhën e fëmijërisë si kohën më vendimtare për të ardhmen në moshën e rritur, çdo familje si njësi bazë e shoqërisë, apo institucion shtetëror, duhet të tregojë kujdes të posaçëm në plotësimin e nevojave zhvillimore të fëmijëve. Njëra prej nevojave më themelore është ajo e sigurisë, mungesa e të cilës e bën të pamundur që të

<sup>1</sup> OKB, Konventa “Mbi të Drejtat e Fëmijës”, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 20 nëntor 1989.

kemi individë të shëndetshëm dhe qytetarë të përgjegjshëm. Plotësimin e kësaj nevoje, në radhë të parë e ka për mision ta sigurojë Policia e Shtetit, si institucioni përgjegjës për garantimin e rendit dhe sigurisë publike.

Ndërkohë, organet e drejtësisë kanë për detyrë të zbatojnë standardet më të larta, në procedimet penale, që kanë për subjekt të miturit në konflikt me ligjin. Shprehja “Drejtësi e vonuar është drejtësi e mohuar”, përbën obligim primar të çdo organi procedues, për të shmangur zvarritjet në çdo proces hetimor e gjyqësor. Kur vonesat lidhen me procese që kanë për subjekt të miturit në konflikt me ligjin, çdo zvarritje apo deformim i procesit hetimor e gjyqësor sjell pasojë të pariparueshme për shoqërinë në tërësi.

Përkujdesja duhet të drejtohet tek të gjithë fëmijët, por, para së gjithash ajo duhet të shkojë tek fëmijët jetimë, fëmijët e rrugës, fëmijët e shpërngulur dhe ata refugjatë, fëmijët e trafikuar, shfrytëzuar ekonomikisht dhe seksualisht, apo fëmijët që janë duke vuajtur dënimin nëpër institucione të ekzekutimit të vendimeve penale.

## 2. Kuptimi dhe rëndësia e drejtësisë penale për të mitur

Drejtësia penale për të mitur si pjesë e sistemit të drejtësisë penale në tërësi, përfshin kushte dhe kritere mbi përcaktimin e personit të mitur në konflikt me ligjin, përcaktimin e të miturit si viktimë apo dëshmitarë si dhe procedurat që lidhen me veprat penale, duke përfshirë ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit, apo çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin.

Në këtë kuptim, “*i mitur në konflikt me ligjin*”<sup>2</sup> konsiderohet çdo person që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale deri nën moshën 18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një veprë penale, është marrë si i pandehur ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale. Ndërsa “*i mitur viktimë*”<sup>3</sup> është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale.

Drejtësia penale për të mitur kalon në disa faza dhe ka për qëllim:

- garantimin e një kuadri ligjor funksional, që siguron mbrojtjen efektive dhe interesat më të larta së të miturit;
- promovimin dhe riintegrimin e të miturit në konflikt me ligjin penal, që ai të luajë një rol sa më të dobishëm në shoqëri;
- garantimin e rishoqërizimit dhe rehabilitimit së të miturit që ka kryer veprë penale;
- mbrojtjen e të drejtave së të miturit në rastet kur është dëshmitar ose viktimë e veprës penale;
- parandalimin e riviktimizimit apo viktimizimit e dytë së të miturit, i cili më parë ka qenë viktimë e një vepre penale;
- parandalimin e përsëritjes së veprave penale;
- mbrojtjen e rendit publik në procesin e administrimit të drejtësisë penale për të mitur;
- rritjen e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të organeve të ngarkuara me administrimin e çështjeve të drejtësisë penale për të mitur;
- garantimin e masave edukative dhe parandaluese për të miturit që kryejnë vepra penale duke siguruar ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës për zbatimin e tyre.

<sup>2</sup> Ligji nr 37/2017: “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, neni 3, pika 4.

<sup>3</sup> Ligji nr 37/2017: “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, neni 3, pika 5.



Në procesin e masave të përgjithshme të drejtësisë penale, për të mitur përfshihen edhe *masat e drejtësisë restauruese*, të cilat nënkuptojnë çdo masë, që lejon të miturin në konflikt me ligjin të kuptojë përgjegjësinë dhe të korrigojë pasojat e një veprë penale, të kompensojë dëmet apo të pajtohet me viktimën, palën e dëmtuar dhe persona të tjerë të prekur nga vepra penale. Në këtë rast, i mituri që ka kryer veprën penale apo pala e dëmtuar, marrin pjesë së bashku në mënyrë aktive për të zgjidhur pasojat e një veprë penale, zakonisht me ndihmën e një pale të tretë të pavarur. Ndërsa, nëpërmjet *institutit të ndërmjetësimit* zgjidhet procesi jashtëgjyqësisht, përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje.

Në funksion të realizimit të drejtësisë penale, për të mitur ngarkohen organe kompetente dhe persona përgjegjës që, sipas rastit janë: gjyqtari, prokurori, punonjësi i policisë gjyqësore, punonjësi i policisë së shtetit, avokati, psikologu, punonjësi social, ndërmjetësi, punonjësi i njësisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe të shërbimit të provës, punonjësi i institucionit të rehabilitimit të miturve dhe paraburgimit e burgjeve, si dhe çdo strukture apo zyrtar tjetër që përfshihet në këtë proces.

Rëndësia e drejtësisë penale për të mitur konsiston në faktin se, ajo fokusohet vetëm për procedurën e administrimit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe për të miturit viktimë ose dëshmitarë të veprave penale. Siç kemi sqaruar më sipër, moshë e mitur konsiderohet nga 14 deri në 18 vjeç. Por rregullat e drejtësisë penale për të mitur, zbatohen edhe për personat e moshës nga 18 deri në 21 vjeç, nëse dikush është marrë i pandehur për një vepër penale të kryer kur ka qenë i mitur. Sigurisht që, rregullat e drejtësisë penale për të mitur, nuk përfshijnë persona që kryejnë vepra penale nën moshën e përgjegjësisë penale. Ndaj atyre nuk fillon procedimi penal ose, nëse ka filluar, pushohet menjëherë. Në këtë rast vihen në lëvizje strukturat e mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatohen të gjitha masat e parashikuara nga ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Qëllimi është që atyre t'u sigurohen të njëjtat garanci procedurale, ndihmë dhe shërbime, si për të miturit në konflikt me ligjin, ashtu dhe kur ata janë viktimë ose dëshmitar, për sa i përket procesit të marrjes në pyetje dhe kontaktit me organet e policisë dhe të prokurorisë.

### 3. Drejtësia për të mitur në procesin e saj historik

Sipas burimeve arkivore dhe literaturës studimore, rezultojnë se fillimet e para të legjislacionit që trajton sistemin e drejtësisë penale për të mitur në Shqipëri, i gjejmë nga fundi i shekullit XIV-të, tek ligji i Sheriatit, i bazuar tek Kurani, legjislacioni i cili ka funksionuar në zonat e pushtuara nga Perandoria Otomane, dhe ka vazhduar deri në fund të shekullit XVIII. Në bazë të këtij ligji, të drejtën për të ushtruar funksionet e hetimit dhe të gjykimit për të miturit në konflikt me ligjin (ashtu sikundër, edhe për të rriturit), i kishin Këshillat e Sheries.<sup>4</sup>

<sup>4</sup> “Këshilli i Sheries ushtronte funksionet e hetimit dhe të gjykimit të çeshtjeve. Në një dokument të Sixhilit të Sheries Elbasan thuhej se: “Të quajturit Musa dhe Gani (i mitur), nga Bishqemi Elbasan pa të drejtë një ditë më parë dhe qëllimisht i qëlluan me shigjetë dhe i vranë të quajturit Mehmet Veli dhe djemtë e tij. Nga ana e Sheries të bëhen hetimet e duhura”. Prof. Dr. Ismet Elezi: “Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri”. Botim i vitit 1997 faqe 13.

Ndërsa në zonat malore të Shqipërisë, nga veriu në jug, që nuk ishin të pushtuara nga Perandoria Osmane, rregullimi juridik i normave të hetimit dhe të gjykimit të çështjeve penale me subjekt të miturit bëhej sipas të drejtës zakonore. Në këtë të drejtë, e cila përfshinte një tërësi normash të pashkruara, të përcjella në traditën gojore nga njëri brez në tjetrin, veç të tjerash, përcaktoheshin rregullat procedurale të organeve të Bajrakut: Pleqve të katundeve, Pleqve të fiseve, Strapleqve të fisit, Pleqve të thjeshtë, Pleqve të çështjeve të veçanta etj., për hetimin dhe ndëshkimin e fajeve dhe të dramave kundër jetës e pasurive, që kishin për subjekt edhe të miturit.

Përcaktime më specifike hasim tek kodi penal dhe ai i procedurës penale otomane, që hyri në fuqi në disa zona të Shqipërisë, në vitin 1878 (1274 sipas kodit kalendarik të vjetër turk), në kohën e sundimit të Sulltan Mehmetit të Dytë. Në këtë kohë u nxorën kanunamatet (kodet), midis tyre edhe kodi penal dhe ai i procedurës penale otomane, të cilët ishin kopje të kodit penal e atij të procedurës penale franceze të vitit 1808, që hyri në fuqi dhe u aplikua në Shqipëri për një kohë të gjatë, nga pozita detyruese e një vendi që sundohej nga perandoria turke<sup>5</sup>. Në këto akte, veç të tjerash parashikohej mosha për përgjegjësi penale e të miturit si dhe procedura e hetimit dhe gjykimit të çështjeve me subjekt të miturit në konflikt me ligjin; p.sh., përgjegjësia penale në atë kohë parashikohej në moshën mbi 10 vjeç.

Edhe pas shpalljes së Pavarësisë, për shkak të nevojave të ngutshme dhe mungesës së legjislacionit kombëtar, Kuvendi i Vlorës vendosi të adoptonte përkohësisht, derisa të krijohet legjislacioni i plotë i shtetit shqiptar, ligjin osman. Për rrjedhojë, sistemi i drejtësisë penale për të mitur në këtë periudhë bazohej në normat e ligjit penal e atij procedural penal osman, të vitit 1878. Ky fakt nuk cenonte, as statusin ligjor të institucioneve ligjzbatuese, as karakterin kombëtar të tyre. Ruajtja e legjislacionit penal dhe atij procedural penal osman, u sanksionua me vendim të Këshillit të Ministrave dhe u komunikua me qarkoren e Ministrisë së Punëve të Brendshme, datë 12 maj 1913, në të cilën thuhej: “Deri në vënien në zbatim të ligjeve të reja, lihen në fuqi ligjet dhe rregulloret e qeverisë osmane”.<sup>6</sup> Si hallka të para gjyqësore, të miratuara nga autoritetet shqiptare për drejtësinë penale në tërësi ishin: Këshilli i Pleqve, Gjyqtarët e Paqit, Gjykata e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit.

Pas shpalljes së Monarkisë, në vitin 1928, legjislacioni penal e ai procedural penal, u orientuan drejt legjislacionit italian. Sistemi i drejtësisë për të mitur, ndonëse ishte i ashpër në përcaktimin e kriterëve dhe sanksioneve, pasi ulte moshën për përgjegjësi penale deri në 10 vjeç, kishte elementë pozitivë, që merrte në mbrojtje të miturit, në rastet, kur subjekt i veprave penale bëheshin ata; p.sh., në rastet kur sanksioni i dispozitave të kodit penal parashikonte dënim me vdekje, burgim të përjetshëm, burgim të rëndë ose burgim jo më pak se një vit për të rriturit dhe kur subjekt i veprave penale bëheshin të miturit, gjykata me kërkesë të prokurorit mund të urdhëronte vendosjen e fajtorit në një institut edukimi. Në rregulloren e burgjeve, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me 18 qershor 1933, parashikohej mbajtja e të rinjve deri në moshën 21 vjeç, në dhoma të ndara nga të rriturit, si dhe vendosja e tyre në burgjet e prefekturave edhe nëse ata ishin dënuar më pak se një vit. Po kështu, parashikohej që të miturit të kishin përparësi në arsimimin dhe trajtimin e tyre.

<sup>5</sup> Grigor Gjika, Koço Nova, *Mbi gjykimin në shkallë të dytë në procesin penal*, Tiranë: Botim i Ministrisë Drejtësisë, 1961. f. 9.

<sup>6</sup> AQSH, Dok. 11171, f. 71.

Sistemi i drejtësisë penale për të mitur, ka funksionuar edhe gjatë viteve 1945-1990, me të mirat dhe zigzaget e kohës. Në mars të vitit 1953, u miratua Kodi i Procedurës Penale, i cili ishte i pari ligj në nivel kodi pas çlirimit të vendit, i cili përcaktonte parimet dhe rregullat e sistemit të drejtësisë penale në tërësi, si dhe asaj për të mitur në veçanti. Me disa ndryshime të mëvonshme që iu bënë këtij Kodi, në vitin 1958 dhe 1979, ky sistem u aplikua dhe funksionoi në Shqipëri deri në qershor të vitit 1992.

Si elementë të veçantë të kësaj periudhe, veçojmë parashikimin e masave edukuese që mund të zbatoheshin ndaj të miturve, siç ishin:

- vendosja e të miturit në një institucion edukimi;
- lënia e personit për edukim, kolektivitet dhe organizatave shoqërore.

Në vitin 1957 në Shqipëri u ngrit një qendër për të mitur, e cila emërtohej: “Kolonia e edukimit”. Ajo ka funksionuar deri në vitin 1969. Më pas kjo qendër u mbyll dhe u hap përsëri në muajin dhjetor të vitit 1986<sup>7</sup>. Në këtë institucion u vendosën bashkërisht, si të miturit e moshës 14-18 vjeç, të cilët ishin deklaruar fajtorë nga gjykatat dhe të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, ashtu edhe ata të moshës nën 14 vjeç, ndaj të cilëve ishte vendosur për të ndjekur shkollën me vendim të komisionit të ndjekjes së krimeve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në bazë të programit të kësaj shkolle, arsimi profesional i të miturve ishte i detyruar dhe organizimi i tyre bëhej në punë të ndryshme, kryesisht në bujqësi. Shkolla e edukimit u mbyll në vitin 1991.

Në vitin 1995 u miratua kodi i ri penal dhe ai i procedurës penale, të cilët bënë një ndryshim të plotë si në koncept, ashtu edhe në parimet e funksionimit të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Fryma e këtyre akteve, për sa i përket trajtimit së të miturve në konflikt me ligjin bazohej tek Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve. Kjo konventë është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më datë 20 nëntor të vitit 1989 dhe përfaqëson një grupim normash dhe detyrimesh, që kanë për qëllim të pranohen në mbarë botën, të cilat mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Komuniteti ndërkombëtar, përmes këtij teksti, bëri të njohur se qeniet njerëzore nën moshën 18 vjeç, duhet dhe kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë. Më 19 dhjetor të vitit 2011, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, miratoi *Protokollin e tretë fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës*, duke krijuar një procedurë individuale të ankimimit, në rastet e shkeljeve të së drejtave të fëmijëve. *Protokolli i tretë opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve*, ka hyrë në fuqi në muajin prill të vitit 2014.

#### 4. Parimet e drejtësisë penale për të mitur

Parimet e drejtësisë penale për të mitur janë rregulla themelore që zbatohen nga çdo person dhe organ kompetent, në të gjitha veprimet dhe vendimet që ato marrin lidhur me të miturin, në konflikt me ligjin. Këto parime zbatohen edhe në veprimet administrative të Policisë së Shtetit apo, organeve të tjera, që kryejnë veprimtari administrative në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur. Disa nga parimet më kryesore të drejtësisë penale për të mitur, janë:

*Prezumimi i pafajësisë.* Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kuptimi dhe zbatimi i këtij parimi në praktikë, është garancia kryesore për mbrojtjen e të drejtave së të miturit në të gjitha fazat e procedimit penal. Efektet juridike të këtij parimi konsistojnë

<sup>7</sup> Me dekret nr. 7003, datë 28. 10. 1985, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe VKM nr. 438 datë 20. 12. 1986.

në:

- çlirimin e të pandehurit të mitur nga barra për të provuar pafajësinë e tij;
- dhënien e të drejtës për të mos iu përgjigjur akuzës dhe për të mos mbajtur përgjegjësi për deklarimet që bën para organit procedues;
- dhënien e të drejtës për t'i kërkuar organit procedues, vetë ose nëpërmjet mbrojtësit apo përfaqësuesit të tij, për marrjen e provave që e shfajësojnë atë etj.

Nga parimi i prezumimit të pafajësisë, buron rregullimi i interpretimit të dyshimeve në favor të pandehurit të mitur, sipas të cilit kur faktet dhe rrethanat e çështjes lejojnë vlerësime dhe interpretime të ndryshme, duhet pranuar interpretimi më i favorshëm për të pandehurin e mitur.

*Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.* Sipas këtij parimi, për çdo vendim apo veprimtari që merret nga organet kompetente, duhet të vlerësohet me përparësi interesi më i lartë i të miturit. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysht:

- nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe rritje e përkatësi në një familje;
- mendimet e fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar;
- historia e fëmijës, duke mbajtur parasysht situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme mund të ndodhin në të ardhmen;
- aftësinë e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës;
- vazhdimësinë e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore ose shpirtërore.

Për zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, organet kompetente kur nxjerrin vendime apo miratojnë akte, i përmbahen argumentimit të posaçëm lidhur me mënyrën se si është analizuar dhe si do të sigurohet respektimi i interesit më të lartë së të miturit.

*Mbrojtja nga diskriminimi.* Të drejtat që burojnë nga ky parim garantojnë çdo të mitur në konflikt me ligjin, të mos diskriminohet, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë së të miturit. Të drejtat e të miturit mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit.

Në Shqipëri janë evidentuar disa raste të diskriminimit të fëmijëve romë për shkak të ngjyrës, varfërisë duke i shfrytëzuar në punë të detyruar, martesave të hershme, keqtrajtimit nga prindërit, ose përfaqësuesit e tyre ligjor etj. Rasti më flagrant është ai i vitit 2011, ku, një grup i strukturuar kriminal merrej me trafikimin e fëmijëve romë në Greqi, duke ndërhyrë deri në transplantimin e organeve të tyre. Gjithashtu, fenomeni i gjakmarrjes vazhdon të mbetet një shqetësim për shoqërinë, duke sjellë si pasojë ngujimin e fëmijëve dhe ndërprerjen e shkollave të tyre.

*Përparësia në dhënien e masave alternative të shmangies.* Në procedurën e drejtësisë penale për të mitur, përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese, vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në

vëmendje, që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit së të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit, përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Sa herë që është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget procesi i procedimit penal ndaj të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij.

Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë. Masat shtrënguese përdoren vetëm si një masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe të jenë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t'i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore së të miturit.

Duke ju referuar të dhënave të Institutit të Statistikës<sup>8</sup>, për periudhën 2005-2015, rezulton se nga gjykatat penale janë dënuar 5696 të mitur. Viti që ka pasur më shumë raste të dënimit së të miturve, është viti 2012, me 883 raste. Mesatarja e të miturve të dënuar çdo vit është 570 raste. Krimet në raport me kundërvajtjet penale të kryera nga të miturit janë më të shumta në numër. Në harkun kohor 2005-2015 janë dënuar të mitur për krime 4886 persona dhe për kundërvajtje 810 persona.

Këto të dhëna, tregojnë se akoma mbetet shqetësuese mungesa e orientimit drejt aplikimit të masave alternative, të shmangies nga procedimi penal, apo zbatimi i masave të drejtësisë restauruese.

*Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut.* Në çdo fazë të procedimit penal me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme. Psikologu garanton, sipas rastit, mbështetjen psikologjike së të miturit dhe vlerëson thëniet e tij, në përputhje me zhvillimin mendor. Prania e psikologut synon që të miturit në konflikt me ligjin, të miturit viktimë ose dëshmitar t'i sigurohet pyetja në mënyrën e duhur dhe t'i lehtësohet dhënia e dëshmisë nga ana e tij, duke bërë kujdes për të eliminuar frikësimin ose ndrojtjen e të miturit nga procesi. Organi procedues, kur është e mundur, kujdeset që të sigurojë praninë e të njëjtit psikolog gjatë gjithë procesit penal, kur është në interesin më të lartë së të miturit. Psikologu, i cili kryen rolin e mbështetësit emocional të fëmijës gjatë procesit të hetimit dhe gjykimit, nuk mund të caktohet nga gjykata për të marrë rolin e ekspertit, duke përgatitur vlerësim psikologjik për të njëjtin të mitur.

## 5. I mituri, si viktimë dhe dëshmitar i veprës penale

Në rastet kur i mituri thirret si viktimë ose dëshmitar i veprës penale, bëhet kujdes i veçantë, që ai të trajtohet në mënyrë miqësore e të ndjeshme, duke respektuar plotësisht dinjitetin e tij. Në këtë proces, merret në konsideratë gjendja e tij personale, nevojat e menjëhershme apo të veçanta, mosha, gjinia, aftësitë e kufizuara, nëse ka, si dhe niveli i pjekurisë. Ai mbrohet nga jeta private, duke mos lejuar ndërhyrjen e asnjë subjekti apo individi. Çdo pjesëmarrës në administrimin e drejtësisë për të mitur, i cili ka të dhëna lidhur me të miturin viktimë ose dëshmitar, është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjithë informacionit, të marrë për shkak të detyrës ose gjatë kryerjes së detyrës. Bërja publike e informacionit lidhur me identitetin e të miturit dëshmitar ose viktimë,

<sup>8</sup> Institutit të Statistikës, viti 2016.

bëhet vetëm me leje të gjykatës. Në procesin e marrjes së dëshmisë ndaj të miturit, si viktimë ose dëshmitar, respektohen shumë të drejta, midis të cilave veçojmë:

*E drejta e të miturit viktimë ose dëshmitar për t'u informuar.* Organi procedues, ka detyrim ligjor të informojë menjëherë dhe gjatë gjithë procesit, të miturin viktimë ose dëshmitar, përfaqësuesin e tij ligjor ose procedural, apo mbrojtësin lidhur me:

- procedurat e drejtësisë penale, përfshirë rëndësinë dhe rolin e të miturit viktimë, kohën e dëshmisë, si dhe mënyrat në të cilat do të kryhet marrja në pyetje gjatë hetimit dhe gjykimit;

- mekanizmat mbështetëse për të miturin viktimë për bërjen e ankesës, marrjen pjesë në hetimet dhe procedurat gjyqësore, përfshirë vënien në dispozicion të mbrojtësit së të miturit;

- vendin dhe kohën e marrjes në pyetje;

- masat mbrojtëse në dispozicion së të miturit;

- mjetet ligjore ekzistuese për rishikimin e vendimeve që sjellin pasoja për të miturin viktimë;

- të drejtat e të miturit viktimë të zbatueshme në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

- mundësinë për të kërkuar dëmshpërblim nga autori i veprës penale, sipas legjislacionit përkatës;

- programet e drejtësisë restauruese në dispozicion dhe funksionimin e tyre;

- mundësinë e shërbimeve përkatëse, të tilla si ato shëndetësore, psikologjike, sociale, financiare dhe ligjore, si dhe mënyrat e përfitimit të tyre.

Për të realizuar këto të drejta dhe parandaluar rrezikun e riviktimizimit dhe viktimizimit të dytë të së miturit, në veprimet procedurale, në të cilat i mituri është viktimë ose dëshmitar, merr pjesë përfaqësuesi ligjor, mbrojtësi dhe psikologu, si dhe, sipas rastit, nëse është e mundshme, edhe personi i besuar i të miturit. Ata kanë të drejtë të shprehin opinionin e tyre lidhur me nevojat e të miturit përpara organit procedural; të informohen në lidhje me akuzat e ngritura ndaj të pandehurit dhe marrëdhëniet mes të miturit dhe të pandehurit; të informohen lidhur me ecurinë e procesit dhe vendimet, lidhur me masën e sigurisë që është vendosur ndaj të pandehurit; të bëjnë ankim në lidhje me vendimin e dhënë nga gjykata, pavarësisht nëse kjo e drejtë ushtrohet ose jo nga prokurori i çështjes, etj. Gjyqtari gjatë gjykimit, dhe prokurori në fazën e hetimeve, mund të ndalojnë përfaqësuesin ligjor të një dëshmitari ose viktime të mitur për të marrë pjesë në veprimet procedurale, vetëm nëse kjo është e domosdoshme për interesin më të lartë të së miturit.

*E drejta për ndihmë juridike.* I mituri viktimë ka të drejtë të mbrohet pa pagesë gjatë gjithë procesit të drejtësisë, nga një avokat, të cilin e zgjedh nga lista përkatëse e hartuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Duke studiuar rastet praktike të mbrojtjes së të miturve rezulton se shpesh herë në caktimin e masave të sigurimit ndaj të miturve, caktohen avokatë kryesisht, të cilët gjenden rastësisht në mjediset e gjykatës. Ata, pa e studiuar dosjen, marrin përsipër përfaqësimin, duke mos pasur aftësitë profesionale për të kryer detyrën e mbrojtësit. Për këtë arsye, kërkohet që kategoria e avokatëve që bëjnë mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin, të kenë trajnim të veçantë dhe të jenë plotësisht të aftë, për mbrojtur të drejtat e të miturve në çdo fazë të procedimit penal, derisa të ekzekutohet vendimi gjyqësor. Kjo, kërkon bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Dhomës së Avokatisë dhe Gjykatës, për të mos ja lënë rastësisë caktimin e avokatëve kryesisht. Cilësia jo e mirë e mbrojtjes ligjore në momentin e caktimit të masës së sigurimit

personal, ndikon negativisht në të gjithë procesin e mëvonshëm vendimmarrës ndaj të miturit.

*E drejta e mbrojtjes kur siguria e të miturit viktimë ose dëshmitar është në rrezik.* Në çdo rast kur siguria e të miturit viktimë ose dëshmitar vihet në rrezik, prokurori, policia gjyqësore ose njësia për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës marrin masa mbrojtëse si:

- shmangien e kontaktit të drejtpërdrejtë midis të miturit viktimë ose dëshmitar dhe të akuzuarit, në çdo fazë të procesit;

- bërjen e kërkesës për nxjerrjen e një “urdhër-kufizimi” në gjykatë (kërkesa regjistrohet në një regjistër të veçantë dhe protokollohet ditën e dorëzimit të saj; në këtë rast zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e legjislacionit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”);

- bërjen e kërkesës për vendosjen e masës së sigurimit “arrest me burg” ose “arrest në shtëpi”, për të akuzuarin me kushtin e ndalimit të kontaktit me të miturin;

- bërjen e kërkesës për marrjen e masave mbrojtëse për të miturin viktimë ose dëshmitar, prej policisë ose strukturave të tjera dhe ruajtjen e sekretit të vendndodhjes së të miturit;

- marrjen ose kërkimin nga autoritetet kompetente të masave të tjera mbrojtëse, që konsiderohen të përshtatshme.

Gjykata, nëse konstaton rrezik për të miturin viktimë ose dëshmitar, mund të vendosë edhe kryesisht për marrjen e masave të mbrojtjes.

## **6. Rregullat e veçanta të marrjes në pyetje të së miturit viktimë ose dëshmitar**

Marrja në pyetje e të miturit viktimë ose dëshmitar është një nga veprimet hetimore më të rëndësishme që kryhet nga organi procedues gjatë procesit të së provuarit. Kur ky veprim hetimor kryhet ndaj të miturit viktimë ose dëshmitar, çështja bëhet më delikate për vetë veçoritë specifike që mbart kjo kategori personash; p.sh., në rastet kur dhënia e dëshmisë mund ta vendosë viktimën ose dëshmitarin e mitur në rrezik serioz për jetën apo për shëndetin, atëherë organi procedues, në përshtatje me moshën, gjatë marrjes së dëshmisë garanton:

- pyetjen e dëshmitarit ose viktimës së mitur, duke përdorur pajisje që ndryshojnë pamjen ose zërin e tij, marrjen në pyetje pas një ekranit jotransparent ose, marrjen në pyetje në distancë;

- pyetjen e dëshmitarit ose viktimës së mitur përpara fillimit të seancës gjyqësore me pjesëmarrjen e mbrojtësit, si dhe video-regjistrimit të pyetjes së të miturit;

- ndjekjen e procesit dhe pyetjen e të miturit dëshmitar ose viktimë, kur është e mundur dhe e përshtatshme, nga të njëjtët persona dhe kufizimin sa më shumë të jetë e mundur e marrjeve të shpeshta në pyetje të së miturit.

Gjatë procesit të marrjes në pyetje të së miturit viktimë ose dëshmitar, gjykata, përveç rregullave të zakonshme që zbaton për çdo person tjetër, zbaton edhe disa rregulla të veçanta, siç janë:

- marrjen në pyetje të së miturit, në mjedise miqësore, edhe jashtë mjedisit të gjykatës;

- realizimin e sigurimit të provës në një kohë sa më të shkurtër pas fillimit të procedimit penal, për të shmangur efektet negative që vijnë nga tejzgjatja e procesit;

- mosrimarrjen në pyetje në shkallët e tjera të gjykimit për të shmangur riviktimizimin e të miturit, me përjashtim të rasteve të caktuara në ligj;

- masa të tjera, që gjykata i konsideron të përshtatshme.

## 7. Shmangia e të miturit nga ndjekja penale dhe dënimi, përmes masave alternative

Dhënia e masave alternative ka për qëllim shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimin e masave të drejtësisë restauruese. Në marrjen e vendimit për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale, vlerësohet interesi më i lartë i të miturit, rëndësia e veprës penale të kryer dhe dënimi i parashikuar për atë veprë, mosha e të miturit, shkalla e fajësisë, dëmi i shkaktuar, efekti frikësues i ndjekjes penale, sjellja e të miturit pas kryerjes së veprës penale, si dhe raporti i vlerësimit individual. Masat e shmangies nga ndjekja penale për të miturin, zbatohen në rastet kur:

- ka prova të mjaftueshme për një dyshim të arsyeshëm se i mituri ka kryer një veprë penale, për të cilën parashikohet dënim me burgim deri në 5 vjet në maksimum ose me gjobë;

- i mituri pranon dhe shpjegon veprën penale në prani të mbrojtësit;

- i mituri nuk është kallëzuar për kryerjen e një vepre penale ose nuk është përsëritës;

- i mituri dhe, sipas rastit, përfaqësuesi i tij ligjor ose procedural japin pëlqimin me shkrim për zbatimin e shmangies;

- i mituri nuk ka marrë pjesë më parë në një program ku të jetë zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale ose ndërmjetësimi;

- dënimi i të miturit për ato vepra nuk i shërben korrigjimit të sjelljes së tij.

Siç konstatohet nga rastet e mësipërme, shmangia nga ndjekja penale e të miturit nuk realizohet për çdo veprë penale, por, për ato vepra që paraqesin rrezikshmëri relativisht të ulët shoqërore. Pendesa, qëndrimi pohues apo, mosqenia përsëritës i një vepre penale, janë gjithashtu kritere vlerësuese për të përfutur shmangien nga ndjekja penale.

Përpara se të merret vendimi për zbatimin e masës së shmangies, organi procedues kërkon informacion nga prindërit, kujdestarët ligjorë, institucionet që kanë dijeni për veprimtarinë e të miturit, përfshirë, sipas rastit, edhe *Njësinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës*, si dhe mendimin e ekspertit, sipas nevojave të së miturit dhe të procesit.

Masa e shmangies së të miturit nga ndjekja penale merret me iniciativë të prokurorit ose me kërkesë të së miturit (përfaqësuesit të tij). Sipas rastit, kur e çmon të arsyeshme, këtë masë e merr edhe gjykata. Kur vendimi për zbatimin e masës së shmangies nga ndjekja penale merret nga prokurori, procedura kryhet përpara se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Fillimisht, i propozohet të miturit për masën e shmangies nga ndjekja penale dhe, në rast se ai jep pëlqimin, organi procedues vendos zbatimin e masës. Në rast se, kërkesa ose propozimi për zbatimin e masës së shmangies nuk pranohet nga i mituri, në konflikt me ligjin, atëherë mbahet një procesverbal, në të cilin pasqyrohen arsyet e mospranimit të masës nga i mituri.

Kur kërkesa për zbatimin e masës së shmangies refuzohet nga prokurori, atëherë, i mituri në konflikt me ligjin ose përfaqësuesi i tij, kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e kësaj mase në gjykatë, sipas afatit të përcaktuar prej 15 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e refuzimit. Në rastet kur vendoset masa e shmangies, prokurori merr vendim për mosfillimin e çështjes penale ose pushimin e saj, duke lidhur një marrëveshje me të miturin për llojin e masës së shmangies dhe ndërmjetësimin.



## **7.1. Garancitë e të miturit për zbatimin e masës së shmangies**

Përpara se të zbatohet vendimi për masën e shmangies nga ndjekja penale, i mituri, mbrojtësi i tij dhe, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor kanë të drejtë të marrin informacion të detajuar mbi thelbin e masës së shmangies nga ndjekja penale, kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit, si dhe pasojat për mospërbushjen e masave të shmangies. Të miturit i shpjegohet gojarisht dhe me shkrim, ose në format e duhura të komunikimit, sipas aftësive të veçanta të së miturit, se pranimi i masës së shmangies nga ndjekja penale është vullnetar dhe se i mituri ka të drejtë të heqë dorë prej masës në çdo fazë. Nëse i mituri nuk ka mbrojtës, ai ose përfaqësuesi ligjor i tij informohen lidhur me të drejtën për të pasur një mbrojtës. Pranimi i veprës penale nga i mituri dhe informacioni i mbledhur rreth tij gjatë procesit të shmangies nuk mund të përdoren në gjykatë kundër tij.

Prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimit, me qëllim zbatimin me kusht të masës së shmangies, nëse i mituri në konflikt me ligjin kërkon dhe garanton përmbushjen e detyrimeve, siç janë: riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale, sipas aftësive të tij dhe sipas rastit; përfshirja në programe të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit; përfshirja në punët e një organizate humanitare ose në veprimtaritë e komunitetit ose të mbrojtjes së mjedisit; trajtimi prej varësisë nga droga ose varësive të tjera. Në rast se i mituri i përmbush detyrimet e sipërpërmendura, prokurori vendos përfundimisht për pushimin e procedimit penal ndaj të miturit.

## **7.2. Masat alternative, të mundshme, për shmangien nga ndjekja penale**

Legjislacioni i drejtësisë penale për të mitur<sup>9</sup> parashikon disa lloj masash alternative që mund të merren, për shmangien e të miturit nga ndjekja penale, masa të cilat përfshijnë:

- programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- këshillimin për të miturin dhe familjen;
- paralajmërimin me gojë;
- paralajmërimin me shkrim;
- masat detyruese;
- vendosjen nën kujdes.

Secila prej këtyre masave mund të zbatohet veç e veç, ose disa masa njëherësh. Kjo, në varësi të raportit të vlerësimit individual të së miturit. Masat e shmangies jepen, sipas rastit, nga prokurori ose gjykata dhe duhet të jenë të arsyeshme, në përputhje të plotë me nevojat e të miturit në konflikt me ligjin apo viktimën. Asnjë detyrim nuk mund t'i imponohet të miturit në procesin e vendosjes së masës së shmangies, e cila mund t'i shkaktojë poshtërim, degradim, përjashtim nga procesi normal edukativ ose punësimi kryesor, si dhe dëmtim të shëndetit fizik dhe mendor të tij. Ndalohet vendosja e një mase shmangieje më të ashpër sesa sanksioni minimal ligjor i parashikuar për veprën penale të kryer.

## **7.3. Programet e drejtësisë restauruese ose të ndërmjetësimit**

<sup>9</sup> Neni 62, i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur.

Ndërmjetësimi është një procedurë jashtëgjyqësore dhe bëhet me qëllim për t'i krijuar mundësinë të miturit, që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej tij ndaj viktimës, komunitetit ose shoqërisë. Ky program, zbatohet kur i mituri, mbrojtësi ose përfaqësuesi i tij, japin lirisht pëlqimin për marrjen e një vendimi të tillë. Në rastet kur vendoset programi i drejtësisë restauruese, të miturit i kërkohet:

- të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe pasojën e ardhur ndaj viktimës;
- të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit ose shoqërisë;
- t'i kërkojë falje viktimës;
- të ndërmarrë veprime të pranueshme ndaj viktimës ose komunitetit.

Masat e drejtësisë restauruese, mund të përfshijnë pjesëmarrjen e të miturit në një punë në interes publik, ose çdo program tjetër, që çon në rehabilitimin e pasojave së veprës penale të kryer nga një i mitur.

Ndërkohë, një masë tjetër alternative për shmangien e të miturit nga ndjekja penale, është ndërmjetësimi familjar ose në grup. Në këtë rast, bashkë me viktimën, marrin pjesë edhe të miturit në konflikt me ligjin apo afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve etj. Në këtë proces, i akuzuari dhe familja e tij, pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen.

Ndërmjetësimi zhvillohet vetëm nëse ekziston pëlqimi i lirë i shprehur, si nga i mituri i akuzuar për kryerjen e veprës penale, ashtu edhe nga personi i dëmtuar. Në këtë proces mund marrin pjesë gjithashtu përfaqësuesi ligjor i të miturit, psikologu, punonjësi i *Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës*, prokurori ose personat e tjerë të caktuar prej tij. Ndërmjetësimi mund të zbatohet edhe si masë shmangieje, por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale.

#### 7.4. Përbushja e masave alternative për shmangien nga ndjekja penale

Masat alternative që aplikohen për shmangien nga ndjekja penale të së miturit, janë detyruese për tu zbatuar sipas kushteve dhe detyrimeve që ato parashikojnë. Në rastet kur i mituri që ka kryer një vepër penale, e përbush detyrimin sipas masës së dhënë, atëherë ndaj tij nuk mund të ngrihet asnjë akuzë në lidhje me po këtë vepër penale. Në këtë rast, prokurori vendos menjëherë pushimin e çështjes penale. I mituri që ka përbushur masën alternative, nuk do të konsiderohet si i dënuar për një vepër penale dhe nuk do të trajtohet si person me të kaluar kriminale. Përbushja e masës së shmangies nga ndjekja penale, realizohet dhe mbikëqyret nga *shërbimi i provës*, në bashkëpunim me *shërbimin e ndërmjetësimit*.

Në qoftë se i mituri, me qëllim, nuk e përbush masën për shmangien e ndjekjes penale, atëherë *shërbimi i provës* informon me shkrim prokurorin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospërbushjes dhe situatën personale të së miturit. I mituri, prindërit ose, sipas rastit, përfaqësuesi ligjor, informohen nga *shërbimi i provës* lidhur me pasojat e moszbatimit të kushteve dhe detyrimeve të masës së shmangies dhe rregullat e shqyrtimit në rast mospërbushjeje. Mospërbushja e kushteve dhe detyrimeve që burojnë prej masës së shmangies nga

ndjekja penale, nuk përbën vepër penale dhe nuk sjell automatikisht kufizimin ose heqjen e lirisë së të miturit. Në këtë rast, heqja ose kufizimi i lirisë ndaj të miturit, konsiderohet nga organi procedues si masa e fundit.

Në rastet kur nuk përmbushet masa alternative për shmangien nga ndjekja penale të së miturit, prokurori, sipas rastit, ndjek procedurën si më poshtë:

- cakton një seancë të veçantë dëgjimore, ku merr mendimin e të miturit, i cili paraqet arsye lidhur me mospërmbushjen e masës;
- jep një vendim për ndryshimin ose revokimin e pjesëshëm ose të plotë të masës së shmangies, pasi ka bërë një shqyrtim të detajuar të fakteve të raportuara.
- kërkon një vlerësim të ri psikologjik, psikiatrik, ose mendim për raportet e mëparshme të ekspertëve;
- revokon ose le në fuqi vendimin e shmangies nga ndjekja penale;
- ndryshon llojet e masës së shmangies;
- zgjat kohën e marrëveshjes.

## **8. Roli i Policisë së Shtetit, në parandalimin e veprave penale ndaj të miturve**

Drejtësia penale për të mitur, është pjesë e sistemit të drejtësisë penale në tërësi, e cila përfshin kushte dhe kritere mbi përcaktimin e personit të mitur në konflikt me ligjin, procedurat për ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin, procesin gjyqësor, ekzekutimin e dënimit, apo çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin. Në këtë kuptim, në planin e veprimtarisë procedurale penale, kompetencën dhe detyrimin për të realizuar drejtësinë penale për të mitur e kanë organi i prokurorisë dhe ai i gjykatës. Ato kanë të organizuara seksione të veçanta, që merren me hetimin dhe gjykimin e veprave penale që kanë për subjekt të miturit në konflikt me ligjin. Ndërsa, Policia e Shtetit, në këtë proces, si detyrë parësore ka veprimtarinë parandaluese, krahas veprimtarisë hetimore që kryen sipas kompetencave që i jep Kodi i Procedurës Penale dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Në funksion të këtij qëllimi, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është ngritur dhe funksionon një sektor i veçantë që ndjek veprat penale që kanë për subjekt të miturit në konflikt me ligjin, së bashku me dhunën në familje. Ndërsa në drejtoritë vendore të policisë, ka specialistë të veçantë që kanë në drejtim veprat e sipërpërmendura.

Duke analizuar situatën kriminale që ka për subjekt të miturit në konflikt me ligjin, për periudhën 2011-2016, rezulton se dinamika e kriminalitetit ka pasur zigzaget e veta, me ngritje dhe ulje, e ndërvarur kjo nga faktorë të ndryshëm ekonomikë, socialë, kulturorë, demografikë etj.

Nëse bëjmë një krahasim të numrit të autorëve në total, me numrin e autorëve të mitur, të ndarë sipas viteve, rezulton se:

- gjatë vitit 2011, janë evidentuar gjithsej 17 773 autorë, nga të cilët 2064 ose 11.6% e tyre janë të mitur;
- gjatë vitit 2012, janë evidentuar gjithsej 21 028 autorë, nga të cilët 2142 ose 10.1% e tyre janë të mitur;
- gjatë vitit 2013, janë evidentuar gjithsej 21 843 autorë, nga të cilët 1657 ose 7.6% e tyre janë të mitur;
- gjatë vitit 2014, janë evidentuar gjithsej 29 593 autorë, nga të cilët 1632 ose 5.5% e tyre janë të mitur;

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*


**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

- gjatë vitit 2015, janë evidentuar gjithsej 34 093 autorë, nga të cilët 2283 ose 6.7% janë të mitur;

- gjatë vitit 2016, janë evidentuar gjithsej 31 231 autorë, nga të cilët 1982 ose 6.3% janë të mitur.

Të ndarë sipas tendencave kriminale kryesore, numri i të miturve si autorë të veprave penale, në vitet e sipërpërmendura paraqitet si vijon:

Nr.	Vitet	Total të mitur	Kundër personit	Kundër Pronës		Seksuale		Kundër familjes %		Siguria rrugore		Droga		Trafiqe		Kufiri	Te tjera			
1	2011	2064	53	2.60%	1158	56.10%	9	0.40%	4	0.20%	217	10.50%	106	5.10%	180	8.70%	15	0.70%	322	15.60%
2	2012	2142	59	2.80%	1125	52.50%	10	0.50%	4	0.20%	162	7.60%	217	10.10%	199	9.30%	0	0.00%	366	17.10%
3	2013	1657	53	3.20%	747	45.10%	6	0.40%	2	0.10%	199	12.00%	133	8.00%	111	6.70%	0	0.00%	406	24.50%
4	2014	1632	31	1.90%	571	35.00%	9	0.60%	13	0.80%	290	17.80%	82	5.00%	146	8.90%	0	0.00%	490	30.00%
5	2015	2283	49	2.10%	884	38.70%	15	0.70%	46	2.00%	388	17.00%	0	0.00%	13	0.60%	21	0.90%	867	38.00%
6	2016	1982	38	1.90%	708	35.70%	14	0.70%	50	2.50%	335	16.90%	52	2.60%	11	0.60%	25	1.30%	749	37.80%
7	Total	11760	283	2.40%	5193	44.20%	63	0.50%	119	1.00%	1591	13.50%	590	5.00%	660	5.60%	61	0.50%	3200	27.20%



Duke ju referuar të dhënave statistikore të sipërpërmendura, rezulton se:

- Rënia më e madhe e krimeve, që kanë pasur për subjekt të miturit në konflikt me ligjin, ka qenë në vitin 2014, 1632 vepra, shifër që zë 5.5 % të së gjithë krimeve në volum.

- Krimet kundër pronës janë tendenca kriminale, në të cilat, numri i të miturve autorë zë një përqindje më të lartë, ku, nga 11760 të mitur autorë gjithsej, 5193 ose 44.2% prej tyre janë të implikuar në krimet kundër pronës.

- Numri i të miturve në krimet seksuale, zë një shifër shumë të vogël, thuajse të papërfillshme në krahasim me totalin e autorëve të mitur: konkretisht gjatë periudhës 2011-2016, janë evidentuar si autorë në krime seksuale gjithsej 63 të mitur ose 0.5% e numrit të autorëve në total.

- Në veprat penale në fushën e drogës, pjesa më e madhe e numrit të së miturve autorë të veprave penale të kësaj fushe e zë "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Konkretisht nga 11 760 të mitur autorë gjithsej, 590 ose 5 % e tyre janë të implikuar në këtë vepër penale.

- Në veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme, numri i të miturve autorë është shqetësues, ku në total, gjatë periudhës së mësipërme janë evidentuar gjithsej 660 të mitur autorë, të cilët përbejnë 5.6 % të numrit të autorëve të mitur.

- Përfshirja e të miturve në kryerjen e veprave penale lidhet me faktorë të karakterit edukativë, kulturorë, ekonomikë, socialë, psikologjikë demografikë etj.

## 9. Përfundime, rekomandime

- Çdo shoqëri demokratike, duhet t'i kushtojë përparësi përkujdesjes ndaj fëmijëve, përkrahjes së nevojave dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre.

- Veprimtaria parandaluese duhet të jetë pjesë e politikës penale, me qëllim mbrojtjen e të miturve nga veprimtaria kriminale. Masat parandaluese mund të jenë të karakterit politik, shoqëror, ekonomik, juridik, organizativ apo administrativ, në varësi të qëllimit se përse ndërmerren këto lloj masash.

- Në programet strategjike që hartohen për mbrojtjen e të drejtave të së miturve në konflikt me ligjin, përparësi duhet t'i kushtohet punës edukative, konsolidimit të ndjenjave të vëllazërisë, mirëkuptimit, tolerancës, uljes së varfërisë, shmangies nga ndjekja penale e të miturve, duke aplikuar masa alternative, restauruese etj.

- Të unifikohet asistenca ligjore dhe psikologjike për të miturit, në të gjitha fazat e procedimit penal, deri në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

- Të organizohen trajnime të vazhdueshme me të gjithë aktorët që merren me zbatimin e drejtësisë penale për të miturit; gjykatës, prokurorisë, oficerëve të Policisë Gjyqësore, punonjësve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, shërbimit të provës etj, me qëllim respektimin e standardeve ndërkombëtare gjatë trajtimit të së miturve në konflikt me ligjin.

- Të bëhen studime kriminologjike dhe përpunohen të dhënat statistikore mbi shkaqet dhe masat për parandalimin e kriminalitetit tek të miturit.

- Përkujdesje e veçantë duhet t'i kushtohet fëmijëve jetimë, fëmijëve të rrugës, atyre të shpërngulur apo refugjatë, fëmijëve të trafikuar, të shfrytëzuar ekonomikisht dhe seksualisht, apo fëmijëve që janë duke vuajtur dënimin nëpër institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

## Bibliografi

1. *Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*, miratuar me ligjin nr. 37/2017.
2. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*, botim i vitit 2017.
3. *Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë*, botim i vitit 2017.
4. *Ligji nr. 98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"*.
5. *Ligji nr. 97/2016 "Për Organizimin e dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"*.
6. OKB, *Konventa "Mbi të Drejtat e Fëmijës"*, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me 20 nëntor 1989.
7. *Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve të privuar nga liria* (Rregullat e Havanës), viti 1990.
8. *Dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 7003*, datë 28.10.1985.
9. *Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438* datë 20.12.1986.
10. Grigor Gjika, Koço Nova, *Mbi gjykimin në shkallë të dytë në procesin penal*, Tiranë: Botim i Ministrisë Drejtësisë, 1961.
11. Ismet Elezi, "Kriminaliteti si fenomen shoqëror, shkaqet dhe parandalimi i tij", në: *Buletini shkencor Kriminaliteti, Rendi dhe Policimi*, Tiranë, 2001.
12. Ismet Elezi, *Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri*, botim i vitit Tiranë: Albin, 1998.
13. *Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 913*, datë 28.09.2012
14. Instituti i Statistikës, *Të dhëna statistikore, viti 2016*.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# “Procedura” në praktikën juridike në RSH, në lidhje me praktikën, për trajtimin e rasteve të shkeljeve mjekësore

— Dr. Elmas SHAQIRI

Instituti i Mjekësisë Ligjore, Tiranë  
elmashaqiri@yahoo.com

---

## Abstrakt

*Kur një i sëmurë mendon se ka pësuar një dëmtim për shkak të një gabimi mjekësor, krejt natyrshëm ai i drejtohet drejtësisë për të kërkuar dëmshpërblim. Kështu, nis një proces për përgjegjësinë mjekësore. Padia e ankuesit varet nga statusi i mjekut përgjegjës. Në rast se mjeku punon me klientelë private apo në një institucion spitalor privat, viktima u drejtohet instancave gjyqësore. Në më të shumtën e rasteve, përgjegjësia civile e mjekut gjykohet në Gjykatën e shkallës së parë nga një trup gjykues për çështje civile, ose nga një trup gjykues për çështje penale, kur bëhet fjalë për përgjegjësi penale.*

## Fjalëkyçe:

**Mjekim i pakujdesshëm, pacient, kodi penal, gjykata.**

## 1. Hyrje

*Gjykata e faktit* në shkallë të parë është e përbërë nga dy dhoma: njëra është ajo penale, dhe tjetra është dhoma civile. Kjo dhomë kur gjykon çështje penale, quhet *gjykata penale*. Mjeku, si çdo qytetar tjetër, mund të thirret, për shembull, për t'u gjykuar në këtë gjykatë për shkelje të ligjit, një rregulloreje, apo për shkelje të kodit mjekësor. Parimisht, gjykata civile konstaton moszbatimin e kontratës për kujdesin shëndetësor dhe, në rast se ankesa e paditësit është e bazuar, ajo i njeh atij të drejtën për dëmshpërblim. Gjykata penale shprehet për krimet penale, si vrasje dhe plagosje nga pakujdesia, dhe ndëshkon fajtorin. Edhe ajo mund të marrë vendim për dëmshpërblim. Për këtë arsye, viktimi e një gabimi, që kërkon gjykimin për përgjegjësinë civile të faktit juridik, ka mundësinë “*të zgjedhë armët*”: palët mund t'i drejtohen gjykatës civile për të rivendosur vlerësimin e dëmit të shkaktuar pasuror ose jo pasuror. Në rastet kur mjeku që ka bërë një gabim, punon në një spital publik, viktimi është e detyruar të ankohet në juridiksionin administrativ, territorial (gjykatën e rrethit ku ndodhet spitali), me përjashtim të rastit kur bëhet fjalë për gabim personal që ndahet nga shërbimi. Gjatë procesit, subjekti do të gjykohet nga gjykata të dhomave, penale, civile, ose administrative. Gjatë muajit shtator të vitit 2012, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin për Gjykatën Administrative, pasi ky ligj ishte edhe një ndër kushtet për hapjen e negociatave për marrjen e statusit të vendit kandidat për në Bashkimin Europian.

Aderimi i Republikës së Shqipërisë pranë organizmave europiane e kërkonte si kusht domosdoshmëri, krijimin dhe funksionimin e Gjykatës Administrative. *Gjykatësit e instancave gjyqësore* ndahen në dy kategori.

- *Gjyqtarët*, që marrin vendim dhe nuk mund të ndërrohen. Në Gjykatën e Apelit, ata janë: kryetari i saj, kryetarët e trupave gjyqësore dhe këshilltarët; në Gjykatën e

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

Shkallës së Parë janë: kryetari dhe gjyqtarët.

- *Prokurorët*, të atashuar në prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore apo pranë atyre të apelit dhe kërkojnë zbatimin e ligjit në emër të Republikës.

Në ndjekjen apo hetimin e çështjeve penale, prokurori me vendim të drejtpërdrejtë, çështjen ia delegon *oficerit të policisë gjyqësore*. Detyra e tij, është mbledhja e provave të fajësisë, në ngarkim të personave që kanë prezumuar kryerjen e veprës penale. Ai “*plotëson*” dosjen në bazë të udhëzimeve të prokurorit të çështjes. Më pas, me mbledhjen e provave, oficeri i policisë gjyqësore i raporton prokurorit, për situatën, provat e mbledhura, dhe stadin e hetimit por nuk i gjykon ato. Oficeri i policisë gjyqësore respekton detyrat e caktuara nga prokurori i çështjes. Nganjëherë, oficerin e policisë gjyqësore (*hetuesin*), e marrin inat se ka shumë fuqi. Në fakt, ai ka mjaft fuqi, sepse vendos për fatin e të akuzuarit.

Procesi zhvillohet sipas procedurave të përcaktuara qartë. Në çdo stad të hetimit organi i akuzës mund të tërhiqet nga akuza, kur konstaton se fakti juridik nuk përbën veprë penale, kur nuk ka prova të mjaftueshme etj. Ky rast në jurisprudencë konsiderohet veprim i organit të akuzës *kryesisht*, që do të thotë se organi i akuzës, *kryesisht*, mund të vendosë fillimin e hetimit, të ngrejë akuzë penale ndaj subjektit të së drejtës, i cili mund të jetë i posaçëm, apo i përgjithshëm, dhe njëkohësisht po *kryesisht*, ky institucion vendos për mosfillimin e çështjes.

Në *procesin civil*, është *kërkuesi*, është paditësi, që kërkon zbatimin e një kontrate ose dëmshpërblim për moszbatimin e një detyrimi, - kërkime të cilat i kundërdrejtohen palës së paditur. Kur, gjykata civile, konstaton së në padinë civile ka elementë të cilët kanë konsumuar figurën e krimit, atëherë gjykata vendos *kryesisht* ndërprerjen e seancës gjyqësore dhe, thirrjen e prokurorit si palë në procesin civil.

Organi i akuzës përgjatë procesit civil, pasi njihet me provat, *kryesisht*, vendos për fillimin apo mos fillimin e hetimit të veprës penale. Në një rast të tillë, kur organi i akuzës vendos fillimin e hetimit penal për shkak të elementëve të kësaj vepre, atëherë gjykata civile vendos pezullimin e gjykimit civil dhe pret deri në përfundim, vendimin e çështjes penale.

Vendimi penal në një rast të tillë mund të përdoret në gjyqin civil, për të kërkuar vlerësimin e dëmit të shkaktuar, fitimin e munguar, dëmin biologjik, etj., pasi është Gjykata Civile e Shkallës së Parë, kompetente për të gjitha mosmarrëveshjet me karakter dëmi pasuror dhe jopasuror, dëm i cili ka ardhur direkt ose indirekt, me veprime ose me mosveprime, *si rezultat i mjekimit të pakujdesshëm*.

Përfundim të veçantë, përbën rasti, kur çështja mund të zgjidhet nga organi administrativ, kur palët mund të kërkojnë për zgjidhjen e saj një juridiksion tjetër, si për shembull: drejtorinë e personelit spitalor, i cili është një organ i administratës që varet nga juridiksioni administrativ.

Çështja, kur palët, kanë kontestime dhe pretendime financiare midis tyre, mund të zgjidhet edhe nga një gjykatë arbitrazhi, e zgjedhur me mirëkuptimin e palëve. Prokurori i Republikës, që mbron akuzën në procedurën penale, nuk ndërhyr në procedurën civile (me përjashtim të rasteve të rralla), sepse mosmarrëveshja ekziston vetëm midis personave të veçantë.

## 2. Diskutimi i gjetjeve

*Në vështrim të gjykimit në “Gjykatë”, është e nevojshme për të vënë në dukje se në*



drejtësinë shqiptare, kërkesa e një dëmshpërblimi presupozon se viktimi do të tregojë se: ka ndodhur një gabim; një dëmtim ose se ka lidhje shkakësore midis tyre. Dëmi jopasuror i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktuale, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cenimi i të drejtave dhe interesave jopasurore që bëjnë pjesë në vlerat e njeriut dhe që nuk janë subjekt vlerësimi të drejtëpërdrejt ekonomik në treg. Në thelbin e saj, kjo dispozitë njih të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi pasuror jashtëkontraktual, i cili është i ndryshëm nga ai pasuror. Renditja e rasteve të dëmit jopasuror, në paragrafët “a” dhe “b” të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë, por të rregullojë për efekt të dallueshmërisë së cenimeve, të drejtën e dëmshpërblimit përkatës dhe rrethin e subjekteve që e përftojnë.

*Gjykata e Shkallës së Parë.* Ajo është kompetente për çdo lloj mosmarrëveshje, me përjashtim të rastit, kur ligji cakton për zgjidhjen e saj një juridiksion tjetër, siç është juridiksioni administrativ.

*Ekspertiza civile.* Kur trupi gjykues i çështjeve civile duhet të gjykojë një çështje për përgjegjësinë mjekësore, ai cakton gjithnjë një ekspert e nganjëherë, edhe disa të tillë. Kur cakton disa ekspertë, ai zgjedh mjekë të specialiteteve të ndryshme, të cilët hartojnë një raport të përbashkët. Gjyqtarët i caktojnë lirisht ekspertët, por përgjithësisht zgjedhin ata që figurojnë në listën e vetme, civile e penale, që përpilohet çdo vit nga Instituti i Mjekësisë-Ligjore dhe miratohet nga *departamenti i profesioneve të lira*, pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Nganjëherë raporti i ekspertëve kundërshtohet dhe, në këtë rast, bëhet një riekspertim. Ekspertiza për çështje civile karakterizohet nga respektimi i vendimit të marrë pas ballafaqimit të palëve. Veprimet e ekspertizës duhet të zhvillohen në prani të palëve në proces. Mjeku ekspert thirret e betohet për ekspertizën. Në rast se nuk thirren palët, ekspertiza mund të mos merret parasysh .

*Procedura penale.* Çdo person, që pretendon se është viktimë e një gabimi mjekësor, mund t’i paraqisë një ankesë të arsyetuar prokurorit të Republikës (Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor). Për shkak edhe të mosnjohjes së ligjit, ngandonjëherë ndodh që subjekti ankues, t’i drejtohet organit të akuzës, prokurorisë, e cila nuk ka juridiksionin territorial për të filluar çështjen. Në një rast të tillë, organi i akuzës, i cili është vënë në lëvizje mbi bazën e ankimimit të ankuesit, kallëzimin penal, duhet t’ia delegojë menjëherë prokurorisë, e cila ka edhe juridiksionin e çështjes. Ky veprim procedural i organit të akuzës, në jurisprudencë dhe në trajtimin doktrinar të së drejtës penale, është i konsideruar si veprim mbrojtës në dobi të shtetasve pasi, “*askush nuk do të dëshironte t’a konsideronte një krim të pazbuluar, si të ligjshëm*”<sup>1</sup>.

*Hetimi paraprak.* Ky i fundit, ndodh shpeshherë, kur organi i akuzës vihet në lëvizje duke u nisur vetëm mbi bazën e një ankimi pranë zyrës së prokurorit. Në një rast konkret, prokurori ngarkon shërbimin e policisë që të zhvillojë hetimet, të cilat shoqërohen në fund me hartimin e procesverbaleve, ku raportohet mbi:

- *dëgjimin e ankuesit* (ky formalitet është në përputhje të plotë, në formë dhe në përmbajtje me kodin e procedurës penale;

- *dëgjimin e dëshmitarëve dhe të personit të akuzuar nga paditësi.*

*Tërësia e veprimeve, që mund të bëjë hetuesi.* Në këtë fazë, oficeri i policisë nuk ka asnjë mjet detyrues; ai nuk mund të japë urdhër që të merret me forcë asnjë person, i cili

<sup>1</sup> Sappideen C. “Medical teams and the standard of care in negligence”. *J Law Med.* 2015 Sep;23(1):69-82. PubMed PMID: 26554200.

nuk u përgjigjet thirrjeve, as të angazhojë një ekspert dhe as të bëjë kontroll. Është ndryshe kur flitet për kapje në flagrancë (gjë e rrallë në fushën mjekësore!), apo kur zbatohet delegimi i kompetencave të oficerit të policisë gjyqësore. Në çdo fazë të hetimit, si një garanci kushtetuese, ligjvënësi si për ankuesin ashtu edhe për të dyshuarin, u ka dhënë atyre të drejtën, që përpara organit të akuzës, të mund të përfaqësohen me një avokat. E rëndësishme është që palëve, duhet t'u shpjegohen shumë qartë termat e përdorura nëpër deklaratat, të cilat janë të një karakteri të një fushe të caktuar, si dhe kuptimi i tyre, me qëllim që të mos ndodhemi përpara shpjegimeve kontradiktore gjatë procedurës së mëvonshme.

*Vendimi i prokurorit.* Kur shqyrton dosjen e krijuar në këtë mënyrë, prokurori i çështjes vendos: *mosfillimin e çështjes*, kur mendon se ka mungesë provash; se fakti nuk përbën veprë penale; se nuk është personi i cili duhet të merret në përgjegjësi etj.

*Thirrja e menjëhershme e të akuzuarit të prezumuar në gjykatë:* kjo ndodh shumë rrallë në fushën mjekësore, kur mungon ekspertiza, por është mjaft e zakonshme në rastet e aksidenteve me automjete, kur ekziston dyshimi mbi gabimin e drejtuesit të mjetit.

Në këtë rast, gjykata jep *fletëthirjen për t'u paraqitur në gjyq; nis mbledhjen e provave*, - gjë që i besohet një oficeri të policisë gjyqësore, i cili ka autoritetin për hetimin e çështjes penale. Në një rast konkret, atij i lejohej të kërkojë zhvillimin e ekspertizës, analizës, kontrole e konfiskime të së gjitha dokumenteve të dobishme, të cilat paraqesin interes për çështjen, duke vepruar sipas rregullave të caktuara me ligj: secila palë (organi i akuzës, paditësi, viktimja, e veprës penale, apo i akuzuari) për të gjitha këto veprime, në rast se nuk janë zhvilluar në përputhje me ligjin, mund të kërkojë që ato të konsiderohen si veprime apo akte absolutisht ose relativisht, të pavlefshme.

*Roli i viktimës në çështjet penale.* Duke qenë i pakënaqur nga mbyllja e çështjes, paditësi, bën kërkesë për rishqyrtim: ligji lejon që ta vazhdojë ai çështjen në vend të prokurorit, dhe për këtë, atij i duhet:

a. të dorëzojë tek hetuesi (OPG) me anën e një deklaratë një kërkesë drejtuar gjykatës për dëmshpërblim;

b. të bëjë pagesën e caktuar nga ky hetues, për të mbuluar shpenzimet e gjyqit, siç janë ato të ekspertizës, të cilat nuk u kërkohen atyre që nuk kanë mundësi të paguajnë. Viktimja e shkeljes penale, që nis gjyqin, ka përgjegjësi kur vepron me keqdashje; në rast dështimi ajo duhet të dëmshpërblejë personin e denoncuar dhe mund të kryejë e të akuzohet për krimin e shpifjes.

Në praktikë, shumica e ndjekjeve gjyqësore kundër mjekëve, janë bërë nga të sëmuret e pakënaqur prej mbylljes së çështjes; kur bëhet kërkesë nga një viktimë, hetuesi është i detyruar të hetojë. Përveç kësaj, kur Prokurori i Republikës nis mbledhjen e provave, paditësi ka të drejtën të bëjë kërkesë për dëmshpërblim, gjatë hetimit, por në këtë rast ai nuk paguan shpenzimet e procedurës, të cilat i mbeten shtetit dhe, nuk mban përgjegjësi në rast dështimi, domethënë, kur çështja mbyllet për mungesë provash.

*Procedura administrative.* "Gjykatat administrative janë gjykata të zakonshme të mosmarrëveshjeve administrative", të cilave mund t'u drejtohesh vetëm duke respektuar format e caktuara nga Kodi Administrativ dhe duhet të zgjidhë çështjet sipas radhës së mëposhtme: kërkesën për zgjidhje me mirëkuptim; kërkesën drejtuar gjyqtarit me pretendime ndaj të paditurve; procedurën; ekspertizën; vendimin dhe apelinin.

*Dëshmia e mjekut ekspert përpara një gjykate:* "Sekreti mjekësor mbulon gjithçka

di mjeku gjatë ushtrimit të profesionit të tij, domethënë jo vetëm ajo që i është thënë, por edhe ajo që ka parë, ka dëgjuar e kuptuar” (Kodi i Deontologjisë).

Në këto kushte, mjeku i thirrur përpara gjyqtarit hetues, kur është fjala për çështje civile, ose nga hetuesi, kur është fjala për çështje penale, apo kur thirret dëshmitar nga prokurori përpara një gjykate, duhet të paraqitet dhe të bëjë betimin që kërkon ligji, kur nuk e di akoma, nëse do t'i bëhen pyetje që s'kanë lidhje me veprimtarinë e tij mjekësore.

Por, kur është fjala për pyetje lidhur me ushtrimin e profesionit, *ai duhet të përmendë sekretin mjekësor dhe të heshtë*. Në rast se flet ai ka rrezik të ndëshkohet me masat e parashikuara nga neni 183 i Kodit Penal, me përjashtim të tre rasteve të parashikuara në të: mjeku është i lirë të japë dëshminë e tij përpara drejtësisë: *kur bëhet gjyq për abort që mbetet i fshehtë; për dhunë fizike ose moskujdesje për të miturit nën 15 vjeç; për përdhunime ose akte të turpshme, por me kusht që viktima të jetë dakord*. Vështirësia qëndron në faktin kur dëshminë nuk e kërkon prokurori, por vetë i sëmuri.

*Mospranimi për të dëshmuar*. I tillë është rasti kur zbulimi i sekretit të sëmundjes ka rrezik të prishë një trajtim apo ta çojë të sëmurin në vetëvrasje, ndërkohë që ekziston një terapi ose ndodhet përpara pasojave të parashikueshme: anulimi i martesës, probleme psikike shumë të rënda dhe në disa raste, kur një i sëmurë mund të mos jetë në dijeni për atë që di mjeku i tij, pra nuk ka elementët që do t'i jepnin mundësi të hiqte dorë nga sekretit; përveç kësaj, dëshmia e mjekut mund të ketë pasoja për gjendjen shëndetësore së të sëmurit. Kjo tregon se shprehjet “*i sëmuri, zot i sekretit*” dhe “*shpëtoje mjekun nga sekretit*”, që përdoren shumë në praktikë, nuk janë të sakta dhe janë pjesërisht të pasakta.

Disa autorë nxjerrin përfundimin se: në rast se detyrimi është absolut, mjeku mbetet i lidhur nga sekretit, edhe kur nuk sheh asnjë pengesë për të dëshmuar. Ky deduksion hidhet poshtë lehtësisht:

Si përfundim, mjeku që thirret të dëshmojë nga pacienti i tij, ka një mundësi: të nxjerrë si shkak sekretin profesional, pa dhënë arsye të tjera, apo të dëshmojë në rast se mendon se ky qëndrim përputhet me kujdesin për të interesuarin.

*Ekspertiza në rastin e shkeljeve mjekësore*. Kjo është ekspertiza më e vështirë sepse, në shumë raste, ajo kushtëzon vendimin e marrë nga drejtësia. Gjykatësit, edhe pse nuk kanë lidhje me konkluzionet e ekspertizës, shpeshherë shtyhen që të ndjekin përfundimet e ekspertëve. Këto ekspertiza për përgjegjësinë mjekësore janë jashtëzakonisht të vështira dhe askush nuk habitet që, shpeshherë, bëhet një kundërexpertizë, ose një ekspertizë tjetër. Në fakt, mjekëve u kërkohet të japin një mendim të vlefshëm për cilësinë e kujdesit shëndetësor, që kanë dhënë kolegët e tyre. *Do të ishte e pavërtetë të mendohej* se, eksperti nuk ka vepruar asnjëherë me ndjenja, në një ekspertizë për përgjegjësinë mjekësore.

Ai i bën pyetjen vetes në mënyrë të pavetëdijshme: “Si do të kisha vepruar unë, po të isha në vendin e këtij mjeku?”

*Mjeku ekspert, që është krejtësisht i ndërgjegjshëm për rolin e tij vendimtar, që ka në këto dosje, duhet të veprojë me maturinë maksimale të mundshme; detyra që i jepet ekspertit: studimi i procedurës, studimi i çështjes, dëgjimi i dëshmitarëve kur dëshmia e tyre është e domosdoshme për sqarimin e drejtësisë, që janë:*

- vlerësimi i fakteve mjekësore, siç kanë ndodhur dhe kërkimi, mbi të gjitha, i një gabimi ose i një moszbatimi të rregullave mjekësore në dhënien e kujdesit shëndetësor;
- kërkimi i shkaqeve të vdekjes ose të pasojave;
- lidhja shkakësore ndërmjet gabimit dhe dëmtimit (pasojat ose vdekja).

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

*Zhvillimi i ekspertizës.* Së pari, duhet të rikrijohet historia mjekësore. Ky rikrijim bëhet nga studimi i hollësishëm i provave të çështjes dhe nga dëgjimi i të gjitha palëve të saj. Rikrijimi i asaj që ka ndodhur, duhet të bëhet me hollësi nga eksperti dhe, ai duhet të tregojë shumë autoritet kur takon palët, që nganjëherë janë të shumtë në numër. Kur bëhet kjo mbledhje, nganjëherë kërkohen edhe prova të reja, ose shtesë informacionesh, që janë të nevojshme për njohjen më të mirë të çështjes<sup>2</sup>.

*Hartimi i aktit mjeko-ligjor (raportit).* Kjo është faza më e vështirë e ekspertizës, gjatë së cilës bëhet rreshtimi i të gjitha provave të çështjes, që mbajnë nga një numër, si dhe paraqitja e plotë e disa provave vendimtare. Gjatë këtij raporti diskutohen faktet mjekësore dhe informacionet që kanë dhënë palët. Raporti përfundon me një ligjëratë, që është elementi kryesor. *Së pari*, ajo përmban përmbledhjen e fakteve; *së dyti*, vlerësimin mjekoligjor të tyre, dhe, *së treti*, përgjigjen për pyetjet që i janë dhënë atij për të zgjidhur me atë detyrë që ka.

*Përgjigja duhet të jetë e qartë, e saktë dhe e mbushur me argumente mjekësore dhe me një bibliografi cilësore.*

*Vlerësimi për cilësinë e kujdesit mjekësor që është dhënë (aspekti penal).* Në këtë paragraf, me fjalën gabim nënkuptohet “*dhënia e kujdesit jo të mirë shëndetësor*”; në fakt, përcaktimi i gabimit mjekësor është në kompetencën e gjyqtarit, jo të ekspertit. Kjo është pjesa më delikate e ekspertizës.

*Mjeku ngarkohet me detyrën për të vendosur, nëse është bërë një gabim në kujdesin shëndetësor, sado i vogël të ketë qenë, ndërsa eksperti duhet t’i tregojë gjyqtarit pasojat e gabimit në ecurinë e pacientit.* Ka raste të lehta ku gabimi është i dukshëm si, harresa e një garze ose gabimi me grupin e gjakut. Por, ka edhe gabime të padukshme, ku dëmtimi ndodh pas një seri paaftësish të vogla, të kujdesit jo të përshtatshëm. Midis rasteve të vështira duhet të përmendim embolinë amniotike, që lidhet në mënyrë të padiskutueshme me një gabim mjekësor, gjë e cila për tu provuar shkencërisht është e vështirë, dhe embolinë pulmonare, ku nuk është e lehtë të paraqitet prova e gabimit<sup>3</sup>. *Në këto rrethana, që organet e drejtësisë të krijojnë një ide të qartë dhe të drejtë rreth karakterit të shkeljeve mjekësore që takohen në praktikën mjekësore, është e domosdoshme kryerja e ekspertimit mjekoligjor.*

Të gjitha çështjet penale që ngrihen kundër personelit shëndetësor, në lidhje me shkeljet në veprimet a mosveprimet e tyre profesionale gjatë mjekimit të pakujdesshëm, kërkojnë gjithmonë një ekspertim të kualifikuar<sup>4</sup>. Është detyrë e ekspertimit mjekoligjor të bëjë vlerësimin e drejtë të shkeljeve mjekësore nëse ato kanë ose jo për bazë fatkeqësinë pakujdesinë, paaftësinë, papërsosmërinë e sotme të shkencës mjekësore.

Duke pasur parasysh karakterin e ndërlikuar të çështjeve që lindin në këto raste, ekspertimi mjekoligjor luan rolin e një këshilltari të pazëvendësueshëm për organet e hetimit dhe të gjykatës, jo vetëm duke dhënë mendime të karakterit thjesht mjekësor, por edhe në përcaktimin e karakterit të shkeljeve mjeko-ligjore. Ndiheja aktive e ekspertit mjekoligjor, duhet të jetë qysh në fillim të çështjes penale (në pyetjen e palëve dhe në administrimin e provave materiale etj). Bashkëpunimi i ngushtë i hetuesit me

<sup>2</sup> Bishop TF, Pesko M. “Does defensive medicine protect doctors against malpractice claims?” *BMJ*. 2015 Nov 4;351:h5786. doi: 10.1136/bmj.h5786. PubMed PMID: 26537736.

<sup>3</sup> Hamasaki T, Hagihara A. “A comparison of medical litigation filed against obstetrics and gynecology, internal medicine, and surgery departments”. *BMC Med Ethics*. 2015 Oct 24;16(1):72. doi: 10.1186/s12910-015-0065-1. PubMed PMID: 26498823; PubMed Central PMCID: PMC4619401.

<sup>4</sup> Berry MD, Polking E, White R., “Thomson Reuters Accelus. Medical Malpractice and Tort Reform”. *Issue Brief Health Policy Track Serv*. 2016 Dec 27;2016:1-136. PubMed PMID: 28248469.

ekspertin mjekoligjor, qysh sidomos në fazat e para të hetimit, do të luajë një rol të rëndësishëm në drejtim të një hetimi sa më të plotë dhe të bazuar nga ana shkencore<sup>5</sup>.

Pavarësisht nga kjo, paaftësia dhe indiferenca gjatë veprimit mjekësor apo kirurgjikal *quhen gabim*. Në rast se ekziston zgjedhja e lirë e teknikës kirurgjikale, kirurgu që zgjedh një teknikë, e cila quhet e papërshtatshme nga ekspertët, mund të dënohet. Për efekt të përgjegjësisë penale apo administrative të mjekut, i rëndësishëm është dallimi ndërmjet gabimit dhe pakujdesisë, pasi mjeku nuk përgjigjet penalisht për gabimin mjekësor, por mund të përgjigjet vetëm administrativisht. Kequshtrimi mjekësor përfshin shkelje të natyrës etike, deontologjike dhe ligjore të mjekut apo personelit shëndetësor në trajtimin e të sëmurëve. Mjekësia është një shërbim profesional në dobi së të sëmurëve dhe të nevojave shëndetësore të njeriut. Duhet të vëmë në dukje qysh në fillim, se ekziston një etikë profesionale mjekësore, që i detyron mjekët t'i shërbejnë me ndërgjegje dhe impenjim profesional çdo të sëmuri, pa dallim race, feje, kombësie, shtrese sociale, ideologjike dhe politike<sup>6</sup>. Mjeku nuk është vetëm mbrojtës i pacientit kundër sëmundjes, por edhe një mbrojtës i shëndetit publik (lufta parandaluese kundër sëmundjeve dhe përhapjes së epidemive, edukimi shëndetësor etj).

Parimi i çdo mjeku duhet të jetë respekti për jetën e njeriut, duke i shërbyer atij në raste sëmundjesh apo fatkeqësish. Në dritën e këtij parimi dhe, sipas thënies së vjetër latine, *“përpara së gjithash, mos dëmto”*, mjeku dhe personeli tjetër shëndetësor duhet të tregohen tepër të kujdesshëm, që të mos shkaktojnë dëmtime tek i sëmuri si pasojë e pakujdesisë.

I sëmuri i beson mjekut shëndetin dhe jetën e tij. Për të përligjur këtë besim, mjeku ka për detyrë të ushtrojë një praktikë të mirë mjekësore, duke ruajtur standardet profesionale dhe një kujdes shëndetësor të shkallës së lartë, në përputhje me kërkesat etikologjore të një njeriu të arsyeshëm dhe të matur. Gjatë ushtrimit të profesionit, mjeku duhet të ketë parasysh që: *kujdesi për të sëmurin* të jetë shqetësimi kryesor; *respekti për dinjitetin* dhe jetën private së të sëmurit; *Ankesat dhe shqetësimet* e të sëmurit të dëgjohen me vëmendje dhe të respektohet mendimi i tij; *Informimi i të sëmurit* rreth gjendjes shëndetësore në të cilën ndodhet të bëhet me kujdes, të jetë i sinqertë dhe i kuptueshëm;

*Trajtimi mjekësor* i të sëmurit duhet të bëhet me mirëkuptim të dyanshëm dhe me profesionalizëm, sipas parimit të *“praktikës mjekësore më të mirë”*. *Eshtë tashmë e njohur se liria e të sëmurit në zgjedhjen e mjekut, pavarësia dhe përgjegjësia profesionale e mjekut përbëjnë trinomin mbi të cilin mbështetet mjekësia moderne dhe ajo bashkëkohore*<sup>7</sup>.

Këto janë tri kërkesa themelore deontologjike, të cilat respektojnë ndërsjellat dhe harmonizojnë të drejtat dhe detyrat e të sëmurit dhe të mjekut. Vetëm duke qenë e ndërtuar në themel me këto tre kërkesa, *“kontrata”* e heshtur mes të sëmurit dhe mjekut do të shfaqej e besueshme, e qëndrueshme dhe e sinqertë. Si në shumë fusha profesionale, edhe në atë të mjekësisë, është e pamundur që kushtet e kësaj *“kontrate”* të rregullohen vetëm përmes normave etike dhe morale. Është e vërtetë që me anë të etikës, kësaj veprimtarie i jepet një ndjenjë, një shtresëzim dhe një kuptim tejet i ngjeshur

<sup>5</sup> Graber ML, et al., “Electronic Health Record-Related Events in Medical Malpractice Claims”. *J Patient Saf.* 2015 Nov 6. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 26558652.

<sup>6</sup> Moore J, Mello M., “Improving reconciliation following medical injury: a qualitative study of responses to patient safety incidents in New Zealand”. *BMJ Qual Saf.* 2017 Mar 9. pii: bmqqs-2016-005804. doi: 10.1136/bmqqs-2016-005804. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28280075.

<sup>7</sup> Pan D. “Doctors Killed My Baby: Argumentative Patterns in Medical Disputes in China”. *Health Commun.* 2017 Aug 18;1-10. doi: 10.1080/10410236.2017.1351271. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28820621.

detyrimi moral, por nga këndvështrimi tjetër pavarësisht nga kjo, *duhet të jetë më se e qartë se aty ku mbaron kontrolli etik, fillon të veprorë forca e ligjit*<sup>8</sup>.

Vlerësimi i gabimit duhet të bëhet në mënyrën më të rreptë që ekziston. *Përpara se të flasë për një gabim, eksperti duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme, ai nuk duhet të ngurrojë që të kërkojë mendimin e specialistëve me formim të ndryshëm universitar.* Parandalimi i komplikimeve trombo-embolike pas operacionit cezarian, për shembull, nuk bëhet njëjloj në çdo vend. *Sipas disave, dhënia e "Heparinës" me peshë të ulët molekulare, është sistematike, kurse disa të tjerë mendojnë se, është e mjaftueshme ngritja e hershme dhe vendosja e një mbajtëseje elastike tek këmbët.* Kur pohon ekzistencën e gabimit mjekësor, duhet të mbështetesh në argumente të forta<sup>9</sup>. Ka raste të thjeshta, ku kartela mjekësore dhe shënimet që janë bërë në reanimacion dhe radiografitë dëshmojnë, ose ekzistencën e një gabimi në diagnostikim, ose të një gabimi në terapi, ose fillimin me vonesë të procesit të reanimacionit. Nxjerrja në dukje e gabimit, duhet të bëhet duke mbajtur parasysh rrethanat në të cilat ndodhi aksidenti.

Eksperti duhet të njohë mjedisin mjekësor në të cilin ka vepruar mjeku. *Kërkesat nuk janë të njëjta, si për një spital të zonës rurale, si për një qendër spitalore universitare*<sup>10</sup>.

Eksperti duhet të ketë parasysh edhe organizimin e shërbimit të rojës. Ai duhet të ketë gjithashtu parasysh, nocionin e urgjencës dhe të vlerësojë qetësisht rëndësinë e miratimit që është dhënë nga një pacient i vetëdijshëm dhe i shëndoshë mendërisht. Gjatë fjalës mjekoligjore që mban, eksperti duhet të shtjellojë qartësisht dhe në mënyrë të kuptueshme për gjyqtarin, mënyrën se si kanë ndodhur faktet, përse dhe si, një mjek ose një ekip mjekësor, ka arritur të kryejë një gabim<sup>11</sup>.

### 3. Përfundime

*Vlerësimi i dëmit* duhet të bëhet konkretisht dhe të mbahet parasysh gjendja patologjike e mëparshme. Në rast se pacienti nuk do të kishte pasur një gjendje patologjike të mëparshme shumë të rëndë, vdekja nuk do të kishte ndodhur dhe, pasojat do të kishin qenë më të vogla<sup>12</sup>. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se gjendja e mëparshme nuk e përjashton gabimin mjekësor, por eksperti duhet t'i shpjegojë gjyqtarit, si ka ndodhur një vdekje dhe në cilat kushte; nganjëherë nuk do të kishte pasur vdekje, në rast se subjekti nuk do të kishte sëmundje të trashëguara. Në fushën e përgjegjësisë mjekësore, dëmtimi zakonisht është fizik, por edhe moral. Duhet të dihet që të vlerësohen si duhet, në tërësinë e tyre, edhe dëmtimet fizike, edhe ato psikologjike. Vlerësimi i dëmtimit psikologjik ka rëndësi në fushën e kirurgjisë estetike, ku i jepet shumë rëndësi cilësisë së informacioneve, që ka dhënë pacienti, përpara ndërhyrjes kirurgjikale<sup>13</sup>.

<sup>8</sup> Kandinov A, et al., "Analysis of Factors Associated With Rhytidectomy Malpractice Litigation Cases". *JAMA Facial Plast Surg.* 2017 Jul 1;19(4):255-259.

<sup>9</sup> Cardoso R, et al., "Evaluative reports on medical malpractice policies in obstetrics: a rapid scoping review". *Syst Rev.* 2017 Sep 6;6(1):181. doi: 10.1186/s13643-017-0569-5. PubMed PMID: 28874176; PubMed Central PMCID: PMC5586050.

<sup>10</sup> Gupta A., "Malpractice claims related to diagnostic errors in the hospital". *BMJ Qual Saf.* 2017 Aug 9. pii: bmjqs-2017-006774. doi: 10.1136/bmjqs-2017-006774. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28794243.

<sup>11</sup> Carlson J., "Provider and Practice Factors Associated With Emergency Physicians' Being Named in a Malpractice Claim". *Ann Emerg Med.* 2017 Jul 26. pii: S0196-0644(17)30786-2. doi: 10.1016/j.annemergmed. 2017.06.023. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28754358.

<sup>12</sup> Friedson A., "Medical Malpractice Damage Caps and Provider Reimbursement". *Health Econ.* 2017 Jan;26(1):118-135. doi: 10.1002/hec.3283. Epub 2015 Oct 26. PubMed PMID: 26498742.

<sup>13</sup> Bokshan S, et al. "Reported Litigation Associated With Primary Hip and Knee Arthroplasty". *J Arthroplasty.* 2017 Jul 11. pii: S0883-5403(17)30584-3. doi: 10.1016/j.arth.2017.07.001. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28781019.

*Autopsia* ka rol vendimtar në vlerësimin e shkakut të vdekjes. Ai është i vetmi mjet për të përcaktuar saktësisht shkakun e vdekjes. Gjatë autopsisë, mund të merren kampione toksikologjike dhe anatomopatologjike. Kur është fjala për një vdekje pas operacionit, është e domosdoshme të mësohet nëse vdekja ndodhi nga një shok septik, nga një komplikacion trombo-embolik, apo nga një këputje e qepjeve<sup>14</sup>.

*Kur autopsia është e mirë, ajo ndikon shumë pozitivisht në përfundimet që do të parashtrijë ekspertit.* Mungesa e autopsisë është një frenim për zhvillimin e mirë të ekspertizës, dhe është gabim që disa mjekë ngurrojnë të kërkojnë autopsi mjekoligjore, kur bëhet fjalë për vdekje pas operacionit. Të kërkojnë autopsinë, nuk do të thotë se këtu ka fajësi; kjo kërkesë tregon se mjeku dëshiron që të sqarohet gjithçka për shkaqet e një vdekjeje. Shpeshherë përfundimet e autopsisë nxjerrin të pafajshëm një mjek, apo një ekip mjekësor, sepse vdekja lidhet me gjendjen e mëparshme shumë të rëndë, ose me një patologji kirurgjikale që s'ka lidhje me asnjë terapi. Kryerja e autopsisë, përcakton lidhjen shkakësore në rast të përgjegjësisë së mjekut për vdekjen e pacientit dhe, në rast të kundërt, për moskryerje të autopsisë nga ana e mjekëve, në shumicën e rasteve me kërkesë të familjarëve, në kundërshtim me ligjin, nuk mund të vërtetohet në mënyrë të saktë dhe shkencore lidhja midis sëmundjes, për arsye të “shkakut të paqartë të vdekjes” dhe shkeljeve mjekësore të konstatuara, duke e bërë përfundimisht përcaktimin e shkakut të ardhjes së pasojës, hipotetik, të mundshëm dhe jo “të sigurt”.

## Bibliografi

1. Thiels C, et al. “Medical Malpractice Lawsuits Involving Surgical Residents”. *JAMA Surg.* 2017 Aug 30. doi: 10.1001/jamasurg.2017.2979. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28854303.
2. Pan D., “Doctors Killed My Baby: Argumentative Patterns in Medical Disputes in China”. *Health Commun.* 2017 Aug 18:1-10. doi: 10.1080/10410236.2017.1351271. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28820621.
3. Gupta A, et al., “Malpracticeclaims related to diagnostic errors in the hospital”. *BMJ Qual Saf.* 2017 Aug 9. pii: bmjqs-2017-006774. doi: 10.1136/bmjqs-2017-006774. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28794243.
4. Bokshan SL, et al., “Reported Litigation Associated With Primary Hip and Knee Arthroplasty”. *JArthroplasty.* 2017 Jul 11. pii: S0883-5403(17)30584-3. doi:10.1016/j.arth.2017.07.001. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28781019.
5. Carlson J, et al., “Provider and Practice Factors Associated With Emergency Physicians' Being Named in a Malpractice Claim”. *Ann Emerg Med.* 2017 Jul 26. pii: S0196-0644(17)30786-2. doi: 10.1016/j.annemergmed.2017.06.023. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28754358.
6. Moore J, Mello M. “Improving reconciliation following medical injury: a qualitative study of responses to patient safety incidents in New Zealand”. *BMJQual Saf.* 2017 Mar 9. pii: bmjqs-2016-005804. doi: 10.1136/bmjqs-2016-005804. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 28280075.
7. Berry M, Polking E, White R, “Thomson Reuters Accelus. Medical Malpractice and Tort Reform”. *Issue Brief Health Policy Track Serv.* 2016 Dec 27;2016:1-136. PubMed PMID: 28248469.
8. Kandinov A, et al., “Analysis of Factors Associated With Rhytidectomy Malpractice LitigationCases”. *JAMA Facial Plast Surg.* 2017 Jul 1;19(4):255-259. doi:10.1001/jamafacial.2016.1782. PubMed PMID: 28199538.
9. Sappideen C., “Medical teams and the standard of care in negligence”. *J Law Med.* 2015 Sep;23(1):69-82. PubMed PMID: 26554200.
10. Graber M, et al., “Electronic HealthRecord-Related Events in Medical Malpractice Claims”. *J Patient Saf.* 2015 Nov 6. [Epub ahead of print] PubMed PMID: 26558652.
11. Bishop T, Pesko M., “Does defensive medicine protect doctors againstmalpractice claims?” *BMJ.* 2015 Nov 4; 351:h5786. doi: 10.1136/bmj.h5786. PubMed PMID: 26537736.
12. Hamasaki T, Hagihara A., “A comparison of medical litigation filed against obstetrics and gynecology, internal medicine, and surgery departments”. *BMC MedEthics.* 2015 Oct 24;16(1):72. doi: 10.1186/s12910-015-0065-1. PubMed PMID:26498823; PubMed Central PMCID: PMC4619401.
13. Friedson A., “Medical Malpractice Damage Caps and Provider Reimbursement”. *Health Econ.* 2017 Jan;26(1):118-135. doi: 10.1002/hec.3283. Epub 2015 Oct 26. PubMed PMID: 26498742.
14. Cardoso R, et al.. “Evaluative reports on medical malpractice policies in obstetrics: a rapid scoping review”. *Syst Rev.*2017 Sep 6;6(1):181. doi: 10.1186/s13643-017-0569-5. PubMed PMID: 28874176; PubMed Central PMCID: PMC5586050.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# Teknologjia në mbështetje të dokumentimit ligjor në luftën kundër kultivimit të kanabisit në Shqipëri

## Rasti studimor i Shqipërisë

Dr. Artur BEU

Drejtoria e Përgjithshme, Policia e Shtetit  
artur.beu@asp.gov.al

Doc. Dr. Ariana NEPRAVISHTA

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kamëz

### Abstrakt

Kultivimi i kanabisit konsiderohet një veprimtari e paligjshme, e cila ka qenë e përhapur gjerësisht në Shqipëri në këto vitet e fundit. Sasitë e kanabisit të sekuestruar gjatë vitit 2015, u vlerësuan publikisht nga Ministri i Punëve të Brendshme në vitin 2016, me rreth 7 miliard Euro. Nuk do të donim të bëjmë një analizë të mirëfilltë në lidhje me faktorët që çuan në përhapjen e kultivimit të kanabisit në Shqipëri, por do të dëshironim të propozonim një zgjidhje të qëndrueshme për luftën kundër fenomenit të kultivimit, duke ofruar një qasje shkencore të evidentimit dhe më pas të shkatërrimit. Qasja është ajo, eksperimentuara me sukses tashmë në Shqipëri, qysh nga viti 2012, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme të Italisë dhe komponentët e një misioni të fluturimeve ajrore më avion special të pajisur me sensorë të teknologjisë së lartë, që mundësojnë evidentimin e bimëve të kanabisit të kultivuara në një territor të caktuar. Qëllimi i këtij artikulli është ai i ofrimit të një rrugëdaljeje, duke u munduar të shpjegohet rëndësia e qasjes shkencore dhe rëndësia mbështetjes së Bashkimit Evropian dhe e partnerëve ndërkombëtarë në këtë proces të ndërlikuar. Ideja puqet me një strategji daljeje dhe një politike të konvertimit të kulturës qytetare dhe të kulturave bujqësore, për t'i dhënë një mundësi njerëzve për të rrokur ligjshmërinë dhe ndarjen nga paligjshmëria, në rastin e atyre që nuk janë pjesë e grupeve kriminale. Pasojat kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti edhe me sigurinë në tërësi. Do të këtë përpjekje të atyre njerëzve që kanë përdorur këtë veprimtari të paligjshme të eksplorojnë mënyra të tjera të paligjshme, por qasja shkencore e bashkërenduar me një veprim të menjëhershëm të zbatimit të ligjit do të jetë zgjidhja përfundimtare. Në një veprim të përbashkët me partnerët ndërkombëtarë duke kërkuar një shtrirje në të ardhmen në nivel më të gjerë.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

### Fjalëkyçe:

teknologjia, strategji daljeje, siguria, bashkëpunim ndërkombëtar.



## 1. Hyrje

Në vitin 2017 jemi dëshmitarë të një ndërrimi të kursit të kultivimit të kanabisit në Shqipëri. Një nga qëllimet e këtij artikulli është demonstrimi i një qasje shkencore, unike deri më sot, të ndërmarrë nga dy vende partnere, sikurse janë Shqipëria dhe Italia, në kontrastin e fenomenit të kultivimit të kanabisit. Deri në vitin e fundit 2016, bazuar në raportet e ndryshme ndërkombëtare dhe në raportet e Policisë së Shtetit, territori shqiptar ka qenë i mbjellë me kanabis, që edhe me gjithë luftën e bërë nga Policia e Shtetit, ka pasur një përhapje të konsiderueshme. Autoritetet shqiptare janë përpjekur të luftojnë fenomenin, me rezultate që janë të konsideruara pozitive nga vetë BE, në progres-raportet e fundit nga 2012-2017. Megjithatë, vendi ka mbetur në hartën e kultivimit dhe të transitit, deri në vitin 2016, ku raportet e fundit të analizave të partnerëve kanë konsideruar sekuestrimet e bëra në Shqipëri dhe jashtë saj, sidomos në vendet fqinje, Itali dhe Greqi.

Nga analizimi i të dhënave sipas raporteve të dhëna nga Policia e Shtetit shqiptar në lidhje me identifikimin/asgjësimin e bimëve narkotike kanabis sativa, për periudhën 2010-2016, rezulton se në vitin 2010, janë identifikuar/asgjësuar 37216 bimë narkotike, ose 2.3 herë më pak se në vitin 2009. Ndërkohë që, në vitin 2011, janë identifikuar/asgjësuar 21 267 bimë narkotike, 16 949 bimë narkotike më pak se në vitin 2010, ose 25% më pak. Në vitin 2012, janë identifikuar/asgjësuar 76 185 bimë narkotike, 55 918 bimë narkotike më shumë se në vitin 2011, ose 2.6 herë më shumë. Ndërsa në vitin 2013, janë identifikuar/asgjësuar 98 491 bimë narkotike, 22 322 bimë narkotike më shumë se në vitin 2012, ose 23% më shumë. Në vitin 2014, janë identifikuar/asgjësuar 551 414 bimë narkotike, 452 923 bimë narkotike më shumë se në vitin 2013, ose 4.6 herë më shumë. Në vitin 2015, janë identifikuar/asgjësuar 797 422 bimë narkotike, 246 008 bimë narkotike më shumë se në vitin 2014, ose 44.6% më shumë. Ndërsa, në

**AKADEMIA  
E SIGURISË**


*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

vitin 2016, janë identifikuar/asgjësuar 2 536 288 bimë narkotike, 1 738 866 bimë narkotike më shumë se në vitin 2015, ose 3 herë më shumë<sup>1</sup>.

Vihet re se kultivimi i bimëve narkotike, gjatë këtyre viteve është shtrirë në të gjithë vendin, por zonat në cilat janë evidentuar/asgjësuar më shumë bimë narkotike janë qarqet: Gjirokastrë, Vlorë, Shkodër, Durrës, Lezhë. Për të qenë më të qartë, duke përdorur burimet e Policisë së Shtetit, po paraqesim grafikisht numrin e bimëve narkotike të evidentuara/asgjësuar gjatë periudhës 2010-2016<sup>2</sup>:

**Grafiku 1**



Sasia e lëndëve narkotike (marijuanë) e sekuestruar nga strukturat e Policisë së Shtetit, gjatë periudhës 2010-2016, paraqitet:

VITI	Lloji	Nr. Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj. Lirë	Kërkim
2010	Marijuanë	380	359	7304 kg, 805.8 gram	559	415	102	42
2011	Marijuanë	503	478	7695 kg, 658.8 gram	734	543	166	25
2012	Marijuanë	822	777	21138 kg, 231 gram	1053	663	342	48
2013	Marijuanë	949	888	20672 kg, 916.9 gram	1137	634	455	48
2014	Marijuanë	1093	992	97226 kg, 101.9 gram	1325	754	459	112
2015	Marijuanë	895	882	11352 kg, 829 gram	1276	790	412	69
2016	Marijuanë	1574	1459	30014 kg, 991.02 gram	2052	1349	591	112
TOTALI		6216	5835	195 ton, 405 kg, 534 gram	8136	5148	2527	456

**Tabela 1**


Sasia më e madhe e marijuanës së kapur/sekuestruar nga strukturat e policisë, është gjatë vitit 2014, sasi e cila përbën 49.7% të totalit të marijuanës së kapur/sekuestruar gjatë periudhës 2010-2016<sup>3</sup>.

Grafikisht, sasia e marijuanës së kapur dhe sekuestruar nga strukturat e Policisë së

<sup>3</sup> Policia e Shtetit 2017.

Shtetit, gjatë periudhës 2012-2016, sipas viteve, paraqitet:

**Grafiku 2**



Sasia e heroinës, kokainës, hashashit dhe marijuanës të kapur nga autoritetet policore të Italisë, gjatë periudhës 2012-2016, me origjinë nga Shqipëria, është si më poshtë në tabelën 2:

N/R	VITI	LLOJI I LENDËS NARKOTIKE DHE SASIA NË (kg)			
		HEROINE	KOKAINE	HASHISH	MARIJUANË
1.	2010	2.026	1.120	0	65.525
2.	2011	17.538	0	0	3190.136
3.	2012	0	0	0	4435.663
4.	2013	97.272	12.131	1.280	5680.416
5.	2014	21.294	0.500	-	7835.548
6.	2015	4.381	-	15.000	2717.576
7.	2016	5.186	-	-	15463.467
	TOTALI	147.697	13.751	16.280	39388.331

**Tabela 2**

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se, në total gjatë periudhës 2012-2016, nga autoritetet policore Italiane janë kapur 39 ton dhe 388 kg marijuanë, ndërsa sipas viteve rezulton si më poshtë:

- Në vitin 2012, janë kapur 4 ton e 435 kg marijuanë - 1245 kg më shumë se në vitin 2011, ose 39% më shumë.

- Në vitin 2013, janë kapur 5 ton, 680 kg e 416 gram marijuanë - 1244.753 kg më shumë se në vitin 2012, ose 28% më shumë.

- Në vitin 2014, janë kapur 7 ton, 835 kg e 548 gram marijuanë - 2 ton e 155.132 kg më shumë se në vitin 2013, ose 37% më shumë.

- Në vitin 2015, janë kapur 2 ton, 717 kg e 576 gram marijuanë - 5 ton, 117 kg e 972 gram më pak se në vitin 2014, ose 2.8 herë më pak.

- Në vitin 2016, janë kapur 15 ton, 463 kg e 467 gram marijuanë - 12 ton, 745 kg e 891 gram më shumë se në vitin 2015, ose 5.6 herë më shumë<sup>4</sup>.


Grafikisht, sasia e marijuanës në kg që është kapur nga autoritetet policore Italiane me origjinë nga Shqipëria, gjatë periudhës 2010-2016, paraqitet:

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>4</sup> Raporti I DCSA 2016



**Grafiku 3**

Raste të kultivimit të bimëve narkotike, të evidentuara nga strukturat e Policisë së Shtetit, për periudhën 2010-2016.

Me rritjen e numrit të bimëve narkotike të kultivuara, është rritur nga viti në vit edhe numri i rasteve të kultivimit të bimëve narkotike të evidentuara: nga 178 raste në vitin 2010, në 1671 raste në vitin 2016, ose 8.4 herë më shumë.

## **2. Misioni i policisë italiane, me fluturime ajrore për zbulimin e kanabisit dhe analiza shkencore e kanabisit**

Në vitin 2007 u krijua baza ligjore mes Shqipërisë dhe Italisë, me nënshkrimin e marrëveshjes në nivel qeverish, për luftën kundër kriminalitetit, për t'i hapur më pas rrugën në maj të vitit 2012, nënshkrimit të protokollit operativ mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentit të Sigurisë Publike, të Policisë italiane, për kryerjen e fluturimeve ajrore me avion të posaçëm të Guardia di Finanza për evidentimin e kultivimit të kanabisit në territorin e Shqipërisë. Në vitin 2012<sup>5</sup>, hyjmë në një epokë të re të përdorimit të teknologjisë, në ndihmë të evidentimit të kanabisit. Pra, qëllimi i misionit është ai i identifikimit të parcelave të kultivuara me kanabis, duke përdorur një avion special të pajisur me sensorë, hiperspektral dhe termik e një aparat fotografik me rezolucion shumë të lartë. Nëpërmjet kësaj teknologjie nga më të avancuarat, avioni, duke ndjekur plane fluturimi të caktuara paraprakisht, kryen një skanim të territorit të vendit duke mbledhur të dhëna spektrale dhe fotografike. Produkti final pas përpunimit së të dhënave, është dërgimi i koordinatave të sakta ku janë evidentuar bimë të llojit kanabis të kultivuar. Po si funksionon ky identifikim shkencor i kanabisit të kultivuar?

Në dispozicion të këtij misioni, janë vënë mjete ajrore si ky i paraqitur në *figurën 1* (Piaggio P166), të cilët janë modifikuar për të mbartur disa sensorë, që marrin të dhëna që më pas përkthehen në koordinata gjeografike për ndërhyrjet policore.

Në fakt territori shqiptar ka shërbyer si “havi” laboratorike e testimit të kësaj teknologjie të re, në vitin 2012. Kjo qasje e re, e propozuar nga një skuadër kërkuesish shkencor të Universitetit të Dytë të Napolit dhe Qendrës së Ekselencës BENECON, në Napoli, me binjakëzimin jo të natyrshëm me një forcë ushtarake, policore siç është

<sup>5</sup> Protokoll Operativ mes Policive të Shqipërisë dhe Italisë 2012




Figura 1

Guardia di Finanza, ka sjellë rezultate të paimagjinueshme deri në atë kohë. Njëri komponent i këtij misioni i përbërë nga burimet njerëzore ndërthuret në mënyrë komplekse me komponentin shkencor, një platformë inovative të sensorëve hiperspektral dhe termal (Itres CASI-1500 dhe TABI-320), në një mjet fluturues të GEA-s, dhe një antenë GNSS një zgjidhje permanente e TOPCON, e pozicionuar në çatinë e laboratorit në Tiranë.

Kjo teknologji mundëson identifikimin në lartësi të mëdha të materialeve artificiale në tokë. Risia e këtij kërkimi shkencor është përdorimi i asaj që quhet firma spektrale e materialeve nga reflektimi i rrezeve diellore ndaj çdo materiali në tokë. Duke qenë të aftë të krahasojnë firmën spektrale të materialeve (natyrale ose artificiale) që në fjalë të tjera do të thotë njohja e gjurmës specifike të secilit material, me objektivitet shkencor<sup>6</sup> (Gambardella & Casbarra 2013).

Figura 2



**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>6</sup> XI forum Internazionale di studi, Hyperspectral and thermal airborne surveying for the characterization and the monitoring of natural and anthropized environment , 2014.

Figura 3





Figura 4



Avioni P166 DP1 (figura 4) bëri 16 misione fluturimi dhe analiza e të dhënave, pas fluturimeve bëri të mundur identifikimin e 62 parcelave me kanabis. Pas përpunimit të mëtejshëm së të dhënave, në laboratorin e BENECON, u bë i mundur identifikimi i 193 zonave të tjera me kanabis. Në fund të misionit 2012, u identifikuan 255 parcela me 403.530 m2.

**AKADEMIA E SIGURISË**

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë »

Kjo përvojë ishte totalisht e re, në një mjedis të huaj dhe bazuar në një protokoll operativ mes forcash policore partnere, me bashkëpunimin e komponentit shkencor<sup>7</sup>.


Pas konkluzioneve të misionit, Policia e Shtetit shqiptar bëri ndërhyrje, të cilat rezultuan me një saktësi prej 100% të objektivave të dhëna. Ky rezultat tregoi për një

<sup>7</sup> Guardia di Finanza, Benecon, Policia e Shtetit shqiptar.



Figura 6

Laboratori kërkimor lëvizës dhe rrjedha e punës



- > Planifikimi i fluturimit
- > Marrja e të dhënave
- > Përpunimi
- > Analizimi

Ekipi:

- Harton planet e fluturimit
- Monitoron fluturimet
- Ruan të dhëna e mbledhura
- Përpunon të dhënat e marra nga pesë sensorët e ndryshëm
- Integron të dhëna për analiza komplekse
- Analizon gjurmët/shenjat spektrale të kanabisit
- Harton hartat tematike
- Perimetron dhe llogarit pozicionin e plantacioneve të kanabisit

Të gjitha të dhënat e mbledhura do të nevojiten për të përcaktuar algoritmin gjysmëautomatik për të zbuluar plantacionet me kanabis në të gjithë botën.

### 3. Rezultatet e misioneve të fluturimit ajror të policisë italiane ndër vite

Duke dashur të bëjmë një panoramë, të situatës 2012-2017, në evidentimin e sipërfaqeve të kultivuara me bimë narkotike, vetëm nga monitorimi ajror i kryer nga avionët specialë të Ministrisë së Brendshme Italiane, në bazë të Protokollit të Bashkëpunimit të nënshkruar me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, në maj 2012, duke marrë në konsideratë vitet 2012-2017, rezulton se janë marrë një sërë të dhënash, që në gjuhën shkencore quhen “big data”, të cilat janë përpunuar falë një skuadre dhe një laboratorit të lëvizshëm, sikurse shihet në figurën 6.

Në vitin 2012 janë kryer rreth 16 misione fluturimi ajror ku janë lokalizuar 62 parcela me bimë narkotike të llogaritura në 20 hektarë tokë. Në veçanti, në fshatin Lazarat, Qarku Gjirokastrë janë kryer dy monitorime ajrore, në datat 7-8 korrik 2012 dhe janë lokalizuar 193 parcela me kanabis sativa, me një sipërfaqe prej 383 hektarë.

Ndërsa në vitin 2013, janë kryer 25 misione fluturimi nga avionët e Ministrisë së Brendshme Italiane, duke monitoruar gjithsej 3818 kilometra katrorë, ose 12.5% të sipërfaqes së territorit të Shqipërisë. Nga ky monitorim ajror janë lokalizuar 304 parcela me bimë narkotike, ose 4.5 ha.

Gjithashtu, nga monitorimi ajror në komunën Lazarat, Gjirokastrë, pas përpunimit së të dhënave nga kërkuesit shkencorë, në këtë komunë është kultivuar një sipërfaqe prej 319 hektarë, duke vlerësuar se nga kjo sipërfaqe mund të prodhohet rreth 900 ton produkt të gatshëm kanabis sativa. Për çdo ha tokë të kultivuar me bimë narkotike në Komunën Lazarat prodhoheshin 2.8 ton produkt i përfunduar.

Sipas të dhënave të marra nga Policia Italiane, në raportin final të fundit të misionit



të fluturimeve 2014 rezulton se është fluturuar në një territor që përbën 15.08% ose 4313 km<sup>2</sup> të territorit shqiptar. Janë dërguar 49 raporte monitorimi për 798 parcela të identifikuar me bimë narkotike cannabis sativa.

Ndërkohë që janë dërguar 36 raporte monitorimi në vitin 2015, ku janë identifikuar 1368 parcela të kultivuara me bimë narkotike. Nga qershori më 14 shtator janë kryer 86h 46' fluturime dhe u identifikua një sipërfaqe prej 447.000 m<sup>2</sup> e kultivuar me kanabis sativa.

Në vitin 2016, janë përcjellë në Policinë e Shtetit 27 raporte monitorimi të Policisë italiane ku janë evidentuar 2086 parcela të konstatuara kryesisht në DVP Durrës, Shkodër, Lezhë, Dibër, Korçë, Fier, Berat, Gjirokastrë dhe Vlorë, (me sipërfaqe 2 117 964 m<sup>2</sup>). Nga këto koordinata janë evidentuar 2086 parcela të kultivuara me bimë narkotike.

Në vitin 2017 misioni i monitorimit ajror filloi më herët më datë 15 maj dhe për pjesën italiane ka përfunduar më datë 15 shtator 2017. Nga monitorimi ajror i këtij viti janë evidentuar 88 parcela me kanabis sativa për një sipërfaqe prej 19 713 m<sup>2</sup> ose 1.9 ha. Në fakt i vetmi konsiderim që mund të bëjmë, është se në territorin shqiptar në vitin 2017 nuk janë evidentuar parcela të kultivuara si në vitet e shkuara. Nuk është në qëllimin e këtij artikulli, të bëjmë analiza të shkaqeve që kanë sjellë në reduktimin e padiskutueshëm të sipërfaqeve të mbjella me kanabis, por të sjellë risinë e një qasjeje shkencore të pakundërshtueshme, në lidhje me evidentimin e bimëve të kultivuara në territor nëse ka apo jo.

Në fakt ndryshe nga analizat krahasuese, jemi përpjekur të japim të dhëna në lidhje me çfarë është evidentuar dhe, jo sa është shkatërruar apo sekuestruar nga autoritetet shqiptare, apo edhe partneret në territoret e tyre.

Në mendimin bazë të këtij artikulli, qëndron fakti se do të ishte e padrejtë të bëjë krahasime të shifrave dhe të parcelave të evidentuara nga viti në vit, nga misioni i fluturimeve ajrore me sensorë në Shqipëri. Një gabim, që lind nga metodologjia e gabuar krahasimore e shifrave të marra ndër vite. Së pari, për faktin se nuk është e mundur të bëhen krahasime për situata krejtësisht të ndryshme, në lidhje me përdorimin e teknologjive që nga viti në vit vijnë duke u përmirësuar, duke bërë që gabimet tekniko-shkencore të bëhen zero. Së dyti nuk flasim për të njëjtën madhësi të territorit, apo për të njëjtën zonë të fluturuar.

#### **4. Një propozim shqiptar për rritjen e kapaciteteve evidentuese dhe kontrolluese të kultivimit**

Në momentin e fillimit të operacionit masiv në Lazarat, në vitin 2014, për goditjen e kultivimit në këtë komunë të Gjirokastrës, një nga preokupimet e para ka qenë çfarë duhet bërë për të goditur në rrejtë këtë fenomenit të kultivimit. Një propozim për një strategji daljeje nga kultivimi i kanabisit, është bërë në Policinë e Shtetit dhe në Ministrinë e Punëve të Brendshme nga ana e disa kërkuesve shkencorë. Monitorimi ajror i territorit nëpërmjet një protokollit operativ, kishte dhënë rezultate të shkëlqyera dhe në këtë drejtim, ishte e mendueshme që diçka të tillë duhet ta kishte vetë shteti shqiptar, në përpjekje të rritjes së kapaciteteve të institucioneve të tij, për monitorimin dhe mbajtjen nën kontroll jo vetëm të kultivimit të kanabisit si veprimtari e paligjshme, por edhe duke shfrytëzuar teknologjinë në dobi të disa fushave të tjera. Në këtë drejtim një projekt i dobishëm, do të ishte ai i krijimit të një skuadre multidimensionale, nga

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

institucione të ndryshme të shtetit shqiptar, që përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Mbrojtjes dhe atë të Mjedisit me bashkëpunimin e Universiteteve e sidomos atë të Politeknikut.

Ideja ka të bëjë me klonimin e atij misioni të sjellë me sukses nga protokollin operativ mes Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë dhe asaj të Italisë, për monitorimin ajror, për zbulimin e kanabisit në territorin shqiptar.

Të dhënat e mbledhura nga sensorët e montuar në një mjet fluturues (avion), do të mundësonin analizimin dhe përpunimin e tyre, duke nxjerrë në pah natyrën e përbërjes gjeologjike e duke u bërë të mundur instituteve bujqësore që të kenë nën kontroll, kultivimin e bimëve të ndryshme, hartëzimin e territorit, kontrollin e territorit sa i takon ndërtimeve pa leje, kontrollin e cilësisë së ajrit, kontrollin e lëvizjeve gjeologjike, monitorimin e pyjeve për emergjencat civile etj.

## 5. Konsiderime

Pas një përvoje tashmë të fituar, falë një bashkëpunimi efikas, me një partner strategjik sikurse është Italia, duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse tekniko-shkencore, mund të propozohen ide që do të sjellin një përfitim të madh në kuadër të sigurisë së qytetarëve dhe të sigurisë së sundimit të ligjit.

Kjo qasje e re, e bazuar në teknologji, do të bëjë të mundur edhe shpejtësinë e proceseve gjyqësore pasi nuk do të ketë nevojë për ekspertiza të tjera shtesë, në lidhje me evidentimin dhe verifikimin, nëse bëhet fjalë për materiale të paligjshme apo për bimë narkotike e veprimtari të tjera të paligjshme.

Kjo risi shkencore, në fakt, duhet të ketë një vazhdimësi në përmirësimin e cilësisë së provave të pakundërshtueshme, të sjella nga agjencitë e zbatimit të ligjit para gjykatës, në mënyrë që çdo proces të jetë i besueshëm.

Në të njëjtën kohë, sjellja e një teknologjie të tillë, do të mundësojë edhe rritje të efikasitetit të zbatimit të ligjit, edhe ulje të korrupsionit në përgjithësi, për shkak të pakundërshtueshmërisë dhe interpretimit të provave gjatë gjyqësorëve. Kjo risi, do të sjellë edhe një rritje të ekonomisë në përgjithësi, pasi çështja ekonomike është edhe motori që bën të mundur zhdukjen e fenomeneve të paligjshmërisë dhe të vënies në punë të një aparati shtetëror në shërbim të qytetarëve.

## 6. Konkluzione

Një projekt si ky i përshkruari në këtë artikull, mund të bëjë të mundur ndër të tjera:

1. Rritjen e efikasitetit dhe të shpejtësisë së sigurimit të provave, bazuar në një qasje shkencore të teknologjisë së lartë.

2. Rritjen e sigurisë dhe të besueshmërisë së forcave të zbatimit të ligjit, duke bërë të mundur rritjen e kapaciteteve teknologjike dhe duke ofruar një qasje shkencore.

3. Rritjen e kapaciteteve bujqësore, duke ofruar zgjidhje në çfarë të mbillet në tokë e duke evidentuar bimët më të përshtatshme për t'u mbjellë në zona të caktuara.

4. Rritjen e sigurisë në tërësi, duke bërë të mundur një kontroll të territorit pasi të jetë hartëzuar dhe në këtë mënyrë, një kontroll edhe mbi veprimtaritë e ndërtimeve të paligjshme dhe identifikimi i autorëve.

5. Rritjen e kapaciteteve kontrolluese të mjedisit, duke bërë të mundur kontrollin e

gazrave dhe monitorimin e ajrit.

6. Rritjen e nivelit kulturor dhe të ruajtjes së pasurisë kulturore, duke bërë të mundur kontrollin e siteve arkeologjike.

## Referenca

1. Albanian State Police report after Lazarat and Dukagjin Interventions September 2014.
2. Press conference, Tirana International 24 September 2014.
3. Albanian State Police report 2012, 2013, 2014, 2015, 2016.
4. Guardia di Finanza report, September 2014, September 2015, October 2016
5. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
6. Ligji nr.9559, datë 08.06.2006 "Për një shtesë në ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 "Per barnat narkotike dhe lëndët psikotrope".
7. Plani i Veprimit "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike" Policia e Shtetit 2014, 2015,2016, 2017.
8. Udhëzimi i Përbashkët i Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shendetësisë "Për trajtimin e lëndëve narkotike apo psikotrope".
9. Analiza Vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme për Sigurinë Publike 2015, 2016.
10. Albanian State Police report after Lazarat and Dukagjin Interventions September 2014.
11. BNE Intellinews, 30 August 2013.
12. Bobbio L., La democrazia non abita a Gordio: Studio sui processi decisionali politico-amministrativi, Franco Angeli, 1996.
13. Capano G, Giuliani M. (2005), *Dizionario di politiche pubbliche*, Carocci Editore, Roma.
14. Carmine GAMBARDELLA, et al., "Hyperspectral and thermal airborne surveying for the characterization and the monitoring of natural and anthropized environment", *XI forum Internazionale di studi*, 2014.
15. Dye T.R. (1972), *Understanding Public Policy*, Prentice-Hall, Englewood Cliffs, NJ
16. E. Rotelli, G. L. Roscio, O. Caputo (2002), *L'amministrazione nella ricerca Isap*. Catalogo 1962-2002, Giuffrè, Milano.
17. EU report Albania 2013.
18. European Commission Report from the Commission to the Council and the European Parliament on Albania's Progress in the Fight Against Corruption and Organised Crime and in the Judicial Reform, 4. 6. 2014 .
19. Fareri P. (2009), *Rallentare. Il disegno delle politiche urbane*, Franco Angeli, Milano.
20. Guardia di Finanza report, September 2014.
21. Howlett, M., Ramesh, M. *Come studiare le politiche pubbliche*, Il Mulino, Bologna, 2005.
22. Kingdon J. W. (1984), *Agendas, Alternatives, and Public Policies*, Little Brown & Co., Boston.
23. PAMECA IV report on Albania 2013, 2014, 2015, 2016.
24. Press conference, Tirana International 24 september 2014.
25. Pressman, Jeffrey L., Wildavsky A. (1973), *Implementation: How Great Expectations in Washington Are Dashed in Oakland: Or, Why It's Amazing that Federal Programs Work at All this Being a Saga of the Economic Development Administration as Told by Two Sympathetic Observers Who Seek to Build Morals on a Foundation of Ruined Hopes*, Berkeley: University of California Press.
26. Wildavsky A. (1992), *Speaking Truth to Power: The Art and Craft of Policy Analysis*, Little Brown & Co., Boston (1 ed. 1979).

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »**

# Roli i inteligjencës kriminalistike

— MSc. Ajdin MBORJA

Akademia e Sigurisë

ajdin.mborja@asp.gov.al

## Abstrakt

*Roli i policisë shkencore, në ditët e dinamikën e sotme, të evoluimit të krimit, ka marrë rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo, si për sa i përket zbulimit të autorëve të veprave penale, ashtu dhe dokumentimit ligjor të fajësisë së tyre. Duhet theksuar se në policinë shkencore sot trajtohen pothuaj 90% e provave të fiksuar në vendin e ngjarjes. Kjo strukturë ka "fatin e mirë" të njihet me të gjitha llojet e provave, vendin dhe kohën e gjetjes e fiksimit të tyre, mënyrën e formimit të tyre e deri diku dhe lidhjen, rrolin e vendin e secilës në mekanizmin e zhvillimit të ngjarjes. Ky aspekt merr një rëndësi akoma më të madhe, kur trajtohet nën këndvështrimin se, një strukturë e caktuar e luftës kundër krimit, ka dijeni për provat brenda fushës së saj, ndërsa policia shkencore trajton provat e të gjitha strukturave të policisë. Duke pasur këtë avantazh, mendojmë se ka ardhur koha që në lidhje me policinë shkencore, të fillojë të ravigjëzohet koncepti i "inteligjencës kriminalistike". Në policinë e vendeve të zhvilluara ky koncept, i ka prej vitësh fillesat e veta dhe sot, po tenton të marrë një rol të veçantë në analizën e përgjithshme të krimit. Ai po fiton terren si brenda vetë policisë, ashtu dhe ndërmjet organizatave të tjera ligjzbatuese e shoqërore që përfshihen direkt apo indirekt në luftën kundër kriminalitetit. Këtë e realizon, duke vënë në dispozicion sasi më të madhe të dhënash, që rrjedhin nga ekzaminimet e ekspertimet kriminalistike, si dhe duke ofruar metodologjinë përkatëse të analizimit të këtyre të dhënave. Nga ana tjetër, inteligjenca kriminalistike hap një perspektive të qasjeve më efikase në luftën kundër krimit, si në nivel operacional, ashtu dhe në nivel strategjik.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**policia shkencore, inteligjencë, kriminalistikë, mënyrë veprimi (modus operandi), prova kriminalistike, ekzaminim kriminalistik, analizë policore, integrim të dhënash.**

## 1. Hyrje

Sot, krimi nuk po njeh më kufij, qoftë lokalë apo shtetërorë. Ai me kohë ka dalë jashtë lokalizimeve, të cilat më parë kanë qenë të ndikuara nga origjina apo fazat e ndryshme të zhvillimit të tij. Mund ta karakterizojmë, me shembullin e trafikut të bimëve narkotike sot: vendi i magazinimit mund të jetë shumë larg vendit të kultivimit; ai i paketimit, në shumë raste nuk ka lidhje fare me dy të parat; mënyrat e mjetet e trafikimit apo pikat e kalimit, kushtëzohen jo nga vendndodhja apo largësia, por nga përshtatshmëri të tjera, e më pas vendet apo drejtimet e shpërndarjes e trafikimit janë nga më të ndryshmet. Por, pavarësisht nga ky lloj diversiteti, të gjitha këto faza kanë karakteristika që lidhen me provat kriminalistike e që i bashkon ato. Identifikimin e këtyre karakteristikave, analizimin dhe lidhjen ndërmjet tyre, e më pas rekomandimet për të pasur një efikasitet sa më të lartë, në luftën kundër kultivimit e trafikut, e realizon “inteligjenca kriminalistike”.

Po e quajmë *inteligjencë kriminalistike* pasi termi i plotë do të ishte *inteligjenca ligjore* (ang.: *Forensic Intelligence*) e cila kupton një spektër mjaft më të gjerë se ai “kriminalistik”, duke përfshirë dhe mjekësinë ligjore, psikiatrinë ligjore, ekonominë ligjore, etj. Por, në këtë punim do të fokusohemi vetëm tek ato fusha që përmbledh kriminalistika tek ne. Policia shqiptare ka implementuar procesin e analizës policore, duke e zhvilluar atë pothuaj në të gjithë komponentët e saj (vlerësime periodike, taktike e strategjike, analizë rasti, analizë risku, analizë profili, etj). Strukturat analizuese në qendër (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë) dhe në strukturat lokale (Drejtoritë Vendore) mbledhin gjithë informacionin e grumbulluar, e duke u ngritur mbi “kufizimet” territoriale e akseseve të njohjes, duke përdorur programe të veçanta dhe punonjës të specializuar, janë kthyer në struktura mjaft të vlefshme duke rritur cilësinë dhe shpejtësinë e veprimeve hetuese kundër krimit dhe, atij të organizuarit në veçanti. Sot, analiza e informacionit kriminal, është baza e njohjes reale të një fenomeni apo dukurie kriminale,

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të siguriës »

apo e parashikimit se çfarë mund të ndodhë, duke dhënë dhe rekomandimet përkatëse, kushte këto të nevojshme dhe të domosdoshme për një luftë efikase kundër krimit. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, orientonte<sup>1</sup>:

Ndërmarrja e analizave dhe studimeve për të evidentuar gjendjen format, mënyrat etj, të zhvillimit të krimit të organizuar, është kusht, pa të cilin nuk mund të parandalohet e luftohet me sukses kjo veprimtari me rrezikshmëri shoqërore.

Ajo që mendoj se duhet të arrijmë, është përfshirja në elementët e analizimit të një krimi apo fenomeni kriminal, edhe e të dhënave apo përfundimeve të ekzaminimeve apo konkluzionet e ekspertimeve kriminalistike, në këtë rast jo vetëm si burim prove, por edhe si karakteristika të veçanta, të përbashkëta, si elementë lidhës të aspekteve të ndryshme të zhvillimit kriminal.

Kështu, në logjikën e shembullit të marrë më lart, përqindje të njëjta të përmbajtjes së THC-së<sup>2</sup> në ngarkesa lëndësh narkotike të kapura në kohë, vende e drejtime të ndryshme, karakteristika të njëjta të paketimit, e më tej gjurmë të njëjta daktiloskopike apo profile të njëjta ADN-je, etj., na lejojnë që të përcaktojmë një origjinë të lëndës, një itinerar të lëvizjes e përpunimit të saj (magazininim, paketim, etj.) e më pas, identifikim konkret të autorëve. Ky punim synon të japë disa mendime për rëndësinë e përfshirjes së të dhënave dhe përfundimeve kriminalistike, në analizat që zhvillon Policia e Shtetit për kriminalitetin dhe më tej, krijimin e kushteve për implementimin dhe zhvillimin e ashtuquajturës “inteligjencë kriminalistike”.

## 2. Çfarë kuptojmë me “inteligjencë kriminalistike”?

Në fokusin e trajtimit të informacionit, termi “inteligjencë” nuk konceptohet si një aftësi apo kapacitet për të kuptuar diçka, por si një “produkt” inteligjent i cili është i gatshëm dhe i vlefshëm për përdorim konkret<sup>3</sup>.

Në policimin proaktiv (parandalues) përdorimi inteligjencës nga agjencitë ligjzbatuese është kthyer në një proces mjaft të rëndësishëm, si mjeti kryesor dhe më efikas në luftën kundër krimit. Përdorimi i efektshëm i procesit të inteligjencës, aktualisht nënkupton diferencën ndërmjet suksesit dhe dështimit, për një agjenci të zbatimit të ligjit.

Inteligjenca mund të mbështesë një gamë të gjerë të luftës kundër kriminalitetit në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar. Në mënyrë të veçantë, kur informacioni është i shumtë dhe shpesh konfuz e kontradiktor, inteligjenca mund të shënojë rrugën drejt politikave efektive<sup>4</sup>.

Përdorimi efikas i inteligjencës, në agjencitë e zbatimit të ligjit është jetësor. Një përdorim i plotë dhe i saktë i inteligjencës, krijon premisa për përballimin me efikasitet të problemeve që do të lindin në të ardhmen dhe do të lejojë autoritetet ligjzbatues, që të kenë një përgjigje paraprake për veprimtarinë e grupeve kriminale. Inteligenca shkon përtej analizës së informacionit, ajo e përfshin këtë të fundit.

Në fushën policore, “inteligjencë” konsiderohet informacioni i cili kalon në procesin e vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe si rezultat i këtij procesi, nuk është më informacion, por “njohuri”, që transmeton vlerësim kuptimplotë të situatës, mënyrat dhe mjetet e mundshme për veprimet në të tashmen e të ardhmen.

<sup>1</sup> “Rekomandimi 96-8”, *Për politikën kriminale në Europë*, shtator 1996.

<sup>2</sup> “TetraHidroKanabinol”, komponenti narkotik i bimës së Cannabis Sativa-s.

<sup>3</sup> Akademia e Sigurisë, *Cikël leksionesh: Informacioni & Analiza*, Departamenti Hetimit të Krimit, 2017.

<sup>4</sup> Muçaj, A., *Intelligence + Analyse Team*, Akademia e Sigurisë.

Sipas Europol-it, inteligjenca është “njohuri” (informacion i procesuar) e i krijuar për veprim<sup>5</sup>. Pra “inteligjenca policore kriminale” ose siç quhet ndryshe “inteligjenca kriminale”, mund të përkufizohet si një produkt i një procesi analitik, i cili trajton një të ardhme të integruar të informacioneve të ndryshme rreth krimit, tendencave të tij, krimit dhe kërcënimit të sigurisë dhe kushteve që lidhen me kriminalitetin<sup>6</sup>.

Ajo është procesi i “*nxjerrjes*” së kuptimit nga faktet dhe produkt i shtimit të vlerës të informacioneve dhe të dhënave përmes analizës. Inteligjenca përfshin mbledhjen, vlerësimin, sistemimin, analizimin, shpërndarjen dhe rivlerësimin e informacionit mbi kriminelë të veçuar apo organizata kriminale<sup>7</sup>. Organizma të ndryshëm ligjzbatues janë munduar të japin përcaktimin e tyre për inteligjencën. Sipas modelit të FBI-së, inteligjenca është procesi i ndërtuar mbi çështjet dhe fazat e mëposhtme<sup>8</sup>:

a. *Nevoja*. Identifikimi i informacionit që na duhet për të mbrojtur të paprekur vendin, rendin publik, sigurinë, etj, çfarë na duhet për të parandaluar dhe goditur krimin.

b. *Planifikimi dhe drejtimi*. Planifikimi dhe menaxhimi i përpjekjeve, nga identifikimi i nevojave, deri tek shpërndarja e produktit të inteligjencës. Kjo, kërkon planifikim specifik të kërkesave për marrjen e informacionit, deri tek shpërndarja sipas kërkesave të inteligjencës.

c. *Grumbullimi*. Mbledhja e të dhënave të zakonshme bazuar në kërkesat, burime të ndryshme.

d. *Përpunimi*. Përfshin marrjen e të dhënave të marra masivisht e në mënyrë të thjeshtë, filtrimin, sistemimin, redaktimin dhe futjen në bazën e të dhënave për analistët.

e. *Analiza dhe paraqitja*. Analiza dhe paraqitja janë pjesa e procesit që kthen të dhënat e zakonshme në inteligjencë. Përfshijnë integrimin, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e produkteve të inteligjencës. Përfshin edhe vlerësimin e besueshmërisë dhe vlerës, si dhe, të lidhjeve. Informacioni integrohet logjikisht në kontekstin përkatës dhe përdoret për të prodhuar inteligjencë. Kjo përfshin dhe të dhënat e thjeshta, dhe inteligjencën e përfunduar. Zakonisht, të dhënat e thjeshta, skematikisht përkufizohen si “pika”, ndërsa inteligjenca përfundimtare, si “lidhja e pikave”, duke vendosur informacionin në kontekst dhe duke nxjerrë përfundime.

f. *Shpërndarja*. Është pjesa e procesit e cila dërgon të dhënat e thjeshta ose inteligjencën e përfunduar “konsumatorëve”, të cilët kanë iniciuar nevojat për inteligjencë.

g. *Feddback-u*. Është informacioni kthyes; ai shërben për një analizë vlerësuese lidhur me realizimin e objektivave. Mund të kemi disa të tillë gjatë procesit për aspekte apo faza të ndryshme. Gjithashtu në fund, kemi dhe një *feedback* përfundimtar, në të cilin duhet të jetë e përfshirë, e përmbledhur, e zgjidhur, e pasqyruar, pra “e mëshiruar”, gjithë problematika e trajtuar gjatë procesit.

Analiza e informacionit policor është zemra e inteligjencës policore. Për kujtesë, analiza e informacionit policor, është procesi i studimit e rishqyrtimit të natyrës së një fakti, ngjarjeje, apo të dhënave të grumbulluara (të gjitha këto me natyrë policore) për gjetjen e hollësive të rëndësishme, përcaktimin e karakteristikave të veçanta dhe marrëdhënieve që ekzistojnë midis tyre, me qëllim arritjen e konkluzioneve rreth tyre<sup>9</sup>.

<sup>5</sup> Cituar nga kursi “Për drejtuesit e lartë”, PAMECA 2009.

<sup>6</sup> Akademia e Sigurisë, *Cikël leksionesh: Informacioni & Analiza*, Departamenti Hetimit të Krimit, 2017.

<sup>7</sup> Drexel, G. E., Harris, D. R., *Basic Elements of Intelligence Revised*, Washington: Law Enforcement Assistance Administration, U.S. De; Revised edition (1976), f. 8.

<sup>8</sup> Muçaj, A., *op. cit.*

<sup>9</sup> Akademia e Sigurisë, *Cikël leksionesh: Informacioni & Analiza*, Departamenti Hetimit të Krimit, 2017.

Pra, elementi kryesor apo lënda e parë e analizës, e më tej inteligjencës, janë informacionet, të dhënat, faktet, etj. Rezultati dhe cilësia e analizës, varet shumë, nga sasia dhe cilësia e elementëve të mësipërm. Përfshirja e sa më shumë informacioneve, të dhënave e fakteve, integrimi sa më i plotë e i saktë i tyre, shoqëruar më pas me një interpretim sa më profesional, të çon në përfitim të një produkti më cilësor, të gatshëm për t'u përdorur konkretisht nga strukturat përkatëse.

Sot, procesi i analizës dhe përfitimi i "produktit inteligjent" realizohet, asistohet, amplifikohet, etj., edhe me anë të sistemeve elektronike si, me ato të grumbullimit e të përpunimit së të dhënave, ashtu edhe me ato të analizimit të tyre. Marrim në studim, të gjitha ato faza që cituam më lart, me qëllim që të vlerësojmë se si mund të implementohet modeli i inteligjencës në fushën kriminalistike. Identifikimi i informacionit që do të shërbejë për të përfutur një produkt inteligjent kriminalistik, në këtë rast, lidhet me të gjitha të dhënat që disponon apo përfiton kriminalistika, si rezultat i aktivitetit të saj. Të dhënat biometrike si, gjurmë duarsh e profile ADN-je, kartoteka balistike, konkluzionet traseologjike, *modus operandi*, e më tej, të dhënat sasiore e sidomos ato cilësore, të përfuturara nga ekzaminimi i lëndëve narkotike, mbeturinave të faktorëve plotësues të qitjes apo eksplozive, etj., janë një bazë mjaft e konsiderueshme nga ku mund të nisemi e të përpunojmë informacionin.

Në bazë të përpunimit, e më tej, të analizës, ne mund të përftojme produkte të vlefshme, të cilat marrin vlerë të konsiderueshme, sidomos në luftën kundër krimit të organizuar, vlerësime taktike e më tej parashikime. Në hetimet proaktive, këto produkte mund të jenë mjaft të vlefshme, për sa i përket profilit biometrik të individit, parashikimit të itinerareve që mund të ndjekë trafikimi i lëndëve narkotike apo i trafiqeve të tjera të paligjshme dhe parashikimit sa më të saktë të mënyrave të prishme të përdorura, etj. Mbi këto baza mund të përpilohen dhe analiza rreziku, të cilat, nëse janë mbështetur mbi të dhëna të sakta e ato të duhurat, me indikatorë rreziku të mirëpërcaktuar, të punuara me cilësi e aftësi profesionale, janë një armë mjaft e fuqishme dhe frutdhënëse<sup>10</sup>.

Inteligjenca kriminalistike përfshin edhe aspektin për sa i përket shkëmbimit të informacioneve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. E ardhmja është drejt unifikimit të metodave e praktikave, aksesëve të ndërsjella në sistemet automatike tip *database* dhe, të identifikimit, etj. Në këtë funksion është dhe procesi i akreditimit të laboratorëve të policisë shkencore, ku synohet standardizimi i metodikave, përshtatja sipas standardeve dhe kontrolli i aparaturave e pajisjeve, standardizimi i niveleve të besueshmërisë, rrjedhimisht standardizimi e besueshmëria e konkluzioneve dhe, njohja e pranimi i tyre si të mirëqena, nga organet procedurale e gjyqësore të vendeve të tjera<sup>11</sup>.

Të gjitha sa më lart, janë pasqyruar në standardet ndërkombëtare ISO 9001, ISO 17020 dhe ISO 17025, të detyrueshme për zbatim për vendet e BE-së dhe aspiruese për në BE. Kjo, lehtëson dhe mundëson akoma më shumë, ndërthurjen dhe bashkëpunimin e inteligjencës kriminalistike policore të një shteti, me atë të policive të shteteve të tjera. Sot, po synohet drejt një unifikimi të së gjithë të dhënave dhe, sistemeve elektronike automatike që përdorin në policitë e tyre shtetet europiane. Kështu, po krijohet një bazë e përbashkët e të dhënave, e të gjithë vendeve të hapësirës *Schengen*; e të dhënave biometrike, si gjurmëve të duarve, etj. Në të njëjtën kohë, me drejtimet e reja që ka marrë

<sup>10</sup> Si shembull, mund të shërbejnë mjaft mirë analizat e riskut të përpiluara dhe të vëna në zbatim nga policia kufitare.

<sup>11</sup> Mborja, A., "Formimi eksperteve kriminalistë përballë sfidave të kohës", në: *Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit*, Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016.



terrorizmi e, për rrjedhojë edhe lufta kundër tij, po punohet për krijimin e bazës së përbashkët të të dhënave, edhe për sa i përket informacioneve të tjera, ku një vend të konsiderueshëm zënë edhe ato që lidhen me të dhënat e përfuara nga ekzaminimet kriminalistike të rasteve të veçanta, ndodhur në vende e kohë të ndryshme.

Në këtë këndvështrim, të gjithë informacionet, të dhënat etj., që disponon, përpunon apo përfiton kriminalistika në tërësinë e saj, përfundimet e nxjerra nga konkluzionet e ekspertimeve, rezultatet e ekzaminimeve, të dhënat biometrike si, gjurmët e duarve, profilet e ADN-së, rezultatet balistike, etj., shoqëruar edhe me ekzistencën e përdorimit prej saj të sistemeve automatike të identifikimit në bazë të gjurmëve biometrike e balistike AFIS, CODIS, ARSENAL, etj., përbëjnë një sasi mjaft të konsiderueshme informacioni, i cili nuk përfshihet fare ose në disa raste përfshihet shumë pak, apo jo plotësisht në tërësinë e informacioneve që analizohen nga Policia e Shtetit, në mënyrë të standardizuar. Grumbullimi i tyre, përpunimi e analizimi, pra përfshirja dhe trajtimi i tyre me të njëjtën shkallë vlerësimi dhe mënyre, ashtu si informacionet klasike policore, me qëllim përfundim e produktit inteligjent, procesuar në të gjitha fazat që kemi cituar më lart, përbën atë që mund të quhet pa hezitim, “inteligjencë kriminalistike”.

### **3. Implementimi i “inteligjencës kriminalistike”, në policinë e vendeve të zhvilluara**

Zhvillimet e kriminalitetit në botë historikisht kanë shoqëruar gjithë zhvillimet shoqërore që kanë kaluar shtete të ndryshme. Më përparimin e shoqërisë, edhe kriminaliteti ka përparuar. Ai është “sofistikuar”, pak a shumë në shkallë të njëjtë me zhvillimin e shoqërisë. I tillë është edhe reagimi i shtetit ndaj këtij kriminaliteti. Në këtë këndvështrim, me shtrirjen e kriminalitetit jashtë kufijve lokale, shtetërorë apo rajonale, policinë e këtyre shteteve filluan të ndiejnë nevojën e përfshirjes sa më tepër të së dhënave mbi autorët e mundshëm, mënyrat e veprimit të tyre, mjetet e teknikat e përdorura, etj., duke përfshirë në analizat e krimet që zhvilloheshin edhe të dhëna kriminalistike apo mjekoligjore, si gjurmët e gishtave, profile apo të dhëna të tjera të marra nga ADN-ja; përfundime të ekzaminimeve balistike, traseologjike, etj., duke hedhur kështu, bazat e para të “inteligjencës kriminalistike”.

Nuk mund të flitet për një datë të saktë të lindjes së këtij koncepti, por duhet thënë se në mënyra të shkëlqyeshme, apo vetëm për krime të veçanta, faktikisht edhe më parë është përfshirë një lloj inteligjence policore. Konkretisht, për krimet në seri, zhvilloheshin analiza, por ato mbeteshin të veçuara e të kufizuara, si në kohë ashtu edhe në hapësirë. Koncepti u konfigurua i plotë, në momentin kur në polici u implementuan sisteme automatike të grumbullimit, përpunimit dhe gjenerimit të së dhënave; pra mund të themi se kushtet e nevojshme e të qëndrueshëm u përvijuan në vitet ‘90.

Duhet theksuar, se rrugëtimi i këtij procesi ka hasur shumë kundërshti, ku arsyeja kryesore ishte mospranimi i ndryshimit dhe qëndrimi në pozitat klasike e konservatore. Gjithashtu, ajo përballë me kulturën e hetimit të veçuar e sipas mënyrave, deri diku, individuale e të personalizuar. Kjo, vështirësohej akoma më shumë, me mungesën e standardizimit, e cila sillte mjaft vështirësi në kombinimin dhe lidhjen e të dhënave<sup>12</sup>.

Por më tej, lindja dhe implementimi i këtij procesi, erdhi si pasojë e nevojës, duke

<sup>12</sup> Mennell, J., & Shaw, I., “The Future of Forensic and Crime Scene Science, Part I. A UK forensic science user and provider perspective”, *Forensic Science International*, 2006 Mar 14; 157 Suppl 1:S7-12. Epub 2006 Jan 23., f. 12.

shuar kështu çdo ide kundërshtare. Fillimisht, nga fundi i viteve '80 lindi nocioni i inteligjencës kriminalistike, duke përdorur të dhëna të indeksuara e standardizuara, të marra nga vendngjarje të ndryshme. Në fund të viteve '90, u pa qartë, që studimi i konkluzioneve të nxjerra nga hetimet, të ndërthurura me ato të përfutuara nga ekzaminimet kriminalistike, jepnin një kontribut kryesor në zgjidhjen e shumë rasteve të vështira kriminale.

Por, edhe vetë policia shkencore, nuk ishte e përgatitur për këtë zhvillim. Ajo nuk ishte në përshtatshmërinë dhe nivelin e duhur për të kontribuar siç duhet në këtë drejtim, ku pengesat kryesore, ishin gama e ekzaminimeve dhe koha e kryerjes së tyre dhe e dhënies së konkluzioneve. Duke u ndodhur përballë një realiteti të tillë, u pa e nevojshme që të përmirësoheshin cilësia dhe dobia e rezultateve kriminalistike, si dhe, afatet kohore. Për të përmirësuar rolin e të dhënave kriminalistike në procesin e hetimit, u rekomanduan katër ndryshime kryesore<sup>13</sup>:

- rritja e fushave të ekzaminimeve kriminalistike si dhe rritja e gamës së tyre brenda së njëjtës fushë;
- rritja e shpejtësisë së kryerjes së ekzaminimeve kriminalistike dhe shkurtimi i afateve kohore të dhënies së konkluzioneve.
- rritja e cilësisë së ekzaminimeve, duke u shoqëruar me rritjen e efektivitetit dhe besueshmërisë;
- realizimi i objektivave të mësipërm, duhet të shoqërohej patjetër me uljen dhe racionalizimin e kostove ekonomike të ekzaminimeve, duke llogaritur tashmë, koston sipas zërave të veçantë e jo më të përgjithshëm.

Gjatë viteve 2000 u bë e qartë për të gjithë, që inteligjenca kriminalistike, tashmë ishte një domosdoshmëri, prandaj ajo duhej të shtrihet e të përsosej më tej. Kjo do të arrihej, duke rritur si sasinë, ashtu edhe cilësinë e të dhënave të ofruara nga kriminalistika. Theks i veçantë u vu sidomos në mangësitë lidhur me integrimin e të dhënave kriminalistike, në procesin e hetimit dhe analizës<sup>14</sup>.

Për shembull, në dokumentin e strategjisë të luftës kundër krimit të organizuar, të Policisë Australiane, të vitit 2009, thuhet se: Inteligjenca ligjore është një nga elementët jetësorë për të forcuar të kuptuarit, hetimin dhe përgjigjet ndaj krimit të organizuar. Më tej, strategjia e hetimit shkencor thekson se qëllimi është të integrojë të dhëna kriminalistike e ligjore në informacionet mbi krimin dhe inteligjencën, në mënyrë që të lidhë veprat me autorët, duke synuar një polici të udhëhequr nga inteligjenca<sup>15</sup>.

Sot, inteligjenca kriminalistike ka gjetur zbatim të konsiderueshëm dhe rezultatet janë të kënaqshme. Ajo po përdoret me sukses jo vetëm në zbulimin apo parandalimin e krimeve të rënda apo të organizuara por edhe në të ashtuquajturin krimin ordiner apo "të volumit". Ky proces është shoqëruar dhe me krijimin e sistemeve përkatëse elektronike. Zvicra është një nga shtetet ku inteligjenca kriminalistike është zbatuar me sukses. Policia zvicerane e ka integruar inteligjencën kriminalistike me hetimet policore, duke përfshirë si krimin e organizuar, ashtu dhe krimin ordiner, por që ka impakt në popullsi. Kështu, inteligjenca kriminalistike ka qenë vendimtare për zgjidhjen e rreth 250 rasteve në vit, të cilat përfshijnë krim të organizuar, vjedhje të automjeteve, zjarrvënien, vjedhje në seri, falsifikim dokumentesh e prodhim e trafik droge.

Në Britaninë e Madhe, vetëm për një muaj referues, inteligjenca kriminalistike ka

<sup>13</sup> Po aty, f. 10

<sup>14</sup> Ribaux, O., et al., "Forensic intelligence and crime analysis", në: *Law, Probability and Risk* (2003) 2, 47-60, f. 47.

<sup>15</sup> *Strategjia e Hetimit Shkencor*, Australia Perëndimore, 2009-2010, f. 6.

qenë vendimtare për zgjidhjen e rreth 2500 raste të krimit ordiner, ndërsa për një vit, me anë të ADN-së janë zgjidhur 15 raste vrasjesh dhe 45 raste përdhunimesh.

Gjithashtu, policia britanike ka zhvilluar dhe disa projekte, tashmë të implementuar, duke përfshirë bazat e koduara të vjedhjeve, gjurmët e këpucëve, etj., përgjithësisht të gjitha të dhënat e marra nga vendngjarjet<sup>16</sup>.

SHBA ka zbatuar me mjaft sukses inteligjencën kriminalistike, për sa i përket ngarkesave të improvizuara eksplozive, të përdorura nga kundërshtarët në konfliktet në Irak dhe në Afganistan. Faktikisht, metoda është zbatuar nga ushtria, por është një proces i mirëfilltë kriminalistik.

#### 4. Elementë të inteligjencës kriminalistike në policinë shqiptare

Elementë të këtij koncepti aktualisht, ne i gjejmë dhe në policinë shkencore shqiptare. Vetë bashkimet e ngjarjeve kriminale, ku janë përdorur të njëjtat armë, autorësia e njëjtë “e dyshuar”, bazuar mbi gjurmët e duarve apo profilet e ADN-së, apo më tej, duke analizuar bazuar në *modus operandi* të njëjtë, përbëjnë një pjesë të inteligjencës kriminalistike. Por, të gjitha sa më lart, mbeten në nivelin e të dhënave e fakteve, ato nuk i nënshtrohen një procesi përpunimi e analizimi të mëtejshëm, ose kjo realizohet vetëm për disa ngjarje të veçanta e në mënyrë sporadike. Gjithashtu duhet të pranojmë se ky proces ka qenë i kushtëzuar edhe nga faktorë objektivë, pasi shtysa ka ardhur jo vetëm si pasojë e dëshirës apo vullnetit profesional, por edhe duke ditur e shfrytëzuar aftësitë teknike dhe produktet që ofrojnë sistemet automatike AFIS, ARSENAL, etj. Elementët e mësipërm, janë përdorur edhe përpara viteve ‘90, por për ngjarje të caktuara e të kushtëzuara në mënyrë të konsiderueshme nga kartotekat manuale e të shpërndara në policitë vendore.

Pas viteve ‘90, sidomos në vitet 2000, me implementimin e sistemeve automatike, procese të tilla si bashkim i plotë i ngjarjeve në bazë të gjurmëve të duarve, të zbuluara e fiksuar në vendet e ngjarjeve, deri diku ai i bazuar në gjurmët balistike e traseologjike, janë kthyer në rutinë të punës së policisë shkencore shqiptare<sup>17</sup>.

Po ashtu, me futjen në përdorim të proceseve, metodave e pajisjeve moderne elektronike si *masspectrometria* e analizimit të drogave e eksplozivëve, ekzaminimi elektronik i mbetjeve të faktorëve plotësues të qitjes, ekzaminimi me anë të ADN-së, etj, krijon një bazë të mirëfilltë për shtrirjen e analizimit të përfundimeve edhe në këto fusha. E përgjithësuar, domosdoshmëria e informatizimit të strukturave përkatëse është evidentuar nga policia shqiptare<sup>18</sup>: *Orientimi i këtyre strukturave drejt inteligjencës, nuk mund të kuptohet pa informatizimin e informacionit dhe krijimin e sistemeve të caktuara të përpunimit të tij.*

Sistemi ADAM<sup>19</sup> plotëson akoma më tej këta elementë, po ashtu edhe sistemi MEMEX. Problemi është se këto të dhëna mbeten të veçuara nga njëra-tjetra, sistemet të ndarë nga njëri-tjetri. Në kushtet e sotme, ata nuk integrohen dhe nuk bashkëveprojnë si e sa duhet ndërmjet tyre. Projekti “RELIEF” (qershor 2012) është një shembull mjaft tregues për sa i përket inteligjencës kriminalistike.

<sup>16</sup> Mennell dhe Shaw, *op. cit.*, f. 157.

<sup>17</sup> Policia e Shtetit, *Analizat vjetore të Policisë Shkencore*.

<sup>18</sup> Policia e Shtetit, *Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013*, f. 18.

<sup>19</sup> Policia e Shtetit, *Sistemi elektronik i të dhënave mbi personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga Policia e Shtetit*.

I financuar nga qeveria zvicerane dhe i marrë për zbatim nga policia çeke, ky projekt konsiston në identifikimin e mjeteve presuese të pakove me lëndë narkotike që kapen e sekuestrohen nga policia (për të gjitha llojet e drogave), me anë të analizës mekanoskopike të ambalazhit. Ky projekt, ka implementuar metodën e studimit dhe analizimit të gjurmëve traseologjike të formuara nga mjetet presuese (matricat e stampave të presimit) në pakot e ngarkesave të ndryshme të drogës të kapura në kohë e vende të ndryshme të Europës, kjo gjë, edhe përmes krijimit të një baze elektronike të dhënash, e cila mund të përfshihet në ato ekzistuese, që janë Sistemi European i Profilimit të Drogave (EDPS) dhe Baza e të Dhënave të Drogave Sintetike të Europolit (ESDDS).

Projekti përfundoi në dhjetor 2016, ai u shtri në policitë e të gjitha vendeve europiane dhe prej 4 vjetësh po zbatohet edhe në policinë shkencore shqiptare. Duke zbuluar e fotografuar (foto kriminalistike) mikrogjurmët mekanike në relievin e ambalazhit të pakove me lëndë narkotike të kapura, duke i grumbulluar bashkë me të dhënat analitike në qendrën e analizimit që ndodhet pranë policisë çeke, asistuar dhe nga sistemi automatik elektronik i ndërtuar për këtë qëllim, ky projekt ka dhënë frytet e veta duke bashkuar në një origjinë të vetme ngarkesa të kapura në vende e data të ndryshme në Europë, duke përcaktuar një itinerar që kanë ndjekur ngarkesat, etj.

Me anë të së dhënave të ofruara nga policia shkencore shqiptare, me anë të këtij projekti, deri më sot janë identifikuar dy raste të ngarkesave të kapura në dy vende të ndryshme të Europës. Kjo është një përvojë mjaft e vyer, e cila duhet të shtrihet dhe në fusha të tjera të ekzaminimeve kriminalistike. Konceptimi, organizimi, shtrirja dhe vënia në zbatim e tij është një model i cili duhet ndjekur për implementimin e projekteve të tilla edhe në drejtim të drogave të lehta e të forta, të trafiqeve të tjera të jashtëligjshme, etj.

## 5. Përfundime

Inteligjenca kriminalistike bën të mundur përdorimin dhe referimin e të dhënave apo konkluzioneve kriminalistike, duke i trajtuar si një të vetme me vendin e ngjarjes, provat, të dyshuarit, etj, si dhe të gjithë të dhënat e tjera. Ajo kontribuon në sigurinë publike duke ofruar informacion të bollshëm, të përpunuar, sasior e sidomos cilësor, duke e kthyer atë në produkt të vlefshëm e të gatshëm për përdorim konkret. Si e tillë, ajo luan rol të rëndësishëm si në nivel strategjik ashtu dhe në nivel operacional. Në këtë kuadër, policia shkencore shqiptare duhet të ndjekë zhvillimin e modernizimin e policisë, në mënyrë që t'i përgjigjet në lartësinë e duhur kërkesave që shtrohen para saj, në luftën kundër kriminalitetit, i cili sa vjen e përsos metodat e organizimin e tij. Në mënyrë që inteligjenca kriminalistike, të jetë sa më efikase, policia shkencore shqiptare duhet të mbështetet e të zhvillojë faktorët si më poshtë:

- *Standardizimi.* Është një nga bazat kryesore fillestare të zhvillimit të inteligjencës kriminalistike. Ai duhet të shtrihet brenda vetë policisë shkencore, po ashtu dhe në sinkron me praktikën ndërkombëtare kriminalistike. Ky standardizim, duhet të përfshijë nga elementët më të thjeshtë, që janë emërtimet dhe mënyra e shprehjes në aktet procedurale dhe konkluzionet kriminalistike, e deri në gamën e ekzaminimeve, metodologjitë e përdoruara, pajisjet, kodet dhe referencat.

Gjithashtu, standardizimi duhet të shtrihet edhe në sistemet elektronike të ruajtjes e përpunimit të së dhënave kriminalistike që ka sot policia shkencore shqiptare e, këto sisteme, duhet të jenë në marrëdhënie interaktive me sistemet e tjera elektronike, që ka në përdorim kjo polici.

-*Akreditimi*. Është një kusht i domosdoshëm, i cili, krahas avantazheve të tjerë, paraprin zhvillimin e një inteligjence kriminalistike efikase. Brenda fokusit të policisë shkencore, akreditimi nënkupton, që personeli është i aftë e i përgatitur, që metodat e përdorura janë të sigurta e të sakta, që pajisjet janë të nivelit të duhur, etj. dhe, jashtë këtij fokusi, rrjedhimisht konkluzionet janë e konsiderohen të sakta e të besueshme.

Po ashtu, e lidhur dhe me standardizimin, duhet të mundësohet nga ana ligjore e teknike dhe shkëmbimi automatik i të dhënave ndërmjet sistemeve të policisë së shtetit, me sistemet që përdorin policitë e vendeve të rajonit e më gjerë.

- *Përfshirja* e inteligjencës kriminalistike në prioritetet dhe në *Strategjinë e Policisë*, është një hap i rëndësishëm që e ngre në një nivel të lartë rëndësinë e saj. Në këtë mënyrë, inteligjenca kriminalistike i ofrohet dhe një qasjeje më të kompletuar, për sa i përket kulturës së kuptimit dhe trajtimit të saj, e nga ana tjetër dhe marrja e masave dhe krijimi i kushteve për zhvillimin dhe integrimin e plotë të saj në veprimtarinë e Policisë së Shtetit.

- *Bashkëpunimi* me agjenci të njëjta të vendeve të tjera, është një faktor vendimtar në zhvillimin e inteligjencës kriminalistike. Policia shqiptare “nuk ka kohë” të eksperimentojë e të zbulojë. Përvoja e sotme ndërkombëtare është mjaft e pasur; ajo duhet marrë, studiuar e të përshtatet me kushtet e nevojat e policisë shqiptare.

Nga ana tjetër, vetë natyra e inteligjencës kriminalistike, kushtëzon një bashkëpunim të ngushtë ndërkombëtar me agjencitë e njëjta të policive të vendeve të tjera, kjo sidomos në shkëmbimin e të dhënave e informacioneve kriminalistike për shtetas shqiptarë, që e shtrijnë aktivitetin e tyre kriminal edhe jashtë kufijve të vendit tonë, ashtu si dhe për ngjarje e veprimtari kriminale që prekin direkt apo indirekt dhe vendin tonë.

## Bibliografi

1. *Kodi Procedurës Penale të Shqipërisë*, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
3. “Rregullore e Policisë Shtetit”, miratuar me VKM nr. 750, dt. 16.09.2015, i ndryshuar.
4. Dearing, P. (Kolegji Policimit në Mbretërinë e Bashkuar) dhe Grace, J., (Agjencia Kundër Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar, “SOCA”, në Mbretërinë e Bashkuar), *Raporti strategjik për policinë shkencore shqiptare*, Tiranë 2012.
5. Houck, M. M., *Forensic sciences; Modern methods of solving crime*, Westport, Conn. : Praeger Publishers, 2007.
6. Legrand T. & Vogel L., “Forensic Intelligence”, në: *CEPS Centre of Excellence in Policing and Security*, issue 9, January, Australia, 2012.
7. Mennell, J., & Shaw, I., “The Future of Forensic and Crime Scene Science. Part I. A UK forensic science user and provider perspektive”, *Forensic Science International*, 2006 Mar 14; 157 Suppl 1:S7-12. Epub 2006 Jan 23.
8. Colin, E., “*Crime Scene investigation*”, ISBN-13: 978-0-7910-9405-1, New York, USA, 2009, f.15.
9. Ribaux, O., et al., “Forensic intelligence and crime analysis”, *Law, Probability and Risk (2003) 2*, 47–60.
10. *Strategjia e Hetimit Shkencor*, Australia Perëndimore, 2009-2010.
11. Standardet ISO 9001, ISO 17020 dhe ISO 17025 (“ISO” - Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin).
12. Policia e Shtetit, *Strategjia e Policisë së Shtetit dhe Plani i Veprimit për zbatim për periudhat 2007-2013 dhe 2014-2020*.
13. Policia e Shtetit, *Analizat vjetore të Policisë Shkencore 1995-2013*.
14. Policia e Shtetit, *Analizat vjetore të Policisë së Shtetit 1995-2016*.
15. “Rekomandimi 96-8”, *Për politikën kriminale në Europë*, 1996.
16. Akademia e Sigurisë, *Cikël leksionesh: Informacioni & Analiza*, Departamenti Hetimit të Krimit, 2017.
17. Muçaj, A., *Intelligence + Analyse Team*, Akademia e Sigurisë, 2017.
18. PAMECA, *Kursi për drejtuesit e lartë*, Tiranë, 2009.
19. Mborja, A., “Formimi eksperteve kriminalistë përballë sfidave të kohës”, në: *Konferenca e I-rë Shkencore Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit*, Tiranë: Akademia e Sigurisë, 2016.
20. Policia e Shtetit, *Sistemi elektronik i të dhënave mbi personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga Policia e Shtetit*.

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

# Auditimi i jakave të bardha, një mundësi më shumë për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin

**Dr. Xhevdet KOPANI**

Drejtor i Përgjithshëm i Shoqërisë së Sigurimeve, Eurosig

xhkopani@eurosig.al

## Abstrakt

Zhvillimi i ekonomisë së tregut dhe kapitalit është shoqëruar edhe me zhvillimin e figurave të ndryshme të krimit dhe të korrupsionit. Etja për më shumë kapitale, më shumë fitime të pamerituara, investime të paargumentuara dhe transaksione financiare të dyshimta janë sinonime të këtyre zhvillimeve të sotme. Këto tendenca në ritje, korruptive, kanë si autorë, biznesmenë, por dhe specialistë të kontabilitetit, financës, auditues, ekspertë dhe profesionistë të tjerë, të profesioneve të rregulluara, të cilët mashtrimin financiar e përdorin për të siguruar përfitime të padrejta. Auditimi i mënyrës së jetesës së profesionistëve të mësipërm, konsiderohet një mjet i fuqishëm për zbulimin e të ardhurave të paligjshme, duke ekspozuar para drejtësisë raste të mashtrimit dhe të korrupsionit. Krimi i jakave të bardha është një krim financiar ku shkak kryesor është lakmia për përfitime financiare. Ky është një komponent i krimit tregtar, i cili përcaktohet si të gjitha krimet që ndodhin brenda tregut në tërësi. Krimet e jakave të bardha, nënkuptojnë krimet e kryera nga individët, korporatat, organizatat, si krime të avancuara dhe krime që kanë nevojë për planifikim, aftësi, maskim e mashtrim. Shembuj të këtyre krimeve janë: evazioni fiskal i të ardhurave, mashtrimi, vjedhja e punonjësve, mosdeklarimi i të ardhurave të punonjësve, krimet financiare kompjuterike, bilancet e dyfishta, mashtrimi me reklamën, krime që lidhen me abuzimet e konfidencialitetit, mashtrimet në investime, apo në aksione, mashtrimet me karta krediti, çeqe, komisione, falsifikim i dokumenteve, mashtrim me gjendjen e falimentimit të kompanive etj. Krimi i jakave të bardha realizohet nga individë që përpunojnë duke manipuluar llogaritë kontabël dhe financiare, në këmbim të rryshfetit në vendin e tyre të punës, pranë biznesit. Qëllimi i përbashkët i figurave të mësipërme të krimit janë mashtrimi dhe përvetësimi. Auditimi i jetesës është një barometër i përcaktimit të shkallës së rrezikut të mashtrimit, brenda një organizate, gjë që obligon kompanitë të organizojnë sisteme të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit proaktiv, antimashtrim për të mbrojtur veten, para se të jenë viktima të skemave të mashtrimit në kompanitë e tyre. I rëndësishëm është, studimi i standardeve të jetesës, së një specialisti të llogarive dhe jo vetëm për të parë, nëse ajo është në përputhje me të ardhurat e raportuara. Auditimi i pasqyrave financiare dhe transaksione bankare mbetet prioritar. Auditimet e mësipërme duhet të jenë pjesë e procedurave të punës të strukturave policore të hetimit të krimit.

## Fjalëkyçe:

**mashttrim, jakat e bardha, auditim i jetës, korrupsion.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Vështrimi përgjithshëm për korrupsionin dhe krimin ekonomik-financiar

Fjala korrupsion rrjedh nga fjala latine “corruptus” që do të thotë “të thyesh”, “të shkatërrosh”. Nuk ka një përkufizim të vetëm dhe të pranuar ndërkombëtarisht, por rrjedh nga kuptimi i shprehjes “shpërdorim detyre për të cilën shpërblehesh, për qëllime personale”; ky është një nocion i dhënë nga “Transparency internacional”. Fenomenet e korrupsionit, natyrisht që janë pjesë e sistemit njerëzor me zanafillë të hershme sa vetë historia e klasave dhe ku preh e tij, janë individë, sisteme private apo shtetërore, qeveri etj. Natyra njerëzore duke qenë oportuniste, e përdori pushtetin e besuar, duke mos e ushtruar në interes të qytetarëve, por për përfitime personale.

Fenomeni i korrupsionit, njihet që nga filozofët grekë, Sokrati, Platoni, Polibi dhe Aristoteli. Arkivat e hershme, deri dhe 1400 vjet para Krishtit, evidentonin faktin që kishte nëpunës që merrni ryshfet, ndërkohë që përmenden si të implikuar dhe zyrtarë të lartë dhe pjesëtar të farefisit të tyre. Referenca të korrupsionit gjenden dhe në libra të Dhjatës së Vjetër.

Korrupsion është një gangrenë e çdo shoqërie njerëzore, prandaj duhet trajtuar si një e keqe e madhe, që duhet luftuar me zhvillimin e sistemeve të brendshme dhe jo me luftë politike dhe mediatike. Korrupsioni, krimi ekonomike, mashtrimi etj., nuk ka ngjyrë, ai mbetet një fenomen i rrezikshëm, pavarësisht se kush qeveris, të majtë, të djathtë, republikanë, monarkistë etj. Gjuha e politikanëve dhe kronikat e lajmeve të medieve të shkruara dhe vizive, të mbushura me lajme për korrupsionin, e ka bërë më pak të dukshëm fenomenin; bashkuar kësaj, edhe mungesa e një hetimi profesional dhe të gjithanshëm, në shumë raste ka sjelle rezultate jo të duhura në këtë betejë.

Korrupsioni ka si partner mashtrimin, i cili, sipas Institutit Amerikan të Auditorëve

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

të Certifikuar<sup>1</sup>, është një koncept i gjerë ligjor dhe i lidhur ngushtë me krimin financiar. Korrupsioni kërkon dy palë që të realizohet, pra kërkon ofruesin dhe përfituesin e përfitimit të paligjshëm, ku që të dy janë të optimizuar nga veprimi korruptiv i realizuar. Në rastin e mashtrimit, njëra nga palët është viktima e mashtrimit. Mashtrimi nuk është gabim njerëzor, apo neglizhencë, por është një përpjekje e qëllimshme për të fshehur dhe deformuar të vërtetën. Mashtrimi shkel marrëdhëniet e besimit, të domosdoshme këto, për ushtrimin korrekt të funksioneve publike, private, profesionale, të biznesit etj., të cilat kanë në themel besimin, kontratën dhe ligjin. Është pikërisht shkelja e tyre, kur dikush përpiket të mashtrtojë një person fizik, juridik ose një institucion shtetëror. Mashtrimi i ndodhur në fushën financiare ka të bëjë me atë që duhet siguruar, përfitime dhe privilegje financiare që natyrisht sjellin humbje, pakësim të aseteve financiare dhe jo vetëm.

Mashtrimi në përgjithësi kryhet nga persona profesionistë, të cilët janë të punësuar nga viktima, ose mashtrojnë shtetin në bashkëpunim me eprorët, ose pronarët e organizatave të biznesit. Korrupsioni dhe mashtrimi janë të lidhur ngushtësisht me njëri-tjetrin - dhe jo vetëm këto të dyja figura të krimit financiar. Natyrisht, përcaktimet në Kodin Penal dhe Kodin Civil, trajtojnë rastet e këtyre figurave të krimit ekonomik, njohja e të cilave nga punonjësit e strukturave ligjzbatuese është domosdoshmëri, aq sa është e domosdoshme dhe njohja e thellë dhe e gjithanshme e këtyre fenomeneve të krimit.

Organizmat ndërkombëtare i kanë trajtuar gjerësisht fenomenet dhe format e krimit ekonomik, përfshirë edhe pastrimin e parave. Janë krijuar dhe trajtohen mjaftë instrumente ndërkombëtare në këtë fushë, si; Konventa e OECD-së, Konventa penale<sup>2</sup> dhe civile<sup>3</sup> kundër korrupsionit e KE-së, Konventa kundër korrupsionit e OKB-së, etj. Pastrimi i parave, është suport i çdo veprimtarie të paligjshme, kurrptive dhe kriminale. Zyrtarët dhe zyrat e korruptuara kanë nevojë për akses në sistemin financiar, në mënyrë që të përthithin përfitime të paligjshme të korrupsionit, blerjes së aseteve, si dhe të mbështesin financiarisht stilin e shfrenuar të jetesës së tyre dhe së të afërmeve të tyre.

Pastrimi i parave në këtë mënyrë, përpiket të kthejë të paligjshmen në të ligjshme, të pastrojë transaksionet dhe përpiket t'i bëjë të pakapshme prejardhjen e mjeteve financiare, aseteve etj. Transaksionet që realizon biznesi, dhe jo vetëm, synohet të kthehen në të rregullta, ku paratë e përfituara në rrugë kriminale, kërkohet të jenë jo vetëm në dukje, por edhe në përmbajtje, të lara dhe të justifikuara. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, e dhjetorit 2005, krijoi si vepër penale të veçantë, fshehjen dhe pastrimin e produkteve si akte korruptive, si dhe parashikon ekzistencën e një sërë masash në këtë fushë. Direktiva e III-të e BE-së "Mbi parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2005/60/EC", në paragrafin 24, kërkon zbatimin sa më rigoroz të procedurave të verifikimit të marrëdhënieve të biznesit me individë që mbajnë ose kanë mbajtur poste publike. Kjo direktivë kërkon një trajtim serioz edhe të figurave të tjera, të kryera nga subjekte të së drejtës penale e civile. Si rezultat i ndryshimeve të Traktatit të Lisbonës, krimet financiare tashmë përbëjnë një pjesë specifike të krimit në tërësi.

<sup>1</sup>AICPA, Instituti Amerikan i Auditorëve të Certifikuar Publik.

<sup>2</sup> Konventa Penale për Korrupsionin (ETS Nr. 173) dhe Protokollin e saj Shtesë (ETS Nr. 191). Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 8778, datë 26. 4. 2001.

<sup>3</sup> Konventa Civile për Korrupsionin (ETS Nr. 174). Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 8635, datë 6. 7. 2000.



Parandalimi i keqpërdorimit të sistemit financiar nga specialistët dhe punonjësit e korrumpuar, varet në një masë të madhe nga puna dhe efektiviteti i institucioneve përgjegjëse për transparencën, në tregun dhe sistemin financiar dhe, aftësisë profesionale të punonjësve të këtyre institucioneve e në përgjithësi të së gjitha institucioneve monitoruese, kontrolluese dhe audituese. Bashkërendimi mes këtyre institucioneve mbikëqyrëse të sistemit financiar, me institucionet ligjzbatuese të Policisë së Shtetit, SHISH, Prokurorisë etj., mbetën sfida të së sotmes dhe të së ardhmes. Kjo, mbi të gjitha, kërkon një frymë jo vetëm bashkëpunuese, por edhe infrastrukturë ligjore dhe thellim të reformës në këto institucione.

Rregullimi i duhur ligjor i profesioneve të kontabilistit, ekspertëve financiar, auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm, marrin rëndësi të veçantë pasi janë këto hallka që implementojnë, monitorojnë, raportojnë dhe kontrollojnë procedurat dhe transaksionet kontabël, ku dhe rreziku i mashtrimit dhe i ekzistencës së krimit të jakave të bardha është përherë prezent.

Në hetimin e krimit ekonomiko-financiar, në reflektim të nenit 135, pika 2 të Kushtetutës të ndryshuar të Republikës së Shqipërisë, merr rëndësi krimi i kryer nga shtresat e privileguara social ekonomike, ose “krimi i jakave të bardha” (Brightman 2009), i cili nuk është i dhunshëm, por paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore.

Punonjësi e kryen krimin në një ambient profesional, veprimet e tij, në thelb kriminale, fshihen e maskohen si punë organizative të një organizate që i bindet ligjit. Shkelësi i ligjit ka pushtet dhe influencë (Kempa, 2010)<sup>4</sup> dhe gëzon besimin e të tjerëve ne rrethin e të privilegjuarve.

Krimi i jakave të bardha kryhet nga ajo kategori sociale, e cila nuk ka pasur më parë kontakte me punonjësit e organeve ligjzbatuese, nga individë të pasur, të arsimuar, të ngritur profesionalisht dhe me një përkrahje shoqërore. Nga këto arsye buron dhe numri i vogël i zbulimeve dhe dënimeve të autorëve. Përveç Kodit Penal, janë hartuar dhe zbatohen një numër i madh ligjesh të tjera që rregullojnë këto marrëdhënie, si ato për rregullimet e profesioneve të lira dhe në veçanti kontabilistit, ekspertit, audituesit, KLSH, por dhe ato të Bankës Qendrore, Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare etj., njohja dhe zbatimi i të cilave është thelbësor për arritjen e suksesit në betejën me krimin ekonomiko-financiar.

Evazioni fiskal, mjedisi ku operojnë bizneset, legjislacioni fiskal dhe ndryshimet e tij të herëpashershme, janë një shtrat i mirë për lulëzimin e mashtrimit në raportimin e të ardhurave, raportimin e pasqyrave financiare, raportimin e listëpagesave etj.

Menaxhimi financiar, politikat fiskale, likuiditeti i qeverisë janë të lidhura me krimin ekonomiko-financiar. Aftësia profesionale e specialistëve të kontrollit, inspektimit, auditimit, punonjësve të organeve ligjzbatuese merr një rëndësi të madhe, aq më tepër kur krimi perfeksionohet, mashtrimi bëhet më i pazbulueshëm, aq më tepër, kur ka bashkëpunim mes specialistëve të krimit të jakave të bardha, pronarëve, menaxherëve, por akoma më i frikshëm, bëhet kur gjejnë mbështetje dhe tek punonjësit e strukturave të policisë dhe prokurorisë.

Ekspertët kontabilist investigues, audituesit, janë specialistë që ndër të tjera merren edhe me zbulimin e mashtrimeve dhe mund të jenë, pjesë e procedurave të zbulimit dhe procedimit të një vepre kriminale, në fushën ekonomiko-financiare. Natyrisht

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
Shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>4</sup> Michael Kempa, (2010) "Combating white-collar crime in Canada: serving victim needs and market integrity", *Journal of Financial Crime*, Vol. 17 Issue: 2, f. 251-264

ekspertët kontabilistë në një procedim kriminal, nuk janë thjeshtë dëshmitar të faktit, siç mund të jenë audituesit, por ata ndërtojnë regjistrat kontabël, bëjnë vlerësime të mashtrimit, aseteve që mungojnë, ose që janë shkatërruar nga mashtrimi financiar. Auditimi i jetës ka të bëjë me hetimet e krimit të organizuar të ashtuquajtura “Krimi i kollareve (jakave) të bardha” i cili është një krim financiar ku përfshihen burimet me status profesional, ose që rrjedhin nga ekspertiza e specialistëve të ndryshëm, pra një krim nga zyrat e specialistëve kryesisht të financës, por jo vetëm.

Pyetjet që shtrohen janë:

1. Si lidhen auditimet e jetës me hetimet e krimit të organizuar?
2. Cilat janë praktikatat më të mira që ekzistojnë në auditimin e jetës, për të dyshuarit për krime të bardha?
3. Çfarë burimesh të ndryshme informacioni mund të konsultojnë hetuesit në praktikën e hetimit të sektorit privat dhe jo vetëm, kur kryejnë një auditim të jetës për një të dyshuar për krime të jakave të bardha?

Siç parashtruam më sipër, mashtrimi përfshin keqinterpretimin, humbjen e pronës, ose të të drejtave mbi pronën. Ai mund të përkufizohet si krijim i paligjshëm dhe i qëllimshëm, i një paraqitje të gabuar që shkakton paragjykime reale ose të mundshme, marrjen e një diçkaje në vlerë, apo shmangien e një detyrimi nëpërmjet mashtrimit. Specialistët e hetimit të krimit është e domosdoshme që ta kuptojnë atë. Kjo kërkon që të njihet koncepti i krimit të jakave të bardha. Shembuj të krimit financiar të jakave të bardha, dhe jo vetëm, janë të shumtë, por ne mund të përmendim disa si: evazioni fiskal i të ardhurave, mashtrimi, vjedhja e punonjësve, krimi kompjuterik, mashtrimi në reklama, krimet që lidhen me abuzimet e konfidencialitetit, mashtrimet në investime, apo aksione, mashtrimet në kartat e kreditit e çeçe, korrupsioni, falsifikimi, mitmarrja, pasqyrat e dyfishta financiare, listëpagesat etj.

## 2. Qasje teorike në lidhje me auditimin e krimit të jakave të bardha

Krimi i jakave të bardha si krim financiar, është rendja pas përfitimeve financiare të paligjshme. Ai është një komponent i krimit tregtar i cili përcaktohet si të gjitha krimet që ndodhin brenda sferës tregtare. Nisur nga kjo krimi i jakave të bardha është një koncept që nënkupton krimet si ato të kryera nga individë, korporata, organizata, si krime të avancuara që kanë nevojë për planifikim, aftësi dhe kompetencë profesionale, si dhe përdorim i të gjitha teknikave moderne të hetimit të krimit. Brenda fushës së kriminologjisë, krimi i jakave të bardha është përcaktuar nga Sutherlan, në vitin 1949<sup>5</sup> si një krim i kryer nga një person i respektuar dhe i statusit të lartë në biznesin e punës së tij. Në zbulimin dhe hetimin e këtyre krimeve, marrin rëndësi investigimi i krimeve, intelijenca e hetimit gjatë hetimit ligjor policor.

Investigimi i krimit është hetimi i krimit i drejtuar në mbledhjen e fakteve dhe informacioneve ku një krim mund të rindërtohet, ndërsa hetimi ligjor, ka të bëjë me hetimin policor në mbledhjen e fakteve për të ndihmuar në zbulimin e krimeve ose parregullsitë e tjera. Suksesi i hetimit varet në masë të madhe nga intelijenca e krimit, e cila përcaktohet si inteligjencë e përdorur, për parandalimin e krimit ose për të kryer hetime e përgatitur dëshmi, për qëllime të zbatimit të ligjit e, ndjekjen penale të shkelësve

<sup>5</sup> Edwin H. Sutherland, *White Collar Crime*, New York: The Dryden Press, 1949, f. 272.

ligjor. Bashkimi i raporteve nga një sërë bazash së të dhënave, që sigurojnë menaxhimin si dhe hetuesit me një pamje të qartë në disa aspekte të jetës së një punonjësi, përbëjnë mekanizëm legjitim për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit.

Krimi i jakave të bardha, kryhet nga individë që përvetësojnë, manipulojnë llogaritë dhe marrin ryshfete në vendin e tyre të biznesit. Megjithatë, hulumtimet në këtë fushë i shërbejnë shumë qëllimeve të eksplorimit, përshkrimit, shpjegimit dhe aplikimit, duke pasur jo vetëm një, por disa nga këto qëllime. Duhet të ketë një arsye për të bërë hulumtime, ose ndryshe nuk do të kishte asnjë vlerë, në raport me shpenzimin e kohës dhe të parave. Pyetjet e hulumtimit ofrojnë udhëzime për llojin e të dhënave, që hulumtuesi do të mbledhë dhe ofrojë, analizat dhe sugjerimet që do të realizojë. Hetimet e krimit të jakave të bardha, drejtohen në mbledhjen e fakteve dhe informacioneve, përmes të cilave një krim mund të rindërtohet. Efekti vjen më pas nëpërmjet vëzhgimit dhe hetimit, nga informacioni i grumbulluar, nga hetimi i akuzave, rrethanave dhe shkaqeve. Hetimi i krimit përfshin gjetjen, mbledhjen dhe përdorimin e informacionit për të dënuar abuzuesit e ligjit. Hetimet e krimeve të jakave të bardha kanë dallime të dukshme, megjithëse ekzistojnë sinerji midis tre profesioneve të ndryshme si: kontabilisti, audituesi ligjor dhe hetuesi ligjor. Audituesit ligjorë janë ekspertë profesional të kontabilitetit dhe tentojnë të hetojnë procedurat kontabël, të realizuara nga kontablistët dhe jo vetëm. Ndërsa hetuesit ligjorë, janë punonjësit e hetimit të krimit, që kanë edhe ekspertizë financiare, por edhe ligjore të transaksioneve financiare dhe ligjore.

### **2.1 Qëllimet e hetimit ligjor, janë:**

- të përcaktojë nëse është kryer krimi ekonomik-financiar,
- të marrë informacion ligjor dhe prova për të identifikuar personin përgjegjës,
- të dërgojë para ligjit dhe drejtësisë të dyshuarin përkatës,
- të evidentohen asetet e përvetësuara.

Një metodë efikase në këtë proces, është ndjekja e gjurmës së parasë, e cila do të sigurojë fakte dhe rrethana sensitive për hetimin ligjor.

Metoda të tjera, janë procedura analitike si: auditimi ligjor, testimi, vëzhgimi dhe inspektimi, bërja e pyetjeve dhe kryerja e intervistave. Vëzhgimi i stilit të jetesës shpeshherë është edhe çelësi i suksesit, duke përbërë një mjet kritik të menaxhimit të saj.

### **2.2 Praktikata më të mira në auditimin e jetës së jakave të bardha**

Që auditimi i jakave të bardha të funksionojë, është e domosdoshme që hetuesit dhe specialistët që merren me gjurmimin dhe hetimin policor, të kenë në konsideratë këta elementë:

- *Qëllimi i auditimit të jetës.* Qëllimi kryesor i auditimit të jetesës, është që të grumbullojë të gjithë informacionin e plotë dhe të saktë, për mashtrimet dhe abuzimet antiligjore, që kanë sjellë përfitime të paligjshme nga punonjësit e strukturave financiare të bizneseve private dhe organizatave publike.

- *Vlerat e auditimit të jetës.* Të grumbullojë informacion dhe të dhëna, nëpërmjet gjurmimit policor, për nivelin e jetesës së punonjësve në raport me të ardhurat e tyre, për aktivitetin e biznesit dhe tu japin organeve ligjzbatuese gjithë informacionin e nevojshëm për një ndjekje policore të çështjes.

- *Përparësitë e kryerjes së auditimit të jetesës.* Kryerja e një auditimi të jetesës ka një përparësi të konsiderueshme, pasi siguron informacionin e nevojshëm për mashtrimin

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

që po ndodh, duke përbërë një bazë të shëndoshtë për hetime dhe veprime të mëtejshme ligjore.

- *Rëndësia e kryerjes së auditimit të jetesës* në të gjithë të dyshuarit për krime të jakave të bardha, është vendimtar për suksesin e hetimeve ligjore.

Njohja me praktikat më të mira që aplikohen në hetimin ligjor të mësipërm, është një bazë e mirë për suksesin e tyre. Disa nga këto praktika janë:

- Punonjësit që merren me hetimin e jakave të bardha duhet të trajnohen në mënyrë të vazhdueshme.

- Auditimi i jakave të bardha duhet të fillojë në fillim të procesit të hetimit, ose sa më shpejtë që të jetë i njohur identiteti i të dyshuarit; kjo do të përbente drejtimin e duhur të hetimit duke kursyer kohe, burime njerëzore dhe duke mos u dhënë mundësi të fshehjes së krimeve dhe mashtrimeve të kryera.

- Duhet të njihet subjekti që është përzgjedhur për hetim.

- Duhet zbatuar një metodologji sa më e saktë, e kryer edhe në auditime të tjera të krimeve të jakave të bardha.

- Duhet dokumentuar metodologjia, procedura dhe proceset e auditimit të jetesës.

- Duhet përcaktuar elementët kryesor të auditimit të jetesës.

- Përcaktohet afati kohor i auditimit të jetesës, por duke mos e ngushtuar në funksion e suksesit të hetimit.

- Të vlerësohet drejtë, kur i dyshuari kryesor ka tejkaluar mundësitë e tij financiare si rezultat i të ardhurave të deklaruara me jetesën që ai realizon.

- Ruajtja e bazës së të dhënave, në mënyrën më të mirë të mundshme që rezultojnë nga auditimi.

- Ruajtja e zinxhirit të provave, në lidhje me informacionin që ato marrin gjatë kohës së kryerjes së auditimit të jetesës.

- Konsiderimin e qasjes të kërkuar, nga i dyshuari për të bashkëpunuar me auditimin e jetesës.

- Gjatë intervistës së të dyshuarit duhet të mbështetemi në dokumente burimore, e të mos kalojmë në përfundime të parakohshme; të shfrytëzojmë bisedat telefonike, emailt etj.

- Të përdorim një qasje metodike në zbatimin e procesit të auditimit të jetesës.

- Ky proces duhet trajtuar si një procesi i vazhdueshëm.

- Duhet të llogaritet dhe raporti kosto/përfitim gjatë hetimit të çështjeve të tilla.

- Ruajtja e bazës së të dhënave, zinxhirit të provave, janë elementë të rëndësishëm të praktikave më të mira në realizimin me sukses të këtij procesi.

- Hetuesit dhe audituesit ligjorë duhet të kenë në konsideratë, gjatë hetimit ligjor që: provat duhet të sigurohen në rrugë ligjore, integriteti i të dhënave është shumë i rëndësishëm, ashtu sikundër, ruajtja e privatësisë, përdorimi i kontrolluar i informacionit, verifikimi në disa burime i informacionit etj., duke u siguruar për saktësinë dhe paanësinë e tij.

Përzgjedhja e burimit të informacionit përbën një mundësi jo vetëm ligjore, por dhe të domosdoshme gjatë hetimit dhe auditimit ligjor.

Hetuesit dhe audituesit ligjorë, duhet të sigurohen që të kenë një informacion të detajuar për burimet dhe mjetet në dispozicion të tyre gjatë kryerjes së auditimit ligjor të jetesës. Konkretisht kjo kërkon:

- Duhet të qasen ligjërisht burimeve të informacionit.

- Të njihen me të dhënat nga interneti, mjetet e informimit publik gjatë kryerjes së auditimit të jetesës.

- Të sigurojnë informacion ligjor për të dhënat financiare dhe jo vetëm.

- Të konsiderojnë opsione të ndryshme të së dhënave në dispozicion.

- Të sigurojnë vlerën maksimale nga procesi i auditimit të jetesës.

- Të marrin informacion nga bankat, shoqëritë e kreditit, investimeve, zyrat shtetërore, fondet e investimeve etj.

Është e rëndësishme të fokusohemi tek përparimi teknologjik në procesin e auditimit të jetesës dhe sinergjitë midis auditimit të jetesës dhe mjeteve të tjera të zbulimit të mashtrimit.

### **3. Nevoja për qasje të reja në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomiko-financiar në Shqipëri**

Reforma në Drejtësi, tashmë e konfiguruar dhe në zbatim e sipër përfaqëson një ogur të mirë, që korrupsioni nuk do të luftohet vetëm në nivelet e larta, por do të thellohet lufta edhe në bazën e tij. Edhe në Europë, veçanërisht në lindje, matja me rezultate konkrete në luftën ndaj korrupsionit, kthimi i besimit të qytetarëve tek institucionet publike, duke treguar seriozitet në luftën ndaj krimit ekonomiko-financiar dhe dëshmuar profesionalizëm dhe paanësi nga organet e drejtësisë, janë sfida të 10-15 vjeçarit të fundit. Në nenin 20, të Konventës Kundër Korrupsionit, të OKB-së (2003)<sup>6</sup>, “pasurimi i paligjshëm” përmendet si një faktor pengues në zhvillimin e ekonomisë së një vendi. Shpjegimi qëndron në konstatimin e pasurimit të zyrtarit, punonjësit të krimit të jakave të bardha, pa gjetur një shpjegim të arsyeshëm në të ardhurat e tij legjitime. Zotëruesi i kësaj pasurie mund të japë argumente, por jo shpjegime thelbësore ligjore për mënyrën e krijimit të ardhurave. Ky është një veprim i kryer me dashje, ose një shmangie nga parimi i barrës së provës në procedimin penal, apo nga e drejta për të heshtur gjatë procedimit penal.

Në buletinin e muajit qershor 2017, të Policisë së Shtetit,<sup>7</sup> evidentohen rastet e luftës ndaj korrupsionit, të cilat konsistojnë në:

Strukturat kundër pastrimit të parasë, gjatë muajit qershor 2017 kanë evidentuar 36 vepra penale, nga të cilat janë zbuluar 32, me 39 autorë të proceduar, të cilët ndiqen në gjendje të lirë.

Gjatë muajit qershor 2017 janë zhvilluar dhe ndjekur 7 operacione kryesore policore. Në këto 7 operacione janë implikuar 96 autorë nga këta: 21 të arrestuar, 73 ndiqen në gjendje të lirë dhe 2 janë shpallur në kërkim. Janë zhvilluar 2 operacione më shumë me 51 autorë të proceduar më shumë. Sektori për hetimin e krimit ekonomik e financiar, ka evidentuar 2 grupe kriminale, ku janë implikuar 11 autorë, nga të cilët 9 janë arrestuar dhe 2 janë shpallur në kërkim.

Në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2012,<sup>8</sup> raportohet se:veprat penale kundër mashtrimit, zënë 2.56% të së gjitha veprave penale, të falsifikimit 5,56%, pastrimit parave 0.56% etj.

<sup>6</sup> Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, miratuar në Nju Jork, më 31 tetor 2003; ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 9492, datë 13. 3. 2006.

<sup>7</sup> Ministria e Punëve të Brendshme. “Mbi aktivitetin e strukturave të MPB për muajin qershor 2017”. *Buletini Informativ Nr. 45*, Tiranë, korrik 2017, f. 36.

<sup>8</sup> Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2012, relatuar në Kuvendin e Shqipërisë, f. 17, 177.

Menaxhimi, është në një pozicion unik për përjetësimin e pasqyrave financiare për shkak të aftësisë së drejtitimit, për të manipuluar të dhënat e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare mashtruese, duke shmangur kontrollet, që nga ana tjetër, duket se do të veprojnë në mënyrë efektive. Edhe pse rreziku i menaxhimit të tejkallimit të kontrollit, do të ndryshojë nga një subjekt në tjetrin, rreziku është i pranishëm në të gjitha subjektet.

Për shkak të mënyrës të paparashikueshme në të cilën mund të ndodhë një mbivendosje e tillë, ajo përbën një rrezik të anomalive materiale, për shkak të mashtrimit dhe shndërrohet në një rrezik të konsiderueshëm. Mashtrimi është konsideruar si një akt fshehjeje i qëllimshëm, mosveprim ose shtrembërim i së vërtetës, në mënyrë që të fitohen avantazhe të paligjshme ose të padrejta, për të dorëzuar një artikull të vlefshëm, një të drejtë ligjore ose për të shkakuar lëndim (Albrecht, Albrecht, Albrecht, & Zimbleman, 2011). Mashtrimi i nënshtrohet dënimeve të ndryshme - nga dënime të lehta, deri në dënime të rënda, të ndryshme nga qëllimet dhe pasojat e veprimeve mashtruese. Siç është paraqitur në Raportin e ACFE-së mbi “mashtrimin” dhe “abuzimin”, për vitin 2016<sup>9</sup>, forma më popullore e mashtrimit është mashtrimi që ndodh në organizatë. Edhe pse frekuenca e mashtrimit në organizatë është më e ulët, në krahasim me korrupsion apo vjedhjet, por humbja mesatare është më e lartë. Ky lloj i mashtrimit nuk ndikon vetëm organizatën, por edhe industrinë, ekonominë, ligjet dhe palët e interesuara. Albrecht dhe Zimbleman (Albrecht, Albrecht, Albrecht, dhe Zimbleman, 2011) përcaktojnë që: “Mashtrimi është shumë i kushtueshëm për organizatat dhe ekonominë, sepse ai redukton të ardhurat neto në bazë të njësisë monetare, pra shuma e të ardhurave shtesë, të nevojshme për të rivendosur fondet e vjedhura, është disa herë më e lartë në krahasim me shumën e humbur nga mashtrimi”. Sistemi bankar përbën 17% të së gjitha rasteve në mbarë botën, i ndjekur nga qeveria, prej 11%.

Menaxhimi mund të përjetësojë raportimin financiar nga kontrollet e vendosura dhe regjistrimi në hyrjeje i paautorizuar apo i papërshtatshëm në ditar, pra mashtrimi në kontabilitet është i lidhur fort me moszbatimin e kontrolleve të brendshme. Në një qasje të auditimit të bazuar në rrezik, një auditues kryen testin e kontrolleve për të vlerësuar praninë e anomalive materiale. Një kriter i përdorur për përcaktimin e mashtrimit në punë, dhe klasifikimin e tij, si një shkelje në sjelljeje e të punësuarve, menaxherëve apo drejtuesve që kontribuojnë në skemat mashtruese, e realizuar nga ACFE, është si më më poshtë:


(a) *përvetësimi i aseteve* - vjedhja apo keqpërdorimi i aseteve që janë pronë e organizatës;

(b) *korrupsioni* - përdorimi i ndikimit në një transaksion të biznesit, për të siguruar përfitim personal apo njerëz të tjerë, në kundërshtim me detyrën e tyre ndaj punëdhënësit ose të drejtave të palës tjetër;

(c) *pasqyrat financiare mashtruese* - subjekti nuk përfaqëson me besnikëri performancën financiare dhe pozicionin përmes pasqyrave financiare.

Statistikat tregojnë se mashtrimi në pasqyrat financiare (të quajtura ndryshe mashtrimi kontabël) është konsideruar lloji më me vlerë i mashtrimit. Menaxhimi mund të manipulojë qëllimisht deklaratat financiare, për të dhënë një pasqyrim sa më të mirë të kompanisë, për të siguruar një bonus më të lartë në fund të vitit, të tërhequr më shumë investitorë dhe për të rritur artificialisht çmimin e tregut të aksioneve, etj.

<sup>9</sup> Shoqata e Certifikuar e Ekzaminuesve të Mashtrimit, 2016.



**Figura 1: Trekëndëshi Mashtrimit.**

Për zbulimin dhe parandalimin e mashtrimeve në një organizatë, është e nevojshme të kuptojmë arsyet kryesore se përse autorët kryejnë mashtrim. Kështu, anëtarët e ekipit të angazhuar duhet të identifikojnë të gjitha burimet e mundshme të mashtrimit. Trekëndëshi i mashtrimit është një mjet i dobishëm në këtë proces, duke siguruar një analizë për të gjithë faktorët që sjellin autorët për të kryer një mashtrim. Trekëndëshi mashtrimit është një mjet i zakonshëm, që përdoret për përcaktimin e rrethanave në të cilat njerëzit janë të detyruar për të mashtruar. Sipas Akademisë së Kontabilitetit dhe gazetës së Studimeve Financiare (Roden, Cox, dhe Kim, 2016), trekëndëshi mashtrimit mund të parashikojë mashtrimin në korporata. Trekëndëshi mashtrimit është i përbërë nga tre zona potenciale.

Përkufizimi ACFE për trekëndëshin e mashtrimit, shpjegon rrethanat sa vijon:

(a) Presioni për shkak të borxheve personale; kanë nevojë për të arritur qëllimet financiare dhe dëshirën për status dhe mirëqenie, mund të ndikojnë lehtësisht në ndërmarrjen e veprimeve mashtruese.

(b) Mundësi për mashtrim duke u mos zbuluar nga të tjerët; mungesa e kontrollit të brendshëm, monitorimit dhe ndarja e detyrave janë konsideruar si mundësi të mira për të mashtruar.

(c) Racionalizimi si promotor i sjelljes që supozojmë, se autori duhet të justifikojë veprimin në një mënyrë që e bën të pranueshme dhe të justifikueshme.

Pasqyrat financiare janë shpesh objekt i manipulimit dhe skemave mashtruese. Rreziku i kryerjes dhe moszbulimit të mashtrimit, është gjithmonë i pranishëm brenda një njësie ekonomike, për këtë arsye ky është një rrezik i anormalive materiale për shkak të mashtrimit, dhe konsiderohet një rrezik i madh. Raporti i ACFE-së mbi mashtrim dhe abuzim, për vitin 2016, ka treguar se sistemi bankar, qeveria dhe prodhimi janë industritë më përfaqësuese të rasteve mashtruese, që përbëjnë 37% të rasteve të mashtrimit në të gjithë botën, në mesin e 23 industrive<sup>11</sup>. Format më të njohura të mashtrimit, kanë qenë keqpërdorimi i aseteve dhe mashtrimi në pasqyrat financiare.

Menaxhimi mund të përjetësojë raportimin financiar nga mos lejimi i procedurave të caktuara të kontrollit të brendshëm, pra mangësitë në kontrollin e brendshëm, janë burimi

<sup>10</sup> Raporti ACFE mbi Mashtrimin dhe Abuzimin, Viti 2016.

<sup>11</sup> Global Fraud Study, Report to the Nations on Occupational Fraud and Abuse, 2016.

kryesor i gabimeve materiale për shkak të mashtrimit. Objektivi i të kuptuarit e kontrollit të brendshëm, është që të identifikohen të gjitha rreziqet që përballet njësia ekonomike dhe të planifikohet reagimi i duhur për të adresuar këto rreziqe (IAASB, 2016). Përderisa përgjegjësia e një audituesi është që të raportojë nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale, si pasojë, ai duhet të kryejë të gjitha procedurat përkatëse, për marrjen e një sigurie të arsyeshme mbi raportimin financiar. Në një qasje të auditimit bazuar në risk, një auditues kryen teste kontrolli për të vlerësuar praninë e anomalive materiale.

Ashtu siç është problematik përcaktimi i korrupsionit, ashtu është edhe formulimi i politikave në secilin shtet, për ta luftuar atë. Për këtë arsye, specialistë profesionistë të BE-së, kanë formuluar edhe kritere të veçanta për luftimin e korrupsionit, kritere që duhen përmbushur nga të gjitha vendet që dëshirojnë të aderojnë në këtë bashkësi. Në rend të parë, është sigurimi i gjyqësisë së pavarur, në zbulimin dhe dënimin e korrupsionit.

Synohet krijimi i gatishmërisë për ta luftuar korrupsionin, nëpërmjet programeve të ndryshme që u ofrohen. Bashkëpunimi me qytetarët është detyrë kryesore e këtyre programeve, pasi vetëm ky bashkëpunim do të sillte rezultatin e synuar. Më 1999, OKB-ja, në kongresin e saj, ka miratuar programin e plotë për vendet e saja anëtare, për të luftuar korrupsionin. Kurse "Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik" (OECD), në bashkëpunim me Agjencinë Qeveritare Amerikane për zhvillim, USAID, kanë formuar rrjetin kundër korrupsionit, për vendet në tranzicion, i cili mundëson bashkëpunim dhe shkëmbim informatash, rreth indikatorëve të korrupsionit që ndihmojnë për formulimin e politikave për ta luftuar atë. Me një fjalë, korrupsioni është e keqja apo gangrena që mund ta bëjë shtetin edhe inekzistent. Qëllimi parësor i çdo qeverie, duhet të jetë pikërisht luftimi i korrupsionit me të gjitha mekanizmat e nevojshëm.

## 4. Përfundime

Si përfundim, mund të themi se korrupsioni është një fenomen që ka lindur me njerëzimin dhe do të zhduket bashkë me të. Por, duke qenë një gangrenë e të gjitha shoqërive, që shkaktohet nga rrethana të përgjithshme të natyrës njerëzore dhe nga faktorë të veçantë, që pasqyrojnë zhvillimin dhe natyrën e një shoqërie të caktuar, dhe që shoqërohet me pasoja negative të natyrës ekonomike, sociale dhe politike, lufta ndaj tij mbetet përherë një sfidë e hapur e mjeti më efektiv për ta realizuar është zbatimi praktik i legjislacionit. Në këtë drejtim, protagonistët janë vetë qytetarët, duke zbatuar vullnetarisht ligjin, për shkak të besnikërisë ndaj tij. Mbetet e hapur mundësia e moszbatimit të ligjit nga të ashtuquajturit zyrtarë, punonjësit e krimit të jakave të bardha, të cilët mundohen të përfitojnë nga praktikatat e institucionalizuara duke mos kontribuar në to; dhe, në këtë rast, del në pah roli i organeve që merren drejtpërdrejtë me zbatimin e legjislacionit dhe i atyre që kontrollojnë këtë zbatim e që evidentojnë pasojat që rrjedhin nga ky moszbatim. Ne jemi në ndërtim të një demokracie, pra jemi në fazën e tranzicionit.

Pikërisht nga praktikatat e shteteve në tranzicion, kemi vërejtur se korrupsioni, si dukuri, është parë të jetë si një nga sfidat më të rënda në ndërtimin e një shteti demokratik. Institucionet e Shqipërisë duhet të kenë prioritet luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të zhvillohet ekonomikisht shteti. Të përqendrohen kryesisht në luftën kundër korrupsionit dhe dënimin e të korruptuarve me në masën e duhur dhe proporcionale me të keqen që shkakton. Mirëpo nuk mjaftojnë vetëm institucionet ligjzbatuese që lufta kundër korrupsionit të fitohet, por duhet të vetëndërgjegjësohen në radhë të parë



menaxherët, pronarët e biznesit, institucionet publike, tatim-taksat, doganat e deri dhe qytetarët, që ky fenomen të luftohet dhe kjo betejë të fitohet.

Duke pasur për bazë praktikën e shteteve që kanë luftuar korrupsionin me sukses, edhe ne duhet të bëjmë projekte konkrete, për luftimin e korrupsionit dhe ato të vihen në përdorim. Duhet të bëhen thjeshtësime të procedurave qeveritare, në mënyrë që të mundësohet dhe të perceptohet funksionimi më i mirë i biznesit dhe të minimizohen fushat dhe hapësirat ku do të mund të vihet në pah korrupsioni. Nevojitet krijimi i kuadrit të duhur ligjor dhe institucional për parandalimin e korrupsionit. Ekzistojnë edhe shumë hapa të ndryshëm që duhet të merren për luftimin e korrupsionit. Duhet që të përcaktohet me ligje, çështja e korrupsionit si dhe të zhduken boshllëqet në legjislacionin ekzistues, d.m.th., të krijohen ligje të cilat caktojnë qartë atë që sot quhet korrupsion dhe të përcaktohen qartë, sanksionet që prekin personat të cilët ushtrojnë korrupsionin aktiv apo pasiv. Të përcaktohet qartazi nga kuadri ligjor, se çfarë kuptohet me termin “krim i jakave të bardha”.

Të rriten kapacitetet e profesionistëve veçanërisht e ekspertëve kontabël, audituesve të cilët kanë një rol të rëndësishëm në identifikimin, zbulimin dhe dërgimin para drejtësisë të shkelësve të ligjit.

Të forcohen kapacitetet e strukturave të hetimit të krimit të “jakave të bardha” në Policinë e Shtetit dhe në Prokurorinë Shqiptare. Të përsosën metodat e hetimit, të rritet transparenca dhe vullneti i këtyre strukturave për nevojën e thellimit të luftës, ndaj këtij fenomeni të rrezikshëm.

Auditorët, veçanërisht ato të sistemit të studimeve pasuniversitare, të thellojnë njohuritë që u japin studentëve në këtë fushë si dhe të koordinojnë dhënien e njohurive me zhvillimin e praktikave mësimore, në organizata të ndryshme.

Auditimi i jetesës është mjaft i rëndësishëm në të gjithë këtë proces. Roli i audituesve ligjorë, ekspertëve kontabilist dhe specialistëve të policisë është vendimtar, për të krijuar një qasje të re ndaj ndryshimeve të argumentuara ligjërish, të mënyrës së jetesës të punonjësve të bizneseve, zyrtarëve etj., dhe argumentimi e dokumentimi i saktë i veprimeve, me qëllim për të përfituar në kundërshtim me ligjin.

Gjithpërfshirja në kërkimin e të dhënave të fshehura, me qëllim arritjen e një vlere maksimale në hetim të krimeve të jakave të bardha, duke rritur efektivitetin e hetimit dhe dërguar para drejtësisë personat abuzues, përbëjnë sfidën e strukturave ligjzbatuese dhe ekspertëve kontabilist dhe auditues.

## Bibliografi

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*, (e ndryshuar).
2. *Kodi i Procedurës Penale së Republikës së Shqipërisë*, (i ndryshuar).
3. *Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*, (i ndryshuar).
4. Organizata joqeveritare ndërkombëtare IKP, *Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit*.
5. Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, OECD, (2002-2015). *OECD Journal on Budgeting*, [http://www.oecdilibrary.org/governance/oecd-journal-onbudgeting\\_16812336](http://www.oecdilibrary.org/governance/oecd-journal-onbudgeting_16812336)
6. Raporti i misionit “Euralius për Shqipërinë”
7. Ismet Elezi, *Komentari i shtesave dhe ndryshimeve në Kodin Penal*, me ligjin nr. 23 datë 1. 3. 2012. Shtëpia Botuese “Erik”, Tiranë 2012.
8. Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2015.
9. Prokuroria e Përgjithshme, *Raportet Vjetore 2011-2015*.
10. Buletine të Policisë së Shtetit 2016-2017.
11. Sotiraq Dhama, *Kontabiliteti Financiar*, Tiranë : SHBLU, 1994
12. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

# Ekspertiza e ADN-së, roli i saj në procedurën penale

— Dr. Sc. Blerim OLLURI

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
blerim.olluri@rks-gov.net

— Dr. Sc. Xhemajl ADEMAJ

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
xhemajl.ademaj@gmail.com

— MSc. Sokol DEDAJ

Agjencia e Kosovës për Forenzikë  
sokol.dedaj@rks-gov.net

## Abstrakt

*Ky hulumtim shkencor, i titulluar “Ekspertiza e ADN-së, roli i saj në procedurën penale” ka për qëllim të studiojë rolin dhe rëndësinë e analizave shkencore forenzike të ADN-së në procedurën penale. Sot, padyshim që ekspertiza e ADN-së luan një rol shumë të rëndësishëm dhe domethënës, jo vetëm në zbulimin dhe identifikimin e kryesit të veprës penale, por njëkohësisht edhe në prezumimin e pafajësisë. ADN-ja sot konsiderohet një ndër revolucionet e arritjeve më kulmore shkencore, por jo vetëm kaq, analiza shkencore e ADN-së vlerësohet si metoda më e përshtatshme dhe më e objektive, në përcaktimin e trashëgimitarit/ve biologjik. Është më se e ditur, që njohuritë dhe përvoja e prokurorit dhe gjyqtarit, nuk janë të mjaftueshme për dhënien e përgjigjeve, në shumë çështje shkencore, andaj kërkohet angazhimi i ekspertit të dëshmuar, me përvojë e njohuri të veçanta shkencore, për dhënien e mendimit dhe nxjerrjen e konkluzioneve shkencore. Metodat që do të aplikohen në kuadër të këtij hulumtimi shkencor, do të jenë kryesisht metoda krahasuese dhe përshkruese, mbështetur në statistika dhe ilustruar me disa shembuj të ekspertizave shkencore të ADN-së, kryer nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, gjegjësisht, laboratorit i ADN-së.*

## Fjalëkyçe:

**ekspertiza, ADN (Acidi deoksiribonukleik), procedura penale, gjenetika.**

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Acidi deoksiribonukleik ose ADN- ja mund të përdoret për të identifikuar një individ përmes mostrave të gjakut, spermës, pështymës, lëkurës ose flokëve, indeve dhe eshtrave. Përveç rasteve të binjakëve identikë, ADN-ja e secilit person është unike. Në fillim të viteve 1990, në vende të ndryshme, në mënyrë intensive filloi mbledhja e mostrave të ADN-së nga vendi i ngjarjes dhe kryes të veprave kriminale, duke zhvilluar dhe sistemuar bazat e të dhënave të ADN-së dhe duke përdorur këto të dhëna për të hetuar dhe ndjekur penalisht krimet.

ADN-ja e gjetur, si dëshmi e vendit të krimit mund të krahasohet me ADN-në nga të dyshuarit për krime. Lloji i testeve dhe analizave të kryera, mund të varet nga aftësitë (metodat analitike të përdorura) e një laboratorit dhe nga cilësia e një mostre të ADN-së. Disa teste mund të identifikojnë burimin e ADN-së me një shkallë të lartë të sigurisë, ndërsa metodat e tjera mund të jenë më pak të sakta. Ndonjëherë rezultatet e testeve janë jo bindëse, dhe testimi mund të mos jetë i mundshëm, nëse ekziston dëshmi (sasi) e pamjaftueshme e ADN-së ose, nëse provat janë degraduar, kontaminuar ose ruajtur në mënyrë jo të duhur.

Rezultatet e testimit të ADN-së shpesh raportohen si një “përfshirje” ose “përrjashtim”. Në një rast penal, një përfshirje, e quajtur edhe një përputhje, në përgjithësi nënkupton që dëshmia e ADN-së nga një vend i ngjarjes, përputhet me atë të një të dyshuari ose një personi të njohur. Një përrjashtim nënkupton, që ADN-ja e të dyshuarit nuk përputhet me ADN-në e marrë nga vendi i krimit. ADN-ja forenzike, për qëllime kriminale, në Kosovë ka filluar të bëhet (analiza e ADN-së) diku nga viti 2008, pas përgatitjes së laboratorit, zhvillimit dhe vlerësimit të metodave analitike dhe procedurave. Që nga viti 2008 e deri më sot, ky laborator ka analizuar mostrat nga vendi i ngjarjes dhe personat e dyshuar sipas kërkesave të hetuesisë, prokurorisë dhe gjykatave kompetente me qëllim identifikimin e kryesve të veprave penale si dhe, sjelljen e personave të dyshuar para drejtësisë, duke kontribuar kështu te sistemi i drejtësisë, në zbardhjen dhe

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

**“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”**

identifikimin e kryesve të veprave të ndrysmë penale duke përfshirë llojet e veprave penale si: vrasjet, dhunimet, vjedhjet, aktet terroriste, kontrabandën, grabitjet, rrëmbimet, testet e atësisë, identifikimin e personave të zhdukur, etj.

Andaj, edhe qëllimi i këtij hulumtimi është që përmes rasteve të kryera dhe statistikave të rasteve, të bëhet një analizë e tyre dhe të nxirret një konkludim rreth rëndësisë dhe rolit të ekspertizave të ADN-së në procedurën penale, - që njëherazi është edhe tema e këtij hulumtimi, - si dhe rreth kostos së ekspertizës së ADN-së<sup>1</sup>.

## 2. Gjenetika njerëzore

ADN-ja është shkurtesë e “acidit deoksiribonukleik”. “ADN është një molekulë e madhe që përmban njësi të quajtura *nucleotide*. Komponentët e nukleotideve janë me bazë organike, pesë-karbon karbohidrati i quajtur riboson dhe fosfate. Në ADN, baza organike (azotike) mund të jetë një nga katër përbërësit: guaninë, citozinë, adeninë, timinë”.<sup>2</sup> Lidhja bëhet ndërmjet A-T dhe G-C, në formë të përdredhur, duke krijuar helikën (vargun) e dyfishtë të ADN-së (Figura 1).




Figura 1: Struktura e ADN-së, a.- Veçoritë kryesore të strukturës së ADN-së; b.- struktura kimike e vargut të ADN-së; c.- Modeli hapësinor i ADN-së.

Kombinimet A-T dhe G-C, njihen me emrin çifte bazash. Më se 3 miliardë çifte bazash gjenden në ADN njerëzore. Megjithatë, vetëm pjesë të vogla të këtyre çifteve përcaktojnë karakteristikat unike ndërmjet personave dhe janë me interes në pikëpamjen kriminalistike.”<sup>3</sup>

“Gjeni është njësia bazë e trashëgimisë. Ai udhëzon qelizat e trupit që të prodhojnë proteina, të cilat përcaktojnë çdo gjë që nga ngjyra e flokëve e deri te ndjeshmëria jonë

<sup>1</sup> Në shumicën e rasteve, zhvillimi i një profili të ADN-së - një përshkrim i përmbajtjes së një pjesë të ADN-së së një personi - mund të kushtojë diku nga 500 deri në 5,000 •, varësisht nga lloji dhe sasia e mostrave, nëse merret nga vendi i krimit ose nga një individ i dyshuar dhe/apo për bazën e të dhënave, dhe llojin e raportit që do të prodhohet.

<sup>2</sup> Gaensslen, Harris, Lee, 2008, f. 244.

<sup>3</sup> Myftari, 2008: 331.

ndaj sëmundjeve.”<sup>4</sup>

Analiza e ADN-së është prezantuar për herë të parë nga mesi i viteve ‘80-të të shekullit të kaluar. Që nga atëherë, ajo ka bërë një revolucion në shkencën e forenzikës, duke u mundësuar zbatuesve të ligjit, që të bëjnë ndriçimin e shumë veprave penale dhe zbulimin e kapjen e kryerësve të tyre. Me mijëra raste janë mbyllur në të kaluarën në mungesë të provave biologjike dhe me këtë rast shumë kriminelë kanë mbetur të lirë, derisa nuk është zbuluar analiza e ADN-së.<sup>5</sup>

Profilizimi i ADN-së, siç është i njohur sot, për herë të parë është përshkruar nga shkencëtari anglez Alec Jeffreys, në vitin 1985.<sup>6</sup> Ai zbuloi se disa regjione të caktuara të ADN-së përmbajnë sekuenca të përsëritura dhe gjithashtu vërejti se numri i këtyre sekuecave të përsëritura të ADN-së, ndryshon nga individ në individ. Me këtë zbulim Dr. Jeffreys mundësoi zhvillimin e analizës së ADN-së për qëllime identifikimi. Rasti i parë i zbuluar dhe i dënuar në bazë të analizës së ADN-së, është rasti i Colin Pitchfork i cili kishte kryer dhunim dhe vrasje të dyfishtë. Regjionet e përsëritura të ADN-së, që janë analizuar në fillim, janë quajtur VNTR (Variable Number Tandem Repeat), kurse teknika të cilën ka përdorur Alec Jeffreys, për t’i analizuar këto regjione, është quajtur RFLP (Restriction Fragment Length Polymorphism).

Që nga ajo kohë metodat për analizat e ADN-së janë zhvilluar shumë shpejt dhe janë përhapur në mbarë botën. Sot, zbatim të gjerë kanë analizat e regjioneve të ADN-së, të ashtuquajtura “Vargjet e shkurtra të përsëritura” apo STR (Short Tandem Repeat), të cilat realizohen me teknikën e njohur si PCR apo “Polymerase Chain Reaction”.<sup>7</sup>

### 3. Variabiliteti i ADN-së

Siç u theksua edhe më lartë, janë më se 3 miliardë çifte bazash të cilat e përbëjnë gjenomin njerëzor. Këto 3 miliard çifte bazash janë të grupuara në 23 çifte kromozomesh: një çift prej nënës dhe një çift prej babait (numri total prej 46 kromozomesh). Sekuencat specifike të bazave që e kodojnë një karakteristikë, quhen gjene. Pozita e gjenit në kromozom paraqet lokusin. Sekuencat ose variacionet e mundshme të një gjeni quhen “alele”. Meqenëse çdo person trashëgon nga një çift kromozomesh nga secili prind, njerëzit kanë nga dy alele për secilin lokus.

Me intensifikimin e hulumtimeve në biologjinë molekulare, janë përcaktuar disa të vërteta shkencore. Shumica më e madhe e molekulave të ADN-së njerëzore (më shumë se 99.7%), është e ngjashme (e përbashkët) në mes të njerëzve. ADN-ja e ngjashme (e përbashkët) krijon karakteristika njerëzore që janë të ngjashme të gjithë njerëzit: dy duar, dhjetë gishta, gjak që mund të transfuzohet dhe organet që mund të transplantohen. Vetëm një pjesë e vogël e ADN-së sonë ( 0.3% apo rreth 10 milion nukleotide) ndryshon midis njerëzve dhe na bën individë unikë (të veçantë), me përjashtim të binjakëve identikë, të cilët kanë sekuenca plotësisht të njëjta të ADN-së. Ndryshueshmëria e aleleve të gjeneve, që ndryshojnë nga një person në tjetrin ofrojnë bazë për identifikimin e ADN-së. Janë zhvilluar metoda për të gjetur dhe karakterizuar këtë variacion gjenetik në vende të veçanta në gjenomin e njeriut.<sup>8</sup>

<sup>4</sup> Seferstein, 2007: 382.

<sup>5</sup> Mbrojtësi Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 12.

<sup>6</sup> Mbrojtësi Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 12.

<sup>7</sup> Mbrojtësi Vëllimi VII Nr. 1, 2011, 12.

<sup>8</sup> Butler John M., 2005:26.




Figura 2: Shembull i polimorfizmit zinxhiror (length polymorphism)

#### 4. Burimet biologjike potenciale te ADN-së

ADN-ja është e pranishme në gjak (jo në rruazat e kuqe, sepse qelizat e tyre nuk kanë bërthamë), në lëngjet gjenitale, në lëkurë dhe në indet e buta, në rrënjën e flokëve, në pështymë, në urinë, në indet kockore dhe në kanalet e dhëmbëve.<sup>9</sup> ADN-ja është e lokalizuar në bërthamë të qelizës dhe mund ta quajmë edhe si ADN e bërthamës, mirëpo ADN-ja mund të haset edhe në mitokondrie të qelizës, të cilën mund ta quajmë si ADN mitokondriale. Analizat forenzike të ADN-së, më tepër janë të bazuara në analizën e ADN-së nga bërthama; këto analiza janë shumë më të sakta dhe japin më tepër informacion, në krahasim me analizat e ADN-së nga mitokondriet.

Analizat e ADN-së mitokondriale janë më pak informuese dhe japin vetëm informata nga vija amësores (trashëgimia nga ana e nënës). Këto analiza, janë veç si analiza mbështetëse dhe nuk mund ta identifikojnë saktë individin. Me anë të analizave të ADN-së së bërthamës, mund të bëhet saktësisht identifikimi i personit të caktuar. Këto analiza, aplikohen me të madhe në forenzikë, për qëllime identifikimi. Prandaj, kur përdoret termi “*analiza të ADN-së*”, fjala është pikërisht për këto analizat e ADN-së nga bërthama qelizore. Kështu, shumicën e kohës kur shkencëtarët forenzikë flasin për ADN-në, është fjala për ADN-në bërthamore. Mund të quhet, po ashtu edhe ADN *gjenomike*.<sup>10</sup>

Dëshmitë të cilat hasen në vendin e ngjarjes, mund të jenë të ndryshme, si: armët, rrobat, shtresat e gjësendet e ndryshme. Këto dëshmi, mund të jenë të njollosura me njolla të ndryshme biologjike, si p.sh., me: gjak, spermë, pështymë apo me materiale të tjera, si inde, qime, eshtra apo dhëmbë dhe mostra nga kontakti (qelizat epiteliiale, djersa).

#### 5. Mbledhja, regjistrimi dhe paketimi i mostrave të ADN-së

Mbledhja e dëshmimeve në vendin e ngjarjes duhet të bëhet me kujdes dhe duke përdorur mjetet mbrojtëse personale (dorëzat, mantelin, maskën). Dëshmitë apo artikujt e veçantë duhet të paketohen në pako të veçanta, duke pasur kujdes që të mos

<sup>9</sup> Myftari, 2008: 331.

<sup>10</sup> Gaensslen, Harris, Lee, 2008: 247.

kontaminohen. Secila dëshmi, duhet të shënohet me të dhënat si në vijim: numri i rastit, numri i dëshmisë, përshkrimi i dëshmisë, data dhe inicialet e personit që e ka mbledhur. Dëshmitë duhet të paktohen në pako prej letre dhe të mbyllen mirë me shirit sigures. Nëse dëshmitë janë të lagura ato fillimisht duhet të teren e pastaj të paktohen.

Dëshmitë me njolla biologjike nuk duhet të paktohen në pako plastike. Sugjerohet që dëshmitë që nuk janë shumë të mëdha, si p.sh. armët, rrobat etj., të paktohen komplet si të tilla dhe të dërgohen në laborator. Kurse, në rastet e dëshmimeve më të mëdha (si p.sh. tapetet, dyshemeja, tavolina), njollat biologjike duhet të merren me tampon steril, të thahen mirë, të paktohen dhe të dërgohen në laborator. Në disa raste (p.sh. njolla gjaku në mur), mund të aplikohet edhe gërryerja e njollës mbi letër të pastër, të bardhë. Të gjitha dëshmitë e mbledhura dërgohen në laborator, ku regjistrohen në sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve LIMS, dhe pastaj ndahen te ekspertët përkatës, për kryerjen e ekspertizave të nevojshme të ADN-së<sup>11</sup>.

## 6. Metodatat dhe etapat themelore të procesit të analizës forenzike të ADN-së

Procesi i analizës forenzike të ADN-së, është i ndarë në disa faza, ndër të cilat më kryesore janë: ekzaminimi i dëshmimeve, ekstraktimi, kuantifikimi, amplifikimi dhe profilizimi i ADN-së. Ekzaminimi i dëshmimeve është si fazë e parë ku dëshmitë kontrollohen për mostra biologjike. Fillimisht bëhet ekzaminimi vizual me anë të syrit të lirë për identifikimin e njollave të caktuara, pastaj ekzaminimi mikroskopik (stereoskopik), pastaj ekzaminimi me anë të dritës UV apo “Alternative”, për identifikimin e njollave të padukshme në dëshmi apo zonat e tyre. Ekstraktimi është fazë gjatë së cilës bëhet izolimi i ADN-së. Në laboratorë të ndryshëm përdoren ekstraktues të ndryshëm, por në në “Laboratorin e serologjisë dhe ADN-së” përdoren tre lloje të ekstraktuesve: *Chelex*, *Diferencial* dhe *Organik*, në varësi nga rastet dhe natyra e tyre.

Kuantifikimi është faza gjatë së cilës bëhet përcaktimi i sasisë së ADN-së. Amplifikimi i ADN-së është faza gjatë së cilës bëhet shumëfishimi i molekulës së ADN-së (krijohen kopje të shumëfishta të ADN-së). Profilizimi i ADN-së bëhet përmes “elektroforezës kapilare”. Gjatë kësaj faze, nga secila mostër e analizuar nxirret profili i ADN-së<sup>12</sup>.

## 7. Statistikat e rasteve të analizuar të ADN-së, në “Laboratorin e Serologjisë dhe të ADN-së” në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016)

Si të dhëna bazë të këtij hulumtimi, janë statistikatat e rasteve të analizuar në divizionin (“Laboratorin e Serologjisë dhe ADN-së”), pranë “Agjencisë së Kosovës për Forenzikë”, gjatë periudhës trevjeçare 2014-2016, *Tabela 1*.

Viti:	Rastet e pranura:	Rastet e ekspertuara:	Numri i Dëshmimeve:
2014	151	127	1828
2015	123	144	772
2016	208	184	1366

**Tabela 1:** Statistikat e rasteve dhe dëshmimeve të analizuar të ADN-së, në “Laboratorin e Serologjisë dhe të ADN-së”, në tri vitet e fundit (2014, 2015, 2016)


<sup>11</sup> Procedurat e ADN-së, AKF-4, 2015.

<sup>12</sup> Olluri B., Disertacioni i Doktoratës, 2016: 20

Nëse analizohen me kujdes të dhënat nga tabela 1, që ka të bëjë me statistikat dhe numrin e rasteve të analizuara në tri vitet e fundit, 2014–2016, vërehet një rritje e dukshme e rasteve të kryera nëpër vite, p.sh., në vitin 2014, janë analizuar 127 raste ADN-së; në vitin 2015, janë analizuar 144 raste dhe në vitin 2016 janë analizuar 184 raste, por nëse bëhet një krahasim dhe analizë në bazë të numrit të dëshmimeve vërehet një luhatje dhe ndryshim i numrit të dëshmimeve nëpër vite, p.sh., në vitin 2014 janë trajtuar dhe analizuar 1828 dëshmi; në vitin 2015 ka rritje të numrit të rasteve, por zvogëlim të dukshëm të numrit të dëshmimeve (772), përderisa, në vitin 2016 ka rritje edhe të numrit të rasteve edhe të numrit të dëshmimeve, krahasuar me vitin paraprak (184 raste me 1366 dëshmi).


Në grafikët në vazhdim janë paraqitur rastet e kryera në “Laboratorin e Serologjisë dhe ADN-së” në tri vitet që janë subjekt i hulumtimit (2014, 2015 dhe 2016) sipas llojit të veprës penale me ç’rast, rastet sipas veprave penale, bazuar në kërkesën e prokurorit apo gjyqtarit kompetent janë kategorizuar në: vrasje, terrorizëm, dhunim seksual, vjedhje, kontrabandë, Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm, test i atësisë, grabitje, kidnapim, zjarre vënie, raste me SI dhe tjera që mund të jenë: aksident i automobilistik, lëndim trupor, kërcënim etj.

Bazuar në numrat (përqindjen) e të dhënave nga grafikët, vërehet një trend dhe raport i njëjtë i rasteve sipas veprave penale në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve të kryera përgjatë viteve, p.sh vërehet se në të tri vitet, ka pasur numër më të madh të kërkesave për ekspertizë të ADN-së, për rastet e vrasjeve (27 – 32 %), pastaj për rastet për kërkim në bazën e të dhënave CODIS sipas kërkesave të ngritura nga INTERPOL dhe EUROPOL (16 – 26 %), pastaj rastet e dhunimeve seksuale (12 – 15 %), vjedhjeve (6 – 8 %), shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (6 – 8 %) e kështu me radhë.




**Grafiku 1: Rastet e kryera në Laboratorin e Serologjisë dhe ADN-së gjatë vitit 2014 dhe klasifikimi i tyre sipas llojit të veprës penale.**





**Grafiku 2:** Rastet e kryera në Laboratorin e Serologjisë dhe ADN-së gjatë vitit 2015 dhe klasifikimi i tyre sipas llojit të veprës penale.



**Grafiku 3:** Rastet e kryera në Laboratorin e Serologjisë dhe ADN-së gjatë vitit 2016 dhe klasifikimi i tyre sipas llojit të veprës penale.

## 8. Raste studimore dhe konkludime sipas veprave

### 8.1 Rast i vrasjes

Dëshmia	D8S1179	D21S11	D7S820	CSF1PO	D3S1358	TH01	D13S317	D16S539
SH.H	10,13	29,30.2	10,12	11,12	17,18	9,9.3	11,13	11,12
MA15-323	13,14	28,30.2	10	9,11	15,17	6,9	11,13	11
B#1.A	10,13	29,30.2	10,12	-,12	17,18	9,9.3	11,13	11,12
B#1.B	10,13,14	28,29,30.2	[9],10,[11],12	9,11,12	15,17,18	6,9,9.3	10,11,13	11,12

Dëshmia	D2S1338	D19S433	vËA	TPOX	D18S51	AMEL	D5S818	FGA
SH.H	16,17	13	17,18	8,10	14,19	X	11	22,24
MA15-323	17,23	12,13	17,18	8	14,15	X	11	22
B#1.A	16,17	13	17,18	8,10	14,19	X	11	22,24
B#1.B	16,17,23	12,13,[16]	17,18	8,10	14,[15],19	X	11,[12]	22,24

1. Nga dëshmia SH.H. është fituar profili i ADN-së nga e dyshuara.

2. Nga dëshmia MA15-323 (pjesë ashtërore dhe muskul) është fituar një profil i ADN-së i një personi të panjohur i gjinisë femërore, personi i panjohur i gjinisë femërore nuk mund të përjashtohet si vajzë biologjike e të dyshuarës, po ashtu e dyshuara nuk mund të përjashtohet si nënë biologjike e foshnjës së gjinisë femërore.

- Gjasa që S. H. të jetë nëna biologjike e personit të panjohur të gjinisë femërore është 99.97 %.

3. Nga mostra B#1.A e marrë nga dëshmia B#1 është fituar një profil i ADN-së i cili profil përputhet me profilin e ADN-së të dyshuarës, kështu që e dyshuara S. H. nuk mund të përjashtohet si kontribuuese e ADN-së në këtë dëshmi.

- Gjasa e paraqitjes së këtij profili në popullatë, është 1 në 8.4 bilion njerëz.

### 8.2 Rast i testit të Atësisë

Dëshmia	D8S1179	D21S11	D7S820	CSF1PO	D3S1358	TH01	D13S317	D16S539
D#1.1	12,14	30,32.2	8,11	11	17,18	6,9	11	11
D#1.2	13,14	31.2,32.2	8,10	11,14	15,17	8,9	8,11	11,12

Dëshmia	D2S1338	D19S433	vËA	TPOX	D18S51	AMEL	D5S818	FGA
D#1.1	16,19	12,16	16,17	9,12	15,17	X,Y	11	23,25
D#1.2	19,24	16,16.2	17	9,11	14,15	X,Y	11,12	20,23

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

1. Nga dëshmia D#1.1 është fituar profili i ADN-së së babait të dyshuar.2.

Nga dëshmia D#1.2 është fituar profili i ADN-së së foshnjës.3. Bazuar në rezultatet e ADN-së, personi që ka dhënë mostrën, nga dëshmia D#1.1, nuk mund të përjashtohet si baba biologjik i foshnjës nga Dëshmia D # 1.1.Gjasa që personi nga dëshmia D#1.1, të jetë baba biologjik i foshnjës është 99.991[%].

### 8.3 Rast i dhunimit

Dëshmia	D8S1179	D21S11	D7S820	CSF1PO	D3S1358	THO1	D13S317	D16S539
MP16-013	10,11,13,15	29,30,2,32,2	8,11,12	10,11,12	15,16,19	7,8	8,11,12	10,12
#3	10,15	30,2,32,2	11,12	10,12	15,16	7	8,11	10,12

Dëshmia	D2S1338	D19S433	vËA	TPOX	D18S51	AMEL	D5S818	FGA
MP16-013	18,19,24	12,13,14	16,17	8,9,11	14,15,17	X,Y	10,12,13	20,22,24,26
#3	19,24	13,14	16	8,11	14,17	X,Y	10,13	20,24

1. Nga dëshmia #3 (mostër referente gjaku nga i dyshuari) është fituar profili i ADN-së së të dyshuarit.

2. Nga dëshmia MP16-013 ( tamponi i marrë nga vagjina e viktimës) është fituar një profil i përzier i ADN-së nga dy persona, njëri i gjinisë femërore dhe tjetri i gjinisë mashkullore.

3. I dyshuari nga i cili është marrë mostra standarde, nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këtë përzierje.

Gjasa e paraqitjes së këtij profili në popullatë është 1 në 261 bilion individë (3.8200E-15).

## 9. Analizat molekulare e gjenetike, analiza e ADN-së sipas kodit të procedurës penale të Kosovës

Në kodin e procedurës penale të Kosovës, neni 145, ligjvënësi ka paraparë dispozitë të veçantë ligjore për rregullimin e analizave molekulare e gjenetike dhe analiza të AND-së.

Lexo me vëmendje nenin 145, të kodit të procedurës penale të Kosovës:  
“Analizat molekulare e gjenetike dhe analizat e ADN-së.”

1. Çdo ekzaminim ose analizë nga ky nen i nënshtrohet rregullave të ekspertizës dhe deklaratës së ekspertit nga nenet 136-142 të këtij Kodi.

2. Gjykata mund të urdhërojë që materiali i siguruar me masat nga neni 144 i këtij Kodi t'i nënshtrohet ekzaminimeve molekulare dhe gjenetike për aq sa masat e tilla janë të nevojshme për të përcaktuar prejardhjen ose për të vërtetuar nëse gjurmët e gjetura i përkasin të pandehurit apo të dëmtuarit.

3. Me qëllim të përcaktimit të identitetit në procedurë penale, indet qelizore mund të merren nga personi i pandehur për identifikimin e ADN-së në pajtim me nenin 144 të këtij Kodi.

4. Indi i marrur qelizor mund të përdoret vetëm për identifikimin e ADN-së, siç është paraparë në paragrafin 1. ose 2. të këtij neni; ai shkatërrohet pa vonesë kur më nuk është i nevojshëm për atë qëllim. Informacionet tjera, përveç atyre që kërkohen për të përcaktuar kodin e ADN-së, nuk përcaktohen gjatë ekzaminimit dhe janë të papranueshme.

5. Provat e gjetura, të siguruara apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale apo që kanë lidhje me procedurën penale mund të ekzaminohen dhe mostrat mund t'i

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

nënshtrohen ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas urdhrorit të prokurorit të shtetit.

*6. Rezultatet nga ekzaminimi molekular dhe gjenetik i mostrave të siguruar sipas paragrafit 5. të këtij neni të cilat nuk përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin mund të ruhen nga Ministria e Drejtësisë deri në një kohë të tillë kur ato të përputhen me të dyshuarin apo të pandehurin dhe derisa ai i dyshuar apo i pandehur të lirohet apo të shpallet fajtor. Ministria e Drejtësisë lëshon rregullore mbi ruajtjen e rezultateve të ekzaminimit molekular dhe gjenetik sipas këtij paragrafi.*

Saç mund të shihet në këtë dispozitë ligjore, ligjvënësi ka rregulluar kushtet e marrjes, analizës, asgjësimit të mostrës dhe ruajtjes së rezultatit të ADN-së, nga i pandehuri. Nëse i bëjmë një analizë kësaj dispozite ligjore, mund të komentojmë dy çështje: E para, ka të bëjë me rëndësinë që i kushton ligjvënësi procedimit me të pandehurin, në kumtimin e marrjes dhe trajtimit të mostrës së ADN-së, dhe e dyta, me ruajtjen e rezultateve, gjegjësisht profilit të ADN-së. Ruajtja e profilit të ADN-së është çështje e cila është identifikuar si çështje problematike, për shkak të paqartësisë ligjore të kompetencës se kush është institucioni ligjorë përgjegjës për ruajtjen, mbajtjen dhe kontrollin e të dhënave të ADN-së në kudër të institucioneve të republikës së Kosovës.

Saç pamë më lartë, kodi i procedurës penale, i Kosovës, në nenin 145, paragrafi 6, i jep të drejtë Ministrisë së Drejtësisë që me urdhër të prokurorit provat e gjetura, të siguruar apo të kapura në vendin e kryerjes së veprës penale, apo që kanë lidhje me procedurën penale, mund të ekzaminohen dhe mostrat mund t'i nënshtrohen ekzaminimit molekular e gjenetik<sup>13</sup>.

## 10. Përfundime

1. Analiza laboratorike e mostrave biologjike dhe ekspertiza e ADN-së kanë një rëndësi të veçantë për zbatimin e suksesshëm të procedurës penale dhe se gjetja, fiksimi, evidentimi, mbledhja dhe analizimi i tyre, duhet të bëhet sipas standardeve më të larta profesionale me qëllim të ruajtjes së integritetit të këtyre provave dhe përdorimit të tyre në procedurën penale.

2. Analizat e ADN-së në hetimet penale, përbëjnë një hap përpara në parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit dhe, janë instrumenti shkencor më i përparuar, me të cilin mund të kryhen karakterizimi, individualizimi dhe identifikimi i personave.

3. Në një kuptim të përgjithshëm, analizat e ADN-së përbëjnë një arritje në lidhje me çështjen e identifikimit personal. Karakterizimi individual që bëhet në bazë të profilit të ADN-së, i cili përkufizohet edhe si identifikim gjenetik, përbën një koncept të përgjithshëm të identifikimit, i cili sikurse gjurmët e gishtave dhe dokumentet e identifikimit kontribuon në përcaktimin e pagabueshëm dhe të saktë të identitetit personal.

4. Ngritja e bazës kombëtare së të dhënave të profileve të ADN-së, është imperativ për çdo shtet, pasi kjo do të mundësonte identifikimin më të shpejt të kryesve të veprave penale dhe shkëmbimin e informatave me shtetet tjera, me qëllim luftimin e kriminalitetit transnacional.

5. Në mënyrë që të mbahen standardet ndërkombëtare dhe të ecet me hapin e shkencës, është e nevojshme që ekspertët të ndjekin trajnime të vazhdueshme dhe të përditësojnë metodat e pajisjet e nevojshme për analizat e ADN-së.

6. Po ashtu, duhet të jetë imperativ i shtetit, trajnimi i vazhdueshëm i hetuesve,

prokurorëve dhe gjykatësve, lidhur me rëndësinë e provave biologjike dhe analizave të ADN-së në procedurën penale, në mënyrë që të ndihmohen ata në kryerjen me sukses të detyrave dhe përgjegjësive të tyre dhe, të jenë të përditësuar me atë çka ata mund të kërkojnë nga ekspertët përkatës forenzik.

7. Ministria e Arsimit duhet të kërkojë nga institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë studime të jurisprudencës dhe kriminalistikës, që në plan-programet e tyre të parashohin lëndë teorike dhe klinike të veçanta, për rëndësinë e provave materiale dhe aplikimin e tyre në procedurën penale.

## Literatura

1. Black's and C. (2006), *Forensic Human Identification*, London.
2. Butler, John M., "Forensic DNA Typing", *Biology, Technology and Genetics of STR Markers, Second Edition*, Academic Press, 2005.
3. Committee on Identifying the Needs of the Forensic Sciences Community, *Strengthening Forensic Science in the United States: A Path Forward*, National Research Council, 2009.
4. Dragan Primorac i suradnici, *Analiza DNA U Sudskoj Medicini I Pravosuđu, Medicinska Naklada Zagreb*, 2008.
5. Estref Myftari, *Kriminalistika, Hyrje në Kriminalistikë*, Tiranë, 2008.
6. Gaensslen R. E., Harris A., H. Lee H (2008), *Introduction to Forensic Science & Criminalistics*, New York.
7. House research organization, *Focus report*, Texas: House Representatives, 2000.
8. Korajlija N. & Muharremi D., *Kriminalistika*, Prishtinë, 2009.
9. Nathan James, *DNA Testing in Criminal Justice: Background, Current Law, Grants, and Issues*, Congressional Research Service, 2012.
10. Olluri B., *Disertacioni i Doktoraturës*, 2016.
11. Saferstein R., *Criminalistics, An introduction to Forensic Science*.
12. Saferstein R., *Criminalistics, An Introduction to Forensic Science, 9th edition*, për këtë botim në gjuhën shqipe, TABERNAKULL.
13. Suzane B., *Dictanary of Forensic Science*, 2004
14. Saferstein R., *Lab Manual, Crimnalistics, An introduction to Forensic Science*, New Jersey.

# Hartimi e zbatimi i programeve bashkëkohore, në luftën kundër kriminalitetit

**MSc. Ilija NASI**  
Akademia e Sigurisë  
ilia.nasi@asp.gov.al

**MSc. Skënder KALEMI**  
Akademia e Sigurisë  
skender.kalemi@asp.gov.al

## Abstrakt

*Në kushtet aktuale të zhvillimit të shoqërisë shqiptare, Policia e Shtetit krahas strukturave të tjera të zbatimit të ligjit, po has problematika dhe forma specifike të shfaqjes së kriminalitetit. Kjo situatë kërkon një njohje të saktë të situatës dhe tendencave që cenojnë sigurinë si dhe koordinim e menaxhim sa më real dhe ligjor, me të gjitha strukturat ligjzbatuese. Policia e Shtetit, në punën e saj, si parim bazë ka zbatimin e ligjit dhe sundimin e tij dhe, për të realizuar këtë parim, ka përcaktuar se krahas formave të tjera, duhet që të arrijë modernizimin e saj nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve të marrjes së informacionit, rritjes së fuqisë zbuluese dhe asaj hetimore. Për realizimin e detyrave të saj institucionale, po shfrytëzon risitë që ofron zhvillimi i teknologjisë dhe informacionit, me ndërtimin dhe implementimin e programeve bashkëkohore, duke u mbështetur në këto procese edhe nga partnerët ndërkombëtarë. Koha kërkon, që policia të rrisë besimin në komunitet dhe në institucionet e tjera ligjzbatuese, si dhe të jetë në gjendje që mbi baza reale dhe të besueshme, të bëjë analiza pune dhe prognoza për kriminalitetin, tendencat që ai ka dhe format në të cilat ai shfaqet. Policia e Shtetit, mbështetur fuqishëm nga programi ICITAP, nisur nga shumëllojshmëria e kriminalitetit dhe procesi i hetimit dhe dokumentimit të tij, bërja e analizave shkencore për shkaqet si edhe në reflektim edhe të vërejtjes së bërë në progres raportin e Komitetit European se “..Policia e Shtetit nuk ka statistika të besueshme”, ka ndërtuar dhe po implementon “Sistemin e menaxhimit policor të çështjes”, i cili do të zgjidhë një sërë problematikash me të cilat ndeshet aktualisht policia. Menaxhimi policor i çështjes dhe sistemi i analizës statistikore me anë të hartave digjitale, është një program me anë të së cilit përfitohen rezultate konkrete që influencojnë në promovimin e mënyrave dhe teknologjive për marrjen, transmetimin, trajtimin dhe shfrytëzimin e informacionit për ngjarjet e ndodhura.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**Policia e Shtetit, raportngjarje, menaxhimi policor i çështjes, bashkëpunimi me strukturat ligjzbatuese, siguria publike.**

## 1. Hyrje

Ndërtimi i strukturave eficiente, të mbështetura me burime njerëzore sa më të shkolluara dhe të kualifikuara, ka qenë dhe mbetet prioritet i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe i partnerëve tanë strategjik ndërkombëtar.

Në këtë angazhim serioz, të rëndësishëm për modernizimin e teknikës, programeve, si dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore, për marrjen me cilësi të informacionit me qëllim rritjen e fuqisë zbuluese dhe kryerjen në përputhje të plotë me procedurën penale të veprimeve hetimore, elementët menaxherialë të planifikimit, organizimit, drejtimit dhe kontrollit, në kombinim harmonik me njëri-tjetrin kanë luajtur një rol shumë pozitiv, zhvillues për organizatën e policisë.

Për realizimin e detyrave të saja institucionale, Policia e Shtetit po shfrytëzon risitë, që ofron zhvillimi i teknologjisë dhe informacioni, duke ndërtuar dhe implementuar programe bashkëkohore, me qëllim ngritjen e nivelit profesional të efektivave. Në këtë proces, ajo është mbështetur në mënyrë permanente nga partnerët ndërkombëtarë e më konkretisht, nga programi ICITAP, i cili ka luajtur një rol të rëndësishëm për implementimin duke përfshirë në diskutime e sqarime për vlerat që ofron edhe prokurorinë e shtetit.

Koha kërkon rritjen e besimit të policisë në komunitet, po kështu, edhe të institucioneve të tjera ligj zbatuese. Në çdo kohë, organizata e policisë, duhet të jetë në gjendje, që mbi baza reale dhe të besueshme, të bëjë analiza pune dhe prognoza për kriminalitetin, tendencat që ai ka dhe format në të cilat ai shfaqet. Implementimi i “Sistemit të menaxhimit policor të çështjes” ishte kërkesë e kohës dhe zhvillimeve të organizatës së policisë gjithashtu, dhe, vërejtja e bërë në progres-raportin e Komitetit

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

European të vitit 2016 se, “Policia e Shtetit nuk ka statistika të besueshme”, ishte indicie serioze për këtë implementim, i cili ka si objektiv evidentimin në kohë dhe ecurinë e ngjarjeve kriminale deri në paraqitjen e akuzës në gjykatë<sup>1</sup>.

Pra, do të zgjidhë një sërë problematikash, lidhur me evidentimin e saktë statistikor, që aktualisht policia ndeshet, lidhur me shumëllojshmërinë e kriminalitetit, proceset specifike të hetimit, punës së vështirë dokumentuese si dhe bërjes së analizave shkencore për shkaqet, motivet dhe tendencat kriminale.

Menaxhimi policor i çështjes dhe, sistemi i analizës statistikore me anë të hartave digjitale, është një program me anë të së cilit përfitohen rezultate konkrete që influencojnë në promovimin e mënyrave dhe teknologjive për marrjen, transmetimin, trajtimin dhe shfrytëzimin e informacionit për ngjarjet e ndodhura.

Objektivat e këtij projekti janë:

- ndërtimi i modulit për regjistrimin e denoncimeve në polici ose prokurori,
- ndërtimi i modulit për regjistrimin e telefonatave të sallës operative,
- modifikimi/përmirësimi i modulit të raportit të ngjarjes,
- ndërtimi i modulit të raportit suplementar,
- ndërtimi i modulit të llojit të statistikave,
- inkorporimi i ADAM si modul të sistemit dhe lidhja e tij me raporte e ngjarjes dhe ato suplementare.<sup>2</sup>

Disa sqarime se ç’është ADAM: “ADAMI ose “Banka qendrore elektronike për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar” është në përdorim nga strukturat e Policisë së shtetit, aprovuar me urdhër nr. 258 datë 6. 6. 2012 të Drejtorit të Përgjithshëm; pjesë përbërëse të këtij urdhri janë edhe procedurat standarde të punës.”<sup>4</sup>

## 2. Rreziqet e përgjithshme<sup>5</sup>

### 2.1 Buxheti

Ky projekt, nga natyra që ka, kërkon shtrirje të gjerë të tij, në të gjitha komisariatet dhe drejtoritë e qarqeve. Çdo sallë operative, duhet të ketë akses për hedhjen e çdo raporti telefonate. Gjithashtu, për të pasur një pasqyrim sa më real dhe në kohë të ngjarjeve kriminale, zgjidhja optimale është krijimi i mundësisë logjistike të çdo oficeri që do plotësojë një raport ngjarjeje në terren ose në komisariat/drejtori, të bëjë hedhjen e raportit, vetë, në sistem. Diçka e tillë do të mund të realizohet duke krijuar në çdo komisariat/drejtori, poste pune të pavarur (kompjuter të lidhur me rrjetin e TIMS), të cilat mund të përdoren nga çdo oficer me të drejtë për tu futur në sistem dhe për të hedhur raportet e ngjarjes dhe raportet suplementare. Diçka e tillë, kërkon krijimin e 2 ose 3 posteve pune për çdo komisariat/drejtori, në varësi të ngarkesës. Diçka e tillë, është plotësisht e varur nga buxheti që ky projekt do të ketë. Mungesa e buxhetit për ketë pjesë të projektit, do të ndikojë në përdorimin e sistemin në shkallë sa më të gjerë, pra do ndikojë në të dhënat që do pasurojnë sistemin dhe rrjedhimisht, në raportet dhe

<sup>1</sup> Progres-Raporti i Komitetit European, 2016.

<sup>2</sup> Nga deklarata e punës hartuar para aprovimit të projektit.

<sup>3</sup> Nga deklarata e punës hartuar para aprovimit të projektit. e vitit 2012, përdorim të brendshëm.

<sup>4</sup> Konspekt, pjesë nga deklarata e punës, hartuar nga Programuesit e Programit ICITAP dhe Grupi i Punës së Policisë së Shtetit, viti 2012, për përdorim të brendshëm.



statistikat të cilat nuk do jenë të plota.

Një tjetër çështje e ndjeshme dhe që preket direkt nga buxheti, është ajo e hartave digjitale. Aktualisht, ka disa opsione për hartën digjitale që mund të përdoret në sistem.

## **2.2 Përdorimi i hartave ekzistuese**

Një opsion i tillë do jetë një zgjidhje jo e mirë, duke marrë në konsideratë vjetërsinë e këtyre hartave dhe ndryshimet e shumta që kanë ndodhur në infrastrukturën e Shqipërisë. Por, një zgjidhje e tillë nuk do ndikohet nga buxheti.

## **2.3 Blerja e hartave statike nga ofruesit lokalë**

Opsion i cili ka varësi direkte nga buxheti i projektit, ku duhet të parashikohen edhe rinovimi periodik i hartave i cili duhet të bëhet manualisht.

## **2.4 Blerja e të drejtës për përdorimin e hartave të “Google”**

Një blerje e tille, është licencë vjetore që “Google” ofron për të gjithë bizneset që kërkojnë përdorimin e hartave “Google” për një grup të kufizuar përdoruesish, por që është më e efektshme në kosto, në raport me hartat që ofrohen lokalisht.

Çështje tjetër, që preket nga buxheti dhe që është pikë kyçe për suksesin e projektit, është faza e implementimit, ku përveç krijimit të posteve të punës, përfshihen edhe udhëtimet dhe dietat e personave që do udhëtojnë në çdo komisariat/drejtori për implementimin dhe trajnimin fillestar për sistemin.

## **3. Synimet që duhet të arrijmë nëpërmjet sistemit “Menaxhimi policor i çështjes”**

Në këtë material, po japim të dhëna për synimet që duhet të arrijmë nëpërmjet sistemit “Menaxhimi policor i çështjes” si dhe disa sqarime për raportin e ngjarjes, kodin policor dhe sistemin ADAM, si pjesë e pandarë e menaxhimit policor. *Menaxhimi policor i çështjes, dhe sistemi i analizës statistikore me anë të hartave digjitale*, është një projekt me anë të së cilit përfitohen rezultate konkrete, që influencojnë shumë në promovimin e mënyrave dhe teknologjive për marrjen, transmetimin, trajtimin dhe shfrytëzimin e informacionit, për ngjarjet e ndodhura dhe për realizimin e analizave në nivel operacional dhe strategjik.

Për të ndërtuar raporte të drejta dhe të besueshme me të gjitha strukturat ligjbatuse dhe, për të bërë me këto të fundit, analiza pune produktive dhe të efektshme, në bashkëpunim me Programin “ICITAP”, ky projekt ka filluar si projekt pilot për raportin e ngjarjes, në vitin 2007, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Gjatë vitit 2008-2009, projekti është implementuar në të gjithë njësitë e policisë në shkallë vendi<sup>5</sup>. Tashmë, për çdo ngjarje të ndodhur, prodhohet një raport ngjarje nga punonjësi i policisë që vete i pari në vendngjarje, i çfarëdo niveli qoftë ai punonjës. Ky raportngjarje bëhet pjesë e materialeve që referohen në prokurori.

Në këtë projekt, janë të përfshirë drejtoritë e policisë së qarqeve, drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit dhe, komisariatet e policisë në vend. Është realizuar faza e

<sup>5</sup> Konspekt, pjesë nga deklarata e punës hartuar nga Programuesit e Programit ICITAP dhe Grupi i Punës së Policisë së Shtetit, viti 2012 për përdorim të brendshëm.

parë e këtij projekti që ka të bëjë me “Raportin e ngjarjes”, i cili përbëhet nga katër dokumente:

- raporti për ngjarjen (llojin e ngjarjes, apo shkeljes sipas përcaktimit në kodin penal etj.);
- raporti për viktimat dhe dëshmitarët (informacionin rreth viktimës/-ve dhe dëshmitarit/-ve të ngjarjes ose krimit të raportuar etj.);
- raporti për personat e dyshuar dhe automatjetet (informacion rreth të dyshuarit/-ve të përfshirë në krimin e raportuar dhe përfshin informacion biografik dhe përshkrues si dhe informacion për çdo automatjet të përfshirë në një krim apo ngjarje të raportuar);
- pjesa shpjeguese (informacionin shtesë dhe detajet e ngjarjes së krimit apo ngjarjes së raportuar).

Projekti i menaxhimit dhe sistemi i analizës statistikore, ofron mundësinë që për çdo raportim për ngjarje, vendoset automatikisht dhe gjenerohet një numër unik për çdo ngjarje që raportohet. Ngjarjet e ndryshme, të cilat përbëjnë ose jo vepër penale siç janë: vjedhjet, vrasjet, aksidentet, vetëvrasjet, etj., hidhen në TIMS në modulën e “Raportit të ngjarjes”.

Raporti i ngjarjes është informacioni i parë *bruto* që merret rreth një ngjarjeje. Ky raport plotësohet në letër, në ato drejtori vendore ku sistemi është implementuar; hidhet nga vetë punonjësi i policisë që e ka formuluar në sallat e TIMS-it, të krijuara tashmë në çdo njësi policore. Ndërsa, në ato struktura policore ku sistemi akoma nuk është implementuar, ai dorëzohet në zyrat e sektorit të analizës së informacionit kriminal të drejtorive ose komisariateve të policisë dhe, hidhen në sistem nga punonjës të këtyre sektorëve. Projekti i menaxhimit të çështjes, ka të bëjë me një sërë fazash për tu zhvilluar në tërësinë e vet si projekt, ku aktualisht, nga ana jonë është zhvilluar faza e parë, e cila ka të bëjë me *raportin e ngjarjes*, si dhe në disa drejtori, është implementuar i gjithë sistemi.

Krijimi i një raport-ngjarje policore, nis në një nga mënyrat e mëposhtme:

- denoncim i qytetarit direkt në polici;
- denoncimi i qytetarit në prokurori;
- telefonatë në sallat operative të strukturave policore;
- konstatim i ngjarjes nga vetë oficerët e policisë.

#### **4. Pasqyrimi nëpërmjet këtij sistemi, i rezultateve dhe treguesve që ka çdo punonjës policie**

Mungesa e një sistemi funksional, i cili regjistron të gjitha ngjarjet të cilat janë burim i një prej mundësive të mësipërme, e bën shumë të vështirë për të mos thënë të pamundur, matjen reale të punës së policisë dhe, si pasojë, edhe të planifikimit të saktë të burimeve në zonat më në nevojë. Statistikat aktuale që prodhon Policia e Shtetit, mbështeten në të dhëna të cilat përpunohen në mënyrë manuale nga ekspertët e sektorit të statistikave. Kjo procedurë kërkon shumë kohë, lë shumë hapësira për interpretim dhe mungesë saktësie në të dhënat që prezantohen. Sistemi i menaxhimit policor të çështjes, mundëson regjistrimin “online” të së gjithë ngjarjeve, që nga informacioni i parë, bruto dhe informacioni i veprimeve hetimore e deri në momentin kur ngjarja do referohet përfundimisht në prokurori<sup>6</sup>.

<sup>6</sup> Konspekt, Pjesë nga Deklarata e punës hartuar nga Programusit e Programit ICITAP dhe Grupi i Punës së Policisë së Shtetit, viti 2012, për përdorim të brëndshëm.

Një sistem i tillë, do këtë përdorues nga shumë struktura policore, që nga salla operative, zyrat e marrjes së denoncimit, sektorët përkatës të hetimit, apo patrullat e përgjithshme dhe do t'i japë Policisë së Shtetit, mundësinë e pasqyrit të punës së tyre, mundësinë e planifikimit të burimeve dhe gjenerimit të sakta të raporteve dhe statistikave, si:

- Hedhjen në mënyrë elektronike “online” në modulën elektronik ADAM të së dhënave të formularëve të ndalim/arrestimit dhe figurës së përshkruar, për çdo të ndaluar dhe të arrestuar, nga ana e vetë punonjësve të Policisë së Shtetit që do bëjnë ndalime/arrestime, duke përfshirë edhe nxjerrjen “online” në kohë reale të numrit të regjistrimit kriminal për të ndaluarit dhe të arrestuarit.

- Krijimin e aksesit për nivele dhe funksione të caktuara të punonjësve të Policisë Shtetit për të marrë informacion për personat e ndaluar dhe arrestuar, të dhënat e të cilëve do të administrohen në modulën ADAM.

- Krijimi i statistikave periodike nga moduli ADAM, për nivele dhe funksione të caktuara të punonjësve të Policisë së Shtetit, për të marrë informacion për personat e ndaluar dhe arrestuar në shkallë vendi e qarku.

- Plotësimin në dinamikë të së dhënave që lidhen me zbatimin e të drejtave së të ndaluarve e së të arrestuarve nga momenti i ndalimit/arrestimit deri në marrjen e masës së sigurisë nga gjykata.

- Krahasimi automatik në sistemin AFIS/APIS në mënyrë të pavarur nga specialistët e sektorit të daktiloskopisë të Drejtorisë së Policisë Shkencore, të gjurmëve të duarve (gishta dhe pëllëmbë) të personave të ndaluar/arrestuar, që mbërrijnë “online”, për identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve, që janë administruar si prova shkencore, në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.

- Identifikimi i menjëherëshëm me gjurmët e gishtave të së gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në pikat e kalim-kontrollit me gjeneralitete të ndryshme në pasaportat e tyre, në rast se ata kanë qenë më parë në daktiloskopi. Rritja e shpejtësisë në kthimin e përgjigjeve për kërkesat që do të bëjë policia kriminale, policia gjyqësore për identifikimin e personave me gjurmë papilare, si dhe Interpol Tirana për personat shtetas shqiptarë, që arrestohen në vende të ndryshme brenda hapësirës së Interpolit.

- Dërgimi “online” në kohë reale, sa më të shpejte, nga çdo drejtori e komisariat policie ku do të instalohen këto “Live Skanerë”, direkt në sistemin AFIS, të imazheve të gjurmëve papilare që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore, në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) dhe që do të merren me anën e gjurmëkopjuesve, si dhe, imazhet e kartelave daktiloskopike të marra me bojë, të personave të shoqëruar, me qëllim identifikimin e këtyre personave.

- Krijimi i një rrjeti unik me pajisje “Live Skanerë” që do të instalohen pranë laboratorëve të policisë shkencore në të gjithë drejtoritë e policive të qarqeve (për Tiranën edhe në të 6 komisariatet e saja), në të gjithë komisariatet e policisë, në rrethet gjyqësore, si dhe në komisariatet e policisë së kufirit dhe emigracionit (gjithsej 44 copë të tillë). Këto pajisje do të lidhen “online” nëpërmjet rrjetit informatik të Ministrisë së Brendshme, me sistemin e identifikimit të gjurmëve të gishtave AFIS/APIS Papillon 7, të instaluar në Drejtorinë e Policisë Shkencore (aktualisht vetëm në disa drejtori qarqesh dhe pika kontrolli, ka skaner, në projektfishën, që u është dhënë ekspertëve të KE-së, janë dhënë sqarime për vlerat dhe mundësitë që i krijohen Policisë së Shtetit me këta skanerë dhe, u është kërkuar mbështetja me fonde konkrete, për pasjen e të gjitha

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

strukturave policore, propozim që është pranuar).

- Përmirësimi i ndjeshëm i cilësisë së marrjes së gjurmëve të duarve dhe të fotografive sinjalitike, të personave që fotodaktiloskopohen duke përdorur teknikat moderne të marrjes së gjurmëve papilare, pa përdorimin e bojës, si dhe fotografimin me ngjyra, me aparate digjitale në momentin e ndalim/arrestimit.

## 5. Përfundime

Sistemi *Manaxhimi policor i çështjes* që po ndërtohet gjatë këtij projekti, do krijojë mundësinë që në të ardhmen të shkëmbehet informacion në mënyrë automatike me sisteme të tjera. Strukturat kryesore, punonjësit e të cilave do jenë përdorues të sistemit janë komisariatet e policisë, drejtoritë e policisë së qarqeve, drejtoritë rajonale të kufirit & migracionit, pikat e kontrollit të kalimit kufitar, komisariatet e trafikut në DPO, komisariatet e menaxhimit të trafikut interurban, prokuroritë/oficerët e policisë pranë prokurorive, departamenti i Krimit të Organizuar/drejtoria e Analizës së Informacionit Kriminal, departamenti i Sigurisë Publike, drejtoria e Mbrojtjes e Përpunimit së të Dhënave.

Këto struktura, janë përdoruesit aktivë të sistemit, të cilët do ta furnizojnë atë me informacion dhe në të njëjtën kohë, do shfrytëzojnë informacionin e tij. Por, duhet të theksohet që përfitues të sistemit do të jenë edhe shumë struktura të tjera të policisë, të cilat do mund të shfrytëzojnë informacionin e sistemit nëpërmjet modulit të raportimit/statistikave. Realizimi i objektivave të mësipërme, në "Sistemin e menaxhimit policor të çështjes", që do të shtrihet në gjithë Shqipërinë, do t'i ofrojë Policisë së Shtetit një sistem, që përveç menaxhimit të çështjes, do të prodhojë edhe raporte e statistika për nivele të ndryshme vendimmarrëse.

Deri tani në funksion të implementimit të këtij sistemi është hartuar Kodi Policor. Nëpërmjet këtij kodi synohet që<sup>7</sup>:

Pasqyrimi në *Raportin e ngjarjes* i të gjithë veprimeve të kryera; hedhja në modulën elektronik të programit ADAM (për ndalim/arrestimet) nga oficerët e policisë, do të bëjë të mundur që të pasqyrohen në mënyrë të saktë të gjithë ngjarjet dhe veprat penale, të cilat janë objekt i punës së policisë. Në këtë mënyrë do të krijohet mundësia e pasqyrimin të së gjitha veprimeve të kryera në funksion të ngjarjeve, si dhe nëpërmjet sistemit do të gjenerohen të dhëna të sakta në lidhje me kriminalitetin, llojet, mjetet e përdorura, pasojat e ardhura, shtrirjen e tij në hapësirë dhe në kohë, etj.

Ne vlerësojmë se, pasqyrimi në këtë mënyrë i ngjarjeve dhe në veçanti, statistikat që do të dalin nga ky lloj pasqyrimi, do t'u shërbejnë strukturave menaxhuese për zhvillimin mbi baza më reale të analizave të punës, të grupeve të punës së vlerësimit taktik dhe atij strategjik, ç'ka do t'i shërbente më mirë orientimit të fuqisë zbuluese, shpërndarjes dhe planifikimit të drejtë e të saktë të forcave dhe mjeteve në dispozicion, etj.

Raporti i ngjarjes/raporti suplementar, do të përfshijë ndryshimet që lidhen me:

- grupimin e veprave penale,
- grupimin e motiveve të kryerjes së veprave penale,
- grupimin e mjeteve të kryerjes së veprave penale,
- grupimin e pasojave në ngjarjet aksidentale.

<sup>7</sup> Konspekt, pjesë nga deklarata e punës, hartuar nga programuesit e Programit ICITAP dhe Grupi i Punës së Policisë së Shtetit.

## 6. Rekomandime

Për implementimin e këtij projekti, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupeve të punës për hartimin e procedurave standarde për menaxhimin policor të çështjes dhe sistemin e analizës statistikore më anën e hartave digjitale”, u ngritën grupet e punës dhe hartuan procedurat standarde në lidhje me:

- modulën për regjistrimin e denoncimeve në polici/prokurori dhe modulit për regjistrimin e telefonatave të sallës operative;
- modifikimin/përmirësimin e modulit të raportit të ngjarjes;
- modulën e raportit suplementar;
- modulën e raportimit dhe statistikave.

Aktualisht, grupi i punës i Programit “ICITAP” dhe ai i Policisë së Shtetit, ka implementuar këtë program, në aparatin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në drejtoritë vendore dhe ato të kufirit dhe migracionit, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë dhe Lezhë; vazhdon puna për trajnimin dhe pastaj implementimin, në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit nga qendra në bazë, si dhe është në përfundim, për prodhimin e moduleve të statistikave dhe të pasqyrimin të ndryshimeve që kanë dalë gjatë fazës së pilotimit në drejtoritë e mësipërme.

Disa nga funksionalitetet që do të mund t’i shtohen këtij sistemi në të ardhmen do jenë:

- Shkëmbimi automatik i të dhënave me prokurorinë. Për këtë, duke qenë se në Prokurorinë e Përgjithshme me financimin e KE-së është ngritur dhe po punon grupi i punës për ndërtimin e sistemit të “Menaxhimit të çështjes”, është bërë dhe firmosur nga titullarët e të dy institucioneve udhëzimi i përbashkët Polici e Shtetit - Prokurori, për mënyrën e bashkëpunimit dhe të funksionimit të sistemeve në faza të ndryshme të procesit hetimor.

- Janë përcaktuar pikat e përbashkëta dhe për çfarë shiritesh do të ketë shkëmbim informacionesh dhe ku do të koepojnë të dy sistemet.

- Në kuadër të punës që po bëhet nga të dy institucionet tona, për implementimin e sistemeve elektronike, nevojitet të identifikojmë mundësitë e përfitimeve të përbashkëta nga këto sisteme.

- Shkëmbimi automatik i të dhënave me sistemet e AFIS dhe MEMEX. Krijimi i një moduli i cili do regjistrojë raportet inteligjente dhe do të bëjë dërgimin automatik të së dhënave në MEMEX.

Për të vazhduar implementimin me sukses të këtij sistemi, duke qenë se përdorues të tij do të jenë të gjitha strukturat operacionale të policisë si dhe fakti se Programi “ICITAP” ka sjellë tashmë 1000 njësi, është ndërtuar puna, në mënyrë të tillë që të gjithë punonjësit e policisë, të jenë njohës të mirë në përdorimin e kompjuterëve. Në çdo institucion policor janë krijuar dhe do të krijohen, në ato njësi policore që s’janë ndërtuar, mini-salla, ku në to do të instalohen kompjuterë sipas nevojës, ku do të bëhet e mundur që çdo punonjës policie, të ketë fjalëkalimin e vet dhe të ketë mundësi që të hedhë në sistem vetë, materialin që i takon e ta formatojë sipas procedurave standarde.

## Referenca

1. Programuesit e Programit ICITAP dhe Grupi i Punës së Policisë së Shtetit, *Deklarata e Punës*, 2012.
2. *Deklarata e punës*, hartuar para aprovimit të projektit.
3. *Progres-Raporti i Komitetit European*, 2016.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

# Profilet psikologjike: domosdoshmëri për hetimin

■ MSc. Anisa AGASTRA

Akademia e Sigurisë

anisa.agastra@asp.gov.al

■ Dr. Silvana IBRAHIMI

Akademia e Sigurisë

ibrahimi.silva@gmail.com

■ Cav. Dr. Ervin IBRAHIMI

Pëfaqësues i

Këshillit të Sigurisë, Itali

## Abstrakt

*Studimet dhe tendencat e fundit po përqendrohen gjithnjë e më shumë te ndërtimi i profileve psikologjike. Profilizimi lidhet me tipologjinë dhe tërësinë e karakteristikave të jashtme e të brendshme të individit, - dhe jo vetëm, - e që ndihmon oficerët e policisë dhe hetuesit, në kryerjen e parashikimeve të sakta rreth probabilitetit që një person të ketë kryer një krim, mundësisë së rezikshmërisë së një forme krimi në shoqëri, etj. Qëllimi i këtij punimi, është që të trajtojë në një pikëpamje analitike domosdoshmërinë e ndërtimit dhe përdorimit të profileve psikologjike në fushën e hetimit, e më gjerë, duke marrë shkas nga niveli i lartë i vëmendjes në rang botëror, në Evropë dhe në Amerikë, për këtë shkencë praktike relativisht të re. Metodologjia e ndjekur, në kuadër të përmbushjes së qëllimit të punimit, është specifike dhe metodat e aplikuara janë ato cilësore, ku është realizuar hulumtim literature në gjuhë të huaj e shqipe; është përdorur analiza logjike, didaktike e me blloqe; si dhe studime rasti të ndërtimit dhe aplikimit të profileve. Profilet mund të jenë të përgjithshme, që mund t'i referohen tipologjisë së formave të ndryshme të krimit, - si rasti i trajtuar në tekst, i profilit të krimit kibemetik në Shqipëri, - dhe ndihmojnë në përcaktimin e shkallës së problematikës së një krimi, për kuptimin e nivelit të rezikshmërisë, etj. Profilet mund të jenë edhe të veçanta, që lidhen me grumbullimin e të dhënave përgjatë ndodhisë së një krimi lidhur me autorin, viktimën, apo edhe me vetë krimin. Në këtë rast, profilet japin një pamje historike të sjelljeve, preferencave, karakteristikave të personit apo ngjarjes. Ato bazohen në burimin kryesor që është skena e krimit dhe shërbejnë për të bërë parashikime, për të ndërtuar një "të dyshuar tip" dhe për të ndihmuar në gjetjen e fajtorit apo të fajtorëve. Këto shpjegime shoqërohen me një studim rasti, ku trajtohet ndërtimi i profilit sipas pesë stave, sipas modelit të FBI-së, që konkretizohen me anë të një ngjarjeje konkrete. Profilet psikologjike përdoren në të gjitha fushat e jetës, e sidomos në fushën e hetimit, fushën ligjore, psikologjike e atë të praktikës policore. Pavarësisht rezultateve jo tërësisht absolute që japin, ato janë të nevojshme për tu përdorur pasi zhvillojnë aftësinë interpretuese e analitike të ngjarjes dhe ndikojnë në efikasitetin e procesit të hetimit dhe studimit të fushës së gjerë të kriminalitetit në përgjithësi.*

## Fjalëkyçe:

profile psikologjike, hetim, parashikim, skenë krimi, stade, tipologji.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Hetimi është procesi i përcaktimit të fakteve dhe kryerjes së ekzaminimeve të hollësishme e të kujdesshme, për të zbuluar atë që mund të ketë ndodhur dhe autorin e ngjarjes<sup>1</sup>. Skenat e aksidentet e automjeteve, vdekjet aksidentale apo të papritura, vetëvrasjet, vrasjet e dyshuara, vjedhjet, mashtrimet, sulmet seksuale, zjarret dhe hetimet e drogës janë të gjithë shembuj të skenave të mundshme të krimit.

Në ditët e sotme po marrin gjithnjë e më shumë vëmendje studimi dhe perfeksionimi i hetimit, sidomos në fushën e ekzaminimeve dhe diagnozave të trurit, problemeve, çrregullimeve dhe karakteristikave të personalitetit e të tjera që lidhen me këto. Për këtë shërbejnë profilet psikologjike, që janë pamje historike të sjelljeve të çdo individi duke dhënë detaje të përsëritura të sjelljes së një personi, si dhe të dhënat dhe vlerat e ndryshme psikologjike të rezultateve psikike të tipareve të tij<sup>2</sup>. Ato përfshijnë sjellje dhe preferenca që i përkasin të shkuarës dhe të tashmes së kohëve të fundit me qëllim parashikimin. Ndërsa profilet psikologjike të personalitetit ndihmojnë në zbulimin e talenteve të veçanta të personi, emocionet, drejtimet seksuale, prirjet për të tradhtuar, vëmendjen e tyre, prirjet për të gënjyer, për të mbajtur sekrete, histori të abuzimit, etj.

Profilizimi ka një histori të gjatë. U përdor që në fillim të viteve 1880, kur dy mjekë, George Phillips dhe Thomas Bond, përdorën gjurmë të skenës së krimit për të bërë parashikime për personalitetin e vrasësit seria, *Jack the Ripper*. Në të njëjtën kohë, profilizimi ka hyrë në rrënjë në Shtetet e Bashkuara, ku, deri në dekadat e fundit, profilistët u mbështetën kryesisht në intuitën e tyre dhe studimet informale. Schlossberg, i cili ka zhvilluar profile të shumë kriminelëve, përfshirë David Berkowitz - “Biri i

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

<sup>1</sup> Për më tepër shih <http://www.csitechblog.com/crime-scene-investigation>

<sup>2</sup> Edmond Dragoti, *Psikologji Ligjore e krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti 2000, 2011), 200.

Samit” i Nju Jorkut - përshkruan qasjen që ai përdorte në fund të viteve 1960 dhe 70: “Ajo që do të bëja,” thotë ai, është ulja. Dhe shikoni në rastet kur kriminelët ishin arrestuar, unë listova sa ishin të vjetrit, qofshin ata meshkuj apo femra, shkallën e tyre të arsimimit, a ishin ata nga familjet e thyera, a kishin probleme të sjelljes në shkollë? Shumë faktorë si unë mund të vijnë me të, dhe pastaj i shtova ato për të parë se cilat ishin më të zakonshme<sup>3</sup>.

Profilët, përdoren në përgjithësi për nxjerrë veçori të autorit e viktimës, për të ndihmuar gjatë procesit të hetimit. Këtu përfshihen forma të ndryshme profilesh, si profilet e personalitetit, profilet e vrasësit, profilet psikologjike kriminale, etj. Nga ana tjetër, profilet mund të përmbledhin veçori të një forme krimi dhe të japin një tipologji të përgjithshme apo të veçantë të asaj forme të krimit. Ato gjithashtu përdoren në çdo fushë të jetës, në procesin e rekrutimit në kompanitë private, në seancat e këshillimit të karrierës, në jetën personale për sa i përket zgjedhjes së një mikeje, partnerit të jetës, marrjes së vendimit të duhur, etj. Në këtë punim, do të realizohet një analizë e gjithanshme e profileve psikologjike në fushën e hetimit, do të arsyetohet se pse janë të nevojshme, do të paraqiten mënyrat, hapat e ndërtimit dhe përmbajtja e një profili, do të shpjegohet përgjatë tekstit nevoja për t’i përdorur ato në fushën e psikologjisë, të ligjit dhe në praktikën policore si dhe do të paraqiten dy studime rasti: një i përgjithshëm që lidhet me profilin e një forme krimi dhe tjetri i detajuar, që përshkruan hapat e procesit të profilizimit sipas modelit të FBI-së, të sqaruara paralelisht me një studim rasti.

Metodologjia e këtij punimi është specifike, pasi fokusohet në fushën e profileve psikologjike në procesin e hetimit. Metoda e zgjedhur është cilësore dhe instrumentet e zgjedhur për të realizuar metodën, janë hulumtimi i literaturës në gjuhë të huaj e shqipe, analizë logjike, dialektike e me blloqe.

## 2. Profilizimi dhe profilet psikologjike

*Profilizimi... nuk përcakton identitetin e kriminelit, por tregon tipologjinë dhe tërësinë e karakteristikave të personit që është i predispozuar për të kryer krimin<sup>4</sup>*

Procesi i profilizimit përfshin investigimin e krimit bazuar në analizën e skenës së krimit, në psikologjinë hetuese dhe në shkencat e sjelljes<sup>5</sup>. Zakonisht brenda këtij procesi hasen tre faza<sup>6</sup>: së pari, punonjësit e policisë mbledhin provat e mundshme nga skena e një krimi; së dyti, provat i adresohen një profilizuesi profesionist, i cili mundëson parashikime për personalitetin, sjelljen dhe karakteristikat demografike të kriminelit të dyshuar; së treti këto prova dhe profile i adresohen oficerëve dhe profesionistëve të hetimit të krimit.

Pavarësisht se nuk sigurojnë saktësi në masën njëqind për qind, profilet i ndihmojnë

<sup>3</sup> Lea Winerman, “Criminal profiling: the reality behind the myth” *Monitor on Psychology*, vol 35, nr. 7, July/August (print), 2004, 66.

Marrë nga: <http://www.apa.org/monitor/julaug04/criminal.aspx>

<sup>4</sup> Criminal Investigative Analysis, National Center For The Analysis of Violent Crime, (NCAVC), FBI Academy, “Critical Incident Response Group” (Quantico Virginia, Qershor 1988), 4. Për më tepër shih <https://vault.fbi.gov/Criminal%20Profiling/Criminal%20Profiling%20Part%201%20of%207>

<sup>5</sup> Për më tepër shih Scott A. Bonn, “The birth of modern day criminal profiling”, 26.05.2015. Marrë nga <https://www.psychologytoday.com/blog/wicked-deeds/201505/the-birth-modern-day-criminal-profiling>

<sup>6</sup> Snook Brent, Cullen M. Richard, Bennell Craig, Taylor J. Paul, Gendreau Paul, *The criminal profiling illusion* CE, Vol 35 “Criminal Justice and Behaviour”, 1257-1276, (International Association for Correctional and Forensic Psychology, 2008), 158.



shumë oficerët e policisë dhe hetuesit në punën e tyre, pasi sigurojnë e grumbullojnë të dhëna për autorët e viktimat, që lidhen me<sup>7</sup>:

- të dhëna fizike dhe psikologjike,
- informacione rreth qëndrimit, banimit dhe punës,
- mënyra së të sjellit para kryerjes së krimit,
- mënyra së të sjellit, vepruarit apo veçori të tjera, pas kryerjes së krimit.

Gjithmonë, ndërtimi i profileve në periudhën hetimore nisat nga premisa bazë që, *skena e krimit reflekton personalitetin e autorit*. Mënyra se si autori realizon krimin, mjetet që përdor, niveli dhe forma e dhunës së përdorur, tregojnë shumë për personalitetin e personit, deri edhe në shfaqje të mundësive që mund të vuajë ose jo, nga sëmundje apo çrregullime mendore. Profili i investigimeve në formën e analizës së sjelljes, që bazohet në shkencat e krimeve, filloi më 1995-n. Sa më të ngjashme arritjet e individëve në bazë të profileve, aq më të ngjashme do jenë sjelljet e tyre.

Një parim kryesor që profilizuesit theksojnë në rastet e një vrasjeje është: “Vendi i krimit mund të përmbajë sende simbolike (objekte ose imazhe) dhe statusi e gjendja e trupit varet nga qëllimi i vrasjes. Nëse vrasja ka për qëllim të demonstrojë një qëllim të gjerë, do të ketë pak përpjekje për të fshehur trupat, e nëse vrasja ka për qëllim të frikësojë brenda kultit, trupat mund të fshihen nëpërmjet varrimit<sup>8</sup>”.

Në shkencën e gjerë të profileve kriminale, sipas FBI (1885) ekzistojnë dy tipa të mëdhenj të kriminelëve: kriminelët e organizuar dhe kriminelët jo të organizuar, në varësi të së cilëve përcaktohet tipologjia, lloji i krimit dhe të dhëna të tjera që nevojiten në hetim, në parashikime për të dyshuarit e deri në gjetjen e shpalljen e fajtorit. Karakteristikat e tyre paraqiten si më poshtë<sup>9</sup>:

Kriminelë të organizuar	Kriminelë jo të organizuar
Nivel inteligjence mbi mesatare	Nivel inteligjence nën mesatare
Socialë	Josocialë
Të kualifikuar profesionalisht	Të pakualifikuar profesionalisht
Status i lartë	Status i ulët
Punë e qëndrueshme e të atit	Punë e paqëndrueshme e të atit
Të aftë seksualisht	Të paaftë seksualisht
Disiplinë jo e qëndrueshme në fëmijëri	Disiplinë e ashpër në fëmijëri
Sens vetëkontrolli gjatë krimit	Ankth gjatë krimit
Përdorimi maksimal i alkoolit gjatë krimit	Përdorim minimal i alkoolit gjatë krimit
Përfshihet në stresin e situatës	Përfshihet minimalisht në stresin e situatës
Jetojnë me një partner	Jetojnë vetëm
Lëvizshmëri në banim (makinë e kanë në gjendje të mirë zakonisht)	Jetojnë/punojnë afër vendit të krimit
Kanë shumë interes për ndjekjen e lajmeve në media për krimin	Nuk kanë interes për ndjekjen e lajmeve në media për krimin
Mund të ndryshojnë punën ose të largohen nga qyteti	Ndryshime të dukshme në sjellje

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

<sup>7</sup> Douglas P. Lyle, “Forensics: Profiling the perpetrator”.

Marrë nga <http://www.dummies.com/how-to/content/forensics-profiling-the-perpetrator.html>

<sup>8</sup> Crime scene profiling 2, “Criminal & Behavioral Profiling”, 32.

Marrë nga [https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423\\_ch\\_2.pdf](https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423_ch_2.pdf)

<sup>9</sup> po aty

Thelbi i ndërtimeve të profileve qëndron në tek grumbullimi i informacioneve nga të gjithë burimet e mundshme; strukturimi i tyre; analizimi e interpretimi me qëllim parashikimin. Profilet psikologjike përdoren sot në fusha të ndryshme të jetës, si aspektin personal ashtu dhe në atë profesional. Ato përdoren si referencë e mirë treguese në procesin e rekrutimit të punonjësve të përshtatshëm në pozicionet e punës në kompani e institucione; përdoren si mënyrë për të njohur tipologjinë e njeriut që shërben në zgjedhjen e një miku, partneri, pune, etj. Sipas studiuesit Douglas (1986) "*Procesi që ndiqet nga një profilizues në ndërtimin e një profile kriminal është i ngjashëm me atë që përdorin mjekët për të realizuar diagnozën dhe planin e trajtimit*"<sup>10</sup>.

Profilet mund të përdoren në të gjitha rastet, në të gjitha format me të gjitha dhënat për t'i shërbyer hetimit të krimit apo procesit të hetimit në përgjithësi rreth problematikës së formave të krimit. Për shembull, sipas studimeve psikologjike shijet muzikore, shprehinë dhe zakonet e blerjeve të një personi, etj., tregojnë shumë për psikologjinë, tiparet apo veçoritë e tij. Sistemet e përparuara të profilizimit të personalitetit zbulojnë cilësi e veçori të sjelljeve të çdo personi për të siguruar një nivel të plotë të dhënash mbi sjelljet e tij aktuale dhe të ardhshme, me qëllim parashikimin në bazë të informacionit të grumbulluar e të strukturuar<sup>11</sup>.

Mund të ndërtohen profile specifike me të dhëna nga skena e një krimi, siç do të demonstron më poshtë në punim, me qëllim parashikimin për gjetjen e të dyshuarve, e në fund fajtorin e krimit. Ndërkaq, mund të ndërtohen edhe profile më të përgjithshme, që të shërbejnë si modele tipike profilizimi, që ndihmojnë në nxjerrjen në pah të nivelit të problematikës së formave të ndryshme të krimeve brenda një periudhe të caktuar kohore, në varësi të interesit, si rasti i paraqitur më poshtë.

### **3. Profil i një forme të krimit: krimet kibernetike në Shqipëri në vitin 2016**

Duke analizuar dinamikën e ngjarjeve në Shqipëri dhe problematikën e fenomenit botëror 'balena blu', që preku të rinjtë shqiptarë, në rast se duam të krijojmë një profil tip të krimeve kibernetike nga të rinjtë, për vitin paraardhës (2016), fillimisht bazohemi tek të dhëna që mund të nxjerrim nga burime zyrtare, siç është Policia e Shtetit. Të dhënat janë të përmbledhura në dy tabelat e mëposhtme.

Nga këto tabela nxjerrim se në Shqipëri, në vitin 2016 janë evidentuar gjithësesi 175 raste të krimeve kibernetike, ku 50 prej tyre janë ngjarje të zbuluara me një nivel zbulueshmërie 28.6% dhe pjesa tjetër ende nën hetim.

Janë evidentuar 143 persona të dëmtuar ose 81.7% e rasteve, nga të cilat në 51% janë femra dhe 11.8% janë grupmoshë 14-18 vjeç, ose në gjuhën e shkencave sociale, adoleshentë. Pak a shumë, është një formë krimi që prek njësoj të dyja gjinitë dhe shihet si problematikë, që mund të dëmtojë më shpesh adoleshentët.

Nga të dhënat, rezultojnë 62 autorë të zbuluar të krimeve kibernetike në rang vendi, ku më problematik janë të rinjtë, të kategorizuar në grupmoshat 18-25 vjeç, në 35.5% të rasteve dhe 25-35 vjeç, në 30.6% të rasteve, ndërsa grupmosha që nuk kryen

<sup>10</sup> Snook Brent, et al., "The criminal profiling illusion" CE, Vol 35 Criminal Justice and Behaviour, fq 1257-1276, 2008, International Association for Correctional and Forensic Psychology, f. 1262.

<sup>11</sup> Për më tepër shih, Thomas Schafer et al., *The psychological functions of music listening* (US: National Library of Medicine, National Institute of Health, 13. 8. 2013).

krim kibernetik është 14-18 vjeç (0 raste). Kjo grupmoshë, është më e prirë të jetë viktimë e këtij krimi, që lidhet me problematikat e moshës dhe personalitetin ende të paformuar, duke mos përjashtuar edhe faktorë të jashtëm social, si edukimi familjar, raporti me prindërit, niveli i shkollimit dhe shoqëria. Ndërsa autorët janë më shumë të rinj, që mund të lidhet me shumë faktorë psikosocialë dhe ekonomikë, si gjithashtu dhe me afrimitetin dhe njohuritë më të mëdha që ka ky brez në raport me internetin dhe teknologjinë. Autorët që kryejnë këtë formë krimi, kanë kryesisht arsim 9-vjeçar, në 54.8% të rasteve, dhe arsim të mesëm, në 32.2% të rasteve. Për sa i përket nivelit arsimor, kjo kategori është problematike në shumë forma të krimit, duke përfshirë edhe vetëvrasjen.

Nga 175 raste të krimeve kibernetike, 27.4% e autorëve janë në gjendje të lirë, dhe kjo shton mundësinë e recidivizmit dhe rrit nivelin e rrezikut të kësaj forme krimi.

Profil forme krimi <sup>12</sup>							
Krimi kompjuterik në Shqipëri në vitin 2016							
Persona të dëmtuar							
Nr.	Gjendja			Grupmoshat		Gjinia	Totali
1	Gjithsej Evidentuar	Zbuluar	Gjithsej dëmtuar	Nën 14 vjeç	14-18 vjeç	Femra	
	175	50	143	1	17	73	62

Profil formë krimi <sup>13</sup>													
Krimi kompjuterik në Shqipëri në vitin 2016													
Autorë të veprave penale													
Gjithsej Evidentuar	Grupmoshat						Arsimi			Gjendja			
	Nën 14 vjeç	14-18 vjeç	18-25 vjeç	25-35 vjeç	35-45 vjeç	mbi 45 vjeç	9 vjeçar	I mesëm	I lartë	Arrestuar	Ndaluar	Gjendje e lirë	Larguar
175	0	11	22	19	6	4	34	20	8	6	3	48	5

Nxjerrja e këtij profili të përgjithshëm të krimit kibernetik ndihmon në pasqyrën e problematikës së këtij krimi në rang vendi: “kë prek më shumë?”, “nga kush kryhet më shumë?”, “sa është zbulueshmëria dhe si janë dënuar ose jo autorët?”, si dhe një analizë e parashikime koncize rreth problemit. Mbi këtë profil mund të ndërtohen profile të veçanta rasti apo të përgjithshme, që mund t’i shërbejnë identifikimit të autorëve apo viktimave të lojës “balena blu” apo të rasteve të tjera të formave të ndryshme të krimeve kibernetike, që mund të çojnë deri tek autori i ngjarjes. Në qoftë se do bënin analiza e paralelizma me balenën blu, viktimat e kësaj loje rezultojnë të jenë më së shumti adoleshentë, si grupmosha më e lehtë për t’u manipuluar virtualisht në aspektin psikologjik, që i çon ata drejt vetëdëmtimit dhe vetëflijimit<sup>14</sup>.

<sup>12</sup> Të dhëna nga Policia e Shtetit për vepra penale, të dëmtuarit dhe autorët e ngjarjeve, për periudhën 1. 1. 2016 -31. 12. 2016.

<sup>13</sup> po aty.

<sup>14</sup> Për më tepër shih:

<http://www.oranews.tv/vendi/balena-blu-loja-e-rrezikshme-per-femijet-verifikohet-ne-gjirokaster>,

<http://opinion.al/balena-blu-cfare-po-ndodh-ne-shqiperi-rritet-ne-nivele-te-frikshme-kurioziteti-per-lojen-vrasese>

## 4. Profilet dhe hetimi

Në rastin e hetimeve, qëllimi përfundimtar është identifikimi i të dyshuarve të mundshëm dhe gjetja e fajtorit të vërtetë të ngjarjes. Dhe jo vetëm kaq, por synimet më largpamëse e gjithëpërfshirëse, janë krijimi i prototipave, profileve përgjithësuese që merren nga raste konkrete e përdoren më tej si modele krahasuese për zgjidhje të rasteve specifike. Metoda e induksionit, marrja, mbledhja e grumbullimi i të dhënave për të formuar një profil dhe metoda e deduksionit, profilet e gatshme përdoren për të zbërthyer ngjarje e raste të tjera e për të parashikuar, kombinohen me njëra-tjetrën duke dhënë produkte efektive dhe duke rritur vlerën e domosdoshmërisë së profileve psikologjike e të personalitetit në fushën e hetimit.

Procesi i profilizimit dhe ndërtimi i profileve lidhet më së shumti me punonjësit e policisë, të cilët janë aktorët e parë që përballen me skenën e krimit. Suksesi i profileve psikologjike<sup>15</sup> konsiston në kombinimin e hetuesve me policët, që sigurojnë të dhëna për çështjen, si dhe në kombinimin e procedurave instiktive me ato shkencore. Një profilizues i mirë vjen si produkt i një eksperience të mirë dhe të zgjatuar në kohë, e cila ndikon në zhvillimin e instikteve dhe mprehtësisë për trajtimin e ngjarjeve, krijimin e profileve të sakta dhe përshtatjen e tyre për hetimin. Hetimi i profilit praktik kriminal<sup>16</sup> përdor fakte logjike dhe përfundime efektive, duke u bazuar mbi eksperiencën me skenat e krimeve, hetimet, ligjshmëritë, sjelljet kriminale në botën reale, kompetencat e hetuesve të vrasjeve, etj.

Analiza e detajuar, e profileve kriminale nga skena e krimit, ofron njohuri të mundshme për llojin e tipin e personave përgjegjës për krimin, motivet e mundshme, stilin dhe problematikën e jetesës së tyre, fantazitë e tyre dhe procesin e zgjedhjes së viktimave, si dhe sjelljen e të dyshuarit, para dhe pas incidentit. Profilizuesit kriminalë përdorin raportet e policisë, fotografitë, deklaratat e dëshmitarëve, raportet laboratorike dhe fotografitë e autopsisë për të kërkuar rreth detajeve të sjelljes. Ky proces i lejon profilizuesit për të kuptuar dhe për të krijuar një ide për krimin dhe autorin. Interpretimi i sjelljeve do t'i ndihmojë hetuesit për listën e të dyshuarve dhe strukturën e procesit të hetimeve<sup>17</sup>.

Thelbi i profilizimit është parashikimi, që është një proces që realizohet në bazë të katër kategorive<sup>18</sup>:

- procesit konjitiv (njohës);
- provave fizike;
- sjelljes së të dyshuarve;
- historikut dhe zakoneve.

Profilizimi, apo mbledhja e të dhënave për të dhënë parashikime rreth tipit të individit që mund të ketë kryer krimin, apo vetë krimit, ndihmon hetuesit përgjatë hetimit. Në rastin e vrasjeve, përgjatë kohës që profilizuesi sheh dhe grumbullon të dhënat nga burimet, shtron disa pyetje kryesore<sup>19</sup>:

<sup>15</sup> Për më tepër shih: Edmond Dragoti, *Psikologji Ligjore e krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti 2000, 2011), 200-207.

<sup>16</sup> Për më tepër shih: <http://www.csitechblog.com/crime-scene-investigation>

<sup>17</sup> Për më tepër shih: <http://www.csitechblog.com/crime-scene-investigation>

<sup>18</sup> Snook Brent, et al., "The criminal profiling illusion", *CE, Vol 35 Criminal Justice and Behaviour*, f. 1257-1276, 2008, *International Association for Correctional and Forensic Psychology*, f. 1262.

<sup>19</sup> Douglas P. Lyle, "Forensics: Profiling the perpetrator".

Marrë nga: <http://www.dummies.com/how-to/content/forensics-profiling-the-perpetrator.html>

- Si e gjeti vrasësi viktimën?
- Çfarë i bëri vrasësi viktimës?
- A u mundua vrasësi të mbulonte gjurmët, dhe në qoftë se po, si veprroi?
- Çfarë dihet për viktimën, që tërhoqi vrasësin? Cilat janë specifikat e veçoritë e viktimës, jetës, përditshmërisë, shenjave të dhunës, etj.?
- Çfarë motivesh e fantazish përdori vrasësi për të lënduar viktimën? Cilat janë mënyrat e përdorura, në një kohë dhe vend të caktuar?

Profilet psikologjike krijohen me të dhëna dokumentacionesh dhe përpilohen me elementë konkretë dhe praktikë, me ato çfarë bëjnë njerëzit dhe jo vetëm me ato çfarë thonë njerëzit. Ndryshojnë nga testet akademike shkencore apo nga testet psikologjike. Nuk është domosdoshmërisë e nevojshme të realizohen teste të shkruara apo verbale dhe as të përdoren pyetje të gjera dhe përgjigje të hollësishme e me shumë detaje.

## 5. Ndërtimi dhe përdorimi i profileve psikologjike përgjatë hetimit

Për të ndërtuar një profil në momentin pasi ka ndodhur një ngjarje kriminale, duhen ndjekur një sërë hapash e stadesh. Në këtë pjesë, pasqyrohen në mënyrë të koncentruar hapat e procesit të profilizimit në momentin kur ndodh ngjarja; burimet nga merren të dhënat dhe informacionet; përcaktimi i llojit të krimit në varësi së të dhënave të grumbulluara nga dy fazat e para; si dhe, ndërtimi i skicës së një profili me elementët përkatës. Të gjitha këto pasqyrohen si më poshtë vijon:

### a. Hapat e procesit të profilizimit <sup>20</sup>:

- vlerësimi i aktit kriminal;
- vlerësimi i specifikave të skenës/skenave të krimit;
- analizimi i viktimës/viktimave;
- ekzaminimi i raporteve paraprake të policisë;
- vlerësimi i raporteve të autopsisë dhe metodave mjekësore ekzaminuese;
- krijimi i një profili të përfunduar të veçorive të autorit të krimit;
- sugjerime për kërkimin dhe profilin e tij.

### b. Të dhëna që përmbajnë informacione të mundshme dhe të disponueshme si <sup>21</sup>:

- të dhëna publike;
- të dhëna mbi historinë e sjelljes;
- veprimtari përdoruese ose konsumatore;
- histori blerjesh;
- anëtarësim në organizata apo klube të ndryshme;
- të dhëna gjyqësore;
- të dhëna demografike;
- fakte pronësie;
- të dhëna nga media;
- të dhëna private apo nga agjenci informacioni;
- mendime të shprehura në dhoma *chat*-i, forume, mesazhe, etj.;

<sup>20</sup> Për më tepër shih: Edmond Dragoti, *Psikologji Ligjore e krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti 2000, 2011), 200-2007.

<sup>21</sup> Po aty.

- Krahasime statistikore me grupe bashkëmoshatarësh, votime dhe informacione të marra nga miqtë, kolegët, të afërmit.

Profilat janë të domosdoshme për ekzaminimin profesional të skenës së krimit. Mbështetja që japin profilet tipike psikologjike, të kriminelëve të organizuar dhe të çorganizuar, tregohet edhe në ndryshimin e skenave të krimeve të kryera nga secili prej tipit të kriminelit.

**c. Ndryshimet e skenave të krimit nga kriminelë të organizuar dhe kriminelë të çorganizuar, paraqiten në tabelën më poshtë<sup>22</sup>:**

Të organizuar	Jo të organizuar
Krim i planifikuar	Krim spontan
Viktima e shënjuar - i/e huaj	Viktima e shënjuar - i/e njohur
Viktimitë e personalizuar	Viktimitë e depersonalizuar
Bisedë e kontrolluar	Bisedë minimale
Skena e krimit reflekton kontroll	Skena e krimit reflektohet si e rastësishme dhe e lëngshme
Kërkon viktimitë të nënshtruar	Dhunë e papritur ndaj viktimitës
Ka kufizime në mënyrën e kryerjes së krimit	Nuk ka kufizime në mënyrën e kryerjes së krimit
Akte agresive para vdekjes së viktimitës	Akte seksuale pas vdekjes së viktimitës
Fshehje e trupit	Trupi nuk fshihet
Armë dhe prova të munguara	Armë dhe prova të pranishme
Transport/lëvizje e viktimitës ose e trupit	Trupi i viktimitës qëndron në skenën e kryerjes së krimit (nuk ka zhvendosje)

**d. Skica e profilit psikologjik nga analiza e skenave të krimit<sup>23</sup>:**

- fotografi e viktimitës/ave dhe të mënyrës së zhvillimit të krimit;  
 - karakteristikat e viktimitës (mosha, seksi, raca, gjatësia, pesha, veshja, ngjyra e flokëve, arsimimi, punësimi) dhe pyetje si "pse u zgjodh kjo viktimitë?", "a ishte e përshtatshme shoqërisht?" etj.;

- informacionin e mjekut ligjor bazuar në autopsi e në informacione të tjera;  
 - raportimin e policisë ose raportimin e të dhënave të tyre;  
 - raportimin e dëshmitarëve për krimin, personat, etj.;

- përpjekjet e bëra për rindërtimin e skenës së krimit dhe nëse krimi ishte i parashikuar apo nëse ishte kryer në zemërim e sipër, nga inati apo i llogaritur;  
 - hipoteza të sjelljes kriminale të viktimitës;

- motivet e mundshme për krimin (vjedhje, zemërim, përdhunim, inat, histori të alkoolit e drogës), etj.;

- tipologjinë e krimit: i nënkuptuar, i një shoqërie të pamjaftueshme/mjaftueshme, i kualifikuar apo jo, faktorët inteligjentë, përdorimi i armëve dhe mënyra e përdorimit të tyre te viktima, etj.;

- mundësinë sugjeruese të teknikave të intervistës.

Për një profilizues, studiues, hetues apo oficer policie, është shumë e rëndësishme të njihet me katër fazat e sipërpërmendura së bashku me elementët e karakteristikat e tyre, në mënyrë që të aftësohen për të ndërtuar profile sa më të mira në përputhje me eksperiencën dhe formimin personal të tyre. Krahas kësaj, në këtë pikë është e nevojshme të përmenden se për çfarë shërbejnë profile psikologjike, ku gjejnë zbatim ato dhe për çfarë ndihmojnë. Nga hulumtimet, analizat dhe konspektet që janë realizuar në këtë

<sup>22</sup> Konspekt dhe analizë, "Crime scene profiling 2", *Criminal & Behavioral Profiling*, 28.

Marrë nga: [https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423\\_ch\\_2.pdf](https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423_ch_2.pdf)

<sup>23</sup> Edmond Dragoti, *Psikologji ligjore e krimit* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti 2000), 205-206.

punim, këto shënohen më poshtë shënohen të përmbledhura.

**e. Për çfarë shërben një profil psikologjik<sup>24</sup>?**

- Ndhmon në vlerësimin e tipareve personale apo të talenteve të veçanta, që mund të verifikohen nga fakte të tjera.

- Japin avantazh në marrëdhëniet zyrtare e jozyrtare, në marrëdhëniet shoqërore, profesionale, politike, ekonomike e morale.

- Zvogëlojnë koston e punës, kursejnë kohë e përpjekje dhe shtojnë produktivitetin e veprimeve.

- Janë të pranishme dhe shumë efektive në proceset gjyqësore.

- Ndhmojnë për të gjetur klientë në tregun profesional të drejtësisë ligjore.

- Japin detaje të sjelljes dhe psikikës së një personi ashtu sikurse të dhënat kreditore në bursa përcaktojnë nivelet e rrezikut në investime financiare.

**f. Përse ndihmojnë profilet psikologjike<sup>25</sup>?**

- Ato ndihmojnë për të përcaktuar nëse:

- personi është me të vërtetë ai që pretendon, që shprehet se është;

- nëpunësi apo partneri në biznes, kanë shprehitë apo motivimin e paraqitur;

- personi që do të punësoni është i ngjashëm me nëpunësin tuaj më të mirë;

- personi që keni zgjedhur si shitës ka profilin psikologjik të një personi të aftë për të shitur;

- partneri ynë ka një vëmendje të hapur apo të kursyer në marrëdhëniet romantike;

- bashkëshorti/-ja ka prirjen për t'i zmadhuar gjërat e parëndësishme;

- partneri është duke na tradhtuar;

- personi me të cilin banojmë apo bashkëjetojmë është person me të cilin mund të merresh vesh, etj.

Në një studim rasti: *Stadet e Profilizimit Kriminal*<sup>26</sup>, nga "Qendra kombëtare për analizën e krimeve të dhunshme" të FBI-së, pasqyruar në pjesën e fundit të punimit, do të paraqitet modeli që ndjek FBI-ja sot për të ndërtuar profilet psikologjike; model, i cili përbëhet nga pesë stade të profilizimit, së bashku me elementët e tyre. Këto stade do të konkretizohen hap pas hapi me një studim rasti real, të një vrasjeje, që ka ndodhur në Amerikë para disa vitesh. Ky model është shumë praktik për t'u njohur konkretisht me punën që realizohet për ndërtimin e profilit dhe kontributin që ky profil jep në punën e punonjësve të policisë dhe hetuesve.

## 6. Përshkrimi i rastit studimor nga FBI-ja<sup>27</sup>

Trupi lakuriq (i zhveshur) i një gruaje u zbulua në orën 15:00 në çatinë e pallatit ku

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> "Konspekt dhe analizë", Për më tepër shih: Edmond Dragoti, *Psikologji ligjore e krimin* (Tiranë: Shtypshkronja Dajti 2000), 200 - 207.

<sup>26</sup> "Konspekt dhe analizë e materialit", John Wiley & Sons Ltd, *Behavioral Sciences & Law*, Vol. 4 (1986), John E. Douglas, Robert K. Ressler, Ann W. Burgess, Carol R. Hartman, "Criminal Profiling from crime scene analysis," 401-421.

Marrë nga: <http://ravenndragon.net/montgomery/crimprofiling.pdf>

<sup>27</sup> "Konspekt dhe analizë", studim rasti, Departamenti i Trajnimeve dhe Shkencave të Sjelljes në FBI, *Inside the criminal mind*, (Virginia: US Department of Justice, 1986).

John E. Douglas, et al., "Criminal Profiling from crime scene analysis" (1986), 12-17.

Marrë nga: [www.all-about-forensic-psychology.com](http://www.all-about-forensic-psychology.com)

jetonte. Ajo ishte masakruar në fytyrë dhe ishte mbytur me rripin e çantës së saj. Thithat e saj ishin prerë dhe i ishin vendosur mbi gjoks. Brenda kofshës së saj ishte shkruajtur me bojë “Ti nuk mund të më ndalësh mua”. Në barkun e saj ishte shkruar “Fuck you”.

Një varëse me formën e një shenje hebraike (chai), të cilën e mbante për fat gjithmonë në qafë, kishte humbur dhe mendohet të jetë marrë nga vrasësi. Të brendshmet e saj i ishin hedhur mbi fytyrë dhe çorapet e saj të najlonit, i ishin zhveshur dhe ishin përdorur për të lidhur kyçet e duarve dhe të këmbëve në kangjella. Vrasësi kishte vendosur në mënyrë simetrike në të dyja anët e kokës së viktimës, një palë vathë që i përkisnin viktimës.

Një stilolaps dhe një çadër, ishin vendosur me forcë në organin gjenital dhe një krehër ishte vendosur në flokë. Nofulla dhe hunda e gruas ishin thyer dhe dhëmbët i kishin humbur. Ajo kishte pësuar fraktura të rënda në fytyrë të shkaktuara nga një ushtrim i madh force. Shkaku i vdekjes ka qenë “asfiksia” nga mbytja me duar dhe me rripin e çantës së dorës. Në trupin e viktimës ka pasur shenja kafshimi, dëmtime e trauma ndërsa në kofshët e saj kishte shembje e hemorragji. Vrasësi kishte pastruar vendin e krimit në çati dhe e kishte mbuluar me veshje e viktimës.

Stadi 1. Profili i Inputeve
Stadi 2. Procesi i Vendimarrjes
Stadi 3. Vlerësimi i Kriminelit
Stadi 4. Investigimi
Stadi 5. Frika

## 7. Analizë rasti sipas stadeve të profilizimit nga FBI

### 7.1 Stadi i profilizimit të inputeve

Mjetet e përdorura nga vrasësi në skenën e krimit, i përkasin viktimës (krehri, stilolapsi, çorapet, etj.) – vrasje e paplanifikuar, ngjarje spontane ku vrasësi nuk kishte planifikuar apo nuk kishte pritur që të vinte viktimja. Skena e krimit ndryshon nga ajo e vdekjes. Rrëmbimi i viktimës ndodh në shkallë dhe dërgohet në një zonë të largët.

*Profili i viktimës:* femër, e bardhë, 26 vjeç, 90 kg dhe punonte si mësuese në një “qendër të kujdesit shëndetësor” me një grup fëmijësh me aftësi të kufizuara. Jetonte me prindërit. Atë mëngjes, vajza ishte zgjuar në orën 6:30, ishte veshur, kishte ngrënë mëngjes, kishte pirë kafe dhe lëng frutash, kishte lënë apartamentin për të shkuar në punë. Zakonisht, kur dilte nga shtëpia ose merrte ashensorin, ose ecte poshtë shkallëve me këmbë, në varësi të gjendjes së humorit. Ajo ishte vajzë e re, e qetë dhe vuante nga një lakim i lehtë i shtyllës kurrizore. Nuk ishte vajzë që mund ta shikoje të dilte natën nëpër klube apo vajzë provokuese që binte në sy për pamjen e saj, pasi dhe sëmundja që vuante e pengonte në këtë pikë.

*Nga informacioni i mjekësisë ligjore:* sperma nuk ishte në organet gjenitale të femrës, nga ku arrihet në përfundimin se autori nuk ka kryer kontakte seksuale me viktimën. Kishte shenja kafshimesh në kofshë dhe në gjunjët e viktimës. Ai i kishte prerë thithat dhe me to kishte bërë shënime në trupin e saj. Shkaku i vdekjes ishte nga mbytja me duar dhe me rripin e çantës. Mjetet e rastësishme tregojnë se autori nuk ka qenë i përgatitur për krimin. Ai mund të ketë gjuajtur me grusht viktimën, për t’i marrë frymën, në mënyrë që kjo mos të bërtiste. Nuk kishte gjurmë thike në trupin e viktimës dhe dëmtimi mund të ketë ardhur nga një brisk xhepi. Me rripat e viktimës kishte lidhur krahët e këmbët dhe më pas, i kishte zgjidhur.

*Nga raporti paraprak i policisë:* një banor i pallatit, mashkull, i bardhë, 15 vjeç, zbuloi portofolin e viktimës që e kishte gjetur në shkallë midis katit të 13 dhe 14 rreth



orës 8:20. Ai e mbajti portofolin derisa u kthye nga shkolla për në shtëpi atë pasdite. Ia dorëzoi portofolin babait të tij, mashkull, i bardhë, 40 vjeç i cili kishte shkuar në banesën e viktimës në orën 14:50 për t'i dorëzuar portofolin nënës së viktimës. Kjo telefoni te puna e vajzës për ta njoftuar për portofolin dhe mësoi se vajza nuk kishte qenë në punë. Në atë moment filluan të kërkonin për vajzën nëpër pallat, ku dhe gjetën trupin e saj. Policia mbërrin në vendngjarje dhe pyet për dëshmitarë të mundshëm që mund të kishin parë vajzën në mëngjes.

### **7.2 Stadi i procesit të vendimarrjes**

*Stili i krimit:* vrasje e njëfishtë, e motivuar nga qëllime seksuale, e paplanifikuar - nisur nga mënyra e organizimit dhe e sofistikimit të krimit. Aktet ishin me natyrë sadiste, me torturë dhe dhunë seksuale mbi trupin e pjetë të viktimës.

*Niveli i rrezikut së viktimës:* i ulët, pasi ajo ishte një vajzë e qetë, e vetëdijshme për handikapun e saj fizik, që bënte një jetë të vetmuar dhe nuk ishte tipi i viktimës që mund të luftonte, të sulmonte apo të bërtiste.

*Niveli i rrezikut të krimit:* i lartë, pasi është kryer në një vend me rrezikshmëri të ulët për krime të dhunshme. Pallati i banimit të vajzës ishte pjesë e projekteve për strehim publik. Banorët ishin 50% të zinj, 40% të bardhë dhe 10% hispanikë. Banesa e saj ishte në kufijtë e një zone të mbikëqyruar nga policia, pra shumë e sigurt dhe e mbrojtur. Në këto zona nuk kishte pasur krime të dhunshme. Nga ana tjetër vrasësi ka kryer krimin në mes të ditës, ku kishte shumë mundësi që dikush ta shikonte. Ndërkaq viktima ka qenë rastësore, pasi ajo herë merrte ashensorin, e herë ecte me këmbë, e sipas hetuesve, ky ishte fati i saj i keq.

*Koha e krimit:* e konsiderueshme, pasi sasia e kohës që vrasësi kishte kaluar me viktimën përbënte rrezik që ky të kapej.

Aktivitetet e kryera mbi trupin e viktimës (heqja e vathëve, prerja e thithave, dëmtimet e traumat në trup, etj.,) ishin procese që merrnin kohë.

### **7.3 Stadi i vlerësimit të krimit**

*Profili kriminal i vrasësit:* vrasësi mund të ishte mashkull, i bardhë, midis 25-35 vjeç, me trup mesatar. Mundësia është që të kishte qenë banor i asaj lagjeje, kompleksi apo banese afër vendbanimit të viktimës. Do të kishte nivel mesatar inteligjence, që ka mbaruar ose vazhdon shkollën e mesme apo ka braktisur kolegjin; nuk do të kishte histori ushtarake; do të ishte i papunë dhe do i përkiste një klase punëtore. Alkooli dhe droga nuk kanë ndikim, pasi ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit. Ai duhej të kishte vështirësi në krijimin e mbajtjen e marrëdhënieve personale me femrat.

Nëse do të dilte në takime, do të zgjidhte një vajzë më të re në moshë, që të kishte më shumë mundësi për ta kontrolluar e dominuar. Do të ishte pa përvojë seksuale dhe papërshtatshmëri seksuale dhe nuk do ishte martuar kurrë. Do të ishte i varur pas pornografisë e me prirje sadiste (çadra në organet gjenitale, masturbimi). Agresioni i madh seksual tregon për urrejtje ndaj femrave, duke u kthyer në një kuriozitet patologjik. Ai është vrasës i çorganizuar, sepse kreu akte me natyrë sadiste në një trup të pjetë.

Ai nuk u shfaq rastësisht në mëngjes, por mund të punonte ose banonte në atë kompleks. Do të ishte person i hutuar apo me probleme mendore. Do të ishte tipi i personit që nuk do të kryente dot akte të tilla me një person të ndërgjegjshëm e të gjallë. Skena e krimit, tregon se vrasësi ndjehet i justifikuar në veprimet e tij dhe se nuk shfaq ndjenja keqardhjeje. Ai nuk është delikat. E vendos viktimën në një pozicion provokues

**AKADEMIA  
E SIGURISË**

*Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:*

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

e poshtëruës, ashtu siç do e donte ai që të gjendej. Sfidon policinë me mesazhin e shkruar mbi trupin e viktimës. Këto mesazhe tregojnë se mund të vrasë sërish.

#### 7.4 Stadi i hetimit

*Grupi i punës:* policia, byroja e hetimit, ekspertiza mjekoligjore, ekipi i ekzaminimit forensik të skenës së krimit dhe prokuroria e qarkut. Krimi mori vëmendje të madhe mediatike, për shkak se ishte vrasje e jashtëzakonshme. U realizua një hetim intensiv me 2000 persona të intervistuar, me kontroll të autorëve të njohur të krimeve seksuale në atë zonë, me krahasim të mostrave të provave të shkrimit nga të dyshuar të mundshëm, me kontroll nëpër spitalet e shëndetit mendor. I dyshuari u kap 13 muaj pas zbulimit të trupit të viktimës.

#### 7.5 Stadi i frikës

Pas marrjes së profilit të kriminelit, policia shqyrtoi dosjet e 22 të dyshuarve, nga të intervistuarit. Njeri ishte më i dyshuari.

*Profili i të dyshuarit:* babai i tij jetonte në të njëjtën ndërtesë me viktimën. Policia kishte intervistuar në fillim babanë, i cili deklaroi se djali i tij ishte pacient në një spital lokal psikiatrik. U mësua, se djali kishte munguar pa leje në spital ditën e krimit dhe një mbrëmje para vrasjes. Ata mësuan se ishte i papunë, jetonte vetëm, nëna i kishte vdekur nga goditja në tru kur ishte 19 vjeç. Kishte pasur probleme të përsëritura akademike dhe kishte braktisur shkollën. Ishte mashkull, i bardhë, 30 vjeç, i pamartuar, fëmijë i vetëm, nga një klasë punëtore me babanë ish-luftëtar. Në dhomën e tij u zbulua një koleksion pornografik. Nuk kishte qenë kurrë në ushtri, nuk kishte të dashur, përshkruhej si një person i pasigurt në raport me femrat, vuante nga depresioni, merrte trajtim psikiatrik dhe ishte shtruar në spital psikiatrik. Kishte histori të përsëritura të tentativave për vetëvrasje përpara dhe pas kryerjes së krimit. I dyshuari u gjet dhe u shpall fajtor duke vuajtur një dënim prej 25 vitesh. Ai mohoi të ketë kryer vrasjen dhe pretendoi se nuk e njihnte viktimën. Ndër provat më bindëse kundër ishin si më poshtë.

*Dhëmbët:* tre dentistët më të mirë, kryen teste të pavarura dhe vërtetuan se dhëmbët e tij përshtateshin me kafshimet në trupin e viktimës. Spitali psikiatrik në të cilin ndodhej, kishte kontroll të dobët, në të cilin mund të hyje e të dilje lirisht. Psikologët mjekoligjorë mund të luajnë një numër të roleve kryesore në një hetim penal. Menjëherë pas një krimi, një psikologu mjekoligjor mund t'i kërkohej që të veprojë si një profilizues kriminal. Profilizimi i kriminalitetit, përfshin psikologun, duke përdorur kuptimin e tij të sjelljes njerëzore, motivimin dhe patologjinë, në mënyrë që të krijojë një profil psikologjik të kryerësit<sup>28</sup>.

Në dekadat e ardhshme, policia në Nju Jork dhe gjetkë, vazhdoi të konsultohet me psikologë dhe psikiatër, për të zhvilluar profilet e shkelësve veçanërisht të rasteve të vështira për t'u kapur. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ka shumë nga fusha e profilizimit kriminal që janë zhvilluar brenda komunitetit të zbatimit të ligjit, veçanërisht të FBI-së<sup>29</sup>.

Në ditët e sotme profilizimi qëndron, nganjëherë diku mes zbatimit të ligjit dhe psikologjisë. Si shkencë, është ende një fushë relativisht e re, me disa kufij ose përkufizime të përcaktuara. Praktikuesit e tij nuk bien gjithmonë dakord mbi metodologjinë apo edhe me terminologjinë.

<sup>28</sup> *The Role of Forensic Psychology in a Criminal Investigation*, marrë nga: <https://www.kibin.com/essay-examples/the-role-of-forensic-psychology-in-a-criminal-investigation-PdlsFZ9h>

<sup>29</sup> Lea Winerman, "Criminal profiling: the reality behind the myth" *Monitor on Psychology*, vol 35, nr. 7, July/August (print), 2004, 66. Marrë nga: <http://www.apa.org/monitor/julaug04/criminal.aspx>

## 8. Përfundime

Si përfundim profilet mund të jenë çuditërisht të sakta në procesin e hetimit. Nga vëzhgimet e vendit të ngjarjes mund të konkludojmë karakteristikat e sjelljes së individit që e krijoi atë. Nga mënyra se si ndërtohet një profil, burimet e informacionit, skica e profilit, stadi dhe përcaktimi i nevojës dhe ndihmesës që jep një profil, shihet qartë se ndërtimi e përdorimi i profileve psikologjike rrit shkallën e interpretimit dhe analizës së ngjarjes, trajtimit të ngjarjes në mënyrë objektive, përcaktimit të veçorive në lidhje jo vetëm me informacionet e përgjithshme nga skena e krimit, por dhe me detajet në lidhje me sjelljen e gjendjen psikologjike të një individit. Këto ndikojnë në efikasitetin e procesit të hetimit dhe studimit të fushës së gjerë të kriminalitetit në përgjithësi.

Për një profilizues të gjithë janë sklllevër të përbërjes së tyre psikologjike. Nga ana tjetër, profilstët përdorin njohuritë e tyre për të cilat është shkelësi tipik që i mban këto karakteristika dhe pastaj parashikon jo vetëm se si hetuesit mund të presin që shkelësi të silltet në të ardhmen, por edhe se cila do të jetë paraqitja e tyre fizike. Në kuadër të parashikimit dhe gjetjes së të dyshuarit, e më tej dënimit të tij, procesi i profilizimit, profilet psikologjike e ato të personalitetit po përdoren gjithnjë e më shumë në vendet e zhvilluar të Evropës si, në Angli, Gjermani dhe më së shumti në Amerikë. Në ditët e stome këto përbëjnë shkencën më moderne e efikase të hetimit, e cila është e nevojshme që të zhvillohet në vazhdim edhe në vendin tonë, si domosdoshmëri për cilësinë dhe saktësinë e hetimit.

## Referencat

1. Dragoti, Edmond. *Psikologjia Ligjore e Krimit*. Tiranë: Shtypshkronja Dajti, 2000, 2011.
2. Brent Snook, et al. *The criminal profiling illusion*. CE, Vol 35 "Criminal Justice and Behaviour," International Association for Correctional and Forensic Psychology, 2008.
3. Criminal Investigative Analysis, National Center For The Analysis of Violent Crime, (NCAVC), FBI Academy. "Critical Incident Response Group," Quantico Virginia, Qershor 1988.  
Marrë nga: <https://vault.fbi.gov/Criminal%20Profiling/Criminal%20Profiling%20Part%201%20of%207>.
4. Douglas E. John, et al. "Criminal Profiling from crime scene analysis". *Behavioral Sciences & Law*. Vol. 4, Wiley, John & Sons Ltd., 1986. Marrë nga: <http://ravenndragon.net/montgomery/crimprofiling.pdf>.
5. Lea Winerman, "Criminal profiling: the reality behind the myth," *Monitor on Psychology*, vol 35, nr. 7, July/August (print), 2004. Marrë nga: <http://www.apa.org/monitor/julaug04/criminal.aspx>.
6. Schafer, Thomas, et al. *The psychological functions of music listening*. US: National Library of Medicine, National Institute of Health, 2013. Marrë nga: <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC3741536>.
7. Bonn A. Scott. *The birth of modern day criminal profiling*, 26. 5. 2015.  
Marrë nga: <https://www.psychologytoday.com/blog/wicked-deeds/201505/the-birth-modern-day-criminal-profiling>.
8. "Crime scene profiling 2", *Criminal & Behavioral Profiling*, 28.  
Marrë nga: [https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423\\_ch\\_2.pdf](https://us.sagepub.com/sites/default/files/upm-binaries/50423_ch_2.pdf).
9. Departamenti i Trajnimeve dhe Shkencave të Sjelljes në FBI. *Inside the criminal mind*. Virginia: US Department of Justice, 1986.
10. Douglas E. John, et al. *Criminal Profiling from crime scene analysis* (1986), 12-17.  
Marrë nga: [www.all-about-forensic-psychology.com](http://www.all-about-forensic-psychology.com).
11. Të dhëna nga Policia e Shtetit për vepra penale, të dëmtuarit dhe autorët e ngjarjeve, për periudhën 1. 1. 2016 - 31. 12. 2016.
12. Kibin. *The Role of Forensic Psychology in a Criminal Investigation*.  
Marrë nga: <https://www.kibin.com/essay-examples/the-role-of-forensic-psychology-in-a-criminal-investigation-PdlsFZ9h>.
13. Lyle P. Douglas. *Forensics: Profiling the perpetrator*.  
Marrë nga: <http://www.dummies.com/how-to/content/forensics-profiling-the-perpetrator.html>  
<http://www.csitechblog.com/crime-scene-investigation>.
14. <http://www.oranews.tv/vendi/balena-blu-loja-e-rrezikshme-per-femijet-verifikohet-ne-gjirokaster>.
15. <http://opinion.al/balena-blu-cfare-po-ndodh-ne-shqiperi-rritet-ne-nivele-te-frikshme-kurioziteti-per-lojen-vrasese>.
16. <http://opinion.al/balena-blu-cfare-po-ndodh-ne-shqiperi-rritet-ne-nivele-te-frikshme-kurioziteti-per-lojen-vrasese>.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

# Sistemi i drejtësisë, reformimi dhe lufta ndaj korrupsionit, garanci e funksionimit të shtetit të së drejtës

— Dr. (në proc.) Adriana ZOTAJ  
Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave  
Materiale të Shtetit, Tiranë  
adrianazotaj@yahoo.com

— Dr. (në proc.) Aulona ZOTAJ  
Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë  
aulona.zotaj@gmail.com

## Abstrakt

Bazuar në arritjet e deritanishme dhe potencialet e rritjes së vendit, si dhe në përputhje me vizionin e përcaktuar në “Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim” (SKZHI), strategjia ndërsektoriale e drejtësisë përcakton vizionin e mëposhtëm për vitet e ardhshme: “Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euroatlantike si një shtet i së drejtës, demokratik dhe garant i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo.” Shqipëria është futur në një fazë të re zhvillimi dhe me perspektiva të qarta integrimi në strukturat euroatlantike. 1 Konsolidimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë është një element shumë i rëndësishëm. Ky element, i cili realizohet përmes luftës ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimin e vendit dhe paralelisht me konsolidimin e qeverisjes së mirë, shërben si garanci e shtetit të së drejtës.

Instituti për Kërkime mbi Alternativat e Zhvillimit, në një anketim të vitit 2009 të titulluar “Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe përvoja”, konstatoi se shqiptarët besonin se gjyqet ndikohen më së shumti nga interesa monetare, lidhjet e biznesit, lidhjet personale të gjyqtarëve dhe konsiderata politike. Këto anketime kanë treguar se shqiptarët besojnë se gjyqësori është një ndër tri institucionet që kanë kontributin më të vogël në luftën kundër korrupsionit. 2

Sipas vlerësimit të GRECO-s2, sistemi i drejtësisë në Shqipëri vuan veçanërisht nga: niveli i ulët i besimit publik; pozicioni i dobët i tij përballë pushteteve të tjera; mungesa e kontrollit mbi përzgjedhjen e gjyqtarë vetë Gjykatës së Lartë; ekskluziviteti i Ministrit të Drejtësisë për të iniciuar fillimin e procedimit disiplinor kundër gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të Apelit; mos qenia aktive e Konferencës Gjyqësore Kombëtare, gjë që ka pasur ndikim negativ në përzgjedhje, progres të karrierës, trajnime si dhe procedime disiplinore kundër gjyqtarëve. 3

## Fjalëkyçe:

sistem i drejtësisë në Shqipëri, zhvillim, faktor ekonomik, ndryshim.

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## 1. Hyrje

Bazuar në arritjet e deritanishme dhe potencialet e rritjes së vendit, si dhe në përputhje me vizionin e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë përcakton vizionin e mëposhtëm për vitet e ardhshme:

“Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euroatlantike si një shtet i së drejtës, demokratik dhe garant i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo. Shqipëria është futur në një fazë të re zhvillimi dhe me perspektiva të qarta integrimi në strukturat euroatlantike. Shteti shqiptar, duke zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë dhe, duke respektuar parimet themelore të një vendi demokratik, do të jetë mbrojtës i të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe interesave të tyre. Garanci për këtë do të jetë qeverisja e mirë, e drejtë dhe e paanshme, e orientuar drejt filozofisë së zbatimit të ligjit për funksionimin e shoqërisë dhe hapjen e rrugës së zhvillimit”<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Vendimi KM nr. 519, datë 20.7.2011 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të Planit të veprimit të saj”.

<sup>2</sup> Instituti për Kërkime mbi Alternativat e Zhvillimit, “Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe eksperiencia”, f. 22-24 (2009).

<sup>3</sup> GRECO, Raport vlerësimi për Shqipërinë nr. 4, 24 -27 qershor 2014.

<http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/news/News%2820140627%29Eval4Albani>.

<sup>4</sup> Vendim i KM nr. 519, datë 20. 7. 2011 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj”.

## 2. Kushtet dhe shkaqet themelore për shtete të dobëta

Shtete të dobëta, quhen ato shtete të cilat karakterizohen nga paqëndrueshmëria ose nga krizat politike, nga funksionaliteti i ulët ose mos funksionaliteti i institucioneve publike, nga shkalla e dobët e sigurisë ose pasiguria, nga kapacitetet e pamjaftueshme ushtarake mbrojtëse, si dhe nga një sistem ekonomik i varfër dhe i prapambetur. Shtetet e dobëta mund të jenë të vegjël, të mesëm ose të mëdhenj. Madhësia nuk përbën kushtet dhe shkaqet themelore për dobësinë e shtetit. Kushtet dhe shkaqet themelore për shtetet e dobëta duhen kërkuar kryesisht brenda vetë natyrës së shtetit. Themelore në dobësitë e shtetit janë shkaqet e brendshme. Shkaqet e brendshme që dobësojnë shtetin janë:

- krizat politike, paqëndrueshmëria, tensionet, përplasjet, konfliktet, konfrontimet e deri te lufta civile për shkaqe politike.
- krizat ekonomike e shoqërore, dobësitë permanente të sistemit ekonomik, përplasjet ndërmjet sektorit publik me atë privat, kapacitetet e ulëta prodhuese dhe eksportuese, aftësitë e pamjaftueshme konkurruese në tregjet hapura, mangësitë në lëndët e para e ndihmëse, burimet e pamjaftueshme energjetike, mungesa e teknologjisë, e infrastrukturës, kapacitetet e dobëta menaxheriale në ekonomi e biznes etj.
- dobësitë institucionale, mosfunksionimi institucional, vakuomet, mbivendosjet ose përplasjet institucionale, paaftësia e kapaciteteve njerëzore, niveli i ulët menaxheria, lidershipi i dobët, korrupsioni etj.

Këto të shoqëruara me probleme sociale si papunësia, varfëria, krimi ekonomik e plagë të tjera shoqërore e psikologjike si depresioni, emigracioni klandestin, trafiqet njerëzore, krizat morale e shpirtërore, janë mjaft komplekse dhe shoqërojnë shtetet e shoqëritë e dobëta. Krizat politike, ekonomike e shoqërore prodhojnë pashmangësish krizat morale e shpirtërore, siç janë krimi, droga, prostitucioni, trafiqet klandestine të çdo lloji, depresionet, vetëvrasjet, krimi në familje etj.

Por, në dobësimin e shtetit ndikojnë edhe shkaqe të jashtme. Fakti që shkaqet e brendshme janë themelore për dobësitë e shtetit, nuk përjashton ekzistencën dhe ndikimin e shkaqeve të jashtme për dobësimin e shtetit. Edhe shkaqe të jashtme mund të ndikojnë për dobësimin, madje edhe për shkatërrimin e shtetit. Pa folur për luftërat, si forma shkatërrimtare të shteteve e shoqërive njerëzore, ekzistojnë edhe shkaqe të tjera të jashtme që shpien në dobësimin e shtetit. Natyrisht, është detyra e shtetit që të mbrohet nga faktorët e jashtëm që synojnë të dobësojnë atë. Shteti shërben si element imuniteti kombëtar në mjediset problematike ndërkombëtare.<sup>5</sup>

Sa më sipër u përmendën faktorë të tillë si: mosfunksionimi institucional, vakuomet, mbivendosjet ose përplasjet institucionale; paaftësia e kapaciteteve njerëzore; niveli i ulët menaxherial; faktorë të cilët janë korrelacion dhe produkt i lidershipit, në kuptimin sesi funksionon lidershipi, a është gati të sakrifikojë nga vetja për njerëzit e vendit të tij, për vendin e tij.

Presidenti Obama, në librin e tij “Guximi për të shpresuar”, shprehet se: “Ne vlerësojmë besimin në diçka më të madhe se vetja, paçka se kjo shprehet në religjione formale apo në paragjykimet etnike. Dhe, ne, çmujmë atë tërësi sjellësh që shpreh vlerësimin reciprok për njeri-tjetrin, ndershmërinë, paanshmërinë, përlulesinë, mirësjelljen, mëshirën. Në çdo

<sup>5</sup> Nijazi Halili, *Çfarë do të kuptojmë me fjalën shtete të dobëta ose 'weak states'?*. Bota Sot, 28. 01. 2016.

shoqëri (dhe tek çdo individ) individualja dhe e përbashkëta, autonomia dhe solidariteti ecin paralel, por edhe në kundërshtim me njeri tjetrin. Shpeshherë vlerat tona përplasen, sepse, duke qenë pronë e njerëzve, ato mund të shtrembërohen apo të kapërcejnë masën. Besimi në vetvete dhe pavarësia mund të kthehen në egoizëm dhe shthurje, ambicia mund të kthehet në lakmi dhe në një dëshirë pa fre për të pasur sukses me çdo kusht”.<sup>6</sup>

### 3. Lidershipi intelektual dhe institucionet

Lidershipi, në vetvete, duhet të jetë një proces i moralshëm, deri në atë shkallë sa të plotësojë nevojat maksimale të mundshme të bazuara tek vlerat, qëllimet dhe arsyet e atyre që udhëheqin procesin e pasuesve të tyre. Këto vlera, është e nevojshme që të nxiten nga mirësia psikologjike, ekonomike, shpirtërore, estetike dhe fizike. Lidershipi është forca që i jep impulse përpjekjeve për civilizim në shoqëritë e civilizuara. Mbështetja e fortë tek masat, është më tepër virtyt i diktaturave sesa i demokracive. Demokracitë mbështeten tek institucionet. Kohët që jetojmë kanë treguar se forca e madhe dhe e vërtetë e një lidershipi, nuk janë turmat, por idetë në të cilat ndjekësit gjejnë ose jo veten e tyre, në arenën politike. Rëndësia e një intelektualit varet në mënyrë të padiskutueshme nga fara që mbjell me punën e tij. Eksperienca britanike, lidhur me lirinë e lidershipit intelektual, është mjaft bindëse.

Në shumë pak shoqëri të civilizuara, intelektualët kanë ndikim të madh në politikë. Rasti konkret është Anglia. Intelektualët britanikë vëmendjen më të madhe e kanë përqendruar tek mbrojtja e lirisë ndaj pushtetit të qeverisë. Për këtë arsye, jo në pak raste, brenda kabineteve qeveritare britanike janë përfshirë intelektualë me famë, të cilët kanë mbrojtur lirinë jo vetëm në vendin e tyre por edhe në të katërt cepat e botes. Ndoshta, aspekti më i veçantë i këtij perceptimi mbi lidershpin intelektual, qëndron tek mbrojtja që intelektualët e guximshëm i kanë bërë ideve të kthyera në institucione politike, prej nga ku gjeneroi suksesi dhe madhështia e një kombi. Përcjellja e famës, që intelektualët udhëheqës përçojnë tek mbështetësit e tyre kombëtarë, nuk është gjë tjetër veçse ambicia e kthyer në institucion politik për të përmirësuar situatën në të cilën gjendet vendi. Janë pikërisht këto institucione, shkalla e lartë e intelektualitetit që me bashkëpunimin midis tyre, çon drejt një klime mirëbesimi, ku pushteti dhe liria nuk janë faktorë kundërshtarë, por komplementarë që plotësojnë dhe ndikojnë pozitivisht tek njeri-tjetri.<sup>7</sup>

### 4. Korrupsioni dhe perceptimi publik

“Ka një perceptim të gjerë të publikut, se sistemi i drejtësisë është i prekur nga fenomeni i korrupsionit dhe ndikimit të jashtëm, në dhënien e drejtësisë. Korrupsioni, mungesa e praktikave transparente, tejzgjatja e proceseve dhe moszbatimi i vendimeve gjyqësore kanë ndikuar në perceptimin negativ të publikut, ndaj transparencës së gjyqësorit. Sot pushteti gjyqësor, konsiderohet si një ndër fushat me nivel të lartë korrupsioni nga raportet vlerësuese të organizatave të huaja dhe vendase, ankesat e publikut apo denoncimeve të bëra në numrat e gjelbër të vendosur në çdo institucion”<sup>8</sup>.

<sup>6</sup> Barack Obama, *Guximi për të shpresuar*, Tiranë: Dudaj, f. 76.

<sup>7</sup> Gjon Boriçi, *Pushteti & lidershipi*, Tiranë: Ufo Press, 2009, f. 8, 29, 34, 35.

<sup>8</sup> Vendim i KM nr. 519, datë 20. 7. 2011, “Për miratimin e Strategjisë Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj”.

Në një anketim të vitit 2009, titulluar “Korrupsioni në Shqipëri: perceptime dhe përvoja”, Instituti për Kërkime mbi Alternativat e Zhvillimit konstatoi se, shqiptarët besonin se gjyqet ndikohen më së shumti nga interesa monetare, lidhjet e biznesit, lidhjet personale të gjyqtarëve dhe konsiderata politike. Këto anketime, kanë treguar se shqiptarët besojnë se gjyqësori, është një ndër 3 (tri) institucionet që kanë kontributin më të vogël, në luftën kundër korrupsionit<sup>9</sup>.

“Në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit”, trajtohen disa çështje që lidhen me antikorrupsionin, të cilat përcaktojnë: a. Neni 5 (1) Çdo shtet duhet, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor, të zhvillojë dhe zbatojë, politikat përkatëse kundër korrupsionit, duke nxitur pjesëmarrjen e shoqërisë për një menaxhim efikas të punëve publike përmes integritetit, transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve; b. Neni 8 (1) Për të luftuar korrupsionin, çdo shtet duhet të promovojë integritet, ndershmëri dhe përgjegjshmëri tek zyrtarët e institucioneve, në përputhje me parimet themelore të sistemit ligjor. Në veçanti, çdo shtet duhet të përpiket të zbatojë, në institucionet publike, kodet ose standardet që përcaktojnë rregullat e sjelljes, për kryerjen në mënyrë të duhur dhe të ndershme të funksioneve publike.

#### 4.1 Çfarë kuptojmë me termin korrupsion?

Korrupsioni është një fenomen kompleks, po aq sa është i vjetër. Termi korrupsion rrjedh nga fjala latine “corruption”, që nënkupton “degradim moral”. Koncepti mbi korrupsionin përgjithësisht ndryshon sipas kontekstit, prandaj është e vështirë të përcaktohet një term i vetëm bashkëkohor, për shkak të dimensioneve të shumta të tij. Zakonisht në kontekstin publik, korrupsioni përkufizohet si një akt antiligjor, që lidhet me abuzimin e pushtetit dhe besimit publik për përfitime personale.

“Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara” (UNDP), e lidh korrupsionin me korrelacionin ndërmjet koncepteve të tilla, si: pushteti, përgjegjshmëria, liria e veprimit, integriteti dhe transparenca. Korrupsioni është një problem universal që afekton funksionimin e administratës publike dhe të drejtat e grupeve më vulnerabel të shoqërisë, në veçanti të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke përforcuar përjashtimin, diskriminimin dhe arbitraritetin. Ekzistojnë tri koncepte që trajtojnë mënyrën se si korrupsioni afekton të drejtave të njeriut: korrupsioni i drejtpërdrejtë, jo i drejtpërdrejtë dhe me ndikim të largët.<sup>10</sup>

Korrupsioni është një problem global. Në shumë raste kompleksiteti i korrupsionit në sektorë të ndryshëm, kërkon një analizë të thellë për të kuptuar më mirë shkaqet dhe pasojat, por edhe për të mësuar apo eksploruar zgjidhje të reja.

#### 4.2 Çfarë përbën një akt korruptiv?

“Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, kapitulli VIII, seksioni I, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit”, 235-247, dhe seksioni II, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë”, nenet 244, 245, 245/1, 248, e në vazhdim, deri në nenet 259 dhe 260, përcaktohet qartë se çfarë është korrupsioni, në çfarë formash shfaqet ai dhe si e përcakton ligji dënimin për këto vepra penale. Në tërësi, një akt korruptiv quhet i tillë kur realizohet në disa parakushte:

<sup>9</sup> “Instituti për Zhvillim Kërkime dhe Alternativa”, *Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe eksperiencia*, f. 22-24 (2009).

<sup>10</sup> UNDP United Nations Development Program, *Anti-Corruption Practice Note*, 2004.

Gjendet në: [http://www.undp.org/governance/docs/AC\\_PN\\_English.pdf](http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf) Udhëzues administrativ.



sjell përfitime materiale, monetare apo morale për persona të caktuar, që kanë lidhje me aktin korruptiv ose për një palë të dytë apo të tretë, që ndërvarët nga veprimi i kryer; favorizon një palë nëpërmjet diskriminimit, abuzimit, shfrytëzimit të një pale tjetër; kur kryhet me qëllim, duke planifikuar rrugën që do të ndiqet dhe pa mbajtur parasysh pasojat që do të sjellë, kemi të bëjmë me korrupsionin aktiv.

Personi apo personat veprojnë që ta nxisin apo që ta bëjnë të mundur aktin korruptiv; në rast të mosveprimit në përmbushjen e detyrave funksionale, detyrimeve ligjore dhe zbatimit të rregullores së institucionit kemi të bëjmë me korrupsionin pasiv. Në rast të moskallëzimit të aktit korruptiv, me apo pa arsye, quhet bashkëpunim në veprën penale të korrupsionit. Personi apo personat nuk veprojnë që ta ndalojnë apo pengojnë aktin korruptiv; shoqëria civile, sektori privat dhe media luajnë rol jetësor në këtë aspekt.

### 4.3 Format me të cilat shfaqet korrupsioni

Korrupsioni mund të shfaqet në shumë forma. Ai mund të jetë:

- I dukshëm ose i përditshëm dhe në këtë rast, duket në fenomenet e zakonshme të jetës, në veprimet transaksionale që kryejmë (shit-blerje, transferimi bankar i parave, depozitimi i të ardhurave etj.) dhe në dhënien ose jo, të prioritetit ndaj gjërave të caktuara.

- I fshehur ose në thellësi, dhe përfshin punën e politikanëve, zyrtarëve, që kanë të drejtë të ndërhyjnë në fondet publike. Këtu përfshihen edhe veprat e korrupsionit në nivelin e forcave të sigurisë, të cilat mund të cenojnë sigurinë ndërkombëtare.

- I padukshëm, që ka të bëjë me politikëbërjen, ose thënë ndryshe politikën që ndërmerren, por që nuk kryhen, me qëllim përfitimin monetar apo material. Në rastin e sistemit penitenciar, mund të themi se dy janë format kryesore të ndikimit të korrupsionit, në të drejtat e personave me liri të kufizuar: ndikimi i drejtpërdrejtë dhe ndikimi jo i drejtpërdrejtë. Korrupsioni me ndikim të drejtpërdrejtë, afekton të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke cenuar parimin e barazisë, paanshmërisë dhe mosdiskriminimit dhe duke privuar aksesin e tyre në këto të drejta. Qasjet teorike bashkëkohore mbi korrupsionin me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e personave me liri të kufizuar në sistemin penitenciar, mbështeten në dy aspekte kryesore organizative.<sup>11</sup> Sipas studiuesit Herman Golstein, këto qasje përpiqen të shpjegojnë arsyet e lindjes së korrupsionit në sistemin penitenciar.

- Një dimension i dytë i lidhur me korrupsionin në sistemin penitenciar, ka të bëjë me mekanizmat për parandalimin dhe kontrollin. Mekanizma të rëndësishme të parandalimit dhe kontrollit janë: edukimi dhe trajnimi mbi etikën, si dhe monitorimi dhe hetimi proaktiv e reagues i akteve korruptive. Sipas kësaj qasje, niveli i zbatimit të këtyre mekanizmave, ndikon ndjeshëm në nivelin e korrupsionit. Sipas studiuesve, ekziston edhe një dimension i tretë i korrupsionit në sistemin penitenciar, që ka të bëjë me ndikimin e faktorëve socialë, ekonomikë, politikë. Sipas kësaj qasje, prishmëritë e publikut mbi sjelljen dhe integritetin e punonjësve të sistemit penitenciar, luajnë rol në performancën e tyre. Besohet se në vendet ku ka presion të lartë të publikut kundër akteve korruptive, performanca e punonjësve të sistemit penitenciar është më pozitive, krahasuar me vendet ku presioni është i ulët<sup>12</sup>. Atëherë, me të drejtë lind pyetja: “Cilat janë ato elemente të cilat ndikojnë në rritjen e presionit të publikut kundër akteve

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:

“ Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë ”

<sup>11</sup> Aduagna Gebeye, B.: Corruption and Human Rights: Exploring the Relationships, 2012, f. 9. <http://www.du.edu/korbel/hrhë/ëorkingpapers/2012/70-gebeye-2012.pdf> Udhëzues administrativ

<sup>12</sup> Udhëzues administrativ1, Parandalimi dhe adresimi i korrupsionit në sistemin e burgjeve.

korruptive?”

Është e rëndësishme që të analizohen elemente të tillë si: kultura kombëtare, ndryshimet kulturore, format e sjelljes, stili dhe drejtimi i lidershipit, përfshirja e publikut në reformat e ndërmarra, dhe faktorë të tjerë, si edhe mënyra se si ndikojnë këta faktorë në rritjen e presionit të publikut kundër akteve korruptive, në vende të ndryshme dhe më konkretisht, në Shqipëri.

## 5. Përfundime

Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, i përbërë nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, shprehet se:

“Në kushtet e mungesës së një presioni të artikuluar nga publiku, të një marrëveshjeje të gjerë politike, si dhe nga mungesa e një tradite të pamjaftueshme demokratike të vendit, shumicat parlamentare dhe qeveritë e kohës janë mjaftuar me ndërhyrje të pjesshme e “kozmetike” në sistemin e drejtësisë, kryesisht të mbështetura vetëm me votat e shumicës.

Çështje më e keqja, vetë natyra e këtyre ndërhyrjeve, ka krijuar hapësira për politikën, që në ndonjë rast synojë kontrollin mbi qeverisjen e institucioneve të drejtësisë për parandalimin e rreziqeve që mund t’i vijnë politikës nga një drejtësi e pavarur. Politika nuk i ka shpëtuar tundimit për të ruajtur sa më shumë rol kontrollues në çështjet që kanë të bëjnë me emërimet, statusin, karrierën dhe disiplinimin e funksionarëve të drejtësisë, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe mbi sjelljen e tyre.

Mospërfshirja e publikut në reformat e ndërmarra deri tani në sistemin e drejtësisë, është një tjetër faktor, që ka minimizuar thellësinë dhe impaktin e tyre. Pavarësisht kompleksitetit të çështjeve që përfshihen nën konceptin “reformë në fushën e drejtësisë”, në thelb, qëllimi i këtyre reformave është forcimi i garancive, që gëzojnë personat privatë në marrëdhëniet mes tyre dhe, në marrëdhëniet me shtetin. Ndonëse ky është një motiv më se i vlefshëm për përfshirjen e opinionit publik në këtë proces, asnjëherë nuk janë bërë përpjekje për të ndërgjegjësuar publikun e gjerë, për përfitimet praktike nga reforma në drejtësi dhe, për të siguruar një platformë për pjesëmarrjen e tij efektive në procesin e reformave. Konsolidimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë është një element shumë i rëndësishëm. Ky element, i cili realizohet përmes luftës ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimin e vendit dhe, paralelisht me konsolidimin e qeverisjes së mirë, shërben si garanci e shtetit të së drejtës.

Mirëfunksionimi i sistemit të drejtësisë është një parakusht kryesor për mbarëvajtjen e sistemit tonë politik dhe ekonomik, si dhe, për mënyrën e jetesës së qytetarëve. Sistemi i drejtësisë, përbën themelin ku mbështetet shteti i së drejtës në një shoqëri demokratike.”<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, ngritur me vendimin nr. 96/2014, dt. 27. 11. 2014, qershor 2015.

## Referenca

1. Vendimi KM nr. 519, datë 20.7.2011 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të Planit të veprimit të saj".
2. Instituti për Kërkime mbi Alternativat e Zhvillimit, *Korrupsioni në Shqipëri, perceptime dhe eksperiencia*, Tiranë: 2009.
3. GRECO, *Raport vlerësimi për Shqipërinë nr. 4, 24 -27 qershor 2014*.  
<http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/news/News%2820140627%29Eval4Albani>.
4. Vendim i KM nr. 519, datë 20. 7. 2011 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj".
5. Nijazi Halili, *Çfarë do të kuptojmë me fjalën shtete të dobëta ose 'weak states'?*. Bota Sot, 28. 01. 2016.
6. Barack Obama, *Guximi për të shpresuar*, Tiranë: Dudaj.
7. Gjon Boriçi, *Pushteti & lidershipi*, Tiranë: Ufo Press, 2009.
8. Vendim i KM nr. 519, datë 20. 7. 2011, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe të planit të veprimit të saj".
9. UNDP United Nations Development Program, *Anti-Corruption Practice Note*, 2004.  
Gjendet në:  
[http://www.undp.org/governance/docs/AC\\_PN\\_English.pdf](http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf) Udhëzues administrativ.
10. Adugna Gebeye, B., *Corruption and Human Rights: Exploring the Relationships*, 2012. <http://www.du.edu/korbel/hrhë/ëorkingpapers/2012/70-gebeye-2012.pdf>
11. *Udhëzues administrativ*, Parandalimi dhe adresimi i korrupsionit në sistemin e burgjeve. Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, ngritur me vendimin nr. 96/2014, dt. 27. 11. 2014, qershor 2015.

# Sfidat dhe mundësitë, në epokën e re të optimizimit të reformave kërkimore, në shkencat ligjore

— MSc. Valeria BARDHAJ

Drejtorja e Policisë së Shtetit  
valeria.bardhaj@asp.gov.al

## Abstrakt

*Përmes këtij punimi, synohet vënia në fokus e dimensioneve të shkencave ligjore, nga ku, globalizmi ka sjellë evolucion të vazhdueshëm në mënyrën e zbatimit të praktikave të tyre. Zhvillimet e shkencave ligjore në shekullin e XXI-të, po krijojnë mundësi të reja për të kryer ekspertiza të gjurmëve të krimit, direkt në skenën e krimit. Përfitimet e hetimeve në kohë reale nga terreni, për shkencën forenzike, janë të mëdha dhe, kjo teknologji, ka potencial për të rritur fuqishëm shpejtësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë ligjore. Shkencat ligjore, lidhen drejtpërdrejtë me metodat shkencore që aplikohen në shërbim të drejtësisë, për ekzaminimin e provave të krimit dhe identifikimin e autorit të veprës penale. Përparimet e shekullit të njëzetë u ndërtuan kryesisht mbi bazat e hedhura në shekullin e nëntëmbëdhjetë, duke përmirësuar teknikat në analizën dhe ruajtjen e provave. Prej viteve '70, ka pasur disa ndryshime të rëndësishme sociale, ligjore dhe shkencore, në sistemin e drejtësisë dhe shkencat e mjekësisë ligjore, të cilat kanë ndryshuar në mënyrë drastike konceptet dhe kornizat e shkencave ligjore. Përmendim këtu, ADN-në, si zbulimi më i madh shkencor i mjekësisë ligjore në shekullin e kaluar, por ka pasur edhe disa ndryshime të tjera kryesore, që kanë ardhur si pasojë e vendimeve të sistemit gjyqësor, të cilat kanë ndryshuar mënyrën se si gjykatat vlerësojnë dhe pranojnë dëshmitë shkencore. Sot, fusha e shkencës forenzike, me të gjitha ndryshimet e vazhdueshme që ka pësuar falë përparimeve në teknologji, u ka mundësuar ekspertëve të fushës, një analizë më të mirë e një qartësim të parimeve shkencore në të gjitha llojet e provave. Shkencat ligjore në shekullin e XXI-të, janë njohur si përbërës kritikë në zbatimin e ligjit dhe zgjidhjen e krimeve, madje ndërlidhja e shkencës dhe teknologjisë i ka mundësuar policisë, që të zgjidhë shumë krime që dikur do të ishin konsideruar si të pazgjidhshme.*

AKADEMIA  
E SIGURISË

Konferencë  
shkencore  
ndërkombëtare:  
« Shkencat  
ligjore  
dhe sfidat  
bashkëkohore  
të sigurisë »

## Fjalëkyçe:

**shkencat ligjore, forenzika, kriminaliteti, skenë krimi, sistem gjyqësor.**

## 1. Hyrje

Shkencat ligjore përgjithësisht përshkruhen si aplikimi i shkencave natyrore në çështjet e ligjit. Shkenca forenzike është unike, duke përfshirë shumë fusha të ndryshme të studimit të ligjit dhe përmban disa nënspecialitete, të cilat ndërveprojnë me zbatimin e ligjit dhe sistemin ligjor. Origjina e kriminalistikës apo shkencave ligjore, është kryesisht evropiane. Shkencat ligjore vijnë nga disiplina të ndryshme, të tilla si gjeologjia, fizika, kimia, biologjia apo matematika, të cilat janë bazike për të studiuar provat fizike që lidhen me krimin. Qëllimi dhe rëndësia e shkencave ligjore, rritet çdo ditë kur zbulohen teknologji të reja dhe se si shoqëria jonë bëhet më e varur nga sistemi gjyqësor, për të zgjidhur mosmarrëveshjet.<sup>1</sup>

Historia shkruan, se gjurmët e para të përdorimit të shkencave ligjore, janë shfaqur që në sundimin e Perandorisë Romake, ku mjeku romak Antistius shqyrtoi trupin e Julius Cezarit, duke përcaktuar se, edhe pse perandori u godit me thikë 23 herë, vetëm një plagë përmes gjoksit shkaktoi i vdekjen. Bazat e shkencave ligjore, datojnë mijëra vjet më parë, ku gjurmët e gishtërinjve ishin një prej aplikimeve të para. Në vitin 1892, një eugenist (përkrahës i sistemit të paragjykuar të klasifikimit shkencor) i quajtur Francis Galton, krijoi sistemin e parë për klasifikimin e gjurmëve të gishtave. Më pas, Edëard Henry, komisioner i Policisë Metropolitane të Londrës, zhvilloi sistemin e Galton, në 1896, bazuar në drejtimin, rrjedhën, modelin dhe karakteristikat e tjera të shenjave të gishtërinjve. Sistemi i klasifikimit “Henry” u bë standard për teknikat kriminale të gjurmëve të gishtërinjve në mbarë botën.

<sup>1</sup> Suzanne Bell, *Encyclopedia of Forensic Science*, Revised Edition.

Ndërsa në vitin 1835, Henry Goddard (ekspert i Shërbimit Policor Metropolitan, forca territoriale policore përgjegjëse për policimin në Londër) ishte personi i parë që përdorte analizën fizike, për të lidhur plumbin me armën me të cilën ishte kryer krimi. Ekzaminimi i plumbave u bë më i saktë në vitet 1920, kur mjeku amerikan Calvin Goddard, krijoi mikroskopin e krahasimit për të ndihmuar në përcaktimin e mbetjeve të plumbave në një skenë krimi.

Me të gjitha teknikat e reja të forenzikës, që dalin më në pah në fillim të shekullit të 20-të, zbatimi i ligjit zbuloi se kishte nevojë, për një ekip të specializuar për të analizuar provat e gjetura në skenat e krimit. Për këtë qëllim, Edmond Locard, një profesor në Universitetin e Lionit, ngriti laboratorin e parë të krimit policor në Francë, në vitin 1910. Për punën e tij novatore në kriminologji forenzike, Locard u bë i njohur si “Sherlock Holmes i Francës”. Të gjitha skenat e krimit, janë këqyruar në bazë të parimit të këmbimit të Locard.

August Vollmer, shefi i Policisë së Los Anxhelosit, krijoi laboratorin e parë amerikan të krimit të policisë në vitin 1924.

Në vitet 1970, një ekip shkencëtarësh në “Korporatën e hapësirës”, në Kaliforni, zhvilluan një metodë për zbulimin e mbetjeve të armëve, duke përdorur mikroskopin elektronik të skanimit. Në fund të shekullit të 20-të, shkencëtarët e mjekësisë ligjore kishin një mori mjetesh të teknologjisë së lartë për të analizuar provat, që nga reaksioni i zinxhirit polimerazë (PCR) për analizën e ADN-së, e deri tek teknikat digjitale të gishtave, me aftësi kërkimi në kompjuter.

## 2. Dimensionet e shkencave ligjore dhe hetimi i skenave të krimit

Dëshira për të zhvilluar një model, për vazhdimin e zbulimeve shkencore dhe metodologjisë, ka qenë një luftë e vazhdueshme, që nga periudha shumë e hershme e të menduarit modern shkencor, në Anglinë e shekullit të 17-të. Për sa më sipër, francezi Edmond Locard, ishte ai që hodhi bazat dhe krijoi laboratorin e parë mjekoligjor, në Lyon, në vitin 1910. Të gjitha skenat e krimit janë kontrolluar në bazë të parimit të këmbimit të Locard, i cili pohon se, kur autorët vijnë në kontakt me skenën, ata do të lënë diçka nga vetja dhe do të heqin diçka nga vendi i ngjarjes, për shembull, flokët dhe fijet.<sup>2</sup> Shkencat mjekoligjore janë të lidhura tradicionalisht me ndjekjen e gjurmëve të krimit, gjë që mund të lejojë shqyrtime metodologjike të gjera, në përputhje me rrethanat e ngjarjes, informacione këto, që kërkohen në shkallë të ndryshme nga gjykatat penale.

Rëndësia e informacionit të gjeneruar nga teknikat dhe metodat e shkencave ligjore, mbështetet më së shumti, tek provat e mundshme që autoritetet policore kanë evidentuar në një skenë krimi, si dhe tek mbledhja e ruajtja e këtyre provave përpara analizës laboratorike. Nëse materiali i gjetur në skenën e krimit nuk ruhet dhe nuk mblidhet me kujdes, pra pa u dëmtuar, analiza e provave të forenzikës është e pavlefshme.

Nga ky fakt, kuptohet fare qartë nevoja e madhe për trajnime të vazhdueshme për të gjithë ekspertët e fushës, veçanërisht në lidhje me procedurat themelore për analizimin dhe mbledhjen e provave në skenën e krimit. Në mbarë botën, ku fusha e shkencave ligjore është zhvilluar së tepërmi, veçanërisht lidhur me zhvillimet teknologjike,

<sup>2</sup> Charles R. Swanson, et al., *The Evolution of Criminal Investigation and Forensic Science*, McGraw-Hill, 2003.

laboratorike janë hapur shkolla të mjekësisë ligjore për të specializuar individë të fushës, në lidhje me mbledhjen dhe shqyrtimin e provave të rëndësishme për studimet forenzike, mbi procedurën penale kushtetuese, teorinë e kodit penal, ligjin e provave etj.

Rëndësia e shkencave ligjore në kodin penal, qëndron në forcën e tij, për të siguruar prova të forta, të cilat mund të pranohen si dëshmi në një proces gjyqësor dhe për mënyrën se si është kryer një krim e se kush e ka kryer atë. Vlerësimi i skenës lejon zhvillimin e një plani për identifikimin, grumbullimin dhe ruajtjen e koordinuar të dëshmimeve fizike dhe identifikimin e dëshmitarëve.<sup>3</sup>

### 3. Mbledhja dhe ruajtja e provave fizike në një skenë krimi

#### 3.1 Ekzaminimi i fijeve të flokut dhe fibrave

Rëndësia e ekzaminimit të fijeve të flokut për shkencat forenzike është vlerësuar për më shumë se një shekull me raste që përfshijnë ekzaminimin mikroskopik të flokëve, të cilat raportohen në mesin e viteve 1800. Themeluesit e kësaj fushe që njihen si, Victor Balthazard dhe Paul Kirk, kuptuan rëndësinë e provave të flokëve dhe shkruan për to.

Analiza e fijeve të flokut është e lidhur ngushtë me analizën e fibrave, duke çuar në përdorimin e zakonshëm të shprehjes “*qime dhe fibra*”. Flokët janë një fibër shtazore e karakterizuar nga një kutikulë me luspa, lehtësisht e dallueshme kur shihet në mikroskop. Analiza është kryesisht e përqendruar tek ekzaminimi i ngushtë i mostrës së flokëve, duke përdorur teknologjinë moderne të mikroskopit, ekzaminim që përdoret për të përcaktuar llojin dhe kategorinë e mostrës së flokëve. Pra nëpërmjet ekzaminimit, përcaktohet nëse janë fije floku të njeriut apo të kafshëve, si dhe të përpiqet të krijojë një origjinë të përbashkët midis mostrave të njohura dhe të rikuperuara në një çështje penale.

Kohët e fundit, përveç analizës së fijeve të flokut me anë të mikroskopit, po përdoret edhe një teknologji e re, duke hetuar e përdorur metodologjinë e ADN-së, në rastet e pranisë së qelizave adekuate të rrënjëve të flokëve.<sup>4</sup> Në të shumtën e rasteve, një material i nevojshëm për këtë lloj ekzaminimi, nuk është i disponueshëm. Megjithatë, analiza e flokëve përdoret gjerësisht në ndjekjet penale për qëllime të grumbullimit të gjurmëve hetimore dhe/ose fakteve materiale për përdorim në gjykim.<sup>5</sup> Analiza kimike e flokëve, mund të përdoret në disa raste për të zbuluar shkaqet e vërteta të një krimi/hetimi. Për shembull, analiza e flokëve, ka çuar në spekulime se Napolon Bonaparti nuk vdiq nga kanceri i stomakut, por nga helmimi arsenik.

Ky përfundim u arrit nga fakti se një pjesë e asaj çka konsumojmë, depozitohet në flokë dhe kështu, ekspertët mund të sigurojnë një provë të rëndësishme nëpërmjet ekzaminimit të fijeve të flokëve. Megjithatë, përpjekjet për të përdorur nënshkrimet kimike të flokëve si një mjet për ta individualizuar atë, nuk janë përmëshur me sukses.

#### 3.2 Gjurmët e gishtave dhe ADN-ja

Në vitin 1858, administratori i kompanisë së Indisë Lindore, Sir John Herschel, u

<sup>3</sup> National Forensic Science Technology Center (NFSTC), *Crime scene investigation, A Guide for Law Enforcement*, U. S. Department of Justice, National Institute of Justice, Office of Justice Programs, 2009.

<sup>4</sup> W. Bruschweiler, M. C. Grieve, “State of the Art in the Field of Hair and Textile Fibre Examinations”. Në, *Proceedings of the 12th INTERPOL Forensic Science Symposium*, (New York, 1998), f. 179-180.

<sup>5</sup> Kiely, Terrence F., *Forensic evidence : science and the criminal law*, CRC Press LLC, 2001.

përball me një problem të madh në kompaninë e tij. Shumë punonjës të kompanisë, përiqeshin të hiqeshin si një person tjetër me qëllim mashtrimin. Për ta ndaluar këtë fenomen, ai përshtati traditat e lashta dhe filloi të përdorë shenjat e dorës si një formë identifikimi në dokumente. Më 1877 u përdor e njëta procedurë për të ndihmuar në identifikimin e të burgosurve. Më pas në vitin 1880, Henry Fauld, mjek skocez, botoi një artikull në një revistë shkencore, në lidhje me identifikimin e kriminelëve bazuar në veçantinë e gjurmëve të gishtërinjve. Në SHBA, në vitin 1915, u formua shoqëria e parë profesionale në fushën e gjurmëve të gishtave, ndërsa në vitin 1924, u krijua në Byronë e Hetimeve një departament identifikimi, paraardhësi i FBI-së.

Gjurmët e gishtave, janë konsideruar prej kohësh si shtyllë e identifikimit të forenzikës, madje edhe në epokën e ADN-së. Meqenëse shenjat e gishtërinjve janë unike për individin, supozohet se një krahasim midis një gjurme të dyshuar me një gjurmë tjetër, është i mjaftueshëm për të individualizuar provat dhe për t'i lidhur ato me një burim të përbashkët.<sup>6</sup> Gjykatat kanë pranuar prova të gishtave për gati një shekull, por ekziston një dallim i rëndësishëm midis pranimi gjyqësor dhe pranimi shkencor. Pranimi shkencor, ndjek metodën shkencore dhe përfshin eksperimentimin, vëzhgimin, rishikimin dhe vlerësimin.

Për shembull, pranimi shkencor i printimit të ADN-së, ka ndodhur së pari në fushën e biologjisë molekulare, biokimisë dhe fushave të ngjashme. Nga ana tjetër, pranimi gjyqësor ndodh në gjykatë, në një mjedis kundërshtar, jo në atë shkencor. Kjo gjë, ndodh për shkak se gjurmët e gishtave u pranuan, përpara se të përcaktoheshin rregullat moderne për pranimin gjyqësor të provave shkencore.<sup>7</sup>

Për sa i përket AND-së, qartësojmë se pasi u zbulua *Acid deoxyribonucleic* (ADN-ja) në vitin 1868, shkencëtarët ecën me hapa të ngadaltë drejt kuptimit të rolit të saj në trashëgiminë e gjeneve. Në fillim të viteve 1950, James Watson dhe Francis Crick konkluduan strukturën e ADN-së, duke sjellë epokën e re të studimit të gjenetikës. Zhvillime të tilla, ishin në dukje, të interesit periferik për shkencëtarët mjekoligjorë.

Në vitin 1985, kur hulumtimi mbi strukturën e gjenit njerëzor nga Alec Jeffreys dhe kolegët e tij në Universitetin Leicester të Anglisë, çuan në zbulimin se pjesët e strukturës së ADN-së të disa gjeneve, mund të jenë po aq unike për individët, sa ç'janë edhe gjurmët e tyre. Sipas Jeffreys, shansi i dy personave që kanë modele identike të ADN-së është të paktën një në 5.5 miliardë.

Analiza e ADN-së, ofron aftësi që nuk gjenden në shumicën e disiplinave të tjera të forenzikës. Kur materiali biologjik transferohet në mes të dhunuesit dhe viktimës në krime të dhunshme të tilla si vrasja dhe përdhunimi, ADN-ja e rikuperuar nga vendi i ngjarjes ka fuqinë për të identifikuar potencialisht kryerësin e veprës penale. Teorikisht, kur testohen shënues të mjaftueshëm gjenetikë, "individualizimi" probabilistik i një profili të ADN-së, është statistikisht i arritshëm veç te binjakët identikë - madje edhe binjakët, nganjëherë mund të ndahen me informacione shtesë gjenetike<sup>8</sup>

Rritja e vazhdueshme, në përmasa të bazës së të dhënave të ADN-së për forenzikën ngre çështje mbi kriteret e përfshirjes, mbajtjes dhe mbi dyshimet për efikasitetin, shkallën e ndërgjegjësimit dhe shkeljen e privatësisë në ruajtjen e këtyre të dhënave personale. Në kontrast me të kaluarën, jo vetëm krimet e rënda, por të gjitha krimet janë subjekt

<sup>6</sup> Suzanne Bell, *Encyclopedia of forensic science, Rev. ed.*, Library of Congress Cataloging in Publication Data, f. 150.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Weber Lehmann J, Beta I., *Finding the needle in the haystack: differentiating 'identical' twins in paternity testing and forensics by ultra-deep next generation sequencing*. Forensic Sci. Int., 2014.



i analizës së ADN-së, e cila gjeneron miliona profile, shumë prej të cilave ruhen dhe kontrollohen vazhdimisht në bazat e të dhënave të ADN-së kombëtare. Interpretimi statistikor i ADN-së, mbështetet në themele të forta shkencor, ku shumica e tyre, erdhi fillimisht nga përpjekjet akademike jashtë arenës së mjekësisë ligjore.

Komuniteti i mjekësisë ligjore është duke u përbërur me pyetjen se, në cilin drejtim do të zhvillohet teknologjia e ADN-së. Një numër i madh ekspertësh, janë të bindur se sekuenca e ADN-së së shpejti do të zëvendësojë metodat e bazuara në analizën e gjatësisë së fragmenteve dhe, ka argumente e zhvillime pozitive në këtë drejtim. Me zhvillimin e teknologjive aktuale të gjenerimit të ardhshëm (NGS), baza e të dhënave të dobishme për forenzinë, potencialisht, mund të zgjerohet dhe analizohet shpejt dhe me kosto të efektshme.

